

Resul BÉDO

BIRBILENJTE

Roman

BIBLIOTEKA

85H-31

B 36



35H-31
B 36

Resul BEDO

Birbilenjtë

Roman



5746P

G.M.R.

Tiranë, 1995

Dy fjalë

1. Një ditë në Janinë

Kur e shikon Janinën e ngritur në atë kodër në anë të Liqenit të duket e përngjajshme me qytetet e tjera të Shqipërisë Jugore. Janina e hershme ruan gjurmë të historisë së saj: Kalanë e ngarkuar dikur me 500 topa të Ushtrisë të Vezir Aliut. Janina qyteti më i madh i asaj kohe që i kalonte të 50 mijë banorët.

Janina ... Sa shumë mund të flasësh për Janinën...

Më duhet të eci mbi bedenat e kalasë për të shikuar birucën ku u mbyllën Birbilenjtë. Më duhet të endem kalldrëmeve të ngushtë nga i kaluan Birbilenjtë kur ushtynë në thellësi të bodrumeve të kalasë dhe kur i përcollën te Rrapi i madh.

Janina! Sa shumë mund të flasësh për Janinën.

Kërkoj gjurmën e vendit të rrapit ku u varën Birbilenjtë dhe legjendën, se trembëdhjet degët e rrapit ku u varën Ata, u thanë. Vetë rrapit i madh i Janinës u shndërrua në rrap të kokalltë.

Kërkoj të bie në gjurmë të themeleve të Hotelit të madh të bashkëfshatarit tim, Nexhip Bedena nga Zhulati. Kërkoj të gjej gjurmët e 13 varreve të Birbilenjve, të bie në gjurmë të atij dervishit zemërmirë, që deri vonë i ruante varret e Birbilenjve, i lyente gurën me gëlqerë të bardhë. Koha ka fshirë shumë gjurmë. Po Birbilenjtë ende përmenden për të bëmat e mirë nga shqiptarë dhe nga grekër. Njeriu i mirë është i pavdekshëm për njerëzit. Dhe u këndohet Birbilenjve edhe nga grekërit, ashtu siç i këndojnë shqiptarët Koçandonit, heroit grek të varur në të njëjtin rrap në Janinë.

2. Këngët e Birbilenjve

Nga vegjëlja i mbaj mend këngët e Birbilenjve. Ndjeja të lëvizte në shpirtin tim dhimbje e trimëri. Mënyra si i këndonin të

moshuarit këngët e Birbilenjve të mbushte me respekt për Birbilenjtë, në veçanti për komandantin e çetës së kaçakëve, Birbilin. Cikli i këngëve të Birbilenjve është përfshirë në libra të hershëm si "Bleta Shqiptare". Këngët e Birbilenjve gjenden në çdo botim folklorik me përmasa kombëtare, ato ia përcjell brezi brezit, prandaj mbijetuan mbi një shekull e gjysëm dhe si duket nuk do të shuhen asnjëherë.

Me një përkujdesje të vazhdueshme e të hershme munda t'i mbledh këngët e Birbilenjve. Mblodha toponime vendesh si "Shpella e Birbilenjve" në Tërbaç të Vlorës, "Sheshi i Birbilenjve" në malin e Dragonit në afërsi të Delvinës, "Shtegu i Birbilenjve", "Lisi i Birbilenjve", "Çoçko", shpella e fundit ku qëndruan Birbilenjtë. Qysh herët, në moshë të re, takova të moshuar që ishin më afër të vërtetës për ato që fliteshin e thuheshin për Birbilenjtë, në veçanti për trembëdhjetë Birbilenjtë e varur në Janinë, mandej mu desh të hulumtoja materiale të tjera, në veçanti të përcaktoja i mbështetur në dokumenta kohën kur jetuan dhe vepruan Birbilenjtë. Dokumenti i gjetur në Kishën e Çatistës në Pogon e quaj si dokument me vlerë të veçantë. Mandej mu desh të shkel në vendet ku ata vepruan dhe kur u binda se mund të ndriçoja jetën, bëmat e këtyre kaçakëve të pagjunjësuar dhe të nderuar e të respektuar, shkrova librin "BIRBILENJTE".

I

1.

“Detit i ka hije vala, Trimit i ka hije Palla”

Një zog sillet mbi shkrepat e honet e thella. Më në fund, me krahë të hapur zogu qëndron pezull përballë erës, në një qëndrim të palëzivshëm. Ja ashtu si zogu edhe fshati më i vogël i Kurveleshit, Rexhini, qëndron majë shkëmbit, përballë degëzimeve të honeve të thella. Ku mbaron njëri nga këto degëzime hedhin themelet nga lashtësia shtëpitë e Rexhinit.

Në mëndjen e udhëtarit të huaj që kalon kësaj ane është e vështirë të ngulitet emri i fshatit të vogël, ngjitur me fshatin e madh, Nivicën. I madhi, si broka e madhe, bënte zhurmë e kishte zë në kasabatë e afërta e dëgjohej gjer në kryeqendrën e Vilajetit, Janinën, kurse i vogli, Rexhini, edhe pse ishte i vendosur në një breg mbi fshatin e madh, dëgjohej pak. Ai ishte fshati që s'bënte përpjetë, një dorë shtëpi, me themelet të mbërthyer në shkrepin majë shkëmbit. Kur frynte në këto anë era e marrë e honeve të thella mbyteshin frymët e gjalla po s'luanin nga vëndi shtëpitë e gurit. Ato ishin ngjitur me shkëmbin, ishin bërë pjesë e tij, si kalaja e lashtë.

Historia e fshatit të vogël dhe fshatit të madh, është historia e vëllait të madh me vëllanë e vogël. Ata jetonin pranë e pranë. Pikëzat e shiut të strehëve të shtëpisë të njerit binin mbi shtëpinë e tjetrit. Këto qëndronin mbi një shkëmb me një kala të përbashkët ndërtuar në kohën e fisit ilir të Kaonëve.

Trima si Hodo Nivica kishte nxjerrë fshati i madh, trima e dijetarë, njerëz të penës kishte nxjerrë edhe fshati i vogël, veçohej ndër ta imāmi kryengritës Budo Bredhi që në Qafën e Peshkëpisë, në luftë me Osmanët që veçuar për trimëri mbi gjithë luftëtarët e

kryengritjes të Balil Nezhës¹, Budo Bredhit i kishin venë këngë se gjalli. Ky ishte një përjashtim. Këngë së gjalli nuk i qenë nxjerrë as Hodo Nivicës e Gjolekë Kuçit, kurse imamit Budo i këndoheshin të bëmat. "Eshtë burrë me shënja Budua ynë" - thoshnin Rexhinasi. Kur dëgjonte Budua thoshte: "Ç'kam qënë unë në atë përleshje para Bilbilit të Shake? Një hiç kam qënë."

Ai, fshati i vogël me pak shtëpi, në njërën anë, në veri ka si një vijë kufiri me fshatin tjetër pikëzat e strehëve të shtëpivë, kurse në krahun tjetër, nga jugë lindja është përroi i thellë i Lekës, me shtrat guri. Buzë këtij shkëmbi ngrihet Saraji i ri i Shake.

Shtëpia e Shakajve, ishte rrafsh me shkëmbin e Përroit të Lekës, dhe shihej dy herë më e lartë nga ç' ishte. Kur delje në sofanë e saj të bëhej se të përpinte humnera. Ajo shtëpi dukej si e shkrirë në një të vetme me shkëmbin. Njerëzit e quajtën atë Saraji i Shake. Thuhej ashtu se kishte ngjashmëri me saraje të Ergjërës dhe nuk kishte dhe një shtëpi tjetër si ajo as në Rexhin e as në fshatrat e tjera rreth, veç sarajeve të Hodo Nivicës në Nivicë dhe Totajve në Progonat.

Shtëpi e Shake u ndërtua në vitin tridhjetë, tetë vite pas gjunjëzimit të Ali Tepelenës, kur në këtë shtëpi erdhi nuse një vajzë e bukur, plot shëndet, nga fshati me lartësi më të madhe në krahinë. Golemi, fshat që përmendet për shëndetin, klimën dhe ujin. Nusja ishte e bardhë si borë. Shtatin e saj belongjë, tumanet shkëlqenjese, këmisha cipë gjarpëri, mandilja me lule dhe brezi i mëndafshë i nusërisë, ia vinin Sorkës të Golemit më në pah bukurinë. Kur flitej për nusen, në fshat e rreth thuhej:

Ta kemi të bukur si Sorkën e Golemit që erdhi nuse në Shakaj. Punëtore si Sorka ... Këngëtare si Sorka ... Sorka, si mushkë drenjë, punëtore si ajo, ia zgjodhi gurin shtëpisë nga honi i thellë. Te shpella me Qiell i mori qoshet për portën. I shoqi i saj, Birbili, i pruri ustallarët nga larg, mjeshtër të gdhendjes të gurit e kjo i dha pamje të veçantë sarajit të Shake. Fare pranë kësaj shtëpie ishin dy gurë të prerë sa sepetet e nuseve, shenjë kjo që fliteshin fjalë e legjenda për nuset që kishin ardhur në Shakaj. Po Sorka e Golemit përmendej veç të tjerave. Kot s' thuhej në Labëri "mushkën prej vëndit e gruan prej Golemit".

1) Balil Nezha udhëhoqi kryengritjen e vitit 1833 kundër Osmanëve. Kryengritësit u ndeshën me ushtrinë Osmane në Qafën e Peshkëpisë në afërsi të Libohovës.

Në shkëmbin ku jetonin: Shakajt kishin folenë edhe thëllëzat. Ligjëronte të shkëmbi thëllëza, ligjëronte edhe nusja e bukur. Kur këndonte Sorka e bukur e Golemit njerëzit vinin veshin në përgjithësi të dëgjonin. Zë më i bukur nuk ishte dëgjuar në ato anë.

“Ajo ligjëronte si thëllëzat e shkëmbit” - thanë njerëzit për Sorkën. Dy vite më vonë, kur Sorkës iu vra i shoqi, në kryengritjen e Balil Nezhës, Rexhinasit folën të tjera fjalë:

- Turqit ia vranë Sorkës këngën në buzë.

- Turqit e detyruan në jetë të jetëve Sorkën e bukur të vishet me të zeza.

- Turqit e ...

Nga viti tridhjetë ajo veshi rrobën e zezë për të shoqin që u vra në Qafën e Peshkëpisë me kryengritësit e Balil Nezhës. Njerëzit menduan se shtëpia në shkëmb u vithis, e përpiu humnera. U vinte keq.

Plumbi i Osmanllinjve që i vrau të zotin i thau rrënjën e jetës kullës në gërxh, - thanë Rexhinasit, kur mësuan që u vra Birbili, por Sorka qëndroi aty, te saraji në shkëmb, vajtoi të shoqin e priti fëmijën. Rexhinasit menduan se ligjërimi i nuses së re një ditë do të pushonte, Sorka e Golemit, gruaja e bukur shtathedhur i preu flokët për burrin dhe preu edhe këngën. Njerëzit u morën me fjalë:

- Do të thahet e vyshket si pisha e madhe në Llukë që e dogji rrufeja. Atë pishë në mal, te stani i Shake, ashtu e mbanin mënd më të moçmit, qëndronte më këmbë pa fletë e degë, por e kokalltë, s'kishte teh sopate që mund ta priste. Nuk ishte zakon që gruaja të priste flokët për burrin, po Sorka si Sorka, atë që i shkrepte e bënte ose pëllciste. Ajo krenohej që i shoqi i saj, Birbili ishte prerë me pallë me ushtarët osmanë. Jo, ajo s' do ta harronte kurrë të shoqin.

“Ikën shpejt helmi nga zemra e nuses së re” - u tha.

Dhe në të dy fshatrat u ndezën thashethemet: “Më është si pelë ergjele që turfullon nëpër livadhet e Llukës, ka sy mëshqerrë e bukurinë e luleve të Këndrevicës, të pret syri i saj, s'ka mashkull që i qëndron verbimit të syve të Sorkës.” Ajo e bëri veshin të shurdhër, e vajtonte të shoqin me ligje. Thuhej në Kurvelesh se kur Sorka qante trimat që u vranë me Balil Nezhën, lotojnë lisat. Kushdo që vritej në luftë me të huajin thirrej Sorka ti këndonte trimërinë në këngë. Po këngët e Sorkës për Balilin e Nezhë dhe imamin Budo Bredhi veçoheshin nga të tjerat. Thanë Kurveleshasit: “Kënga e lartësosi

Budo Bredhin më tepër se jatagani. Thoshnin në Labëri: "Budo Bredhi është imam me mend dhe burrë me zemër".

Shtatë muaj mbas vrasjes së burrit Sorkës i lindi djali. Ajo i vuri të birit emrin e babait të vranë Birbil dhe i derdhi të birit bashkë me qumështin në buzë trimëri në zemër e në mendje. Kur i murmëriste të birit, kojshitë dëgjonin teshun e pallës dhe krismën e pushkës. Ajo delte me djalin e shoqet i flisnin:

- Ç'është ky moj korbë, dy herë më i madh nga mosha që ka?

Sorka gëzohej. Birbili i vogël që kur kish rënë në tokë nga shtrati i saj e vunë në peshë dhe zigji theu gjashtë okë.

- Për marshallah - thanë Rexhinasi e Niviciotët kur e panë fëmijën - E gëzofitë emrin e babës dhe i vunë nën jastëkun e djepit jataganin e të etit.

- Kot nuk thuhet "zgjidhe nusen se ta bije në prehër" - flisnin njerëzit. Golemtë prunë për nipin djepin e punuar nga mjeshtrit e Janinës. Sorkës i brofi zemra nga gëzimi kur mësoi se imami Budo Bredhi shkroi me dorën e tij te harku i djepit:

"Të preftë jatagani mbi hasmin si Babës tënd".

"Të dashtë zemra dheun e Arbërit si Babës tënd".

Djali që lindi i hovte shëndeti. - I ngjante babës, u thoshte me mburrje Sorka shoqeve. Burrit të saj, Birbilit në luftën e Peshkëpisë i qenë hedhur sipër shtatë zebeke¹ e dot s'e vunë nën këmbë ... Sorka i vuri djalit emrin e të shoqit, Birbil. Ajo donte që djali t'i ngjante babës jo vetëm në shtat e në pallë, por edhe në të bëma e në këngë, të ligjëronte si bilbilat në pllajat e Këbuzit e në Këndrevicë që s'e prejnte kurrë këngën, të mos hiqte asnjë herë pallën nga dora, si i ati. Birbil të bëhet në këngë e me pallë, si i ati - thoshte.

Në ceremoninë e vajit është rregull që i largojnë të vegjëlit, sepse fjalët e grave vajtoresh e në veçanti të Sorkës, bënin të lotonin gurët e jo njeriu. Kurse Sorka e mbante djalin e saj me vete.

- Hiqe djalin - i thonin shoqet, - e lëndon në zëmër për Babanë e vranë, - është mirë ta largosh motër-o, e ke djalë të vetëm.

- Ta largoj?! E përse? - ndizej Sorka e Golemit me zemërim e

1) Emër krahine diku në afërsi të Anadollit - sinonim i emrit Osman. Lexuesi do ta ndesh shpesh herë emrin zebek në vend të fjalës osmanlli, sepse nga zebekët përbëheshin forcat kryesore të osmanëve që vepronin në ato vite në Vilajetin e Janinës.

turfullonte si mushkë krraçe.

- I lëndohet zemra jetimit moj korbë, nuk ia lëshon i madhi tengën që e mundon të voglin se dhimbja e bluan të voglin me mish e kockë.

- Oh, duron njeriu, duron e s'plas si guri.

- Është ende i vogël djali, ruaje djalin, Sorkë! Të duam të mirën, moj Sorkë, që të flasim.

- Ose të bëhet trim për shpatë, o më mirë nën dhe se mbi dhe, - gjegjej Sorka dhe e shikonte në sy të birin. Ata sy i bulonin në zemër njomësinë e syve të të vogëlit dhe bukurinë e syve të burrit të saj të vrarë. Një Birbil kishte vdekur e prerë nga palla dhe një tjetër kishte lindur. Domodeku i nënës - i fliste Sorka të birit dhe e ledhatonte. Dhe çdo herë nuk harronte t'i thoshte: "T'u qëndrosh zebekëve si i qëndron lisi erës."

Sorka e Golemit ishte grua e prerë në ato që thoshte. Djali, më shumë se kushdo tjetër, ia njihte vetitë të jëmës. Edhe kur i bindej, ai qe gati të gërvishte, si ato macet e egra të Llufës. Golemsja krasiste ç`nuk duheshin dhe linte të rriteshin te djali lastarët, që pa to jeta e labit majë shkrepit mbetej pa asnjë kuptim.

"I ke prerë kokën Babës tënd - murmëriste. Lum nëna për ty or bir", dhe e thithte me afsh në gjji. Ajo e kuptonte që një Birbil kishte rënë dhe një tjetër po rritej.

Ja, atë lisi që dogji rrufeja në mal te stani i Shake ia zuri vendin një lastar i hollë, po i papërkulur, që gjithnjë harbonte përpjetë sikur don të arrijë majën e malit. Edhe djali i saj, ashtu si ai lastar, po lëshonte shtat, po rritej. Po a do të bëhej ai si b çai? Lastari i lisit dhe djali shkonin krahas.

Birbili që u vra ishte çoban i rritur në Këndrevicë, kishte pirë qumësht deleje e ujë bore. Çobani në Këndrevicë rritet me shëndet që e kanë lakmi të tjerët. Në luftën e Peshkëpisë iu hodhën sipër shtatë zebekë e dot nuk e vunë poshtë.

Djali vinte shëndet të mbarë, po Sorka nuk e besonte t'ia arrinte babës. Birbili i Shake, i shoqi, ishte si një bredh shullëri. Edhe Sorka e Golemit matej me një pishë mali. Ajo e donte të birin, të fortë që ti qëndronte erës, të pritej me pallë me zebekët, prandaj i ushqente trupin e shpirtin.

- Fatpreri djalë, liqe moj korbë nga prehri kur shkon në vaje. I thërmohet zemra moj Sorkë, është i vogël.

- Ç'më thoni? T'u dëgjoj? Ka hak për të marrë, i ka vranë babanë zebeku - u thoshte Sorka. Guxon një ful që trembet nga lloja e tij të ngrejë dorë kundër zebekut? Hë, de. - u pyes - guxon? Shoqet mblidhnin supet. Shpirti i Sorkës ishte i trazuar, sytë e saj të ndezur, kërkonin të priste palla, kërkonin të ...

Sorka e veshte djalin ndryshe nga fëmijët e tjerë. Në vend të potureve i kishte prerë fystanellë të bardhë me dyzet palë, ashtu siç mbanin luftëtarët kryengritës. Në vend që t'i qelhte kokën si shokët, Sorka i linte çepe mbi ballë, ashtu si e mbante i ati i djalit, ashtu si e mbante çdo lab i rritur, që kur t'ia priste kokën zebeku, për t'ia çuar Pashait në Janinë, të mos t'i ndynte fytyrën, por ta kapte te xullufja sipër ballit.

Birbili i vogël i Sorkës mbante çepe të gjatë. E ëma ia bënte dredhës, në një kosë të vemte, që ia kishin zili burrat e moshës së rritur, sepse Birbili e kishte trupin dhe gërshetin të plotë, flokët korb të zi e kosa i arrinte te këmbët dhe Sorka ia lidhte për mezi.

Këngët e vajtores Sorkë ishin rrënjë të baltës së shkëmbit. Sorka në vajet nuk nanuriste fjalë dhimbjeje, por çdo fjalë e saj ndizte trimëri në gjoksin e njerëzve. Në korin e vajtoresve peshllizeza gjendej përherë aty djali trupbëshëm, me vetulla të shtruara anash dhe fytyrë mashkullore, që jepte shpresa se diç do të bëhej. Gratë e përkëdhelnin vogëlushin.

- Më ka synë e kaut, moj korbë, - i thoshnin shoqet, Sorkës. Edhe kur u bë i madh, Birbili e ndiqte t'ëmën e tij prapa si manar. Atij i pëlqente të dëgjonte vajtimet e grave. Ato nuk ishin vajtime. Ligjet e korit të vajtoresve të veshura me robe korb të zeza ishin klithma e thirrje. Djalit i hynin në shpirt ligjërimet, fjalët e sarta. Ulej ku mundte, vinte pëllëmbën e dorës te faqet e dëgjonte. Ato, gratë e tjera, pas vajit e përkëdhelnin. Birbili bëhej përherë e më i pashëm në fytyrë. Disa thoshin se djali ka marrë nga dajët, se burra të bëshëm si familja ku qe rritur në Golem Sorka, nuk kishin parë më. Të tjerë thonin se djali i kishte rrëmbyer kokën babës, por Sorka e shikonte që syrin e saj prej mëshqerre ia kish dhënë ajo vetë të birit.

Nuk e qortoi asnjëherë dhe Birbili, në moshë fare të vogël, u bë zot i shpellave. Shpellat, humnerat në këtë vend janë aq të shumta saqë larg tyre është e pamundur jeta. Ishte i mitur kur djali hyri nëpër këto shtigje guri.

Në lodër, djali i Sorkës, Birbili s'dinte të zbrapsetj, kthehej në

shtëpi me hundën tërë gjak. Një herë. Sorka u tregua e pamëshirshme kur e shikoi të birin të ligështuar se ishte rrëzuar nga shkëmbi. Në vend që ta qetësonte ajo e goditi fort me pëllëmbën e rëndë e djali u hoq buzë përroit të Lekës. Lotoi Birbili i vogël gjer në mbrëmje dhe askush nuk i shkoi pranë.

- Qyqja ti moj Sorkë - i thanë shoqet, - ti po e rrit djalin si të jetë këlysh ujku e do ta lëshosh në pyll.

Sorka kryexhevap me fjalë:

- Zebeku i ka kthetrat më të forta se ujku. Nuk e dua djalin të parin në të ngrënë e të fundit në të shtënë.

Atëherë në fshatrat e Kurveleshit u tha se Sorka jetonte me këngët e gjakut. Gjaku i vajtores Sorkë ishte shndërruar në mallkim e urrejtje për zebekët që ishin mbyllur brenda mureve të kalasë së fshatit Nivicë. Gjaku i saj i vërshonte në dej edhe të birin.

2.

Era e detit që hyn thellë nga gryka e thellë e Shurit të Kuçit i jep jetë dhe gjallëri pllajës së Kurveleshit të Sipërm. Avujt e Jonit vesojnë barin dhe lulen, mëlcojnë lakrën e pemët, e bëjnë bulmetin dhe mishin e deles të shijshëm si në asnjë vend tjetër, që labërit kanë dëshirë ta kenë përherë në sofër, ashtu të shkrurosur, në erën cërgë të mishit të pjekur në hell.

Birbili, si çdo djalë i këtyre anëve, u mësua të bënte furka nga dru bliri, furka për plaka e për nuse të reja, dinte të bënte lugë nga dru bliri, dëllënje e piksi, rrathë për këmborë, krrabë druri për merak, dyjare dhe kupa druri nga dru panje, me aromë dhe të bukura. Kot nuk thuhej se djalit të Sorkës "Çi sheh syri ia bën dora".

Ai në moshë të vogël mori prapa një djalë tjetër, më i madh në moshë, Emir Kunadhe e quanin. Birbilit i pëlqente ai sepse, kur e merrte malli për mish Emiri e vriste në buza dhinë e egër, kur i hahej mjalti ia merrte bletës në shkëmb. Emiri e kishte shtëpinë në anën tjetër të honit por përballë sarajit të Shake, buzë shkëmbit, në Poporavë, te atody kalatë prej guri. Nuk kishte shteg në buza ku Emiri të mos ngrinte leqe për të kapur kunadhe. Nga këto lëkurë të kunadheve lëkurë-lëmuara e të vogla, e jo nga lëkurët e deshe e të cjepe, Emiri ngriti atë shtëpi të lartë përkarshi shtëpisë së Shake. Të

lartë sa ajo dhe të bukur. Nga kjo, atij, në të dy fshatrat i flisnin me mbiemrin Emir Kunadhja. Por ai që la gjurmë të pashlyëshme në jetën e Birbilit nuk ishte Emir Kunadhja por ish kryengritësi Budo Bredhi.

Sorka donte ta veçonte djalin nga Emir Kunadhja. "Nuk më pëlqejnë njerëzit që verbohën nga paraja" - i thoshte të birit. Një mëndje i thoshte Sorkës ta ndante djalin e saj nga Emir Kunadhja, çoç i mungonte në karakter Emirit. Po edhe i pëlqente. Birbili, duke ecur mbas gjurmëve të Emirit kishte shkelur të gjitha shtigjet e buzave të Kurveleshit.

Ai ende pa u rritur që shndërruar në sorkadh mali. Ky merak i nënës për të birin sikur u shua, kur djali tek endej shkrepave e humnerave, takoi dhe u miqësua me mikun e babës së tij, kaçakun Budo Bredhi. Asaj i vinte mirë që djali takonte kaçakun Budo që e kërkonte koshalla. Kish dëshirë të shijonte i biri erën e barotit. Kur djali i tha se Budo Bredhi nuk e mësonte vetëm të priste me pallën e babës, por i mësonte shkrim dhe i lëçiste libra, Sorka u mërztit.

- Nuk më pëlqen të më bëhet djali imam, - i tha Sorka dhe e largoi nga "hoxha" kryengritës që qëndronte ende kaçak në malin e Këbuzit.

- Mos Sorkë! - iu lut Budo Bredhi. Ai ndjeu boshllëk në shpirt kur djali i qëndroi larg.

- Jatagani më duhet djalit për zebekun, - i thoshte Sorka.

Budua ishte në gjendje të kuptonte se Sorka, duke ligjëruar trimërinë e trimave që priteshin nga palla, donte vetëm trimëri. Një herë kur Budua zbriti te stani i vejushës në Llufë gjeti rastin të flasë për shkollën dhe për librat:

- Na duhet edhe libri moj motra Sorkë, Pashai i zebekëve të Janinës librin e dënon. Të verbërin e gremis ku të duash.

- Mbase, por s'dua ta mësoj, nuk dua! - ankoj Sorka.

Budo Bredhi endej pyllit të Llufës e prapë dilte te stani i vejushës Sorka dhe i fliste asaj për librat. I fliste edhe për pallën. Se vajtoret lypset të dëgjojnë trimëri që t'i këndojnë trimërisë.

Kur fliste Budo Bredhi fjalë të librave Sorka trembej. zbrapsej si të ishte para magjistarit. Po djalin bëri si bëri e la të mësojë. Kur ajo shikonte si i bënte erë jataganit i biri i saj, thoshte: "Dy herë më i fortë se i ati do të bëhet, mjer zebeku që do t'i dalë përballë pallës së tij".

3.

*“Ç’e kujtoi Budo Rexhinë
Hoqi sarkëz e peshlinë,
Veshi silah e martinë
Të lufton me Osmalinë.”*

Budo Bredhi, ose siç njihej Hoxhë Rexhini, ishte shkolluar në vende të largëta. Pse kishte ardhur ky njeri mendjendritur e qëndronte në këto shkrepë s’ dimë të flasim. Por edhe zogu shtegtar kthehet në fole. Për Budon e Rexhinit thoshin se ka një barrë mend. Ai, në kryengritjen e Tridhjetetreshit, edhe pse kishte mësuar në Stamboll, e hoqi çallmën e hoxhës dhe u bashkua me kryengritësit.

Ai mësoi Birbilin e vogël të shkruante. Djali i vejushës, Birbili hynte në shkrepë e guvat në mëngjes e dilte andej në mbrëmje. Bisedonte me kaçakët e endej pas thëllëzave, ngrinte çarqe e sillte në shtëpi thëllëza krahëshkruara e të bukura.

Mbas viteve tridhjetetë Budo Bredhi u end disa vite kaçak maleve. Imamët e bylykëve që ndiqnin kaçakët kur faleshin nëpër xhamira, mallkonin imamin Budo. E shanin që njeriu i shkolluar në medresenë e Stambollit ishte bërë hajn. Imamët si imamët, përsëritnin paprerë:

- Imami Budo i Rexhinit është bërë xhind. Imami Budo nuk është më imam po jezit.

Budo Bredhi e dinte ç’bënte. Ai endej stan më stan dhe interesohej edhe më shumë për djalin e shokut të tij të vranë në Peshkëpi. Atij i pëlqente të takohej gjithnjë me djalin e motrës Sorkë. Kështu e quanin kryengritësit vajtoreshën Sorkë që ligjëronte Balil Nezhën dhe trimat e tij të vranë në kryengritjen e viteve tridhjetetë në Qafën e Peshkëpisë. Sorka e qau me ligje:

*Në qafë të Peshkëpisë
Lufton i biri i xhixhisë
Balil-o, Balil nuri ...*

- Shqiptari që s’ mëson pallën e pushkën kot ka lindur, - i thoshte djalit Budua. Kur Birbili hodhi shtat i tregoi si u vra i ati i tij. Shpesh i fliste me pasion për kryengritjen, sikur djali të ishte burrë.

“Deshëm të bënim Shqipërinë prandaj e bëmë kryengritjen .
Deshëm të mos vdisnim nizamë të Ordisë së Shtatë¹ në Jemen dhe të
mos na rrjepin me taksat, prandaj e bëmë kryengritjen. I vumë
pushkën turkut që ta bënim Shqipërinë. Grekërit e bënë Greqinë. bënë
shtetin e tyre. Edhe ne duhet ta bëjmë...” Djalit i hapej drita e syrit
si sumbullat e ujit kristal që nxjerr buronja e malit.

“Eh!, psherëtiste, sa burra të maleve tona vdiqën me shpresën
se do të bëhej Shqipëria. Nuk u bë por fara u hodh dhe në mos sot,
nesër, Shqipëria do to bëhet o bir!”, përfundonte bisedën sa herë
takohesh me djalin Budo Bredhi.

4.

*“Mylazim dëgjo haberë:
Dil nga kalaja si çupë
Shqiptari s’do halldupë.”*

Më 6 qershor 1847, pasi kishte çarmatosur zebekët e kalasë së
Nivicës dhe kishte vlarë Ekrem Halldupin, kajmekamin e Progonatit,
Kurveshli dhe Labëria e gjithë ngritën krye. Kolona e kryengritësve
nisi shtegtimin...

- U priftë pushka - uronin nënat e motrat. Dhe shtonin: - “Ta
marrin vesh Osmanët se as ushtarë u vemi, as taksa u paguajmë. Ta
marrin vesh mirë se ...”

Burri hijerëndë, Hodo Nivica i kalave, njëri nga krerët e
kryengritjes, kaloi me rrëmbim hypur mbi kalë nga Poporava. Rruga
gjarpëronte nëpër pyllin e lajthive fletëbuta. Ndjehej afër shtëpisë së
Shake trokthi i kalit qafëgjatë, kal këmbëshpejtë e zëmërak, si i zoti,
mbi të cilin qëndronte shoku i Gjolek Kuçit, Hodo Nivica. Kafsha nisi
të ecë me rrëmbim, sikur e ndjeu që shkonte në drejtim të betejës.

Ishin mësuar me përlëshjen kali dhe i zoti. Sorka e pa atë dhe
duke u prerë rrugën, i foli:

- Udha mbarë o trim i shkrepage të Labërisë, preftë palla tënde
sa më shumë zebekë.

1) Ordia e Shtatë ishte Armata e Shtatë e ushtrisë Osmane e vendosur
në territorin e Jemenit ku gjenin vdekjen djemtë e Arbërisë që thirreshin
nizamë e redifë.

- Fol moj sojllëshë, si e ke punën?

- Nje rixha të bën vejusha e një luftëtari që mbeti në luftë me Balil Nezhën.

- Urdhëro trimëreshë, - i tha Hodua, me një respekt të shumëfishuar për gruan që i vuri këngë Bilal Nezhës e shokëve të tij.

Ajo i hodhi dorën dhe i shtrëngoi frerin kalit. Kali i Hodo Nivicës nuk ishte mësuar ta kapte çdo njeri nga hundët, turfulloi dhe u ngrit me të dy këmbët e prapsme, sikur do fuste gruan nën dy këmbët e para. Gruaja nuk u praps. Asaj nuk iu drodh qerpiku. Hodos i pëlqeu guximi i vejushes. Pasi ia uli zemërimin kalit, Hodua i tha:

- Fol, moj motër, fol se shpejtohemil!?

- Djalin e vetëm që rrita me të zezën e thoit, e rrita për këtë ditë, dua të ma pranoni në radhë me trimat e Gjolekës e të Hodos, kurse Budo Bredhi kërkon të ma bëjë djalin dudum.

Hodo Nivica i foli bimbashit të taborrit kryengritës. Budo Bredhi erdhi me rrëmbim.

- E, Budo Bredhi, si është puna? - kjo grua trimëreshë ankoi.

- Jo o Hodua i kalave, nuk ankoj po kërkoj - u shpreh Sorka e vendosur në kërkesën e saj.

Budo Bredhit iu vijëzuan më tepër vijëzat e ballit, ktheu vështrimin nga Maja në malin e Këbuzit, balli i Budos i gjerë si pllajet e Këbuzit. Ai e kishte përkëdhelur e rritur fëmijën në ato vende.

- Eshhtë i madh në trup, por i vogël në vite, djali, Hodo, - i tha Budua.

- E njeh djalin?

- Si jo, e kam rritur.

- I vogël? Uh, ç`më dëgjojnë veshët, - ndërhyri Sorka. Kur shkel katërmbiljetë vjeç djali martohet, si qenka i vogël? Djalin e di mirë, o Budo, e kam rritur për pallë - ankoj. Mos xhani i motrës Budo, mos ma lëndo zemrën. Mos o Budo xhani, djali është rritur. Dhe ashtu, krenare, i drejtohet Hodo Nivicës:

- Pyeti të gjitha nënat e Arbërisë ku i duan djemtë, pranë hirit apo në radhët e kryengritësve. Eh, një burrë si ju është mal dhe kupton ç`është urrejtja për të huajin. Ju e derdhni urrejtjen përmes pallës, Hodo, kurse ne gratë... Sorkës iu mbushën sytë me lot. Hodo Nivica u zu ngushtë. Kali i Hodos ashërinte.

- Kënga jote moj Sorkë e pret zebekun më tepër se palla ime - i tha Hodo Nivica. Po Sorka e Golemit s`lëshoi pe.

- Pa erën e pallës s'ka ç' të këndojë vajtoria o komandant Hodo. Merreni djalin tim, merreni në luftë, ndryshe gremiseni në buzë, ose gremiseni ju, ose e gremis vetë.

Hodo Nivica dhe Budo Bredhi shikuan sy më sy njeri - tjetrin.

- Ku është djali? - pyeti Hodua? - Është i armatosur?

- Mban armën e babit, kajatagan e pisqollë - foli gruaja në vend të Budos.

- Ashtu? Sytë e Hodo Nivicës u ndezën flakë, vetullat gjëmb, kali rrëmoi tokën. Donte të merrte rrugë. Kolona e kryengritësve u vargas në drejtim të Gusmarit. Syri i mendjes të Hodos shkoi më larg, në drejtim të Delvinës dhe prapë u rikthye në Poporavë. Mbeti vështrimi te balli i gruas, te sytë e saj të ndezur. I foli shokut:

- Jepi një rrugë kësaj pune o Budo Bredhi. - foli Hodua e ra në mendime. Shikonte herë fytyrën e nënës e herë të Budos. Të dy i luteshin, pritnin vendimin. Nëna plot mlllef që të pranohej i biri i saj në kolonën kryengritëse, Budo Bredhi zemërdhëmbshur që të mos të merrej. Pritej në heshtje fjala e kryetrimt. Kali ulte kokën e turfullonte, godiste e rrëmonte dheun, që i zoti të kuptonte se kishte afsh e donte të ecte. Por Hodua e mbante frerin shkurt, s'e lëshonte për udhë. Tej, te kthesa e madhe, në Poporavë kalonin në varg kryengritësit. Më në fund kryetrimi, Hodua i kalave foli:

- Të bëhet ajo që kërkon nëna, Budo.

- Dielli tu bëftë rrugë, o Hodo Nivica, diell - tha vejusha dhe iu zbukurua balli e i ndriçuan sytë nga gëzimi.

Budo Bredhit iu drodhën qepallat. Ai s'donte të vihej jeta e djaloshit në rrezik. Ata mbetën vetëm. Hodua e bëri kalin veri.

Me atë që bëri Sorka e Golemit i ndezi prush zemrat e kryengritësve. Ajo eci në atë rrugë dhe në një hap me kryengritësit gjer në Golem. Kur e pa shokun e burrit të saj, Budo Bredhin të ligështuar për djalin, iu kthye me fjalë:

- Përse të dhimbset. Po m'u vra djali me pallë do ta ngjallë nëna në këngë.

Budo Bredhi përsëri heshti. Ai, ashtu i heshtur e vetullngrysur dëgjonte vajtoreshën që tërë afsh i thoshte:

- Atëherë as shqolla e as palla që i mësove, s'hyjnë në punë? Përse ja mësove djalit jataganin? Hë, de, më thuaj përse? Që të presë koka të pulave? Përse ia mësove arfet që të bëhet imam e të bëhet dudum duke bërë mëk-mëk në xhami? Atëherë më mirë most'ia kisha

lidhur kërtihzën. Njëqind herë më mirë. Ç'më shikon ashtu, s'më njeh? E ëma e tij jam, nuk jam njerka, po mëmë. Mos, Budo! Mos u ligështu kështu, se nuk bën mirë., djem të nënave janë të gjithë këta që shkojnë të priten me pallë me hasmin.

- Më dhimbset, moj Sorkë, - tha ai, akoma është i vogël.

- E mua s'më dhimbset djali? Ka nënë që s'i dhimbset djali? Na dhimbset më shumë vatani, Budo. Mos unë e kam gur zemrën?

Budo Bredhi ndjeu emocionet e përleshjes së parë me osmanët në luftën e Peshkëpisë. Atëherë i thanë e ke nga gjaku, të ka zënë gjaku. Atë sot nuk e lutoi gjaku, po vështrimi i vejushës, fjalët e saj. Ligjërimet e saj për udhëheqësin e kryengritjes, Balil Nezhën. Ai murmuriti ligjërimin e vajevicës: "Në qafa të Peshkëpisë, lufton i biri i Xhixhisë, Balil-o, Balil nuri!" Dhe pastaj ligjërimet e Sorkës për Budo Bredhin.

Në fshatin Golem kryengritësit bënë një pushim të shkurtër. Kishin shpërthyer këngët kur Sorka i qëndronte pranë të birit. Ajo e ndjeu thellë në shpirt ndarjen. Edhe në vitin tridhjetetë, ashtu e kishte ndier ndarjen me të shoqin që i mbeti në luftë. I trokiti në mendje mendimi i mbrapshtë: "Po sikur djali të mbetet në luftë si a ati? Atëherë jeta në sarajin e Shake do të shuhet". I largoi mendimet ogurzeza për të folë me të birin.

- Birbil! O trim i nënës - i foli. I shikoi shtatin e veshjen e të birit. Ja mati trimërinë në dritën e syrit.

- Mjerë zebeku ç' do të pësojë nga palla jote - i tha dhe i lëshoi çepenë e gjatë.

Birbili i vogël nuk foli. Ai nuk ishte mësuar dhe nuk priste nga nëna fjalë përkëdhelëse. Sorka ishte grua me gjoksin të mbushur me mlllef e zemërim për pushtuesit. Në çastin që do të ndaheshin i tha:

- Ose trim, ose më mirë nëna të të presë kufomë.

Birbilit i ndritën sytë. Ai qiti nga milli pallën dhe vrapoi të arrinte Budo Bredhin që ecte në ballë të taborrit, që sapo nisi shtegtimin.



54469

5.

*"Gjoleka ynë, hundë më hundë
me Valiun e Janinës, - i thotë:
O t'i, o unë."*

Qershori kishte bërë i mbarë. Fusha e Golemit e malet përreth ishin mbuluar me tërfil e trëndelinë. Kryengritësit qëndruan disa orë në këtë fshat. Këtej rruga e tyre do të ishte gjithnjë tatëpjetë. Andej nga majat e larta të maleve, kryengritja do të zbriste në vendet e ulëta.

Për kryengritësit Golemasit zbritën nga stanet mësheret me djathë e u vunë në hell qengjat pirës. Aq shumë mishëra në hell nuk mbahej mend që të ishin vënë herë tjetër. Birbili i vogël endej nëpër moshatarët e tij që dridhnin mishrat në hell. Ai u buzëqeshte. Edhe ata i buzëqeshnin. Ishte i vetmi, ai, Birbili që në moshë të vogël ishte rreshtuar me luftëtarët kryengritës. Armët ishin të rënda për moshën, por nga shtati Birbili dukej bukur i rritur.

Kryengritësit ishin shpërndarë, shlodheshin dhe këndonin. Flisnin edhe për kryengritjen. Pritej të vinte në Golem Gjolek Kuçi. Ai erdhi mbi një kalë të bardhë. Kishte fustanellë të bardhë me dyzet palë. Kali i Gjolekës, xhind, trufullonte nën hundë dhe hingëllinte. Kërkonte të lëshohej veri në fushën e luftës.

Birbilin e shtyu zilia, ai bëri këmbë. Donte të shikonte nga afër pallën e "larë me cullufe" e koburen e Gjolekës.

Disa kryengritës ia filluan këngës. Ajo ishte përshëndetje e respekt për kryetrimin që erdhi. Ai u shfaq papritur dhe të gjithë i përpiu gëzimi. Gjoleka i hidhte sytë sa në një rënë anë në tjetrën. Në fjalët që këmbente me luftëtarët u hetonte mendimet. E pruri radha të ndodhej ballë për ballë me kryengritësin e vogël. Birbili mbante tirq e fustanellë si të rriturit. Kishte në dorë pushkë e në brez kobure të argjentë. Jataganë të mëdhenjtë, jatagan edhe ai. Veshja dhe armët ia nxirrnin më në pah tiparet e veçanta që e veçonin Birbilin nga djemtë e tjerë të fshatit. Ai kishte tërhequr vëmendjen e gjithë kryengritësve. Vëmendjen e Gjolek Kuçit në veçanti e tërhoqi shtati i hedhur si lastar, pamja e fytyrës, çepea e gjatë, një pullëz e zezë në faqen e djathtë, vetullat e plota, balli i gjërë dhe sytë e gjallë plot dritë të djaloshit. Te i vogli maste pulsën e të mëdhenjve. I foli Hodo Aliut:

- Ku e çon këtë çilimi, o Hodo.

Djali mblodhi supet, ndjeu peshën e hijes së rëndë të kryetrimit. Syri i Gjolekës i madh, si syri i kaut, fustanella qumësht e bardhë, palla vetëtimë. Rreth mezit i qëndronin dy koburet e derdhura në serm. Gjoleka ishte ngarkuar rëndë me armë.

Birbili donte ta shikonte sa më gjatë kryetrimin hundëshqiponjë, me llërën e dorës të plotë e ballin që ia zbukuronin Gjolekës vetullat e zeza, vetullat kaleshe, e qerpiku i syrit tel. Djali e dëgjoji nga afër hapin e rëndë të Gjolekës që i afrohej.

Birbili shikoi syrin e Gjolekës dhe koburet në brez. Palla e larë vetëtimë i rrihte Gjolekës pëqinë. Sa herë i kishte folur nënë Sorkë për koburet e Gjolekës që kishin vrarë kaftanazin. E mbante në gojë Arbëria Ismail Beun¹ e Kaninës që e vrau Valiu i zebekëve të Janinës, sepse punonte për Shqipërinë. Po fjala që tha Gjoleka ia gremisi, e pickoi midis zemre dhe priste me padurim që të mbaronte fjalën kryetrimi Gjolekë. Kreu i kryengritësve, Gjoleka i Kuçit e hetoi se ç'mendonte djali por ai te i vogli maste pulsën e të mëdhenjve. I foli Birbililit:

- E pret dot krahu yt, o voglush, halldupin? - i tha Gjoleka.

- Nuk e kam ndërmend që me pallën e babait të grij duhan - ia ktheu Birbili i vogël kryetrimit. Mënyra si e shikoi i vogli i pëlqeu kryetrimit të kryengritësve.

Kryengritja i rrëmbeu të gjithë. Çdo gjë shikonte ashtu siç e kishte parashikuar Gjoleka e Hodo Nivica. Aty ku u takuan, aty edhe u ndanë Gjoleka e Hodua. Kali i kryetrimit mori vrapin. Një kal i bardhë me shalë pashai. Kali i sertë, linte gjurmë dhe copëza e çika stërralli. Gjoleka i Kuçit erën... Disa kryengritës ia morën këngës:

*Gjolek' e Hodo Ali
Janë një e s'bëhen dy.*

Kolona e kryengritësve nisi shtegtimin në drejtim të Zhulatit për të zbritur në Delvinë, kurse Gjoleka i Kuçit zbriti në luginën e Mesaplikut ku ishin mbledhur kryengritës nga tërë krahinat. Buçet kënga e kryengritësve:

Mesaplik te Rrapi i Thatë

1) Ismail Bej Kanina, gjyshi i Ismail Qemalit.

*Çu mblodhë gjithë kazatë.
Vjen Himara si Rigatë
Ma mbani këngën ma mbani
Do këndoj se ma do xhani
Na bashkoi jatagani
Nuk na ndan dot shejtani
As ungjilli as kurani
As turku as grekomani*

Njëra kolonë e kryengritësve mori drejtimin e Janinës, tjetra të Beratit.

II

1.

*“Kurveleshi majë shkëmbi
Pataksem si s’lot nga vendi.”*

Kryengritja e Gjolekës e vitit Dyzeteshtatë u shtyp me zjarr e hekur. Në krahinën e Progonatit në vend të Kajmekamit Ekrem Halldupi, që e vranë kryengritësit, erdhi Kajmekami i ri, një zebek me një emër të rëndë. Çollak Zylyftar e quanin.

- Kajmekami i ri e ka gazin në buzë e djallin në bark - thanë kurveleshasit.

- Kësaj here e shkretuan Labërinë, e mbuloi zia tokën e Arbërit moj motra - u thoshte Sorka.

Kodrat, shtigjet, qafat e sheshet e Labërisë mbas dështimit të kryengritësve morën emërtime të reja: “Sheshi i Eshtrave”, “Qafa e Gjakut”, “Shtegu i Pritës”, “Kodra e barutit”, “Varri i zebekut”, “Bredhi i Budos”, “Palla e Leskoduqe”... Ish kryengritësit të vogël, Birbilit, i vjen mirë që këto vende morën emra të rinj, por brenga e njerëzve ia lëndonte zemrën.

Kërkesat e kryengritësve, edhe pse ajo u shtyp, lëshuan rrënjë në thellësi të dheut. Kajmekami i ri i Progonatit dha urdhër të varrosen vetëm zebekët e ordisë që shtypi kryengritësit.

Nuk ishte e lehtë të varroseshin aq shumë zebekë të mbetur në luftë me kryengritësit maleve të Labërisë. Ishte detyrë e tij e parë për kajmekamin e Progonatit që gjer edhe zebeku i fundit të hynte në dhe. Në një urdhër tjetër kajmekami thoshte: “Kryengritësit e vrarë të mos varrosen. Për dinsëzët, për ata që morën prapa harbutin e Kuçit, Pohrixhiun e Buronjës, Gjolekën dhe Hodo Nivicën, Allahu s’ka vend varri, t’i hanë korbmat e zhgabat kufomat e tyre”.

Natën kufomat e luftëtarëve kryengritës ishin zhdukur, i

kishte përpirë dheu. Nuk i kishin ngrënë zhgabat siç kërkonte kajmekami Çollak Zylyftar. Aty ku ishin vrarë aty i varrosën natën dhe më vonë te çdovarr luftëtari të vrarë apo grup luftëtarësh u ngritën qivurë me gurë që lyheshin me gëlqere të bardhë.

Kur mësoi të vërtetën Kajmekami dërgoi koshadhët. Ata i përmbysen qivurët të ngritur në kujtim të të rënëve në kryengritje. Koshadhët i prishnin ditën, labërit i ngrinin natën. Sorka i ligjëroi me ligje kryengritësit.

- Ajo sorra e zezë të heshtë - urdhëroi kajmekami i ri i Progonatit, Çollak Zylyftari. - Do t'ia nxjerr sytë nga kafka po nuk heshti.

- S'ka forcë doletit të ndalojë lotin, do t'i qajmë trimat - ishte gjegjur e zemëruar Sorka dhe e ligjëroi kryetrimin, Hodon e Nivicës:

*“Në sheshin në Kamenicë!
I shkreti Hodo Nivicë
T'u qep nizami galicë.
Bam me top e dot s'të vrisnë”.*

Kudo që ndodhej në stan apo në shtëpi, rrugës apo duke punuar, Sorka ligjëronte. Ligjërimet e saj në fillim delnin vajë, por në dasmat e gëzimet ktheheshin në këngë.

Kënga aq sa e shtroi urrejtjen këmbëkryq në vatrën e labërve për zebekët dhe pashain e Janinës ngriti lart lavdinë për trimat. Njerëzit i thanë:

- Ligjëroje trimërinë e kryengritjes motër Sorkë.

- Ligjëroje me ligje Gjolekën e Kuçit dhe Hodo Alinë e Nivicës, motër Sorkë.

- Ligjëroje Arbërinë, motër Sorkë ...

- T'u lumtë ai zë motra Sorkë, t'u lumtë ajo mendje moj Sorkë e Golemit, e mbajte gjallë trimërinë në vatrën tona...

Pastaj u lëshuan fjalë të tjera thumbonjëse e zemërore:

- Kur i këndove Gjolekës e Hodos ç'tu desh ti këndoje trimërisë të zebekëve, motra Sorkë?

- I këndova trimërisë - thoshte Sorka, - ku është thenë që në

1) Vend në afërsi të fshatit Palavli në Delvinë ku u bë një përlëshje e madhe e kryengritësve me trupat osmane.

këngë të harrohet e të përdhohet trimëria?

- Kur i këndova bymbashit Budo Bredhi që u kacafyt me taborrin e tij kryengritës me halldupat në Palavli çë ndyve gojën me komandantin e zebekëve, një halldup si bylykbashi Shahin Hatibzade. Si ti nxorri goja ato lavdërime, si i thure aq bukur ato ligjërime? Dhe kujt i këndove, një zebeku të ndyrë, vërtet zabit ushtrie, suvari i rrallë, po yt bir që hyri në luftë së pari herë e preu atë me pallë si kec.

Sorka e Golemit hazërxevap:

- Kur e ka lënë Arbëria zakonin e saj? Ç`po më thoni? Të mos respektojmë trimërinë? Jo, motra, jo! Trimëria u bë shesh për shesh. Luftuan zebekët e Valiut të Janinës dhe na detyruan të tërhiqemi. Të mohojmë atë që bënë ata? Jo! Ç`do të thonë të pasmit, me kë luftuan të parët tanë, me pula të ngordhura? S`ka lezet! Arbëria e ka lavdëruar trimërinë, shajë tjetrin po jepi hakun. E lëvdoj Hodo Nivicën për ato që bëri në Kamenicë të Delvinës dhe përmendi disa vargje:

*Hodo bej, Hodo Desturi
Me dymijë djem prej guri.*

- Kur e lëvdoj Hodon, pse të mos e lavdëroj mençurinë e zotësinë e Hysni Pashës, Valiut të Janinës që i pruri asqerët nga ana e anës dhe u preu rrugën trimave tanë në afërsi të Janinës duke dalë dhe vetë në sheshin e luftës? Ç`më thoni, të hesht? Në hesht Sorka nuk do të heshtin vajovicat e tjera. Nuk është vetëm një Sorkë e vetme në Arbërinë tonë që ligjëron trimërinë, janë me bylyk të tjerat dhe s`do ta lënë që trimërinë ta mbulojë dheu. Këtë zakon të lashtë e kanë respektuar të parët tanë, si mund ta shkelim?

- Mos më folni për tim bir, u detyrova të hesht. Ai bëri trimërinë po nuk e çoi deri në fund. Ndërhynë të tjerat:

- Ç`të bënte më tepër Birbili yt, moj Sorkë, e preu zabitin e suvarisë me shpatë.

- E preu e çë? A vdiq zabiti Shahin Hatibzade?! Jo, motrani. Mos e harroni që bylyku i suvarisë i këtij zabiti i çau përmes kryengritësit në Grykën e Kuçit, bëri atë që tanëve u kushtoi shumë. Ky zabit, me trimërinë e tij të detyron ta nderosh, kurse Birbilin tim këngëtarët i thanë: "Rritu djalë, rritu se i ke ende buzët me qumësht!" Nuk i këndohet kënga atij që e lë trimërinë në mes të rrugës, kurse ai tjetri, duam, apo s`duam do t`ia çmojmë e nderojmë trimërinë. Kush ◦

nuk di të çmojë trimërinë e tjetrit s`di të çmojë as trimërinë e vet. Këtë zakon e ka patur Arbëria dhe dhentë zoti mos e ndryshoftë kurrë! Mos harroni që këngëtarja nuk është si magjistarja që e ndron plumbin në argjend e flori. Jo, këngëtarja pohon të vërtetën. Vëtëm e vërteta zë vend te këngët tona, siç zë guri i latuar në qoshen e murit të shtëpisë. A mund të zërë vënd në mur një gur i pa gdhendur mes gurëve të latuar? Nuk mbahet gjallë trimëria moj motrani duke mohuar trimërinë e të tjerëve. Do t`i thuhet fjalë lavdëruese zabitit të bylykut Shahin Hatibzade, ai i fitoi ato me pallë në sheshin e luftës dhe vetëm me pallë në sheshin e luftës mund t`ia marrësh.

- Kurrë s`ka për t`iu dukur në këtë anë ky zabit Turqie.

- Kushedi, mali me mal nuk takohen kurrë, njeriu me njeriun edhe mund të tokohen një ditë.

- Nuk i dihet - thuhet që zebekët janë inatçi dhe hakmarrës.

- Bimbashit Tahir përse i këndove?

- Kur nizamët e Bimbashit Tahir, hynë në Grykën e Lepushës u mehi çapi, u ngriu gjuha dhe thanë:

- Allah! Allah! Kjo është Gryka e Xhindëve. Erdhi aty imami i taborrit që ti binte zebekët se aty ku shkel këmba e nizamit të dovletit mëlcohet dheu, arratisen xhindet dhe vinë melaqet. Kështu u tha imami i taborrit dhe fup dolli në ballë Bimbashi Tahir e tha:

- Shtegun e kanë mbyllur dinsëzët e Gjolekës. Shtëpinë ia dogja. Do ti rrëmbej dinsëzit Gjolekë me teh të jataganit kokën dhe do t`ia ngul mbi një shkop e tu them këtyre:

- Ja ku e keni trimin tuaj. Po nuk e bëra këtë mos më flisni me emër, dhe nxorri nga milli jataganin e ngriti dorën lartë që të shikohej nga nizamët, thirri:

- Uxhum! Uxhum!

Tre sulme bënë njëri pas tjetrit.

Prandaj i këndova Bimbashit:

Bimbash Sulejman Tahiri

Përposh Kuçi i hyri.

U dogj Kuçi si Misiri.

- Mirë bëra që i këndova. Të vërtetën thashë.

- Kur arriti te burimi memë i Buronjës s`bëri dot asnjë çap më tutje Bimbashi Tahir.

- E pastaj?

- Doli yzbashi Shahin Hatibzadea, doli dhe çau si shigjetë përmes tanëve në Shur, i hapi shtegun me jatagan ushtrisë që të bashkohej. Si ta lërja pa e ligjëruar trimërinë e këtij zabiti?

2.

Biruni zebekëve me gurë Ti bëjmë baltë e pluhurë

Kur mbushi Birbil Shakua moshën e nizamit u shfaq në Kurvelesh zabiti i rekrutimit, Asllan Fesati. Sillej me defterët e rekrutëve të rinj në duar. Nga ajo ditë shtëpia dhe stani i Birbilit ishte pylli e shkrepat. Aty, mes pyllit e shkrepit Birbili hodhi shtat e vuri shëndet. Ai matej me çobanët më të fortë dhe s'kishte njeri që i delte përballë. E zente demin nga briri, rrëzonte mushkën mëz në tokë, jo më njeriun. Sorka e shikonte që djalit të saj i hovi shëndeti, por ajo kërkonte që të derdhte në shpirtin e tij forcën e karakterit të shqiptarit. Ajo donte që Birbili i saj të mos e harronte kryengritjen. Fjalët e s'ëmës dhe ligjërimet e saj ngacmonin zemrën e ndezur prush të ish kryengritësit, mbanin të ndezur zemrën e djalit dëshirën për të jetuar në liri. Por liria mbeti vetëm një ëndërr. Malet i mbuluan zebekët me plafin e rëndë të errësirës. Një natë fare papritur kur ra në gjumë, Birbili ishte prishur në fytyrë dhe e mbuluan djersët. Ai ishte në ëndërr.

- Birbil, - i foli Sorka. Ai nuk u përmend.

- Korba, e kam keq djalin.

Birbili jetonte në ëndërr ditën e fundit të kryengritjes, betejën e Shurit të Kuçit. Kujtoi edhe atë ditë kur Budo Bredhi u mundua ta largonte, por Birbilin e rrëmbeu përleshja. I binte erë këllëçit, godiste e zbrapsee pak të merrte forcë. Më në fund qe ndodhur ballë për ballë me një kalorës mjekërzi, që ju duk se kali i tij e futi shtatë pashë nën dhe. Atë kalorës zabit me grada e goditi¹ me jatagan dhe e ndjeu që e goditi fort sepse ju duk sikur ju këput jatagani në dy copa. Ai e pa kur mjekërtelit ju njom mjekra e zezë nga gjaku dhe ra plasur në tokë si një dash bridredhur që theret në qafë.

1) Ishte Bimbashi Shahin Hatibzade, ushtarak që do të ndeshet shpesh emri i tij në këtë tregim të gjatë për Birbilenjtë.

- E preva, e vrava! - thirri në gjumë.
- Birbil! - i foli Sorka. Ai u përmend.
- Isha në ëndërr, nënë, - i tha ai i përhumbur. Në ëndërr kishte përjetuar çastin më të rëndësishëm të përleshjes. Atë çast kur kryengritësit luftonin te Buza e Radit. Aty i qe shfaqur Gjoleka majë një guri. I gjithë shndriste, e bardhë këmisha, e fustanella, kalcat e festja. Shndritnin armët e lara në flori. I binin te këmbët plumba por ai qëndronte, vëzhgonte. Priti çastin gjer kishin hyrë në pritë shumica e nizamëve dhe thirri:

- Biruni zebekëve me gurë, ti bëjmë baltë e pluhur.
Dhe gryka gjëmoi. Prandaj populli i këndoi:

*Treqind lebër qimeverdhë.
Te gryk'e Kuçit u derdhë.*

U hodh Gjoleka drejt përleshjes. U duk sikur fluturoi dhe humbi mes përleshjes. Këto kishte parë në ëndërr. Dëgjoi që te Kroi i Zotërisë disa çobanë këndonin:

*Gryk' e Kuçit, gryk e keqe
Lufton Gjoleka me derte
Gjoleka në Shur të Kuçe
Me fustan mbi gju hajduçe
Pall' e larë me cullufe
E mban Gjoleka mbi supe.*

Jehona e kësaj kënge vinte nga larg, kurse burimi i këngës ishte Sorka, nëna e tij.

3.

*Dola në rrugë e të prita
Moj nepërka pika pika,
Më vrave të rëntë pika.
Unë s'ta hodha për të vrarë
Po ta hodha për të parë.*

Mali i Nivicës është fole e zogut këngëtar. Aty është burimi ujëftohtë që kur ngopesh me mish dashi të pjekur në hell e bukëvalë

çobenjësh e vlerëson çfarë uji gurgullon në atë gurë të bardhë. poshtë një shkëmbi që del si një kokë përbindëshi sipër kurorës të bredhit e pishës. Në këtë pyll të madh dhe në honet e shpellat strukeshin djemtë që s`donin të shkonin nizamë. Këtu, vjedhurazi syrit të zebekëve të kalasë së Nivicës sillej rreth e kulloste delet ish kryengritësi Birbil Shako. Ai çdo ditë, kulloste natën dhentë dhe në mëngjez, vjedhurazi dilte tek shkëmbi i madh mbi buronjën. Atë ditë kishte dalë më herët, ngaqë kishte radhën e ujit. Kroi i Zotërisë gurgullonte ujë të ftohtë te Zalli i bardhë. Ai i hodhi sytë për rreth. Sytë xham të bariut, dallonin më larg se dylbitë e oficerit të rekrutimit Asllan Fesatit, që ishte vënë në kërkim të tij dhe të djemve të tjerë, të cilët nuk dëgjonin të shkonin nizamë.

E veja robëtohej për djalin, përgjerohej për të. Nuk thuhej kot në Rexhinë e në Nivicë, djali i vejushes Sorkë si kali i pashait. Kur e pyesnin Sorkën shoqet ajo thoshte:

- Do ta mbaj tim bir me pekule, e kam djalë shpirti, vetë do të vuaj si qeni e djalin s`do ta lë të ma rrëmbejë Ordia e Shtatë.

Sorka e Golemit mendonte se djali më i pasur i fshatit ishte djali i saj. Ajo mendonte sè i pasur është ai që gëzohej me shpirt. Dhe shpirti i djalit të saj nuk qe vrarë ... Ai endej maleve i lirë dhe s`do të bëhej kurrë skllav me rroba nizami e të humbte jetën me Ordinë e Shtatë në shkretëtirat e Jemenit.

- Dua ta shoh tim bir gjithë jetën duke kënduar - u thoshte Sorka e Golemit shoqeve të saj. - Dua të ma ketë shpirtin djali plot gaz e këngë, ketë dua dhe për këtë e treta rininë time.

Po ajo që ëndërronte nëna ishte gremisur në zemrën e djalit. Syri hetonjës i Sorkës shikonte që diçka e mundonte zemrën e djalit të saj. Ç`të ishte ajo? Frikë e koshadhes që mbliidhte nizamë? Jo, tjetër gjë ishte. Birbili i saj nuk dinte çfarë ishte frika, por ...

Zogu s`e pret cicërimin kur i vjen vakti. djali s`e pret këngën ... Ajo, sa herë kishte ditën e ujit dëgjonte tingujt e fyellit të birit të saj. Ç`ishin ato gjuhëza zogu që ligjëronte fyelli i Birbilit? Ato ishin mallëngjyese, të përlotura. Ç`derdhte nëpër tinguj fyelli? Gjëmën e vrasjet që la pas Ordija e Shtatë që shkeli Labërinë apo dramën e dashurisë? Sorka nuk mundi ta veçonte njëren nga tjetra. Birbili doli sipër stanit dhe vazhdonte t`i binte dyjares.

Delet kullosnin të heshtura në njomishten nën shkëmb te Lisi i kokalltë me shenjë i stanit të Sharke. Birbili ua ka hequr gjuhëzat

zileve dhe ato janë kope e shurdhër. Ka vite që qendronin në degën e një shelqërori te stani. Ende nuk ishte hequr zia në Labëri për trimat e rënë në kryengritjen e madhe fshatare të Gjolekës. Këmborët e zilet e tufave ishin pa gjuhëza. Birbili dëgjonte si e priste njomishten tufa e deleve, si guisin thëllëzat. Rreth tij çdo gjë e butë e ëmbël dhe me aromë dehëse. Një larash grabitqar endej në qiell dhe priste rastin. Larashi - tha Birbili - është si korbi i zi me emër "Daut"¹ që i rrëmben Arbërisë djemtë siç rrëmben larashi qëngjin. Larashi e përplas qëngjin në shkëmb dhe e shqyen. Korbi i zi, vapori me emrin "Daut" i përcjell djemtë në Jemen dhe kthen në vendlindje kartën e djegur. Vapor i "Daut" ishte emëruar "Vapor i vdekjes!" Ardhja e tij sillte vetëm ulërime e gjëma.

Birbili e ndërpreu melodinë e ëmbël të fyellit vetëm kur pa vajzën e Zeno Krekëzës që mori bucelën dhe u duk përtej, tek zalli i bardhë. Hirua - tha. Ajo ishte. Ajo duhej të zbriste sa më parë nga kroi. U hodh me rrëmbim. Arriti aty. Ecte lehtë dhe nuk donte ta trazonte se ashtu e shihte më mirë shtatin e bukurinë. Vajza kishte ulur sytë poshtë. Ç' vështronte ajo, curilen e ujit që binte në bucelë apo gjinjtë e saj? Birbilit i bulëzuan dritëzat e bebet e syrit, i ngazëllehej zemra, donte që ajo ta shikonte sa më shumë veten me sytë e saj, të kuptonte që ishte rritur. Djali hodhi një gur dhe i buzëqeshi ashtu siç mund ti buzëqeshite rrezes së diellit që binte mbi ujin e koritës.

- Kujdes Birbil, po endet mortja nëpër shkrepat tona, kërkojnë nizamë, ka ardhur Asllan Fesati - i tha ajo. Birbilit i pëlqeu që vajza interesohej për të. Ai qeshi. Buzëqeshja e tij ishte përgjigje për vajzën.

- I ka të shkurtëra këmbët Asllan Fesati, nuk guxon të ngjitet në shkrepat ku grenë folenë bilbylat.

4.

*"Dallandyshe gushëbardhë
Mos na pe djemtë nizamë?
- Djemt'i treti rëra,
Djemt'i piu malli,
Djemt'i mbyti tënga."*

1) Vapor që merrte dhe kthente rekrutë nga Shqipëria në Jemen. në Ordinë e Shtatë të Ushtrisë Turke.

Rreth strehëve të shtëpive cicëronin zoqte e vegjël gushëbardhë. Thuhej në çdo shtëpi: "Mos i vrisni dallandyshtet, ato sjellin fjalët e nizamëve, bien nga larg selamet e nizamëve, të Ordisë së Shtatë. Dhe aty ku njerëzit ndërtonin shtëpinë e tyre, aty ndërtonte folenë edhe zogu i bukur. Birbili donte ti shikonte dallandyshtet si vërtiteshin e përllaseshin te strehëza e shtëpisë, donte ti dëgjonte kur ato cicëronin. Gjuhët e zogjve ishin gjuhët e nizamëve, kështu i thoshte nëna Sorkë. Dhe ai, çdo pranverë, sa vinin dallandyshtet e ndërtonin folenë në strehët e sarajit të Shake, te shkëmbi i humnerës u këndonte:

*"Dallandyshe faqekuqe
sqep gjilpërë, bisht gërshërë
Ç'thonë nizamët në Jemen,
Fol o zog, ç'lamje hjen?"*

Një herë kur ishte i vogël, mbante mend që u kishte prishur folenë dhe ato endeshin rreth me klithmën si njerëzit që mblidhen rreth një të vrari. Atij i erdhi keq që u prishi folenë. Nëna Sorkë e qortoi. I tha:

- Cicërimat e zogut ishin fjalët e selamet e djemve, të dërguar nga Jemeni. Porosi për mbarë fëmijët e Arbërisë:

*Mos i ngacmo dallandyshtet
Dallandyshtet bien selamet e nizamëve ...*

III

1.

*"Erdhi kuraja në Delvinë
Ku më gjeti mua të zinë,
Në male me trëndelinë,
Ku kullosja bagëtinë"*

Asllan Fesati, yzbashi i rekrutimit, shënonte emrat e djelmoshave të defterët e tij, hetonte në sy shëndetin e secilit dhe përbri emrit vinte shënimin "dërgohet nizam në Ordinë e Shtatë". Ai i ruante defterët në tri kopje, se po të humbiste një defter, do ta nxirrnin nga situata e vështirë dy të tjerët. Yzbashi e dinte mirë që po të shtrydheshin fletët e defterëve nxirrnin pika floriri. Asllan Fesati endej fshat më fshat me to në hejbe, mbi kalë të zi. Kurveleshasit sa herë kalonte pranë tyre i thoshin njëri - tjetrit "mbaje yzbashin e defterëve". Ndërsa ai ecte rëndë - rëndë, bënte punën e tij, pa kthyer kokën as majtas as djathtas. Në çdo hap që hidhte e mbante në krah Emir Kunadhen.

Yzbashi Asllan kishte dy vjet që endej me Emir Kunadhen dhe kishte hedhur në defterë emrat e djemve të tri kurave. Të tri kuratë kërkoheshin për nizamë. Urdhëri i Hysni Pashës, Valiut të Janinës ishte që të dërgoheshin në Skelë nizamë se po vinte nga Ordija e Shtatë vapori "Daut"

- Nata u verbon shikimin, natën duhet të veprojmë - u tha Kajmekami Çollak, zabitëve që kishin ardhur në kalanë e Nivicës për të kapur në befasi djemtë e kurasë që do të shkonin nizamë.

- E kanë bërë zakon të ikin pa u gdhirë, janë si vllindet njerëzit e këtij vendi - tha Yzedin Takijexhiu, dizdar i kalasë së Nivicës dhe komandant i zebekëve.

Në Kurvelesh kishte filluar operacioni i "Gjuejtësit e ketrave".

Ishin dërguar në malësinë e Kurveleshit koshalle e zebekë sepse disa herë vapori "Daut" vinte e ikte bosh. Ordija e Shtatë kishte boshllëqe në efektivat e saj dhe kërkoheshin nizamë. Mungesa e nizamëve i rëndon frymëmarrjen perandorisë - thoshte Valiu në një bujurlldi që i dërgoi Kajmekamit të Progonatit.

U vunë në kërkim të gjithë për të kapur në bafasi djemtë e kurasë.

- Në mëngjez herët dalin nga fshati dhe humbasin në Shkrepa - i shpjegonte yzbashit të Koshadhës Emir Kunadhja, një ish kryengritës që ishte vënë në shërbim të Dizadarit të kalasë të Nivicës.

- Atëherë, asnjë lëvizje, as zë e as zhurmë, forca e kurthit është e fshehta jonë. Kujdes, se për nur të Islamit s' do ta fal as nizamën më të mirë po të sillet si leshko., zini shtigjet e rrugët çark në çdo rrugicë, në çdo portë shtëpije, kudo çarqe ... Pa çarkun mos prit të zësh kunadhen, është kështu yzbash Asllani?! Yzbashi i defterëve, Asllan Fesati lëvizi prej vendit, u përkuil, nderoi e tha:

- Këta dinsëzët t'i shkrehin çarqet, shkelin në ato shtigje, ku s' të shoh syri.

Yzbashi Asllan i ngjante një voze. Duke u endur nëpër stane ishte dhjamur e rënduar. Ai kishte për detyrë të mbushte defterë dhe të interesohej që kartrat e djegura të nizamëve që vinë nga Ordija e Shtatë tu njoftoheshin familjeve. "As me vendin e komandantit të koshadhës për Vilajetin nuk e ndërroj këtë detyrë, ku ka më rehat, jetoj midis bulmetit e mishit, po më mbyl dhjami e rushfeti, kjo është punë për mua?" - thoshte me vete Asllan Fesati, kur zebekët përgjonin nëpër shtigje për të kapur djelmosha për t'i dërguar nizamë në Jemen.

2.

*"Në Rexhin e prunë kaluar
Me bezeliqe në duar
Me litar në kraharuar".*

- Bah! Ç'më shohin sytë? Ku është rritur ky tigër?! pyeti yzbashi Asllan.

- Ka berë zullum çausi Hysen? Kush është ky ari?

- Djali i vejushës Sorkë, - shpejtoi t'u flasë çausi me emrin Hysen, me sytë të djaloshi i lidhur këmbë e duar, i mbërthyer majë

kalit.

- Ehë, ka çarqe të rënda dovleti ... Yzbashi Asllan fliste i gëzuar. Birbil Shakua i lidhur këmbë e duar qëndronte majë kalit. Të dy e shikuan njëri tjetrin vëngër.

- Më në fund të shtira në kurth o djali i Sorrës së zezë. Ç' me shikon ashtu sikur do ta më shqyesh? Birbili nuk foli.

- Shtinie më të tjerët në kala. Më parë shëtiteni, po, po, shëtiteni që ta shikojnë ujqërit e tjerë të zezën që i pret.

Çaushi Hysen kapardisur ecën në drejtim të fshatit. Dëgjoheshin çapet e rënda të këpucëve të patrullës dhe gjurmët e kalit. Birbili i lidhur shtrëngonte dhëmbët, u hidhte bashkëfshatarëve që e shikonin vështrimet e vëllait, ndërsa zebekëve shigjeta shponjëse.

- Ky është ujk, vallahi ujk - murmëriti nëpër buzë Kajmekami Çollak, Dizdari i kalasë, yzbashi Yzedin heshti ...

- Kokëshkëmb, gur për kokën tënde i bërë të gjitha, ç'fitove - i tha Emir Kunadhja. Birbili e vështroi i habitur. Nuk i besohej që një ish kryengritës të arrinte gjer në atë shkallë, ti shërbente hasmit.

- Ja sjell mentë në kokë Ordia e Shtatë - tha yzbashi Yzedin. Birbilin e shtynë brenda portës së kalasë.

- Bëri dëm? - pyeti yzbashi Yzedin, komandant i kalasë.

- Ulëriu si ujk, - tha çaush Hyseni, mënd e mbyti një nizam.

Kaloi aty një grua me tumane që kapërxeu rrugën dhe mori shpatit të malit. Mbante në tërkuzë një fëmi, një tjetër përpara në duar, dy të tjerët i hiqte përdore. Kalonte nëpër dredhat e një rruge në shkëmb, mbi shpellën me Qiell. Fëmijët i vinin me rradhë, njëri pas tjetrit gjer te më i vogli që ndukte gjirin e nënës. Më të mëdhenjtë e ndiqnin pas si sorqeth të vegjël nëpër shtegun e gurit. Kajmekami i numëroi fëmijët.

- Kam thënë unë - tha Asllan Fesati, - këto lindin, i rrisin e pastaj kur marrin këmbë humbasin të gjithë në shkrep. Syri ynë i sheh këta vetëm kur janë këlyshë të vegjël dhe kur plaken. Ne s'jemi në gjendje t'i marrim nizamë, të paktën një në dhjetë vetë.

- Është vend i egër - shtoi Yzedin Takijexhiu, yzbashi i zebekëve dhe dizdar i kalasë së Nivicës.

- Jezitit i tregohet vendi me tehun e pallës - i tha kajmekami.

Këtu duhet të mbeten në tokë zhaba dhe një qiell qyq. Ndryshe është t'u djegësh shtëpitë e grunjaret e ndryshme t'u rjepësh lëkurën. Kasollen e bën përsëri, kurse dy lëkurë allahu nuk u ka dhënë

njerëzve. Ordija e Shtatë është xhenet për të bindurit dhe xhehnem për dinsëzët. Ka thënë Padishahu që ata të Arnautit istanit mi degdisni në Jemin.

- U bëftë e Padishahut - thanë me një zë të gjithë dhe u përulën, si të faleshin në xhami.

Brënda kështjellës djelmoshat e kapur bënin zhurmë.

4.

*“Dhe kush do t’i kthehet shtëpisë
Me gjysma të terezisë
Nga avazet e borisë.”*

Tingujt e borisë që vunë në rresht nizamët e zebekët e kalasë të Nivivës trëmbën “nizamin” e fshatit me rroba zhele. Ai mori vrapin të ikte.

- Kapeni atë, kapeni! - foli kajmekami Çollak që nga bedenat e kështjellës. Ai vrapoi aq shpejt sa edhe vrapuesi më i mirë s’do t’ia arrinte.

- Përse u treëmb ai nga tingujt e borisë? Ai është arratisur nga Ordia e Shtatë. U end një vit shkretëtirave gjersa erdhi në vendlindje. Ishin nëntëdhejet e dy djem në atë kura, pesë u kthyen të gjallë, të tjerëve u erdhën nga Ordia e Shtatë kartërat e djegura. Njëri prej tyre që u kthye është ky që u tremb. Me qesëndi e quajnë “nizami i fshatit”.

Nizamë e koshadhët nuk e njihnin njeriun që vraponte. Thërrisnin:

- Ai bën për asqer, kapeni atë! E qëlluan me pushkë. Përsëri thërritnin: Kapeni! Kapeni! Njeriu që mbante borinë në dorë hyri në shkëmb. Aty ku shkeli ai, të tjetër s’mundën. Po zërat vazhdonin: - Kapeni atë, kapeni! ... Ai ecte në shkëmb. I ishte zgjuar instikti i vetëmbrojtjes në atë shkallë që medoemos donte të shpëtonte.

- Ku shkon lumzi, - psherëtiu një nga pleqt e fshatit, do të gremiset në humnerë.

Yzbashi i zebekëve të kalasë së Nivicës Yzedin Takijexhiu nuk guxoi t’i tregojë Kajmekamit për njeriun që vraponte në shkëmb.

- Ai bën për asqer. Kapeni atë! Ai është mace e egër, të kapet! - tha kajmekami Çollak Zylyftar.

Koshadhët iu afruan shkëmbit, por asnjëri nuk guxoi ta kapte,

Ishte vend me rrezik. I flasin në emër.

- Mos i folni në emrin e tij - u tha Emir Kumadhja - ai nuk përgjigjet, kur i thërret në emrin e tij. Ai e ka harruar emrin e tij.

- Po si t'i flasin?

- Asqer Dovleti i Ordisë së Shtatë.

- I flisni ashtu - urdhëroi Kajmekami i Progonatit.

I folën njeriut në shkëmb:

- O asqer i Dovletit të Ordisë së Shtatë! - O asqer Dovleti i Ordisë së Shtatë!

Ty, ty! - oshëtiu shkëmbi nga tingujt e burisë që mbante me vete i fshehuri në shkëmb. Ai kishte bori.

- E solli nga Ordia e Shtatë, e la mendjen në Jemen dhe pruri shtatin dhe borinë - foli më i moçmi i fshatit.

U bë heshtje ...

5.

Rekrutët e mbledhur gjatë operacionit "Gjuajtësit e ketrave" do të niseshin për në Ordinë e Shtatë. Nën dritaret e shtëpive të Rexhinit e të Nivicës përgjonin nënat e motrat. Pritej të niseshin rekrutët e rinj. Nizami që niset për në Jemen dhe i vdekuri përcillen më ulërimë.

U foli nizamëve të rinj imami i taborrit. U tha fjalë dhe u lexoi pjesë të kuranit. Rekrutët qëndronin si të shushatur. Imami u foli gjatë nizamëve duke menduar se fjalët do t'ua lehtësonin brengën. Por, edhe mbas fjalëve të imamit nuk i pa ndonjë ndryshim në fytyrat e zymta të rekrutëve. Ende pa mbaruar fjalën imami i Ordisë, disa djelmosha u mblodhën kokë më kokë. Njëri prej tyre, Birbil Shakua ia mori këngës. Ia mori këngës Birbili dhe ia kthente një djalë Niviciot.

- Birbil, o xhani i nënës - foli nënë Sorka te dritarja.

- Birbil! - murmëritën buzët e vajzës Hiro.

Birbili vazhdonte këngën:

*Qani nëna, qani motra
se neve ma mori llota,
Medet, o shok, medet
Sos do të vemi në kurbet*

6.

*U bëni nizamëve të rinj vrapime
Vrapi e trullos nizamën e ri.*

Nizamët e rinj i prunë në kështjellën e Porto Palermos në breg të detit. Brënda nureve të trasha të kështjellës i mbanin mbyllur si zogu në kafaz. Birbilit iu kujtua kur zinte thëllëza dhe i mbante të mbyllura në kuvli. Ai ndjeu frymëmarrjen të rëndë, i dukej sikur muret e kështjellës peshonin mbi gjoksin e tij. Tha me vete: “Kurrë s`kam për të mbajtur më thëllëza në kafaz”.

Kështjella hijerëndë i shtypte me hijen e saj. Ajo ishte më tepër burg se vendbanim.

- Këtu do të qëndrojmë gjersa të vijë vapori “Daut” - u tha yzbbashi Asllan. Me nizamët e rinj kishte punë yzbbashi Asllan. Ai endej nëpër bylykët, lexonte emrat e bënte shënime me shkronja që u ngjajnë insekteve të tokës. Diku shkruan: “Nizamë për Ordinë e Shtatë.” Kur mbaroi Asllan Fesati, u foli nizamëve imami.

Ditët e tjera bylykët i nxorrën në stërvitje ... As vapa dhe mundimi nuk ua vret dëshirën çaushëve për t`u bërë nizamëve të rinj sa më shumë vrapime. Birbili e kuptoi që ushtria qënkej e çaushëve. Tha me vete: “Zot i nizamit qënka çaushi”. Çaushët bënë sipas porosive të zabitëve dhe zabitët sipas porosive të yzbbashit Asllan që thoshte:

- U bëni nizamëve të rinj vrapime. Vrapi e trullos nizamën e ri.

Natën nizamët e rinj mund të merrnin pak frymë. U dha lajmi se pritej të vinte vapori “Daut”.

Nizamët e rinj mbliidhen në Kështjellë. Aty, në mes të errësirës, ia nisën këngës. Zbrazej në këngë dhimbja:

*“Do të shkojmë te Moll e Kuqe
Do bëjmë talim me supe.
Do të na flasë bimbashi turçe
Neve turçe nuk dimë.
Do na lozin kamzhinë.”*

7.

*Vjen vapori zeherlli
Nëpër det si mal i zi.*

Deti Jon bënte tallaz, nxinte. Dallgët po vinin radhazi, përplaseshin me forcë mbi shkëmbenjt e zbrapseshin të munduara. Çdo gjë rreth kalasë dukej e trishtueshme.

Anash mureve të kështjellës kalonte i shoqëruar një njeri i lidhur, ende i pa veshur me rrobat e nizamit. Syri i stërvitur i yzbashit Asllan e pa atë.

- Kush është ai? - pyeti çaushti që foli.

- Ai u përpoq të arratiset - tha çaushti.

- Të ndëshkohet sipas elifeve të Ordisë së Shtatë - tha me rreptësi Asllan Fesati dhe u largua. Pas pak u dëgjuan tingujt e trumpetave.

- Mësohuni me trumpetën, ajo është nanurisja e nizamit - u tha nizamëve të rinj imami. Yzbashi Asllan doli përballë bylykut të nizamëve e thirri:

- Nga dita e somte jeni të regjistruar në tre defterë si nizamë të Ordisë së Shtatë. Ja këtu u kam të gjithëve, në këto hejbe. Rregullorja e Ordisë së Shtatë për nizamën që kërkon të arratiset parashikon: prerje të qafës me pallë dhe varje në litar. Po ky jezit as do të pritet dhe as do të varet. Një dënim tjetër e pret. Kur je afër ujit e në kështjellë, rregullorja e Ordisë së Shtatë parashikon mbytjen e të dënuarve në ujë. Në rregullore ka disa lloje mbytjesh: "Mbytje e shpejtë, bëhet atëherë kur të dënuarit i lidhet guri në qafë dhe humbet në fund të detit. Mbytja e ngadalshme bëhet atëherë kur ... Mbytja me pikë uji në kokë bëhet kur jeton i dënuari në qeli të kështjellës". Eshhtë mbytje e rehatshme por nuk ia kemi ngenë të presim. Ky do të vdesë nga uji i kripur i detit. Po, po, nga uji i kripur i detit."

Nizamët e prunë buzë detit. Qëndronin të heshtur, me vështrim tutje, mbi detin. Deti nxin. Deti, ashtu si rrëmben dhe e baltën nga bregu, rrëmben edhe njerëz.

- Deti! Lubia e madhe. Erdhi vapori "Daut".

Y y y! Y y y! - lëshoi grahamën korbi i zi në det.

Nizamët si të ngurosur, si shkëmbenjtë rreth themeleve të kështjellës qëndrojnë grumbull e në heshtje përballë detit. Një zë e thyen heshtjen. Njëri i foli në emër Birbilit që ishte ulur mbi një gur

të bardhë në breg.

- Eja Birbil, eja ta marrin një këngë. Ai nuk lëvizi prej vendi. Ata e filluan këngën. Ai dëgjon:

*Do na djegë e shkreta vapë.
Si zor të kthehemi prapë.*

Si i delte ashtu zëri i marrësit si ulurimë rrënqethëse. Përse ia pret ashtu prerë tjetri. E kthyesi, ç'që ajo që bënte ai? Ishte këngë ajo që dëgjonte apo vajtëm. Kënga ngjante me kujet e mandatëve. Një me ulërimat e nënave e të motrave të nizamëve ... Mos ishte ajo këngë letra e djegur që vinte nga Molla e Kuqe për nizamët e rij që ishin mbledhur kokë më kokë? Ajo nuk ishte këngë por ulërimë. Ai e ndjeu si asnjëherë tjetër pikëllimin e ndarjes. Në çastin e ndarjes edhe bebëza e syrit e më të fortit loton. Po në sytë e lebërve, pas vitit dyzeteshtatë lotët ishin tharë. Sa do të duronte Labëria teshun e thikës në fyt si delja te kasapi? Ajo do të ngrihej. Me siguri që do të ngrihej. Po kur?

Birbili i mpirë nga këto mendime pyeti: "Kur do të ngrihet Labëria, kur?!" Desh të godiste ballin e tij. ta godiste gjoksin me grusht. Ai filloi të kuptojë që, një nga shkaqet se mund të përseritej dyzeteshtata e shtyri Valiu e Janinës ta zbraste vendin nga forca e pallës, të mblidhte sa më shumë nizamë në Labëri. Kishte dëgjuar se Valiu i Janinës kishte thënë:

- Kush e heq nizamën prej vendit, ka nxjerrë shejtanin nga shtëpia.

8.

Lodra e Ordisë së Shtatë I vë mend nizamit.

Disa zebekë e lidhën nizamën që ishte arratisur në drurin e rjetës që ulet në det, një rjetë nga ato që kapin peshqit.

Yzbash Asllani dhe shënjë që i lidhuri në drurin e gjatë të lëshohej në ujë. Zhytej thellë e prapë nxirrej, sipas shenjave që bënte Yzbashi Asllan. Sa herë e shtynin në ujë, yzbashi e çaushtë gajaseshin me nizamën që përpëlitej, kurse nizamët e rinj zbeheshin.

- Iku në udhë të shejtanit, prandaj duhet të vdesë edhe në

barkun e shejtanit - u tha nizamëve të rinj yzbashi Asllan.

Dy çauhë të mëdhenj e zhytën nizamën në ujë, e mbajtën aq sa deshi yzbashi Asllan dhe nxorrën. Nizami u lodh; nxorri ujë, hapi sytë, ashtu si bën një i therur, u koloviti në rrjetë si peshku kur e nxjerrin nga uji. Zë nuk nxorri.

- Mirë, ashkosun. Eshtë lezet, për allah, lezet i madh dhe i pëlqyer. Ashkosun! Ashkosun! Kështu edhe trushkulurve u vinë mentë. Nuk guxojnë të largohen nga bylyku i tyre. Ka ligje Ordia e Shtatë.

- Egërsirat janë më të buta kur shqyejnë delen - foli Birbili.

- Kujdes, Birbil, çauhët përgjojnë - i foli tjetri në krah.

Nizami pranë ujit sa u përmënd përsëri u fundos dhe prapë e nxorrën.

- Vëllai ynë - tha Birbili dhe u drodh në trup e në shpirt.

Nizami përpëlitej si pula kur i pritet koka. Yzbashi Asllan gajasej.

Mbllaçit fjalë:

- Lodër, për allah lodër e bukur! Lodër e Ordisë së Shtatë që i vë mend nizamit.

Birbili kafshoi gjuhën. Afër tij ishte një çauh me këllëç në mez. Birbili i afrohet, bën ti hidhet që t'ia marrë për të hyrë në ndeshje me mburravecin Asllan. Sa herë ia hidhte sytë yzbashit Asllan i vërshonte gjaku e bëhej gati t'ia hidhej. "Pallë ka ai për mezi, pallë do të rrëmbej edhe unë" - tha. Yzbashi Asllan kishte edhe pisqollë me serm kurse Birbili ... Lëvizi ngadalë dhe ia hoqi tjetrit pallën nga këllëfi.

Çaushi nuk u përmënd për pallën që i mori Birbili. Kur yzbashi Asllan urdhëroi ta zhytnin nizamën në det Birbili i shkrepëtinë sytë dhe u turr drejt tij. Tehu i pallës së yzbashit sa godiste mbi një gur nxirrte xixa. Të dy u nxeën e secili donte të merrte kokën e tjetrit.

Birbili mundi ta dallojë që ai ishte i ngadalë në rrotullim, kuptoi që yzbashi Asllan rrotullimin e bënte ngadalë, e pengonte barku i madh. Ai pikërisht në kohën që rrotullohej e preu me shpatë. aq sa s'kishte përse ta godiste së dyti. Rrëmbeu defterët e rëndë me emra të nizamëve dhe i hodhi me rrëmbin në thellësinë e detit dhe vrapoi të ikte. Yzbashi Asllan i përgjakur thërriste: "Defterët! Defterët!" Ishin shkruar në ata defterë emrat e disa kurave të djemve të Labërisë.

E qëlluan Birbilin me pushkë dhe iu vunë prapa. Birbili mori të përpjetën e malit. Ditën t'etër Birbil Shakua e hidhte vështrimin nga

malet, malet i kujtonin kryengritjen. Kryengritja erdhi në sytë e tij si një zjarr i shuar. Korbi i zi, vaporri me emrin "Daut", dukej si një pikë e zezë në det që gjithnjë largohej. Ai u ul te një shkrep në mal dhe sodiste vaporin "Daut" deri sa pika e zezë i humbi nga sytë.

- Iku, fshami. Ndjeu t'i dhëmbë në gjoks ... I rrëmbeu "Korbi i zi" Labërisë loçkën e zemrës ... Eh vapor "Daut" kusar! - murmëriti nizami i arratisur.

- Eh vapor kusar!

IV

1.

"I shkreti Demo Idriz U godit sisë më sisë"

Birbili u end si i verbër. Ditën delte në shkrep, kurse natën strukej nëpër kasolle. Nuk ishte e lehtë vetmia, errej e ghdihj i lagur. Në Rrëzomë, në këtë fushë të ulët, afër detit, binte për ditë shi, në male borë. Një ditë sytë e tij kërkuan shtëpinë e një kryengritësi të vrarë me Hodo Nivicën në Sheshin e Kamenicës (Palavli).

Demua - tha me vete birbili. Ai e kishte parë atë djalë në përlëshje. Në dritën e syrit i kishte mbetur trimëria e Demos nga Vergoi. Birbili e kishte çuar trupin e djalit të asaj shtëpie mbi kalin e tij. Ishte goditur luftëtari sisë më sisë me plumb.

"Aty duhet të trokas, aty!" - tha Birbili dhe mori drejtimin nga fshati Vergo.

Nata u bë edhe më e zezë. Ai doli nga shpella dhe eci shpatit të kodrës. Në fund të kodrës, e ngjitur për shkëmbi ishte shtëpia e Demos. I erdhi rreth avllisë. Ngjiste erë e binte shi i përzier me borë. Zhurma e erës e shuante trokthin e patrullave të koshadhëve. Qëndroi një kohë në heshtje. Në shtëpi kishte dritë. Ende të zotët nuk kishin rënë në gjumë.

Birbili trokiti lehtë në portë. Asnjë përgjigje. Shiu binte me kanaçe. Të flohtit i shkonte në palcë, uria e gërryente. Nuk dinte ç' të bënte. Të fliste? Në fshat kishte koshalle. Bubullimat dhe breshëri që binte mbase nuk i linte të zotët e shtëpisë të dëgjonin trokitjet. Një herë, kur iu ngurmuan qentë bëri të largohej, të fshihej përsëri në shkëmb, por era e rrëmbyeshme, furtuna që filloi e beri të ndërrojë mendim. Trokiti dhe një herë. Mbas derës dëgjoi një zë të lehtë:

- Kush është?

- Një mik - foli Birbili.

- Nga vjen kaq vonë, o njeri? Ç`hall të ka katandisur në këtë ditë?

- Kërko hem nga i huaji, babo, - i tha Birbili.

- Mos jeni ai nizami nga Kurveleshi që preve Yzbashin e rekrutimit me jatagan? Në je ai mos druaj të hysh në shtëpinë e Demos trim, më trego të vërtetën. Ndryshe i vur thembrat andej nga vure ballët, ik, largohu o njeri!

- Më detyroi, pra e preva - tha Birbili. I zoti i shtëpisë hoqi llozin dhe porta u hap. Ulen pranë zjarrit.

- Ulu o trim, na kanë shumë borxhe për të larë, djalë të kam, një si Demon që m`u vra me Hodo Aliun në Kamenicë, mos ki merak, s`të ka për të gjetur koshadha në jetë të jetëve. Birbilin e ngrohte më tepër fjala se zjarri.

Dy muaj të dimrit qëndroi në atë shtëpi dhe u njohën më mirë. Kur i zoti i shtëpisë mësoi se ai në vitin dyzeteshtatë i pruri trupin e djalit të vvarë në shtëpi mbi kal u dha mbas tij me mish e shpirt. Natën që iku, aty buzë vatrës, te shtëpia në faqe të shkëmbit, plaku i Vergosë i thoshte Birbilin:

- Derën e shtëpisë e ke të hapët, mos harro që në këto anë do të kesh gjithmonë miq e shokë ... Eshtë nur jeta e kaçakut nga rëra e Jemenit. Të lehtë s`do ta kesh, por njeriut që më pruri kufomën e djalit të vetëm në shtëpi më bie barrë ti them dy fjalë dhe bën mirë ti vësh vathë në vesh:

- Të dëgjoj babë! Plaku vazhdoi:

- Mos trazo njeri, njerëzit mjaft mbajnë në shpinë Valiun zullumadh të Janinës dhe Ahmed bej gjarpër`n. Si do të vijë halli dilu në krah atyre që janë krahëhapur. Ndih 10 fakirfukaranë dhe asnjë herë mos bën keq.

- Më zëntë buka sytë po bëra ndryshe, babë!

- Do të kërkojnë të tjerë të afrohen, hallexhiu te hallexhiu afrohet, prano ata që s`kanë bërë zullum, ki kujdes mos e ngre hundën, mos kërkë të dalësh kreu se nuk mban samar në kurriz labi, biro!

- Ashtu do të bëj.

- Mundohu ti mbash gjallë në shpirtin tënd e të shokëve të tu kërkesat e kryengritësve të Gjolekë Kuçit.

- Nuk shkel mbi gjakun e shokëve të mi, babë!

- Palla jote filloi mbarë, zëri yt eci përpara gjurmës tënde. Mos harro që palla jote preu osmanlli, preu një yzbash të Hysni Pashait. kjo

është shënjë e mirë, por palla që pret vetëm një herë dhe bie në gjumë mbetet pa zot. Kujto bir ç'këngë këndon Labëria për Leskodukajt e Bolenës, për Sadedin Memushin e Zhulatit. Sadedin Memush një herë ka bërë nëna. Ai i qëndroi besnik deri në fund kryengritjes të Gjolekës të Kuçe. Pushka e Sadedin Memushit ndriti tërë kohën. kurse pushka e atij qenit që të kam folur, Myslim Hajdutit u përnuar dhe s'ë mori njeri prapa. Mos pandeh se e ke jetën të gjatë pizeveng Myslimi. Jo bir, jo! Me sot e me nesër. Do të gjëjë Pashai njerëz shpirtzinj që kanë për ti ngrënë gurmazin. Plaku e përcolli Birbilin gjer te shkambi buzë Gurrës duke i uruar:

- Diell raftë mbi gjurmën tënde, o bir!

Hija e Birbilit humbi tej shkrepit ...

2.

*"Më mirë jetoj si ujku në shkrep,
se sa të vdes i lidhur në qeli, nga pika e
ujit në kokë."*

Malet e Kurveleshit, në ditët që arriti Birbili, ishin ende të rënduara nga bora. Bardhësia, në ditët me erë e thëllim, bëhej më shkëlqenjësë. Të ftohtit nuk durohej. Në hapin e parë kaçaku ndeshi në dy armiq, koshadhën dhe dimrin. U struk në shkëmb. Jetonte i vetnuar duke përgjuar anë shtigjeve e rrugëve fjalët e njerëzve. Atyre fjalëve të shkëputura nga njëra tjetra, që dëgjonte, mundohejt u bënte lidhjen. Një lidhje të vetme. Njëëzëzit përsëritnin fjalët: Koshadhë, taksidar, memurë, zebekë, xhelepçi, topjakth, kajmekam, fukarallëk, shpirt ... Këto i dëgjonte më shumë. Nga fjalët i lindi dëshira të dinte ç'thonin edhe për atë. Mendoi me vete. Vërtet ç'thonë njerëzët për mua? Mos më quajnë me atë emrin e ndyrë kusar? Ashtu si thonë për Myslim zgjeben? Jo, jo! E dinte që ajo që bëri, duke vrarë një osmanllë, në Kurvelesh e në gjithë Labërinë nderohej. Ai nuk kishte vrarë një kaftanas si Gjoleka, por një vrasës, atë që i rrëmbente Labërisë loçkën e zemrës dhe ia përcillte tutje. Kishte vrarë një yzbash mburravec që Pashait të Janinës i kishte djegur shumë. Ndaj duhej të qëndronte larg syrit të koshadhëve e zebekëve. Nga njëëzëzit dëgjoi se tellalli në Janinë, në Delvinë e Ergjëri, kishte folë ditën e pazarit: "Hysni Pasha, Valiu jetëgjatë i Janinës, i jep njëmijë lira turke atij që do t'i bjerë të prerë kokën e nizamit të arratisur, Birbil Sharkos." Ndjeu diçka të

pajetuar tjetër herë. Me kokën e tij kishte filluar të merrej vetë Valiu i Janinës. I erdhi mirë që filloi të merrej me të Valiu. Bëri një krahasim të Valiut me Ordinë e Shtatë. Si njëri dhe tjetri i kërkonin jetën. Të kesh armik direkt Valiun e Janinës ishte një gjë që Birbilin e krenonte, por në çdo hap që do të hidhte e kishte kokën në torbë. Tash e mbas koshadhet e zebekët do ta ndiqnin për gjurmë. Duhet të bënte kujdes. Duhej guxim. Trimëria dhe frika jetojnë krahas. Një çast iu afrua edhe më tepër hija e frikës.

Një herë kishte ndodhur që një kaçak, i njohur për trim e që bëmat e tij ishin vënë në këngë, falë guximit kishte shkrehur shumë prita por një ditë, kur kapërxente nëpër një shteg të ngushtë të guvave të Nivicës, i brofën në befasi te këmbët një tufë thëllëzash dhe aty i ra arma nga dora. Nga ky çast u veçua nga të tjerët. "Nuk bëj për kaçak" - tha dhe iu nënështrua fatalizmës. Murmëriti me vete: "Nga kjo duhet të ruhem."

I vetmuar Birbil Shakua bluante mendime. Iu kujtua Budo Bredhi. Budua nuk e mësoi të priste vetëm me pallë. Ai i fliste për frikën dhe trimërinë. I kishte thënë babë Budua: "tri frikësime hyjnë në shtatin e njeriut: njëra i hyn ndërmjet lekurës e mishit, një tjetër ndërmjet mishit e kockës e një tjetër ndërmjet kockës e palcës. Nga e fundit zor që shërohet njeriu." Po deri sa kishte guxuar të hynte në ato ndeshje të pabarabarta në anën e detit e ndjente që nuk i shkonte për shtat ajo fjala e fundit. Ai i kishte thënë frikës tutje në moshë të vogël. Po trimëria rritet duke prerë me pallë. Në fund, sikur i mbaroi ato fjalë por truri filloi të bluaj diçka tjetër. Vetmia e bën kaçakun njeri që murmërit me vetveten. I pruri edhe një herë në mend fjalët që dëgjoi. Valiu kishte nxjerrë për atë një bujurllidi të veçantë. Foli nëpër buzë, përtypi nëpër dhëmbë, fjalët:

- "Faleminderit o Pashë, kur nxjerr bujurllidi të veçantë për mua më bën mirë".

Një nga ditët dëgjoi dy çobanë t'i flisnin njëri tjetrit:

"Dëgjove, Birbil Shakua u bë Gjolekë!"

- Unë Gjolekë?! E kishte parë Gjolekën në krye të Armatës Kryengritëse. E kishte parë në Grykën e Kuçit kur punonte pallën. E kishte parë afër, shumë afër, e me mend tha: "Gjolekën një herë e lindi

1) Kur një njeri veçohet nga të tjerët për trimëri në Labëri i thonë "U bë Gjolekë".

nëna. Si mund të jem unë Gjolekë? Ku Gjoleka e ku unë!...” Desh t’i ngurmohej atij që foli: “Jo, jo! Mali mbetet mal dhe Gjoleka mbetet Gjolekë! Atë s’ mund ta arrij as unë dhe as të tjerë. Gjoleka ... Gjoleka ... Gjoleka!”

Fjalën “U bëre Gjolekë” së pari herë ia tha edhe një nga Zhulati, Asllan Gjoça. Më vonë ia thanë atë fjalë dajët e tij, në Golem dhe ja ... Ai u bë gjak nga fytyra, e rrëmbeu turpi.

Më vonë dëgjoji që fjala “U bë Gjolekë” ishte përhapur në gjithë Labërinë si një epitete për çdo njeri që merrte guxim e kundërshtonte me armë pushtuesin.

E ndjente se duhej t’i shmangej syrit e veshit të njerëzve. Me kokën e tij kish filluar të merrej Valiu i Janinës dhe duhej të bënte kujdes. Lëvizti prej vendit. Eci shkrepit me hapin e shpejtë e të lehtë të sorkadhes, me syrin e veshin në përgjim dhe me dorën te palla.

3.

Nuk mbaron Ordija nga tehu i një jatagani Atëhere ç’duhet të bëj?!

Birbili u struk në shkrepat pa shtigje. Jetonte në vetmi të plotë. U mësua të flasë me vetëvete.

- Jam unë kaçak dhe kryengritës apo thjesht një nizam i arratisur, që në mos sot, nesër, do të më bjeri këmba në kurth. Ika nga ushtria, mora malin, po ç’drejtim të ndjek?!

Koha është me mjegull dhe më duhet t’i njoh shtigjet. Kot s’pyes veten:

- Ku shkoj?! Hë pra, ku shkoj?!

Nuk dua t’ia bëj vetes këtë pyetje nga që trembem se nuk mund t’i përgjigjem saktë.

- Ç’ të bëj? Të qëlltoj mbi një pushtues, të vras një zebek nga të kalasë?!

- Ja, vrava katër apo pesë. Mbaron Ordia nga tehu i një jatagani? Mbaron nga plumni i një pushke?! Jo, asnjëherë?!

- Atëherë ç’duhet të bëj?!

Mendime nga më të ndryshmet i shpalosen rrugës. Befas ju duk se ra në shtigje të zëna. Asnjë dalje.

- Ç’ të bëj?!

Ju bë sikur një zë i thoshte:

- Hapat e tua më ngjajnë me ecjen e rrëmbyer të pelës qorre. Nënështroju fatit, ulu në bincën e zezë të kalasë së Janinës dhe duro pikën e ujit në kokë. Nuk je i pari nizam që vdes në bodrumet e Janinës nga pika e ujit.

I strukur në gunë atë zë s`donte ta dëgjonte. Atij zëri s`do ti nënështrohej. Tjetër duhet gjë duhet të bënte. Prandaj sa herë i trokiti ai mendim, aq herë e përplasi me forcë pëllëmbën te balli i tij.

Psherëtiu i lodhur.

- Eh, sa e vështirë qënka kjo punë!

Si thanë ata dy çobanët?

- U bë Birbil Shakua Gjolekë! U bëra?! Eh, si mund të bëhet Gjolekë një njeri si unë që s`kam qenë asnjë ditë në nizamllëk! Gjoleka ishte me mend, dinte të komandonte njerëzit. I fortë në pallë dhe i fortë në mendje, kurse unë? Unë endem si i verbër? Një, si gjithë të tjerët.

Kur njëri nga çobanët tha se Birbili u bë Gjeolekë, tjetri ia priti: Na e bëjmë ka po mos na del viç. Kush ka të drejtë nga dy çobanët që kaluan rrugës?

- Ç`të veçantë kam unë nga ata? Ç`jam unë?

- Një hiç, pjesë e trungut të një lisi pa diell që ndryshket, gur në fund të honit që e mbulon myshku, një qenie e gjallë që endem në shkrepat ku nuk ka jetë. Mbase e veçantë është ajo që më dhuntuan prindërit e mi: Shtati i lartë. Po, po, shtati im. Forca e shëndetit më shtyn përpara. Më hanë duart, kërkojnë të punojnë pallën, më kërkon syri të vë në shënjestrën e pushkës kokën e Pashait të Janinës. E, mendja. Mendja ime s`çan dot, nuk gjen dot shtigje. Mendja ime, derisa nuk shikon rrugë edhe shtigje është e verbër. I duhej Labërisë Gjoleka e Hodua. Ata vdiqën me pallë në dorë. I duhej Labërisë Çelua, po Sulltani e verboi në binca. I duhej imami i mençur e trim, Budo Bredhi, por Valiu e syrgjynosi dhe humbi pa nam e nishan në Konjë.

Hodhi veshtrimin te armët e tij dhe iu kujtua zhulatasi i Hotelit në Janinë. Me vete tha:

- Njeri i mençur është. Kur isha në Vergo më dhanë selamet e tij. Ai më dërgoi bashkë me armët edhe selamin dhe fjalën. Më tregoi se kam përpara dy rrugë: Të keqen dhe të mirën.

Po endem vetëm. Rruga që po ndjek s`është e qartë. Pyes veten:

- Cili është shtegu ku duhet të dal, si do të jetë fundi im?.

Bluante në mendje monologë të gjatë. I mbledhur shuk nën

gunën e kaçakut ndjeu sikur dikush, shoku i tij i kryengritjes. Emir Kunadhja i tha:

- T' i hedhim të gjitha pas krahëve, t' i harrojmë ç' na punoi Ordija dhe të nënshtrohemi.

- Bah! Kurrë! Këtë s' kemi për ta bërë.

Foli me zë, si ta kishte Emirin pranë:

- Këtë s' duhet ta bëjmë.

Duket sikur thonjtë na janë prerë, po vetëm duket. Dhe të gëzohen zebekët. Është herët të gëzohet zabiti i zebekëve të kalasë, është herët të gëzohet Kajmekami i Progonatit, Çollak Zylyftari. Do të gjëjmë forca e mënyra lufte, ka njerëz trima të arratisur në malet tona.

Eh, psherëtiu. Ai që i duhej vendit tani ishte Budo Bredhi. Ai dinte të lidhte nyje të forta në litarë, pa këto lidhje çdo hap yni do të dështojë.

E bëri zakon të murmuriste:

- Endem në jetë si guri në rrukullimë. Jeta ime një gur në kaminë që e puth paprerë flaka dhe vetëm flaka.

Pyes vetveten:

- Gjer kur kështu?!

- Mos pyet djalë.

- Kush? Mos më bënë veshët? Ishte ky zëri i brendshëm imi apo i Budo Bredhit?

Më duket se shkrepat digjen paprerë. Edhe stanet digjen. Gjithshka digjet ... Ndjej në kraharorin tim prushin e djegies, të rrëmbimit të shokut e vëllait. Ku i zbriti vallë shokët e mi lubia me emrin "Daut". Në Mollën e Kuqe apo më larg? Akoma nuk dihet. Ende s' kanë filluar të vinë kartërat e djegura për shokët e kurasë time. Kartërat e djegura i bien haberet ...

Syri i tij nuk e sheh mirë Shtegun se bën hije të rëndë Valiu në Janinë. Dhe në çast në vesh, në shpirt, në ndërgjegje i erdhi papritur një mendim tjetër. Me atë mendim donte të jetonte më gjatë. Me vete tha:

- Digjet çdo gjë në Arbëri. Djeg Arbëria jonë prush, si zjarri i kaminës i mbuluar me dhe. Si ky zjarr djeg edhe unë, biri i saj. Flakët e kaminës tresin gurin. Ato s' i shuan dot shiu e furtuna. Ja, këtë nuk e di mirë Valiu i Janinës ... Arbëria jonë ngjan si kamina, digjet në brëndësi. Do të vijë përsëri dita. Patjetër do të vijë. Do t' ja bëjë fora

jatagani ynë. Ateherë ...

Dhe iu kujtuan vargjet e këngës të kryengritësve:

Do të dridhen zebekët në këshjtjellën e Nivicës

Do të dridhet kajmekami në Progonat.

Do të dridhet Valiu ne Janinë

Të gjithë do të dridhen ...

4.

Tradhëtari kurrë mos lind Dhe po lindi, kurrë mos i rrit.

Ditën e fundit të prillit të vitit pesëdhjetë Birbili shullohej nën një shkemb, pa hyrje e dalje. Aty i vetmuar mes shkrepit e ndjente veten të sigurt e ra në gjumë. Në gjumë iu bë sikur ishte rrethuar. U përmend i trembur. Nuk i erdhi mirë që ishte trembur. Edhe në ëndërr kaçaku duhet të shohë trimërinë. Kurse ai ... Eh, - psherëtiu. Nuk është e lehtë kur ke të bësh me një Vali zullummadh.

Ishte duke vëzhguar larg, në drejtim të këshjtjellës ku qëndronin zebekët, kur befi afër tij një njeri. Ai, njeriu fytyrrollë, me hundë pak të shtrembër e vetulla të rralla, kishte sy bojëhiri. Edhe pse ishte ditë me mot të keq, Birbili i dha të njohur. Ai ishte shoku i tij i femënisë, Emiri.

Njerëzit nuk flisnin mirë për Emirin. Pastaj, thuhej se Emir Kunadhja kishte thenë se më bie të marr hak për Yzbashin Asllan. Emiri kishte punuar gjatë për listat e rekrutëve që u dërguan nizamë në Ordinë e Shtatë, ose si i thonë në Labëri "Ordija e vdekjes".

Emrat e djelmohave të disa kurave qenë regjistruar në librat e Asllan Fesatit sipas kallzimeve të Emirit. Birbili sa e pa afër dyshoi. Emiri ose si i flisnin fshatarët "Emir Kunadhja". Ç'kërkonte Emir Kunadhja? Gjurmën e kunadhes, apo gjurmën e Birbilit? Nuk e besonte që një ish kryengritës të vihej në ndjekje të ish një kryengritësi tjetër. Nuk e besonte që shoku i tij ta gjurmonte. Po ja, e pa nga afër dhe fytyra e Emirit iu duk dy herë më e shëmtuar sa ishte. Emiri dhelpër, njeri që fuste hundën në çdogjë. Thuhej: "Atë që ta bën tëndi, s'ta bën dot i huaji."

Kur vendasit bënë krahasimin e Birbilit me Emirin, thoshin: "Jeton bleta majë malit, jeton edhe miza nën bisht të kalit".

Emir Kunadhja lëshonte nëpër shtigje çarqe. Kurthet i vinte në shtigjet e buzëve e të honeve. Atë ditë ai, në vend që të gjente kunadhen, gjeti në borë gjurmën e nizamit të arratisur. Nuk kishte tjetër njeri në Rexhin e Nivicë që të shkelte vendin si Birbil Shakua, veç Emir Kunadhes. Kunadhe e kishte nofkën dhe si kunadhe i kishte trupin dhe këmbët. Për të thuhet: “Aty ku kalon zogu kalon edhe Emiri”. Emiri është zot mbi tërë malet - e mburrte Dizdari i kalasë. Po Emiri nuk ua vinte veshin lëvdatave. Ai shprehej hapur: “Nuk ha fjalë Emiri, ka të tjerë që u pëlqejnë fjalët. Emiri gëlltit lirën e Stambollit, kur tundet prej vendit stambollesha tundet edhe Emiri! Mos harroni që për lirën luan prej vendit vetë Sulltani e jo më Emiri që dridhet kur i dëgjon tingullin”.

Sa herë që u vunë koshadhja në ndjekje të kaçakut Birbil e duhej të shkelej vendi nga koshadhët e zebekët, hazerxhevap Emiri. Ato që kishte bërë për të tjerët s' do ti kursente as për Birbilin. Ai u kthye me vrap në shtëpinë e tij te shkembï dhe në rrëmbim hoqi teshat e veshi të tjera, nga ato që shkonin me kapele të kuqe me xhufkë. Si kaloi kufirin e padukshëm midis dy fshatrave mori drejtimin për në kështjellë. Njerëzit e pikasën se çdo të bënte dhe i prenë rrugën.

I tha njëri:

- U thafsh si lisi që godet rrufeja po e kallzove te i huaji vëllaun tënd! U thafsh me rrënjë e me degë Emir, dëgjon!

Kurse një tjetër:

- U verboftë nga sytë ai që vë të huajin në gjurmë të djalit që u bë “Gjolekë”.

Fjalët e hutuan, por ja që iu kujtuan lirat ...

- Çokselam! - përshëndeti i papërmbajtur Emir Kunadhja rojen e kështjellës. Donte sa më shpejt të njoftonte se kishte rënë në gjurmën e Birbilit.

- Largohu! - i foli roja dhe i ktheu grykën e armës.

Emir Kunadhja u zgërdhesh dhe u përkul.

- Kë kërkoni? - pyeti roja.

- Dizdarin e kalasë, yzbashin Yzedin.

- Nesër, nuk e shikon që u bë natë? As hyn dhe as del njeri në

kala.

Emir Kunadhja fërkonte duart. Një kokore leshi e mbronte nga thëllimi. Ti priste era hundët e s' mund të qëndrohej. Po Emiri i duronte. Ngulmonte të takonte Dizdarin e kalasë. Një herë roja iu

ngurmua rëndë, e hodhi dorën në jatagan po Emiri edhe kësaj here nuk u zbraps.

- Kërkoj Dizdarin e kalasë, jep shenjë - i tha rojes. Zebeku lëvizi përtueshëm brenda shufrave të hekurta të portës së kalasë dhe diç lëvizi. Në godinën e zebekëve u dha sinjal dhe mbas pak, nën harkun e portës të madhe lëvizi hieja e gjuetarit Emir ...

- E, evlat ç'habere më prure? - e pyeti me padurim Dizdari i kalasë.

- ...

5.

*"Mësoi këngën dyfekut
Ti shpëtosh pritës e shtegut".*

Në agim të ditës, zebekët e kalasë së Nivicës ishin vendosur në prita.

- Shëëët - u bëri shenjë zebekëve me gisht yzbashi Yzedin. Ai e shikonte Guvën e Ujkut. Në krah të saj guri nxjerr ujë, formon një ujëvarë tjetër. Asaj vendasit i thonë: "Dëstila e Gusmarit". Çdo fshat në Kurvelesh ka ujëvarat e tij dhe destilat. Destila e Nivicës, Destila e Progonatit, Destila e Lekdushit. Destila e ... Shkumët e bardha të ujvarave qenë gjërat më të bukura që shikonte kaçaku në këto ditë te ata shkëmbinj.

Andej, te Destila e Gusmarit zbriste një shteg. Aty e hodhi vështrimin komandanti i zebekëve. Pritej që aty të delnin zebekët e çaushtit Hysen. Ata ndodheshin disa hapa përballë guvës dhe çaushtit Hysen rrëshqiti si një gjarpër në drejtim të guvës ku ishte kaçaku. Yzbashi Yzedin kur e pa nuk u përmbajt, thirri:

- Ashkosun çaushtit Hysen! - Ashkosun!? Fjala i mbeti në buzë nga krisma e papritur e pushkës së Birbilit. Jo, nuk është krismë pushke. Ajo ishte krismë e rëndë. Ishte më e rëndë se gjëmimi i krismës së topit Shahin, krisma e topit të dorës që i kishte dërguar nga Janina Birbilit hotelxhiu Nexhip Bedena nga Zhulati. Tre nga pesë zebekët që shkuan në hyrje të guvës dhe çaushtit Hysen u mbytën në gjak, dy të tjerët u plagosën ose ishin trembur. Ata s'bëheshin për gjallë. Pushka top i hapi shtegun kaçakut.

Yzbashi i zebekëve të kështjellës, Yzedini shikon nizamët e përgjakur. Kaçakun nuk e shihte. Urdhëroi të fuqizohej rrethimi.

Kaçaku me fustanellë brofi si një shqiponjë e trembur ... E morën në shenjë pushkët.

- Ai është, ai është, - foli Emir Kunadhja i papërmbajtur por edhe i kujdesshëm që mos të binte në sy që ishte bërë çorës i zebekëve.

Thërritën zebekët:

- Bëhu teslim arnaut Birbil!

Përballë në radhorët e gjelbërt, u pa Ai, duke ecur me rrëmbim nëpër shkrepë.

- S'ka ku shkon, asaj ane s'ka asnjë shtegdaljeje - i tha gjithë shpresë Emiri, komandantit të zebekëve.

- E dua të gjallë arnautin! E dua të gjallë - thirri yzbashi Yzjedin.

Birbili e dëgjoji fjalën e yzbashit. I shtyrë nga goditjet e plumbave ai kalon buzave e honeve të thellë, aty ku s'ka kaluar asnjëherë. Më në fund u struk në shkëmb. Mendoj se nuk do të shkelnin dot aty zebekët. U ngujua te shkrepë dhe u bë sy e veshë. Përgjonte. U befasua. Mendoj që zebekët ishin larg, kurse ata ishin afër, fare afër.

Yzbashi Yzjedin ecejakë, i flet Emir Kunadhes:

- A ka shtegdalje nga humnera ku ka hyrë dinsëzi? Emiri e njeh mirë atë vend, i shpjegon dizdarit të kalasë:

- Edhe zog me krahë të bëhet e të fluturojë s'ka ku shkon. Përpara tij është humnerë e pafund. Fjalët ia shtuan shpresat dizdarit, foli:

- Hapni sytë. Ai është aty, është aty! Rrëshqisni më përpara, e dua të gjallë jezitin!

Zebekët e koshadhet lëvizën këmbëdorazi më përpara. Yzbashi bindet edhe më shumë që ai s'ka shtegdalje. U thërret zebekëve:

- Të kapet i gjallë!?

I thërret Birbilin:

- Bëhu teslim o hairsëz!

6.

*Të thirri yzbashi,
Të thirri tri herë.
Nдалu Birbil, ndalu
Nga shkëmbi mos bjerë.*

Tej atij shkrepri fillonte humnera, çahaj mali si ta kishte prerë tehu i një shpate. Ishte një shkrep guri e hon i thellë. Çdo zebek që kalonte aty i ngrinte gjaku e bënte: Allah! Allah! Zbrapsej i trembur, s'donte as të përfytëronte atë që kishte parë. Aq të frikshme ishin humnerat. Drejt asaj humnere pa shtegdalje ecte Birbili. Pushkët hidhnn drejt tij plumba. Shtigjet ia kishin mbyllur. Ai zuri vend pas një guri dhe heshti. Gurin e nxiu flaka e barotit. Zebekët afroheshin duke qëlluar. Ai u foli zebekëve:

- Larg, mos u afroni!

Nuk donte ti vriste por zebekët iu sulën me sy të ndezur. Atëhere ai i qëllloi. E zbrazti arautkën, kur i erdhi njëri nga zebekët afër ... Qëllloi. Përmes të shtënave u shty më afër humnerës.

- Për allah ai po shkon drejt varrit të tij, - u tha i gëzuar zebekëve yzbashi Yzjedini Takijexhiu.

Ata i afrohen. I flasin të dorëzohet.

- E dua të gjallë jezitin e Aliut - u foli Yzbashi zebekëve.

Birbili hodh edhe disa hapa të tjerë nga humnera. Shkonte andej edhe pse e dinte që humnera ishte përpara. Vrapoi drejtim asaj dhe mbeti, qëndroi si trup pa jetë kur e pa thellësinë e pafund të honit. Gjysmën e faqes së shkëmbit e mbulonin shkurret, drurët me gjethe dimërore. Gjysma tjetër shkëmb. Në shpinë tytat e pushkëve, përballë humnera. Edhe te njëra edhe te tjetra ishte strukur vdekja. Ajo, si një shtrigë e priste ta përpinte. Hodhi drejt saj një hap dhe iu duk sikur ngriu, u bë edhe ai një copë e atij shkëmbi. Ktheu sytë prapa, qëllloi. Dëgjoi zë:

- Bëhu teslim o Birbil kaçaku! Po kaçaku u humbi një çast nga sytë.

- Ş'ka ku shkon - tha Emir Kunadhja. - Dëndësoni pushkët! - foli Dizdari i kalasë së Nivicës. Zebekët u vunë në krah të njëri-tjetrit dhe morën shënjë.

- Dyfeqisni në hare. Mos e vrisni malukatin - foli me zë të lartë

yzbash: Yzjedin. E dua të gjallë. Do ta çoj vetë në Janinë, aty të vdesë dinsëzi, aty në bodrumet nga pika e ujit më kokë që ta kujtojnë të tjerët e ti binden firmanit të Sulltanit për të shkuar nizamë.

Birbili u ngrit në këmbë. Pushkët e zebekëve nga afër e morën në shenjë. Dizdari i kalasë klithi:

- Mos e vrisni! E dua të gjallë!

Birbili qëndroi në këmbë. U trëmb më shumë nga fjala që dëgjoji: "E dua të gjallë" se ça nga plumbat. Dukej sikur ngriu në vend. Ata afroheshin drejt tij. Ai hodhi disa hapa të tjerë në drejtim të humnerës. Goja e humnerës i bëhej si më e frikshme se goja e egërsirës. Më e frikshme se plumbat e zebekëve. Edhe një hape ndante nga humnera. Një hap i vetëm e ndante nga vdekja.

- Ndiqeni! Nuk do të guxojë ta hedhë atë hap - tha Dizdari i kalasë.

Birbili s'po lëvizte dhe Dizdari i kalasë u bind për atë që tha. Dhe u foli zebekëve:

- E dua të gjallë! E dua të gjallë jezitin! Do ta çoj vetë në Kalanë e Janinës.

I foli Birbilit:

- Bëhu teslim, s'ke ku shkon o dinsëz.

Një diçka u duk sikur u ngrit papritur në fluturim. Ç' ishte ajo? Thëllëzë e malit? Zogu i Shqiponjës? Jo! Ishte Birbili. Ai vuri përpara, kryq arnautkën, dhe u hodh. Fustanella hapet si parashutë, pushka e pengon dhe trupi bie lehtë, sipër kulpërit e shkurreve Birbilit në çast iu duk se iu thyen këmbët, u gjunjëzua ... Por falë shtratit të butë të kulpërit e gjetheve u ngrit në këmbë. E mblodhi veten nga hutimi dhe e ktheu armën nga shkëmbi, aty ku dolën kokat e zebekëve. Zebekët ranë në shehadet, nga e pabesueshmja bënë:

- Allah, allah!

Birbili përsëri i qëlloi me pushkë ... Ndërsa Dizdari i Kalasë të Nivicës vazhdonte:

- E dua të gjallë jezitin! E dua të gjallë!

Po Birbili fluturoi si zog shqiponje dhe u humbi nga sytë zebekëve.

7.

Nga ajo ditë Birbil.t nuk iu dëgjua më krisma e pushkës dhe

i humbi gjurma. Në fillim në Kurvelesh, mandej në tërë Labërinë u përhap fjala së Birbil Shakua ishte vrarë. Në shtëpinë buzë Përroit të Lekës grahën njerëz. Erdhën gra me lot në sy e burra të heshtur. I thoshin nënës:

- Sorkë, moj Sorkë zeza, të hodhi turku mavrinë dhe të nxiu shtëpinë, moj korbë. Të ktheu në qyqe mali moj e zezë! Dikush nga gratë lëshoi kujën dhe fshati i vogël buzë humnerës Rexhini u mbush me ulërima. Po Sorka si Sorka, rrudhi ballin e tendosi vështrimet, thirri:

- Kush nga tanët e pa Birbilin tim të vrarë! Njerëzit mblodhën supet. U tha një ditë se trupin e Birbilit e binin të vrarë në një kalë. Po në vend të Birbilit mbi kalë ishte trupi i një çaushti të vrarë nga Birbili dhe letra që ai i dërgonte Kajmekamit të Progonatit. Kjo i ndezi edhe më shumë fjalët dhe e detyroi Kajmekamin Çollak Zylyftar të niste lajme të tjera:

“Dinsëzi Birbili nuk është vrarë ... Dinsëzi këto ditë bëri hatanë, vrau edhe një çausht tjetër ...” Atë ditë, kur erdhi në zyrat e tij kali me trupin e çaushtit e tërboi kajmekamin, ia humbi fjalët dhe sillej rreth, mbështetej te topi mbi murin e kështjellës e thoshte:

Birbili është bërë hije shkëmbi

Birbili është bërë xhind ...

Lebërit thanë ndryshe: “Birbil Shakua u bë Gjolekë!”

8.

*Kur kaçakut i ngrinë guna,
i ka marrë zjarr shtëpia.*

Murlani në Luginën e trandafilit të Egër frynte më tërbim, buçiste gryka e thellë, “Ç`mënxyrë” - tha Birbili. Ndjeu mpirje të fytyrës, ftohje të nofullave. Në luginë sundon vuvërima e erës. Ai ecën ... Ku shkonte? Nga kurrizet e malit borën e re që sapo ra e rrëmben era dhe mbush pa prerë luginën. Atë e godasin në fytyrë si teh brisku ngarkuar me “miell” të bardhë. Një çast tha: “Mbarova! Përballë ulërin një egërsirë, një ulërimë zvarritëse e ujkut të uritur. “Dimër” - murmëriste, dimër i fortë”. U struk te gërxihi, pushoi pak fryma e erës. Guna i ishte lagur, kishte ngrirë. Kur i ngrin guna kaçakut i ka

marrë flakë shtëpia. U end në shkrep gjer sa gjeti shtegun. Përballë, mbi shkëmb shtëpia e Emir Kunadhës. Birbili ishte i bindur që Emir Kunadhja nuk ishte më ai kryengritësi i vitit dyzeteshtatë që i mori flakë fustani në luftimet në Palavli të Rëzomës së Delvinës. Por mendoi që atë natë të trokiste në shtëpinë etij. Ajo ishte e vetmja shtëpi në fshat që zebekët e koshadhet s'bënin kujdes. Trokiti në derë. Një cast nuk ndjeu zë, foli:

- Emir!

Trokiti më fortë dhe përsëri zë:

- Emir!

Pastaj heshtje. Thëllimi i erës godiste në fytyrë Birbilin. Një cast feksi papritur një dritëz dhe pastaj hapa ... Birbili i dëgjoji hapat që afroheshin. Pas pak lëvizi llozi i derës dhe hapsi lëvizi bravën dhe dera u hap. Ata të dy, Birbili e Emiri u gjendën ballë për ballë. Qëndruan një kohe aty në heshtje e në terr, me sytë të ngulur te njëri-tjetri.

- Do të falesh - i tha Emiri.

Birbili nuk foli. Ai hyri me rrëmbim brenda. Edhe Emir Kunadhja me rrëmbim e mbylli derën që të ndalej furia e erës. Kaçakut i pushuan veshët nga gjëmimet e honeve e vuvarima e erës. Ndjeu avullin e ngrohtë të shtëpisë.

Aty, afër zjarrit të dy ish kryengritës qëndruan gjer në orët e vona përballë njëri-tjetrit. Këmbyen fjalë të sërta:

- Nuk është Valiu i Janinës tapanxhë që ti biesh sa herë të pëlqen - i tha Emiri.

- Nuk të shan njeri kur përdor sopatën kundër ujkut - ia ktheu Birbili.

- S'të ndahet Kajmekami Çollak Zylyftari. Eshtë zot i vendit kajmekami Çollak. Nuk është dudum Kajmekami Çollak si ai që vrau Gjoleka.

- Gjeli e quan veten mbret kur hypën e këndon sipër togut me pleh. Pa ta provojë të dalë nga furriku ku është mbyllur?

- Ç'flet kështu Birbil, e ka dorën të fortë kajmekami Çollak. Të ha me mish e kocka.

- Kur kam zënë ujkun për bishti nuk i trembem qenit.

Fjalët e sërta u ndalën. Ata vështronin njëri-tjetrin ndër sy. Përmes bebëzave të syve këmbëheshin shtiza shponjëse. Heshtën. Në oxhak bubullonte flaka e zjarrit po vatra ishte e ftohtë. E nisën bisedën

nga e para, u përplasën në fjalë. Pastaj Birbili i flet për ditët që jetuan në vitin e kryengritjes, tjetri hesht.

- Mos prit të të ngrohë zjarri i shuar - i tha Emir Kunadhja - harroje kryengritjen.

- Ai zjarr nuk shuhet kurrë - tha Birbili i zemëruar.

- Me se ma provon që plaku im që më ka vdekur u ngjall?

- Nuk prisja të dëgjoja nga ti këto fjalë, si të është fikur në gjoks ai prush që ndezi te trimat e maleve tona kryengritja? Hë de, më thuaj vëlla, si?

- Ç'që kjo që bëre Birbil? - Më mirë të kishe shkuar nizam se

...

- Të vdisja në rërën e Jemenit, ku piqet buka në diell.

- Bëre gabim!

- Bëra ashtu si më foli kjo - i tha Birbili dhe e vuri pëllëmbën e dorës mbi gjoks, në anën e majtë.

- Nuk përmbysët Valiu i Janinës nga një jatagan, Birbil!

- Nuk jam një jatagan, as njëqind jataganë, as njëmijë, por një pyll me jataganë. Kur të zgjohen malet tona njeri i huaji. Emir Kunadhja shtrëmbëroi buzët. Mënyra si bëri ia shtoi zemërimin Birbil, foli qetë e me dhimbje:

- Ehë, tani kuptoj, ajo që më kanë thënë e nuk e kam besuar qënka e vërtetë. Shkule të keqen nga zemra vëlla, jemi rritur bashkë, s' bëhet kjo që po bëni. Ku është parë të ndjeki vëllai vëllain, më thuaj, ku? Preje atë pjesë të zemrës që të është kalbur. Hiqe atë perde që të ka verbuar syrin. Nuk e heq dot? E përse nuk e heq dot? Interesi të shtyn të bësh atë që të nxin fytyrën? Eh, Emir, Emir!

Emir Kunadhja, i drojtur, dëgjonte. Ai heshti, fliste vetëm Birbili. E kuptoi që tjetri s'ia shkulte dot të keqen nga zemra dhe e ndjeu dhimbjen si një shtizë, i kaloi si një neshter therrës dhe u prish në fytyrë. Birbili, me fytyrë prej të vrari e me fjalë lutëse i thosh "Mos vëlla, mos? ..." Po Emir Kunadhja s'kishte ndërmend të ndërronte rrugë. Birbil Shakua, doli nga shtëpia mbi shkëmb duke iu lutur ish kryengritësit:

- Kujto kryengritjen e madhe dhe shkule të keqen nga zemra, vëlla.

I zoti i shtëpisë heshti ...

* *

*

Ditët e tjera të javës moti mori për mirë. Afshi i diteve të pranverës i dha vendit gjallëri. Rojet e kalasë i bënëin sytë katër për ta mbajtur larg tyre të keqen. Ata i mbanin sytë në shtigjet që dilnin prej shkëmbi. Edhe Dizdari i kalasë doli te bedenat e sodiste humnerat pafund të maleve të Kurveleshit. Ai e dinte që aty qëndronte nizami i arraturisur që preu yzbashin Asllan. Ishte përhumbur në vëzhgim kur një vuvërimë ere iu meli fjalën. Një Shqiponjë erdhi sipër kalasë. U avit mbi ata të dy. U duk sikur zbriti me vërtik për ti rrëmbyer në kthetrat e saj. Dizdari vuri dylbinë në sy, sikur do të shihte në trupin e shqiponjës kaçakun Birbil.

- Zog i tmerrshëm - tha Kajmekami i trembur nga era e afshi që lanë pas krahët e shqiponjës. Kur mori veten edhe kajmekami Çollak vuri dylbinë të shikonte. Në buza ka kafshë të egra të trembura.

- Ky zog të shtin frikën - tha përsëri kajmekami Çollak Zylyftari.

- Kurse këta e gdhendin në djep e në prag të portës - shtoi Dizdari i kalasë.

Kajmekamit iu duk sikur zogu i madh e kishte rrëmbyer atë edhe po e endëte nëpër shkrepë për të kërkuar humnerën ku ta përplaste. E largoi vështrimin nga shkrepët e buzat dhe u kthye me vështrim mbi muret e brendshme të kështjellës. U shpreh i lodhur:

- Ma lodhi shpirtin ky kllaçak mali.

9.

*"Ylbere dhe flak' e kuqe
Të digjet nuri mbi supe."*

Birbili ua humbi një kohë gjurmët koshadheve e zebekëve. Ai shtegtoi larg, përsëri në drejtim të Delvinës. Mbas dy muajve u kthye në malet e Kurveleshit. Buji një natë në grykën e Jetëshkurtër, te stani i vëllait të Budo Bredhit. Natën flinte në stan e ditën strukej në shkëmb.

- Mënçurinë e trimit nuk e tregon vetëm palla, i duhet edhe fjala - i tha vëllai i Budo Bredhit. Birbili heshti. Fjala e shtyri në mendime. Këtë ia kishin thënë edhe në vende të tjera. E ndien të domosdoshme të dijë ku po shkon ai vetë, ku po shkojnë edhe kaçake të tjerë që enden maleve shpresë këputur. Lypset të bien gjurmë drite

në hapat që hedhin ai dhe kaçakët e tjerë. Po dritën ai ende e shikon të mjegullt. E udhëheq mendimi që duhet t'i bëjë mirë vëllait e keq të huajit - pushtuesit. Të ndërshkojë kusarin e të ndihmojë të varfërin. Po a qenë mjaft këto?

Kur doli nga gryka Jetëshkurtër u struk te shkëmbi përballë fshatit të lindjes. E rrëmbeu dëshira të ecte nëpër njomishten. Ashpërsinë e flokëve të tij të dredhur e përkëdhel pushi i butë i fletës llapushë të panjës.

E kaloi ditën në vetmi, duke soditur bukurinë e natyrës. I pëlqeu ashpërsia e shkëmbit dhe filladi i pyllit. Ndjeu papritur afër një fëshfëritje gjethe. "Dhia e egër" - tha dhe dorën e hodhi te pushka. U befasua kur i erdhi në shënjestrën e pushkës koka e bukur e një vajze me bistaleca të lëshuara sipër xhupit të shtrënguar fort për mezi, te beli. Pamja e vajzës verboi pushkën dhe të zotin. U drodh dhe e zuri frika gjer e hoqi gishtin nga këmbëza e shkrepjes. Hoqi pushkën i trembur dhe vuri gishtin te buza, i lutej vajzës të mos fliste. Po vajza nuk e kishte parë kaçakun që qëndronte i mbështetur te guri.

"Më mirë që nuk më ka parë" - tha. Në shpatin e malit ishte ndezur krisma e sopatave, dëgjoheshin zëra. Gratë i thërrisnin shoqja - shoqes, ia përcillte shpella shpellës zërin e krismën e sopatës. Kaçaku aty, me çepë të gjata. me feste kaçaku, me silahun në mes, e me arnautkën në dorë.

"Si nuk më shikon", - thoshte me vete. Vajza verbohej nga forca, që ushtronte kur godiste me sopatë me sa fuqi kishte degën e dushkut. Zemra e kaçakut të strukur në shkëmb gufonte. Birbili ndjeu verbim në vështrim kur i erdhi më afër Hirua. Ajo ngjante me thëllëzën që del majë gurit dhe shpupuris pendët. Ai e shikoi dhe harroi që ishte kaçak. Hodhi një gur të vogël, mandej dy-tre të tjerë. Vajza qëndroi një hop. Edhe thëllëza qëndron një hop e mandej ngrihet në fluturim sipër shkëmbit.

- Mos është Birbili - tha Hirua me zë të mekur.

Hiros i vinte mirë që Birbili, i fejuari i saj u bë "Gjolekë". Edhe po të vritej do të vritej në pallë, do të mbetej në këngë.

Ajo iku. Ai u ngurua në vend nga habija. Mbeti aty i pushtuar nga hutimi. Ju pre fryma. Çfarë ishte ajo që i verboi shikimin. bukuria e vajzës apo... Pse e humbi ashtu dhe heshti si vuvi. Në bebëzat e syve qëndronte ende fytyra e saj e bardhë, tiparet e bukura të fytyrës. sytë feksës që ia verbuan dritën e syve të tij. Ndjente afshin e puhisë të erës

së malit, aromën e luleve dhe fare pranë ligjërimin e birbilit zog që se priste këngën.

Kur ngjitej me dru së përpjetës; Hirua dëgjoi që dikush hodhi një guriçkë të vogël para këmbëve të saj. Nuk pa njeri. Eci përsëri. Dhe përsëri një guriçkë tjetër. Kur dolli te dredhat afër fshatit dalloi kaçakun që mori anën e shkëmbit dhe fluturoi në drejtim të shpellave

...

Birbil - tha e gëzuar dhe ndjeu pasiguri në ecje. Për pak e rrëmbeu barra e rëndë. U trëmb edhe nga kaçaku, edhe nga humnera.

- Nënë! - tha dhe një afsh marrëmëndës i erdhi në gjoks.

V

1.

*“Në pyet nëna ç’nuse mori
Tre plumba në kraharuar
Gjashtë në këmbë e në duar.”
(Kënga e Nizamëve)*

Në det u pa një pikë e zezë ... Në fillim ajo pikë nuk tërhoqi kureshtjen e njerëzve. Pika e zezë dalëngadalë zmadhohej. Nuk ishte më një pikë e zezë, por një shkëmb i zi. Njerëzit e qytetit bregdetar e njohën.

- Dauti!. Dauti! - thanë. Vaporit “Daut” kthente në vendlindje nizamët që liroi Ordia e Shtatë. Y, y, y! - u dëgjua grahma e vaporit “Daut”. E njëjtë si dhe grahma e vdekjes.

“Dauti”, ndryshe nga vaporët e tjerë, ishte vapor i lyer me bojë të zezë, siç lyhet një arkivol. Binte pas shtatë vitesh nga Ordia e Shtatë kuranë e parë të nizamëve të liruar. Kuraja e parë e nizamëve ishte thirrur nën armë dy vjet mbas dështimit të kryengritjes.

Nizamët kthehen në vendlindje. Kuverta e vaporit të zi plot e përplot me nizamë të liruar. Vaporit “Daut” sa herë vjen bie me vete zeher¹. Vaporit ka shumë epitete: “Vaporit i zi”, “Vaporit kusar”, “Vaporit zeherli”. Ai i ka rrëmbyer djemtë e Arbërisë në moshë të re dhe i kthen burra të pjekur. I rrëmben djemtë dhe i kthen me fytyrë si t’i përkasin një race tjetër e jo malësorëve lebër fytyrëçelur, të bardhë si bora e Këndrevicës dhe gjak të kuq si lulëkuqja mes gjelbërimit të grurit.

Në kthim zakonisht “Dauti” bie më tepër kartëra të djegura e më pak nizamë të gjallë.

Me këtë vapor udhëton edhe një burrë flokëbardhë, shtatimët,

1) zeher - helm

me mustaqe të bardha e i mbajtur mirë. Ai, gjithë rrugës, vështron me dhimbshuri fytyrat e nizamëve. Kthehet mbas shtatë vitesh nga internimi.

Në kuvertën e vaporit disa djem, ish kryengritës me Gjolekën e Hodon u mblodhën kokë më kokë dhe nisën një këngë. Flokëbardhi kishte vite në Konjë dhe është i përmalluar për këngën.

Vapori çan detin, i afrohet bregut. Malet dhe kënga lartohen. Kënga e shtyn flokëbardhin të kujtojë betejën e kryengritësve. Ai përjeton luftën, ata këndojnë. Mbështetet flokëbardhi Budo Bredhi në parmakun e vaporit dhe mërmërit: "Eh, Hodo, Hodo! Një herë pjell nëna Hodo".

Nizamët e liruar duke kënduar këtë këngë tregojnë se janë të lidhur shpirtërisht me ngjarjet e kryengritjes. Ata lartojnë zërin. Vapori "Daut" bën: Y, y, y! Jetojnë në një vapor kënga edhe vdekja. I afrohen portit të vogël. Ata me zë edhe më të lartë këndojnë.

Flokëbardhi, që kthehet nga internimi nuk u përmbyt më, hyri midis tyre dhe i përshëndeti:

- Tungjatjeta, trima!

- Babë Budo, i folën nizamët. Imami Budo nuk u jep të njohur nizamëve. Atyre ua ka pjekur fytyrën afshi i diellit të Jemenit. Shtatë vite të rreshtimit ushtarak u rëndojnë mbi supe. Stërmundimin e tyre Budo Bredhi e shikon në sytë e vrarë, në fytyrat e rreshkura.

Leshrabardhi Budo, ecën nëpër disa nizamë dhe qëndron te bashi i anijes "Daut". Qëndroi gjatë me vështrim te malet e Labërisë. Ato në fillim iu shfaqën si një bllok i vetëm, pastaj secili mal shfaqti konturet e tij. Nizamët e flokëbardhi të përmalluar përmëndin emëra maflesh. I ka rrëmbyer malli për vendlindjen. Një përmallim e trishtim sundoi në vapor kur u kënduan emrat e nizamëve që u vinin kartërat e djegura. Ata dëgjonin emrat e shokëve të tyre e rrudhnin ballin dhe me vete pyesnin: Nga se kishte vdekur nizamit? Nga plumbi apo prerja me pallë, nga mundimi apo nga sëmundja? Mbi këto gjëra nuk flitej në kartën e djegur. Aty shkruhej vetëm emri i nizamit. Vendi, nga dërgohej letra, tregon se aty ka mbetur nizamit. Asgjë tjetër. Mbi zarf letra është djegur me cigare. Kjo shenjë është mjaft që në derën ku shikon letra të pritët shpresa e të hapet vaji për djalin.

Letrat e djegur vaporit "Daut" zakonisht i bie shtatë vite mbas dates që djem të thirren nizamë, sepse ato arrijnë në një kohë me ata që lirohen. Dhe në bordin e vaporit "Daut" në një kohë bashkëjeton

jeta e vdekja. Ai është vapor fantazëm, vapor i mortajës. Në se gabimisht ka ardhur një herë letra e djegur s'prish punë, vapori "Daut" sjell një letër tjetër të djegur. Ordia e Shtatë është e përpiktë. Ajo e kthen Defterin që i është dërguar me emrat e nizamëve. Në bordin e vaporit "Daut" duhet të jenë aq nizamë sa në ditën që u thirrën nën armë. Ky është rregull. Paçka se për Ordinë e Shtatë ka pak rëndësi nëse janë të gjithë nizamët të gjallë ose jo. Vaporit "Daut" kthen aq nizamë sa ka marrë, as më shumë e as më pak, ca në letër e ca të tretur. Defteri i nizamëve mbahet në anije i kyçur në dhomë të veçantë ... Edhe thesi me kartëra të djegura aty mbahet ... Ja pra bashkë janë, në një vend nizamët e gjallë dhe kartrat e djegura të shokëve të mbetur pa jetë, larg tokës së tyre.

Kur "Dauti" kaloi nëpër ngushticën e Korfuzit, nizamët e liruar u grumbulluan te vendi ku ndodhej qatipi i Ordisë së Shtatë. Qatipi mbante dy defterë në duar. Sapo e pyesnin nizamët ai hap defterin e parë dhe lexon emrin e nizamit.

Hyso Gjeçi nga Progonati ... nisët për në Ordinë e Shtatë në tetor të vitit pesëdhjetë.

- Dua letrën e djegur, letrën, nguli këmbë një nizam i liruar nga taborri i tij, ndoshta ai është i gjallë ... Kalojnë nëpër duar faqet e defterit, e gjen, lexon: "Është vlarë në malet e Jemenit, e ka shkruar Ordia e Shtatë në librin e Shehitëve. Ja letra e djegur ... "Një tjetër pyeti: Dhe hazër xhevap qatipi i Ordisë së Shtatë, hapi defterin e letrave të djegura. Lexoi:

- Selim Gjik Kryqi nga Tërbaçi, mbeti shehit në luftën ... rahmet i pastë shpirti. Është shënuar në listën e shehitëve të Ordisë së Shtatë.

- Mehmet Gjin Leka nga Zhulati mbeti në të njëjtin vend, rahmet i pastë shpirti! Shehit!

- Meto Kunjova nga Bolena, e vrau yzbashi i disiplinës. Në djall i vaftë shpirti. Është regjistruar në listën e dinsëzëve.

- Nevrus Gërxxhuni nga Lekdushi, efektiv i taborit dyzetedy, u gremis në shkretëtirën e Gjarpërit me Zile, humbareqi ...

- Çobo Shtredhi nga Nivica, desh të ikte dhe e varën ... zullumqar. Shau dovetin dhe u var ... Gjendet në defterin e humbareqëve, bashkë me Bedo Resulin nga Zhulati.

- Gjin Gjergji, i biri i Haxhiut nga Gusmari, humbi në Guvën e Lubisë kur po mbushte ujë me kafshë për bylykun, humbi me gjithë

kafshë. Eshtë në librin e meqaresë të Ordisë. Mbetet në regjistrin e humbareqëve ...

Fliste qatipi i Ordisë emra të tjerë:

- Magripi, i biri i Mevludit nga Kuçi, Nexhipi i biri i Veselit nga Golemi, Axhemi, i biri i Bames nga Mashkullora, Çarçani nga Kopaçëza gjenden në librin e hairsëzëve.

- Haxhi Hutashi nga Vërmiku, ka ngrinë nga të ftohtit në malin ... Mbetet në listën e hutaqëve.

- Oj, qatip, aman për kokën tënde, nafaku i zotit, unë jam i gjallë.

- Defteri? - Ku është Haxhi Hutashi nga Vërmiku? - pyeti qatipi.

- Siç më shikon, i gjallë mbeta por ...

Lexon qatipi emra, dëgjohet zëri i tij; shehit ... hutaq ... hairsëz ... humbareq ...

- Mjaft! - mjaft! - klithi burri flokëbardhë. Eshtë gjaku ynë ... Eshtë zemra jonë. Mos na shkelni mbi zemrën ... Mos na shkelni mbi gjakun ... Nizamët te bashi i anijes këndonin:

*Mbeçë more shokë mbeçë
Përtej urës së Qabesë ...*

I afrohet bregut vapori i zi. Afrohet bashkë me të edhe isoja e këngës. Ajo nuk është këngë ... Ajo është ulërimë:

*Në pyet nëna për mua
I thoni që u martua
Në thëntë se ç'krushq i vanë
Sorrat e korbat e hanë.*

2.

*I shkreti Hodo Nivicë
Te sheshi në Prapanicë,
Ju qep nizami galicë
Bam me top e dot se vrisnë.*

Endet mendja e imamit Budo Bredhi fshatrave dhe jeton me kujën e madhe. E pruri kujën në Labëri vapori "Daut" që solli kartërat

e djegura. Ishin ngritur këta djem në kryengritjen e dyzeteshtatës që t'i shpëtonin vdekjes në shkretëtirat e Jemenit. Kishte punuar jataganin Budo Bredhi dhe përfundoi syrgjyn në Konjë.

- "Eshhtë e padurueshme" - tha kalorësi.

- Urdhëro babë Budo, - i foli djali nga Vergoi që e shoqëronte.

Plaku flokëbardhë psherëtiu, hoqi thellë frymë e ndjeu dhimbje.

Afër Palavlisë, te sheshi në Kamenicë ku u zhvillua njëra nga përleshjet e mëdha të kryengritësve, me taborët e Ordisë të Janinës, tha:

- Dua të qëndroj pak te ky shesh o bir! Ai zbriti nga kali, u end nëpër sheshin e Kamenicës, doli në brigjet anash lumit Vriz e soditi. Nuk i ka të ngopur syri.

Atë ditë u vra dhe u pre tek sheshi në Kamnicë taborri kryengritës i Budo Bredhit. Luftuan kryengritësit e taborrit të Budo Bredhit me taborrin e Bimbashit Jusuf. Atij iu kujtua kur ia mori Bimbashit Jusuf kokën me pallë dhe ia nguli në majë të një shkopi. I trembi më shumë nizamët koka e prerë e Bimbashit se tehu i jataganëve të kryengritësve.

Budua e kujton çastin kur taborri i tij hyri në luftim dhe ata u thyen. Kujton gëzimin e kryengritësve. Kur mbeti vetëm te dredha e rrugës, që zbret në Vriz, kujtoi edhe djalin katërmbëdhjetë vjeçar, Birbilin. Në vapor, njëri nga nizamët i kishte folur për ngjarjen buzë detit dhe arratisjen e Birbilit. Në çdo hap që hedh dëgjonte bëmat e Birbil Shakos. Ai mburri trimërinë e djalit dhe nënën e tij. Ai dhe Sorka kishin derdhur në zemrën e Birbilit atë që kërkohej.

- Kështu duhet të jenë nënat tona - tha flokëbardhi, - t'u derdhiin djemve bashkë me qumështin trimërinë. Vetëm kështu mund t'i qëndrojë Arbëria furisë së erës.

- Ecim babë Budo - i tha djali nga Vergoi që e shoqëronte.

- Ecim bir, ecim! foli flokëbardhi me portretin e Hodo Aliut e të Gjolekës në bebëzat e syve.

Ecën komandanti i taborrit të kryengritësve i përhumbur nëpër sheshet e luftës. Kujton luftimet te Qafa në Palavli ... Kujton përleshjen në Gjavorak ... Prerjen me shpatë në sheshin e Bradhomës, te kullat e Resule dhe te rrapi në Kohinovë, topat që vuri turku aty. Erdhën dymbëdhjetë taborë me nizamë. Hodo Nivica si Hodua, majë kalit endej sa në njërin bylyk kryengritës te tjetri. Ishte ngritur e gjithë Labëria në kryengritje.

Në vazhdim të rrugës për në Kurvelesh, Budo Bredhi bujtë për drekë në shtëpinë e ish kryengritësit që e shoqëroi. Gjithë rrugës jetoi me dëshpërimin e dështimit të kryengritjes së vitit dyzeteshtatë.

S' më tret balta po nuk jetova edhe një herë dyzeteshtatën - tha.

3.

*"U nis mortja, u nis
Nga sheshi në Kamenicë
Në Agaraj u degdis
I shkreti Demo Idriz
U godit sisë më sisë.*

- Djali! Djali im! - tha i zoti i shtëpisë, kur njeri ia mori këngës të djalit të Agare Demos, që u vra te sheshi në Kamenicë. Budo Bredhit iu drodh qerpiku. Ju kujtua djali i shtëpisë Demo Idrizi.

- Luftoi si trim - tha Budua dhe hoqi festen nga koka. Foli për bëmat e Demos. Kënga vazhdoi.

Këngët e kryengritësve kishin mbetur si jehona e prasme e krismës së një pushke që vonon për t'u bashkuar me krismat pasardhëse.

- Aty ku jeton gjallë trimëria, aty jeton edhe shpresa - tha Budo Bredhi.

- Këngët e kryengritjes i djegin shumë Pashait të Janinës o babë Budo - tha një djalë. Përse i djegin?

- I mënçuri nuk do që të zgjohet luani prej gjumit se kur zgjohet mjer ai që bie në kthetrat e tij. Nuk është budalla pashai i Janinës, biro-o!

- Vendi ynë është përgjumur - tha fytyrë lëtyra Emir Kunadhe që doli në bregun e detit për të pritur vaporin "Daut". Fjala ia gremisi qetësinë në çast, Budua iu kthye ish shokut të tij të llogores së luftës në kryengritjen e dyzeteshtatës:

- Iku ajo kohë kur Arbërit pinin hashash nga Valiu i Janinës, kryengritja e madhe e zgjoi Arbërinë.¹

- Mbas kryengritjes Arbëria ra në gjumë akoma më të rëndë.

- Të gënjen mëndja, Emir. Luanit i tremben më shumë kur shlodhet e duket i përgjumur. Zgjimi i Arbërit është po aq i frikshëm

1) Arbër dhe Arbëri e quajnë veten edhe krahinat përreth Labërisë.

për Valiun e Janinës sa edhe zgjimi i luanit. Dëgjova se shoku yt, Birbili, është bërë Birbil me zë.

- Me një qyqe nuk vjen behari.

-?

- Me këto mendime që ke o Budo Bredhi një ditë kam për të të parë përsëri me pranga në duar - i tha Emir Kunadhja që rrinte këmbëkryq i krekosur në krye të oxhakut duke numëruar kokrrat e tespiveve.

- Pastaj? - pyeti Budua. Më thuaj, çë se më hodhën prangat, çë se më prenë kokën? Unë shpresoj ... Gjithmonë kam shpresuar. Ajo që shkrepri në dyzeteshtatën u kthye në bubullimë. Trokiti liria dhe ngriti peshë zemrën e Arbërit ...

- Trokiti dhe iku - tha Emiri. - Dhe ashtu si do allahu, ra në gjumë mileti.

- Jo, nuk ka ikur - tha Budo Bredhi i zemëruar e hoqi me përçmim vështrimin nga Emiri.

Pastaj kthehet dhe u flet të tjerëve:

- Gjaku s`bëhet ujë vëllezër! Është më mirë që djemtë e Arbërit të vdesin me pallë se t`i rrëmbejë lubia e Ordisë së Shtatë.

Budua përsëri thoshte:

- Më mirë të vdesin djemtë në pallë se të treten në shkretëtira. Trimit i ka hije palla.

- Ashtu babë Budo, ashtu - thanë disa djem që ishin në moshë për t`u thirrur nizamë.

- Hë, kush u ysht në vesh këtyre, o Emir Kunadhja? E këtyre është Arbëria. Dheu i tyre i ëmbël si mjalti i bletës zogëz. Nuk e dëgjon Emir? Ka filluar të ngasë përsëri erë e sertë, mjerë atë që e lëshon zemra. Ke dëgjuar për trimëritë e Birbilit?

- Fatprerë do të jetë edhe Birbili, si i ati që përfundoi në tehun e thikës të një zebeku.

- Ç`po flet kështu Emir, largoje të keqen nga uxhuti o bir!

Fshati u mbush me ulërime e vajtime. U shpërndanë kartërat e djegur të djeme që kishin vdekur në Jemenin e largët.

VI

1.

*“Arnaut, he arnaut
Në vend të bukës - blen barot”.*

Kajmekamit Çollak Zylyftar i erdhi zemërimi në gjoks si valë e nxehtë, shtrëngoi frymën. Pyeti dizdarin e kalasë:

- Ç`pret arnauti që u kthye nga Konja, përse hyri imami Budo në “Grykën Jetëshkurtër”? Më trego, ç`pret ai aty, vdekjen apo lirinë?! Ndez sherrin imami Budo. Kujdes me imamin Budo!

- Starfulla, ajo që ëndërron ai, kurrë s`ka për të ardhur gjegji yzbashi Yzjedin Takijexhiu.

Dërgoi fjalë:

- Në qoftë se ai nuk rri urtë do ta djeg si xhindin me barot, do të digjet në flokët e tij.

- Me Arbërit na veçoi gjaku që u derdh ... Kanë filluar të thonë: “Gjaku s`behet ujë!” - Hëm, ku u shkon mendja, te gjaku.

- S`ta falin gjakun këta njerëz. Është rrenjë e vjetër, u munduam e dot se shkulëm.

- Kaçaku Birbil Shako ka disa vite që i fryn erës së gjakut. Dhe mëria e gjakut në vend që të shuhet, rritet. Fjala: “Gjaku s`behet ujë” është shtruar buzë vatrave.

Kajmekamit Çollak iu kujtua koha e kryengritjes kur u vinin thikën lebërve në gushë e gajaseshin më gaz. Por edhe labërit më xhind, u ndritnin sytë kur therreshin zebekët.

- Kjo ishte një këputje, një ndarje e madhe në shpirt që s`do të ndreqet kurrë. Si mund të ndreqet buka që thyhet? A njafton vetëm të thuhet, se deri sa jetojnë nën një diell e sa derisa ka një allah mbi kokë, u ndreq kulaçi i thyer? Jo, ky është një gabim i pafalashëm i Pashait të Janinës që do të kushtojë shtrenjtë. Këta janë akrepër

vdekjeprurës ... Këta do të bëhen shkak që perandoria jonë të tronditet si i sëmuri nga malarja, të zbehet e pse jo, më në fund të vdesë. Hej starfulla, ç' ma pruri në gojë atë fjalë ... Jo, jo! Nuk shuhet kurrë dielli i perandorisë. Perandoria jonë është e pavdekshme". Përsëndeti: "Çok Pasha, Padishah!" Nga këto mendime u shkëput që të kthehej aty ky filloi, te ai flokëbardhi Budo që erdhi nga Konja. Do të dijë mbi veprimtarinë e tij, pyet:

- Ky njeri është i ditur, i mësuar, përse hyri në shkëmb për të jetuar? Kjo më shqetëson.

- Aty, në shkëmb e zgjodhi shtratin e vdekjes - i tha yzbashi Yzjedin.

- E në qoftë ndryshe, ç'ka bejmë? - Tjetri belbëzoi.

- Dërgo koshadhen, rrëmbeje miun dhe nxirre nga brima ku është strukur, ma sill këtu një orë e më parë. Kam lajme që ai, çepedredhuri që erdhi nga Konja bën takime me kaçakët. Më dogënis rëndë ajo fjala që thonë: "Gjaku s'bëhet ujë!"

- E kam thirrur sa herë, e kam provuar me të mirë e me të keq, s'ka dëgjuar. Eshtë mbyllur në Grykën Jetëshkurtër dhe thotë: "Këtu do të qëndroj gjer në ditët e fundit të jetës, gjer në fishekun e fundit të pushkës".

- Jazëk për ty, ke bërë një marrëzi që s'të falet, ta bëjë një çauash nizamësh e jo më një dizdar kalaje. Përse e lejove të ikë? Çdo ai në atë shkrep guri. Rrëmbeje me forcë. Rrëmbeje!

- Do të prishim më tepër punë po të vëmë dorë mbi të, do të ndizen gjakrat, do ta kemi veshtirë ta shuajmë sherrin - foli Dizadari i kalasë, foli ashtu që tiparet e tij të mos ndiznin zëmërimin te kajmekami.

- Dërgo forca dhe rrëmbeje nga mjekra kukudhin.

- Edhe koshadha, edhe nizamët po të shkojnë, ai do të luftojë, do të na bëjë dëm. Ai është mbyllur në vendin e xhindëve e nuk i thonë kot atij vendi "Grykë Jetëshkurtër".

- Sikur edhe gjëmën të bëjë, të nisen, të nisen zebekët sa më parë; koshadhet e nizamët. Nuk duhet ta lëmë të marrin frymë as flokëbardhin Budo dhe as kaçakun Birbil. Si shumë kaçak janë mbledhur rreth kaçakut Birbil.

- Nën urdhërat tuaja, por do të ndizet sherri. Më mirë hiqni dorë nga ai mendim. Shejtani fle, pse e zgjon?

- Kush fle, ai?! Nuk më besohet.

- Qëngjin e urtë e marrin dy nëna.
- Nuk heq, jo, ose Budo Bredhin këtu, ose koshadhet e zebekët e tu të gremisen në shkëmb. Mirë!?
- Kërkohet iza e valiut kur ndizen sherre si ky, - tha yzbashi Yzejdin.
- Fjala ime është fjala e valiut - u shpreh tërë vrazhdësi kajmekami Çollak.
- Ditën e nesërme në mengjes herët koshadhet e zebekët u nisën

...

Koshadhet e zebekët që u dërguan në Grykën Jetëshkurtër s' dolën gjallë. U dërgua një patrullë tjetër ... Edhe ajo s' u kthye. Ç'farë ndodhi? Ishin vrarë apo gremisur në buza. U tha:

- Aty ka xhinde ... Nizamët e zebekët i rrëmbeu frika e xhindit ... Ata hoqën dorë nga Gryka Jetëshkurtër. I kishin pritur kaçakët dhe i kishin prerë me jatagan. Kajmekami Çollak pyeti i shqetësuar: Të kujt ishin kaçakët? Të çetës së Resul Sejditit, apo të Birbil Shakos? I kishin goditur zebekët në një kohë, të dy palët. Ditën tjetër, në mëngjes herët, në një letër, Birbili i thoshte kajmekamit:

- Kur të shikosh majën e veshit do të shkelë në Grykën Jetëshkurtër këmba e zebekut.

2.

“Trimëria është fryma e pavdekësisë së Arbërit”.

Në dëstilën e manganën e Budo Bredhit, te Gryka Jetëshkurtër, Arbërit bien shajak, velënxa e brrucë ... Budua pyet. Kërkon të dijë për kaçakët, kërkon të dije për Birbil Shakon, për atë që i mësoi armët, goditjet me shpata dhe të shkruaj e të lexojë libra, atë që i ushqeu dëshirën të luftojë për Arbërinë e për të jetuar i lirë. Ai ndjeu kenaqësi kur dëgjon bëmat e kaçakut Birbil.

Çeta e Birbil Shakos endej nëpër krahinat e Vilajetit të Janinës. Krahas saj vepronte një çetë tjetër e komanduar nga Progonatasi Resul Sejditit. Budo Bredhi e njëjtte Resulin në luftime pranë Palavlisë. Në Kamenicë e kishte veçuar për trimëri në gjithë taborin kryengrihtës. Ndjeu se trimëria nuk është shuar në Arbëri. Foli me zë të brendshëm. “Trimëria është fryma e pavdekësisë së Arbërit, ajo përsëritet, gjendet

në çdo furkë stani, në lulen e trëndelinës, jeton në barin e malit, në fyell e në këngë. Burimet ushqyese të trimërisë s'kanë për t'u shterur kurrë në Arbëri." Tha: "Një pikë rrjedhëse jam edhe unë vetë që nuk pranova të vdisja në Konjë".

Hedh vështrimin në pllajën me pyll. Në vitin e kryengritjes turqit e dogjën pyllin, por mbas viteve lastari i ri, rrënja lëshoi më shumë degëzime e pylli ka marrë hov përsëri. Ashtu edhe Arbëria, ashtu edhe ajo ... Kishte përhumbur në mendimet e veta. U shkëput prej tyre nga një zë gruaje që e përshëndeti:

- Tungjatjeta bimbashi Budo.

- Eja moj trimëreshë, lëre Budon të dergjet në shtratin e pleqërisë, ç'e mirë të pruri? Ç'i ke këto moj trimëreshë? I hoqi dhe i numëroi gunat, pastaj u kthye me vështrim nga gruaja. Fytyrë e parë - tha. I vinte në kujtesë se diku e kishte parë. Zëri ishte ai i Sorkës të Golemit. Ajo do të ishte. Nuk mbante mend të kishte në këto fshatra dhe një grua tjetër me zë burri e shtathedhur si Sorka.

- Nuk më njohët? - i tha Sorka.

- Më verboi sytë Konja moj motër. E hoqi vështrimin nga gunat për të soditur të zonjën e gunave. Fytyrë e parë - tha. Gruas i kishin filluar ti griveshin anash flokët.

- Motra Sorkë? - foli Budua i habitur nga takimi i papritur.

- E dija që do të të shikoja - i tha Sorka e gëzuar. Eh, vëlla Budo, ti je si kalaja Buzë Bredhit. E shikon si duket shkëmbi i Gërzhunit, si një kala e vërtetë?

- Motër, motër! i foli flokëbardhi Sorkës, vajtores që ligjëroi me ligje kryengritësit e nizamët që u dërgohen nga Ordia e Shtatë kartërat e djegura.

Budua e di që me ligjërimet e Sorkës, edhe të kishte vdekur në Konjë, do të mbetej i pavdekshëm në këngë. Kënga e larton njeriun por ... Ç'është të thoshte? Kënga i shkonte Gjolekës e Hodo Nivicës që mbyllën jetën kurse ai ende ishte gjallë dhe zor i mbushin fjalët ata që jetojnë në një kohë me këngën. Ky ishte edhe shkaku që ai u mbyll në Grykën Jetëshkurtër ku të jetonte i lirë, pa e shkelur trollin ku jetonte këmba e zebekut. Kishte caktuar edhe vendin e varrit. Aty majë thepave ku s'guxojnë të shkelin zebekët, aty me shtynë në dhe.

Ç'i ke gjithë këto guna moj motër? - e pyeti Sorkën.

- Guna të kaçakëve. Ke harruar që kaçaku e do gunën të re në çdo vit, o Budo Bredhi, apo i harrove hallet e kaçakut.

- U plaka motra Sorkë, u plak Budo Bredhi. E verboi Konja Budo Bredhin. E treti Konja Budo Bredhin.

- S' dëgjon lisi i madh nga rrufetë, Budooo! Mos e thuaj më atë fjalë - i tha Sorka duke hedhur gunat në derstilë një e nga një.

- U duhen shpejt? Mos mi vono, Budo.

- Nuk ka radhë për trimat - tha Budua.

Njëri nga nipat e tij u afrua, shikoi gunat. Budua e Sorka ulen te pjergulla në hije të lisit e bisedojnë. Budua i tregon trimëri të luftëtarëve të kryengritjes. Sorka s' di të lotojë. Ajo me lotin thur ligjet për trimat. I foli trimit:

- U rralluan lisat e mëdhenj, ikën deshët me këmborë, u vra Gjoleka e Hodua, u verbua nga sytë Çelua trim, e ka mbyllur valiu në biruca të errëta të kalasë së Janinës, ke mbetur fill i vetëm o Budo Bredhi.

- E, moj Sorka e Golemit, ke të drejtë dhe s'ke. Edhe Lisi i Madh dikur ka qënë i vogël.

- Lisa të mëdhenj ka shumë në Malet e Kurveleshit, por me zë kanë mbetur Lisat e Kadhe¹, Budo!

- Kur gjuan rrufeja mbi lisat e mëdhenj marrin shëndet lisat e vegjël, motra Sorkë, ke parë të thahet lisi i vogël sepse u godit i madhi? Ku ma ke Birbilin, si është?

- Mirë, bën jetën e kaçakut. Një ditë më tha një djalë:

- E shikon këtë bredhin e madh moj nëna Sorkë? Ç' të shikoja.

Ishte ai bredhi te shkëmbi ku strukeshe ti në dimër kur ishte kaçak. Të kujtohet?

- E shikoj - i thashë.

- Shikoj mirë. Ky gjithë dimrin hahet me furtunën, po furtuna bredhit i zgjat rrënjët. As te këmba nuk të vjen Birbili im, Budo!

- E ke gabim Sorkë. Birbilat njëherë vijnë, janë si yjet e mëdhenj që shihen rrallë në qiell. Si guxon ta thuash atë fjalë? Kush tjetër ka filluar në malet tona të presë vite me radhë koka pushtuesish si Birbili yt. - Resuli i Progonatit, Myrto Dukagjini i Golemit, Asllani i Zhulatit, Leskodukajt yje të Bolenës, Balili i Kolonjës. Eh sa ka! Ka Arbëri shumë Birbila. Ata janë male.

- Malet kanë maja, me majat merret kënga o Budo Bredhi.

1) Lisa të mëdhenj idërmjet Gusmarit e Progonatit ku krahina mbliidhej në kuvende të mëdha.

- Porosite nipin të ma këtë kujdes gunën e Birbilit
Budua e mori gunën në dorë, e peshoi në dorë, i shikoi qepjen
e qëndisjen.

- E ke qëndisur me tegel për merak. Si këngët dhe punët moj
Sorka e Golemit.

- Jo nuk është dora ime, tjetër e ka qëndisur gunën e Birbilit.
E ka ngrirë në gajtan Hirua, vajza e Zejno Krekëzës. Një vit mbasi të
internuan në Konjë e fejova djalin.

- Vajzë e mirë e derë e mbarë - tha Budua.

- E mirë po fatzezë, mbeti në derë të babës, im bir s' kujtohet
për martesë, Budo! I dërgoi Birbili fjalë që e dua gunën të fortë dhe
ja çka bërë vajzë zeza, leshprera ajo. Më vjen keq për vajzën Budo. Ta
shohësh ç' nuse kam zënë për Birbilin mbetesh pa mend, i thotë diellit
dil se dolla. Ajo qëndis në çdo gunë zogun e Shqiponjës. Është zogu
i Arbërit, është Shpinja që më ka dhënë babë Budua na thotë Birbili.

- Ashtu është motra Sorkë, Birbili nuk luan vetëm pallën por
edhe fjalën, ato që mëson njeriu në libra nuk i mëson dot në shtëpi.

Pashai në Janinë dhe zebekët e tij dridhen kur e shikojnë këtë
zog.

- Zebekët ia presin kokën njeriut që e mban këtë zog.

- E di mirë Birbili yt se ç' bën, tu lumtë motra Sorkë. E nderove
Labërinë me këngë, kurse biri yt me pallë.

- U dha tepër mbas pallës e librit Birbili dhe po harron rrënjën.
Nuk dua të shuhet jeta në sarajin majë shkëmbi. Thahet jeta kur
s'përkundet djepi, Budo! - foli Sorka e mërzitur. Ajo u bë gati të nisej.

- Do të vij përsëri - i tha.

- E pres Birbilin me gjithë Birbilat e tjerë - tha Budua. Ata u
ndanë. Gruaja humbi shtigjeve të ngushta honeve, kurse ai u kthye në
Grykën Jetëshkurtër.

3.

I kam lënë fishekun te pragu.

E paralajmërova:

"Mos më ndiq se do të të vras"

Një natë më vonë, Budo Bredhi me Birbil Shakon, bisedonin
rreth vatrës. Në fillim ia ngjiten vështrimin hetonjës njëri-tjetrit,
ashtu si bën njeriu për të kujtuar një ngjarje të hershme. Takimi i

kislite befasuar. Kryengritësi i vogël, Birbili, ishte bërë burrë shtatlartë e me fytyrë të ashpër, kurse supet e gjëra të Budo Bredhit ishin ulur, trupi i madh i bimbashit Budo Bredhi sikur ishte zvogëluar nga vuajtjet në vitet e syrgjylnllëkut në Konjë, por edhe nga pleqëria.

Kur e pyeti se përse u bë kaçak, Birbili, iu përgjigj me rrëmbim:

- Se shoh mllëfin të strukur në shpirtin e njerëzve o babë Budo, - prandaj u bëra kaçak. Se shoh njerëzit në ditë të hallit, prandaj u bëra kaçak. Se shoh lëngimin në çdo prak të Arbërit, prandaj u bëra kaçak. Se shoh që Ordija e Shtatë i rrëmben Labërisë loçkën e zemrës, djemtë e saj, prandaj u bëra kaçak.

- Emrin tënd e dëgjova në Konjë, është bërë "Gjolekë" Birbil Shakua më thanë. Të them të drejtën, më erdhi mirë, po të rëndë e ke barrën, or bir. Kam dëgjuar që Valiu i Janinës i jep njëmijë lira turke atij që do t'ju kapë ose do t'ju vrasë.

- Ashtu është, babë Budo. Po më keq e kam me hafijen e tij. Emir Kunadhja më ndjek këmbakëmbës. I kanë rënë trutë në qafë Emirrit. Dje i kam lënë fishekun te pragu. E paralajmërova: "Mos më ndiq se do të të vras". Disa herë i kam thënë ta lërë atë rrugë, por ai s'heq dorë. Si është e mundur, që një ish kryengritës të bëhet hafije e të huajit?!

- Edhe atëhere Emir Kunadhja u dha si tepër pas plaçkës, të kujtohet? Njeriu që merr prapa lekun verbohët.

- Dota vras. Vetëm grahmat e fundit të vdekjes mund ta ndajnë atë nga pabesia e ligësitë.

- Skifteri nuk rrëmben sorra, Birbil!

Birbili heshti ...

4.

*"Tashti fat'i Labërisë
Varet nga Bashkimi jonë,
Të heqim cipën e zisë
Duhet prapë të luftojmë".*

Një javë mbas takimit që bëri me Budo Bredhin, Birbili me luftëtarët e çetës ecën nëpër Grykën Jetëshkurtër. Anash malet me shenja të bardha guri. Një shenjë ... Njëqind shenja ... Akoma më shumë ... Në çdo shenjë është pika e gjakut të derdhur. Ishte vit me shenja gjaku, viti dyzeteshtatë i kryengritjes së madhe të Gjolekës

Shenjat e bardha ishin kurorë e kryengritësve të rënë. Çdo shenjë përfaqësonte një ngjarje, një episod lufte, qëndresën dhe emrin e një trimi. Malet ishin mbushur me shenja, gurë të ngritur në formën e një piramide. Këta gurë në çdo pranverë lyhen me gëlqere të bardhë. Pranë tyre shkojnë nënat e motrat dhe i ligjërojnë me ligje. Shkonin arbërit dhe u këndonin këngën e trimërisë. Shkonin kaçakët dhe u vinin lule.

Pashai i Janinës kur dëgjoi ç'bënin lebërit për trimat e rënë në vitin e kryengritjes lëshoi një bujurllid, ku shkruhej:

"Gjynaçarëve, atyre që ngritën dorën kundër Sulltanit e hazëretit t'u prishen qivurët e njerëzit të mos shkojnë më te vendet ku është derdhur gjak, se gjaku ndez gjakun" ... Në fund të bujurdisë thuhej:

"Kush ziret duke lyer shenjat e gurëve ku janë vrarë dinsëzët dënohet me një dele taksë. Kush ngrë qivur të ri do të paguajë taksë pesë dele dhe një qyp me gjalpë. Nuk lejohet t'u këndohet këngë dinsëzëve. Të dërgohen zebekët e të rrafshohen shenjat e gurëve që janë ngritur për dinsëzët. Ndalohen vajovicat të thurrit ligje për dinsëzët. Ndalohet ..."

Po shenjat e gurëve prisheshin nga zebekët ditën e ngriheshin natën, më të lartë e më të bukur, nga Arbërit. Këngët për trimat në vend që të shuheshin u ndezën më tepër.

Duke ecur nëpër Grykën Jetëshkurtër, Birbili me kaçakë të tjerë, në shenjë nderimi ndalej pranë shenjave të bardha.

Shtegtonin kaçakët nëpër grykën e ngushtë ku qe mbushur me gurë shenje. Mbeti grykë me shenjë Gryka Jëshkurtër. Në çdo shkrep, si jehonë e përjetshme, kishte mbetur këtu krisma e pushkëve dhe thirrja: "O prite shallvaregjërin!" Dhe vinte si jehonë piskama e kryengritësve: - Eheee! Eheee-heee! Prite more, priteeee halldupin!

Birbili u ul mbi një shkëmb, të rënë prej mali, me të dy duart të mbërthyera te pushka. Pret Birbili t'i grumbullohen shokët. Pret Resul Sejdinin me Progonatasit ... Pret Shahinin e Asllanin e Zhulatatit ... Myrto Dukagjinin e Golemit, Balil Zhupën e Kolonjës, Kara Koçiuin e Smokthinës.

Kur mblidheshin kaçakët bëheshin bletë. Ku qëndronte ai, mbi gurin e bardhë, gurgullojnë burimet. Ai ndjeu freskinë e ujit të ftohtë. Mendonte për mbledhjen, jetonte me fjalët e Budo Bredhit: "Duhet të përsërisim Besëlidhjen". Ai me shokët e tij e prisnin me padurim

mbledhjen. Dëgjoi një zë: "Ehe-heee! Eheee! Kujt i fliste zëri, kaçakëve të malit apo dikujt tjetër ... Ishte Myrto Dukagjini i Golemit.

Mëngjesi i zuri kaçakët te derstilat, në Grykën Jetëshkurtër. Aty, ujët e bollshëm shkumëzon në kazanin e madh të destilës, përplas e rreh me kopanë shajakun e gunave të kaçakëve, për t'i bërë ato të buta, të qëndrueshme dhe të ngrohta.

Disa hapa më tej bredhit të madh piqen mishërat, dridhen mbi prush kukurecët. Në degët e Shelqerorit napa me djathë të njomë, gjizë e ngrohtë dhe qumësht. Çdo gjë është përgatitur me kujdes. S' duhej të shihte syri e të dëgjonte veshi i afijeve ç'bëhej te derstila në shkëmb.

Era e mishit të pjekur ndjehet nga larg. Janë prerë deshët e cjepët përçorë. Nga Këndrevica tri kafshë prunë borë. Eshtë vapë dhe mishin e tret më lehtë uji i borës. Lëkurët me urrël varen aty, afër napave me djathë të bardhë. Njeri nga kaçakët, burrë shtatlartë me armë e veshje që të verbon, me ballë të gjërë, symadh e vetull trashë, doli përballë të gjithëve. Lëvizi ashtu që të tjerët e kuptuan që do të fliste.

- Alamet trupi paska Birbil Shakua. Ishte njëri nga nipat e Budo Bredhit ai që foli. I pëlqeu pamja, i pëlqeu veshja. Për bukurinë e veshjes thuhej në një këngë se: "Birbil Shakua që në mes e lartë, është i gjithë i artë".

- Ua paçim borxh o burra, borxh në jetë të jetëve - u tha Birbil Shakua me një vështrim dashmirës çobanëve. I Falënderoi në emër të kaçakëve.

- Mirëse erdhët vëllezër, gjëmim u bëftë fjala juaj, zjarr zemra e top pushka! - foli imami Budo Bredhi.

Birbilenjtë mbanin fustanella me gjashtëdhjetë palë kinda, kinda të holla e të lehta e me një bukuri verbuese. Kalcat e tyre, njëlloj te të gjithë, të qëndisura në krye e në fund. Afër gjurit kalcat i mbante gajtani kuqezi. Dhe në anën e jashtme të pulpës së këmbës uleshin me gajtan dy xhufka, njëra e kuqe dhe tjetra e zezë. Çorapet, një se një, çorape leshi me lule. Një të gjithë dhe opingat, nga një lëkurë me një xhufkë ngjyrë vjollce te maja. Këmishat të gjëra, çibunet prapa të ngrira në gajtan e të ngjashme me krahët e shqiponjës. Të gjithë me armë. Qelshja e ulët, jo e gjitha si qylafët e bardha të lebërve me majë, pak më e shkurtër nga ato copa të rrahura e të ngrira, ashtu që të mos griseshin e të mbanin flokët e shkapërxyera të kaçakëve. Secili kishte

nga një "Arnautkë" të gjatë, të qëndisur në ar dhe me flori. Nuk ishte kursyer floriri. Armëtari në një rën anë kishte shkruar emrin e mjeshtrit shqiptar nga Grabova që kish mundur ta bëjë këtë armë kurse në tjetrën emrin e luftëtarit që do ta mbante armën. Emri i armëtarit dhe emri i luftëtarit ishin derdhur në flori.

- Ka gisht në këtë punë hotelxhiu i Janinës - tha Birbili.

- Nexhipi! - foli bimbashi Budo i përmalluar. - E Nexhip Bedena i Zhulatit! Ai e njihte hotelxhiun.

Atë ditë të gjithë kaçakët vunë përmezi silahë të rinj, shndritës, secili shihte rreth mezit zogun më të bukur të maleve: Shqiponjë! Kjo ishte shenjë e veçantë që e dallonte çetën e tyre. Silahet edhe pisqollat ishin qëndisur te mjeshtrit e Janinës. U dërgonte habere hotelxhiu se "mjeshtrit kanë shkrirë talentin e tyre". Atë ditë erdhën edhe zinxhirët ku vareshin vezmet e barutit dhe vajnicet e armëve. Nga Ergjëria u erdhën disa ditë më parë edhe jataganët.

- Djem, mbase më takon edhe mua plakut të them dy fjalë, - foli Budo Bredhi. - Erdhët në konakun tim, u prita siç munda, tani më dëgjoni edhe fjalën.

- Folë babë Budo, folë bimbashi Budo!

Budo Bredhin e kishte rënduar mosha po më shumë e kishte plakur Konja, krija e detit i kishte zbardhur vetullat e trasha dhe ia kishte lëshuar mbi sy, por zakonet që kur të fliste t'i ngrinte përpjetë nuk e kishte harruar. Fjalën e Budos veç ta dëgjoje, priste hekur! Ai si nguli të dy këmbët, ashtu si motit kur i fliste taborrit kryengritës, tha:

Kur u flas si imam, them: - Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet për çdo nevojë. Në këtë sèkëllid të madhe që jetojmë le të lutemi: O Allah, vetëm Ty të kërkojmë ndihmë! Udhëzoni për rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre që begatove me të bëma të mira. Ti falemi të madhit Zot dhe hasmi ynë do të jetë farësosur. Edhe pse jemi prej një feje, Pejgameri ka thënë se cilido që nuk interesohet për gjendjen e myslimanëve nuk është prej tyre.

Kur u flas si ish kryengritës u them: Valiu i Janinës Hysen pashai thotë: "U bëre ujk të vrava, u bëre qëngj të hëngra. hë pra, ç' duhet të bëjmë?"

"Kishin malet tona pyje ku i kanë? Kishin livadhet tona lule, ku i kanë? Kishin nënat tona djem, ku i kanë? E mbuluan vendin kartërat e djegura, i përpiu djemtë varri i madh me emrin Ordija e

Shtatë”.

Jetova një kohë të gjatë në Konjë dhe kur erdha m`u duk se qe shuar trimëria në malet tona. E pashë vendin të djegur. Ishte djegur pylli por jo rrënja, po dalin përsëri lastarët e rinj në malet tona, dëgjohej kënga e bilbilave, shenjë e mbarësisë dhe e shpresës. Të gjithë ata që shkojnë në rrugën e Allahut do të gjejnë kënaqësi e lumturi. Veziri i Janinës vëllezër mbas sulmeve të Ordisë sjell me vete plafin e rëndë, ta hedh sipër jo për të të ngrohur, por për të të zënë frymën, këtë plaf “të ngrohtë” ia grisët ju, Birbilenjtë. Më pëlqen t`u drejtohem me këtë emër të bukur se birbila që ligjëroni jeni. Do të vijë koha që malet tona do të mbushen me shumë birbila. Pashait të Janinës kjo i dhëmb. Sa më shumë t`i dhëmbë pashait, aq më mirë është. Apo jo?

Në një zë komitet:

- Ashu është imami Budo!
- Ashu është babë Budo! Ashtu!
- Ashu është bimbashi Budo!

E mori fjalën një kaçak nga Progonati, tha:

- Veziri i Janinës në vend të shurupit të jep helm dhe të thotë: “pi evlat, bën rehat, allahu mendon për ty”. Unë ç`duhet të bëj për jetën time, për Arbërinë time? Gjyturumi s`bëhet gjallë, kaçaku është ndryshe.

Myrto Dukagjini i Golemit, një burrë i bëshëm me flokë kaçurrela të lëshuar mbi ballin e gjërë, u çua dhe si mbështeti të dy duart mbi tytën e arnautkës, u dha shenjë shtatë luftëtarëve golemas që kishte me vete dhe të gjithë njëherësh e hodhën dorën te palla. U ndie të bënte erë këllëçi. Ai foli vetëm një fjalë:

- Erdhëm këtu nga çdoskaj, erdhëm fshehtas syrit të koshadhës. S`ka vdekë trimëria në Arbërinë tonë, jo!

Asllani i Zhulatit pruri fjalët e ngrohta që dërgonte hotelxhiu i Janinës, Nexhip Bedena i Zhulatit që u pëlqyen nga të gjithë.

- Eshhtë burrë me mend Nexhipi - tha Budo Bredhi. Kurse tjetri foli se kaçakët kishin fole në male, aty ku ulen këmbët e maleve të Labërisë, buzë Vjosës në Veri dhe në Fushën e Delvinës në Jug.

Kryengritësi i vitit dyzeteshtatë. Resul Sejдини, i rrahur nga thëllimi i gjithë dimrave që kishte kaluar në shkëmb që nga viti i kryengritjes dhe i djegur nga dielli i korrikut, kishte dalë tjetër Resul nga fytyra dhe nga shpirti. Tehu i shpatës shihej në syun e tij që të

priste e të kallte datën. I prerë në fjalë e i fortë në pallë. Nga vendi ku qëndronte, me sytë te shokët e tij Progonatas, goditi fort me dorën e rëndë qytën e "arnautkës" e me zë të lartë tha:

- Vëllezër, delja e butë përfundon në qafën e ujkut. Po kaçaku nuk është dele.

Fjala erdhi e qëndroi te Birbil Shakua që veçohej nga populli dhe nga kaçakët e tjerë, për bëmat e tij humane, për trimëritë që kish treguar për të shpëtuar nizamët dhe ndihmuar të varfërit. Ai me vështrim te kaçakët tha:

- Dhimbja e jonë u bëftë flakë dyfeku, u bëftë forcë në tehun e jataganit e raftë mbi zebekun ashtu siç bie rrufeja mbi lisin. Pushka e kaçakut ja kërcet ja pëlçet, se dyfek që të vrasë vetë nuk ka, jatagan që të presë zebekun vetë nuk ka o vëllezër. Pastaj vazhdoi:

- Një herë, kur isha duke u endur nëpër fshatrat e Janinës, një grek, burrë i moshuar, që e kishte jetuar qëndresën e Ali Pashë Tepelenës në Janinë, më tha: "Ju shqiptarët e humbët rastin që të bëheshit shtet më vete dy herë, një herë në kohën e Ali Pashë Tepelenës dhe më vonë, në kryengritjen e Gjolekës. Ai foli dhe heshti. Budo Bredhi e pyeti:

- E ju ç' i thatë, o bir?!

- Kush guxon nuk e humbet asnjëherë shpresën, - i thashë. - Do të dalë në selamet edhe vendi ynë.

- Mirë i ke thënë, o mëndjendritur Birbil. Ne, edhe në rastin e parë edhe në të dytin nuk ishim larg nga fitorja. Ama, kush gjuhëzohet njëherë s' do të thotë që është i mundur. Jo djem, jo! Shkëndija që ndezët ju Birbilenjtë!, në Kurvelesh, duhet të shtrijë veprimet gjërazi mbi krahinën tonë e në gjithë Vilajetin e Janinës. Eh, djem, ju jeni bilbilat që lajmërojnë se po afrohet behari. Atë që ndiell bilbili këngëtar s'ka gjë që e ndalon. Dhe le të mbulojë kënga e bilbilave Labërinë siç mbulon bari gurët në pranverë - tha Budua me sytë të mbushur plot gëzim.

Birbil Shakua vuri re se fjalët e prunë urrejtjen për Pashain e Janinës dhe zebekët e tij në atë pikë, sa urrejtja mbushi gjokset e kaçakëve. Thirri me zë kumbues:

- Besabesë! - dhe nxorri jataganin nga milli.

- Besabesë! - folën kaçakët. Bënë erë jataganët ...

1) Nga kjo ditë e pas kaçakët qëu mblodhën në Grykën Jetëshkurtër, e quajtën vetveten Birbilenj.

- Besabesë! - jehoi oshëtima e zërit të përbashkët të Birbilenjve nëpër honet e thella të Grykës Jetëshkurtër. Ata e dëgjuan disa herë jehonën e zërit të tyre ta përsërisnin humnerat e thella: Besabesë! Besabesë! Besabesë!

Besëlidhja e kaçakëve nisi rrjedhën. Birbili e ndjente atë, e shikonte. Ajo, në pritje të ngjarjeve të tjera do të ngjante me rrëketë e malit që derdhet drejt luginës për t'u bashkuar me të tjerat në një shtrat të vetëm që bashkarisht të formojnë lumin. A ishte Arbëria në atë pikë që nga rrëketë të vërshonte lumi si në vitin e Gjolekës? Akoma nuk ishte, por urrejtja që ziente për Pashain e Janinës dhe zebekët vrasës ishte më shumë se një lum. Dhe atëherë palla do të merrte forë, dhe rrëkeja e Birbilenjve do të hynte në vërshimin e kryengritjes si krah i armatosur që ia kishte ngrënë erën halldupit. Fjalët e Bilbilit pëlqeheshin e nxiteshin nga kaçakët duke thënë: Folë vëllai ynë Birbil! Fol!

Dhe Birbili vazhdoi:

U mundëm në dyzeteshtatën jo se nuk ishim trima dhe nuk luftuam por armiqtë tanë qenë më trima se ne! Atëhere ç' të bëjmë? O burra të bëhemi më trima se sa jemi. E kërkon koha të themi:

- "Gjaku s'bëhet ujë!" Ata, njëzëri e përsëritën fjalën:

- "Gjaku s'bëhet ujë!" "Gjaku s'bëhet ujë!"

Fjala e përbashkët, si një betim, jehoi përsëri në shkëmbenjtë e Grykës Jetëshkurtër.

- Gjaku s'bëhet ujë! Gjaku s'bëhet ujë! Me këto fjalë ata kujtonin gjakun e derdhur në kryengritjen e dyzeteshtatës. Zgjimit i shërbente gjaku i të rënëve në kryengritje, i shërbenin këngët. Në vatrat tona shuhet trimëria pa këngë. Po në këto vatra kurrë nuk do të perëndojë kënga lavdimtare për trimërinë.

Birbili vuri re që kaçakët ishin aq të vendosur sa edhe vet ai. Atij nuk i duhej të gdhendte e të formonte tiparet e tyre, ato ishin skalitur në ditët e vështira të jetës së çdo kaçaku, por e quajti të udhës që në atë çast bashkimi të kaçakëve në një çetë të vetme disa nga ato që i kishte lexuar në libra e kishte dëgjuar për lëvizjen e kaçakëve të popujve të tjerë të Ballkanit dhe që duhej t'i prinin në jetë një kaçaku t'ua përsëriste. Dhe tha:

- Lypset të vemë çelik në zemër e hekur në këmbë që t'i bëjmë ballë erës e thëllimit. Në hapat tona të na prijë ndjenja e dashurisë për vendin dhe urrejtja për zebekët që na kanë shkelur vendin. Mbase na

duhet t'i përsërisim edhe një herë vetitë që duhet të ketë kaçaku.

Dhe pastaj shpjegoi:

- Kaçaku është si plumbi i zbrazur. Dihet që plumbi i zbrazur s'kthehet prapa, ashtu edhe kaçaku. Prandaj erës e furtunës t'i tregojmë gjoksin. Gjëja më e çmuar për cilindo nga ne të mbetet trimëria, levendllëku e arma. Trimëria është perëndesha e kaçakut, ai e nderon dhe i përulet trimërisë. Kaçaku lypset të thotë: "Në varr më vini armën që të vras zebekun që më shkretoi shtëpinë dhe mos më varrosni shtrirë, por në këmbë, se në këmbë i qëndrova pushtuesit. Mos të harrojmë që ne, bijtë e Labërisë, kur e zëmë parmendën e bëjmë të lërojë tokën, kur e zëmë arnautkën e bëjmë të këndojë. Kaçakun o vëllezër, aty ku e zë nata aty e ka pallatin e tij. Gjithmonë të kërkojmë plumbin e "keq" se kaçaku nuk duhet të zihet i gjallë. Endërra jonë mbetet: "Plumbi në ballë e në zemër që ti shpëtoj pështymës së zebekut zgjebanik".

- Në një mendje e në një fjalë jemi o Birbil Shako - thanë të tjerët.

Era që erdhi me rrëmbim nëpër grykën e Jetëshkurtërve trazoi çepenë e gjatë të Birbilit. Ai e hodhi atë pas, e mpleksi flokun nëpër rripat e kryqëzuara dhe prapë vazhdoi të fliste:

- Syri ynë ka një shenjë të vetme: Valiun e Janinës dhe këlyshët e tij, shushunjën e Janinës, Ahmed beun. Ai është si një shushunjë që nuk ngopet me gjakun e fakir fukarasë. Të qëndrojmë në krah të fakirëve e të skamësve se i bëjmë mirë vendit dhe kështu na dëgjon e na ndihmon edhe zoti. Kaçaku s'është cub mali, po luftëtar, njeri që duhet t'i shtrohet këmbëkryq, në zemrën e tij, fisnikëria e shpirtit të milletit. Kaçaku mbron të varfërin e të ndershmin, gjithnjë bën mirë dhe asnjëherë keq. Kaçaku s'ankon nga lodhja e mundimi ... Kaçaku lakmon armën e përbuz paren. Pre e pallës së kaçakut bëhen hesapçitë dhe taksidarët e Valiut, ata të gjithë që si shushunja i pinë gjakun fakir fukarasë. Pre e pallës së kaçakut bëhen yzbashët e çaushtët e rekrutimit që duan t'i thajnë Arbërisë sonë loçkën e zemrës, duke i dërguar djemtë e saj nizamë në Ordinë e Shtatë, në Jemen. Arbëria jonë e ka trupin të qendisur me plagë e xhunga. Valiu lëshon bujurllidi, ku thotë: "Arbërit duhet t'i rrihni me kopaçe sa tu ikin djajtë nga trupi." Syri ynë do të vëzhgojë mbi këta, palla jonë do të godasë mbi këta. Prandaj bukuria e kaçakut është arma, dashuria e kaçakut është arma. Me armë i vihet përballë forcës së dovetit dhe në ndihmë të hallexhinjve

e fakir fukarasë. Për armën s`duhet të kursejmë as floririn as argjendin. Kush s`di të mbajë armën s`di të ruaj shpirtin. Dhe shpirti ynë është Arbëria.

E mbylli fjalën e tij me thirrjen:

- Mjaft jetuam o vëllezër nën hije. Nën hije as bari nuk ngre krye. Të mos harrojmë që ai që s`ta ka frikë armën kur e ke të varur në sergjen, s`ta ka frikë as kur e ke në sup. Lypset të shtrihen degëzimet tona në të gjitha fshatrat, pak e kudo.

Birbilit dhe Birbilenjve ua ndezën sytë ëndërrimet. Budo Bredhi e kapi atë ndryshim të papritur të kaçakëve. Tha:

- Në sytë tuaj djem shohim rrezën e dritës së nesërme. Luftëtarët e lirisë sado të vegjël të jenë janë më të mëdhenjtë e më të fortët në botë.

Mbasdite, kur dielli u fsheh pas maleve, Birbilenjtë si fluturat e bardha kaluan te Shtegu nën vargëzimet shkëmbore ... Burri flokëbardhë Budo Bredhi, tund dorën gjersa ata u zhdukën në thellësi të honeve. Era i ledhatonte ballin e flokët dhe i rrëmben fjalën, e ktheu atë në bubullimë:

- Udhë e mbarë o shqiponja të Arbërisë!

VII

1.

*“Xhepel e topjak s’ka
Jemi popull fukara
Që rrojme me lakëra”.*

Një vit veprimtari e çetës të bashkuar të Birbilenjve i dha asaj hove e zë. Kishte Birbilenjtë padukshëm në çdo fshat, ata bashkoheshin me çetën natën në kryerjen e aksioneve dhe ditën i ndeshin në bisht të parmëndës ose në stane e pranë tëndave. Zjarrin e ndjekjeve Birbil Shakua e Resul Sejдини e tërhiqnin mbi vete dhe mbi çetën që asnjëherë nuk ishte mbi njëqind luftëtarë dhe kurrë më pak se pesëdhjetë luftëtarë.

Në veprimtarinë e saj luftarake çeta e Birbilenjve shënonte: Prerjen e karvanëve te Guri i Ylyncit, në Qafën e Muzinës dhe në afërsi të Lekëlit afër Tepelenës; prishjen e karaulëve të zebekëve në Subash, Skërficë, në Qafën e Muzinës e më Palokastër; rrëmbimin e shpërndarjen fukarasë të disa depove të të dhjetave në bereqet; kërcënimin disa herë deri në vrasje të taksidarëve që mblihdnin taksat, xhelepet e topjakët; shpëtimin disa herë të djemve që merreshin nga zebekët me forcë për ti dërguar nizamë në Ordinë e Shtatë; shpërndarje ndihmash për të vobegtit.

Birbilenjtë ndihmonin fukaranë që të blente dhi që t’u njomte buzën me qumësht fëmijëve, njerëzit që martoheshin e të tjerë për të përballuar gjëmën, në veçanti familjet e nizamëve që u vinte letra e djegur. Birbilenjtë dënonin me dënime të rrepta hajdutët që vidhnin. Këto virtyte i dhanë emër çetës së Birbilenjve.

Mbas një viti, kur u kthyen në Kurvelesh, zëri i Birbilenjve kishte rrëmbyer shumë krahina. Ata pasi u endën rreth e rreth maleve qëndruan në malin e Këndrevicës. Edhe pse ishte muaj vere, mali pa tëndë, Këndrevica i detyroi Birbilenjtë të mbanin të hedhur krahëve

gunat e rënda e të ngrohta.

Çobanët e mirëpritën ardhjen e tyre me të shtëna armësh. Kryeçeliku urdhëroi që t' u vihën çjepëve zilet e buqet. Ishin hequr ato në vitin dyzeteshtatë kur dështoi kryengritja dhe në shenjë zije për të vrarët tufat mbaheshin shurdhane. U ngazëllye shpirti i çobanëve dhe i Birbilenjve kur u dha në pllajën e malit tufa e madhe e dhëne. Kopea e madhe e dhenëve e mbushi pllajën dhe duke ndjekur pas cjeptë përçorë në një dyzinë zile Janine i afrohej nomesë.

- I vure këmborët e zilet - i tha Birbili kryeçelikut të stanit.

- Kur është gjallë trimëria është çdo gjë e gjallë në Arbërinë tonë - tha kryeçeliku i stanit. - Kur ju shikoj juve sikur shikoj trimat e Hodos dhe të Gjolekës.

Birbilenjtë qëndruan aty, me gunat të hedhura krahëve. Nga ky vend syri i Birbilit bridhte buzave, aty ku ishte endur kaçak i vetëm, pastaj ndali te Gryka Jetëshkurtër, ku qëndronte Budo Bredhi. U mbështet te shtredhi dhe shkroi një letër për Budo Bredhin.

2.

Atë ditë, një re që erdhi nga deti shkundi një shi të lehtë. Mbas vesës që lëshoi reja që doli nga deti bukuria e malit Këndrevicë u bë verbuese. Një hark ylberi hodhi dy krahët nga njëri mal në tjetrin. Në asnjë mal tjetër nuk e sheh syri atë bukuri! Kot nuk i thonë Këndrevicë "Shtëpia e deles dhe mbreti i maleve". Birbilat zogj filluan këngën. Bashkë me ta edhe Birbilat njerëz, kurse te shtredhi çobanët i vunë në hell mishrat ... Dhe pastaj të dy palët, zogjtë e njerëzit, vazhduan ligjërimet.

- Do të tërbohët Dizdari i kalasë të Nivicës kur të dëgjojë ardhjaen e xhemedijes' të Birbilenjve në këto anë - thanë çobanët me vështrime të ngulitura te luftëtarët e çetës. Midis kaçakëve, dy prej tyre, Birbili dhe Resuli, binin më në sy në pamje e veçoheshin prej të tjerëve.

Çobanët bënin kujdes të veçantë për ata dy burra të rritur si demat në lëndinë. I habisnin mustaqet bishtgjatë të përdredhura rreth veshëve të Birbilit, vetullat e tij kaleshe, që i qëndronin te balli si shtëllungë në furkë. Habiteshin me syrin e bukur hetonjës të Birbil

1) Çetë - turqisht.

Shakos, me kalcën e pulpës që thuhej mund të mbante dyzet okë drithë, me flokët e gjatë që i mblidhte në mes rreth rripit të silahut, me shtatin e lartë që delte një shuplakë mbi të tjerët. Një tjerër s'ja arrinte në shtat e në pajme veç Resulit të Progonatit, që ishte mbi të gjithë Birbilat, i pari i të parëve. Mbase edhe nga moshë. Resuli ishte një dhjetëbukësh përpara të tjerëve. Në këngë po se po, po më tepër veçohej në fyell. Aq sa shokët i kërkonin komandantit të çetës, Birbil Shakos, që fyelli i Resul Sejditit të ishte i larë në flori. Ishte i vetmi shpenzim që bëri çeta e Birbilenjve, veç armëve dhe veshjes. Gjithë thesari i saj u shpërndahej të varfërve. Ata ishin betuar kështu dhe këtij betimi i qëndronin besnikë.

Kur erdhi nga Janina fyelli i larë me flori, Resul Sejditit i Progonatit e ngajti culën në majë të buzës. Kudo që pushonte çeta dëgjohej kënga e lëshonte cula tinguj të butë e të ëmbël. Kur mishërat u vunë në hell, Resuli i Progonatit nxorri culën që vetëtinte si rrezet e diellit mbi pllajën e shkëmbit dhe ligjërimi bënte të lodronin thëllëzat në mal, të pushpuritej sorkadhi në shkëmb dhe të mehte veshi i njeriut. Pastaj në stan u soll fjala rreth trimave në kryengritje, të dertet e nizamëve e për taksat. Dhe herë mbas here u bënë shaka e lodra.

Birbilin e fton në ndeshje njëri nga kaçakët. Ju desh forcë e madhe Birbilit dhe nuk arriti ta nposhte qëndresën e Myrto Dukagjinit të Golemit.

- Me zër nga mezi, hajde ç'pret, - i foli Myrto Dukagjini.

U mbërthyen sërisht në mundje. Atij i përvisheshin palët e fustanellës ngjyrë gri, Birbilit fustanella me lyrë e kaçakut.

- Bah më gremise, për allah më gremise! Ata ishin të tyre, njeri i motrës, tjetri i vëllait. Ama në të mbërthyer bënin si dy deshë të zëmëruar, i shqyenin lëkurën njëri-tjetrit për ta gjunjzuar. Pastaj filluan të "priten" me shpata e jataganë. Goditen e prapsen. Prapë u mbërthyen më duar. Të tjerët i nxisnin. Duhej të fitonte më i fuqishmi. Forca nderohej e respektohej nga kaçakët. Kaçaku kërkohej që të mbante demin e egër në vend. Kushdo nuk mund të bëhej kaçak.

Kaloi një kohë, nduk njëri e nduk tjetri, asnjëri nuk ra në tokë. Në fund, si papritur Birbili i dehur nga gëzimi lëshoi trupin. Kjo i dha rast tjetrit ta shtrëngonte fort në mes e t'ia dobësojë forcën e qëndresës. Erdhi fjala, lodra e kënga me rradhë në të gjithë. Vetëm njëri nga çobanët heshte. Ai s' u bë gjallë, e dinte që kryeçeliku do ta merrte në

gojë emrin e tij. Sa herë kishte mysafirë në stan kryeçeliku e tregonte atë që i kishte ndodhur çobanit me Yzbashin e zebekëve të kalasë së Nivicës. Kur foli kryeçeliku u bë gjallë edhe çobani.

- Ehe, përhera flitet për morrin tim - tha çobani. Sillet fjala rreth e aty vjen, te i ziu çoban.

- Ç`thonë? - e ngacmoi Birbil Shakua dhe u shpupurit, gjë që tregonte se fjalën e Çobanit e pëlqente. E nxiti të tregojë: Fol vëlla fol!

- E ç`të them, o Birbili i maleve, gjë e ndyrë morri për muhabetë e dasma, por sillet nga sillet fjala e del dhe te morri tim. Dua s`dua më duhet të ushqehem, të heq këpushën nga kërthiza dhe ...

- Ç`farë?

- Kush ha dhjamë dashi e ka në kërthizë morrin - tha njëri nga kaçakët dhe vuri shenjë gazi në faqe. Çobani heshti, harroi ç`tha, theu koçonarin, thithte palcën e kockës. Eshtë e mirë palca e deles për vajosjen e pushkës e të jataganit - tha çobani.

- Oj, lugati, të ndez kureshtjen, e nis fjalën, të shtyn në luced e thotë: Ec tani. E ku të vete? Hë, si u bë më tej, folë, folë! - i tha kaçaku me padurim çobanit - Si u bë më tej? Ç`ndodhi pastaj?

- Ç`të bëhej. - Unë ss hodha dorën në gjoksi. Kruhesha. Dizdari Kalasë, Yzbashi Yzedin pandehu se do nxirrja armë dhe i frikosur e hodhi dorën te pisqolla, e nxorri me rrëmbim dhe m`u kërcënua:

- Hiqe dorën nga gjoksi, ç`kërkon të bësh, të më vrasësh? - më tha.

- Jo efendi, jo - i thashë. Ç`të bëj i ziu, ja kërkoj këtë këpushë, e shikon që ma bëri brimë brinjën?

- Përse bën ashtu? - më tha ende i zbehur në fytyrë.

- Dua ta hedh këtë në kutinë e parave të taksës, - i thash yzbashit të zebekëve të kalasë së Nivicës, për morrin. - Bubu si u bë, xhind u bë, i nguli yzengjitë kalit dhe iku, fluturoi tutje nga ... Po fjala mori dhenë e zoti im sa herë bëhet muhabet më detyron ta tregoj atë ngjarje. Ma ka bërë benë komandanti i Zebekëve të kalasë, Yzbashi Yzedin, më kërcënon. Ta preva gjuhën po nuk heshte. Hesht më thotë po unë nuk mund të hesht.

Në anë të tëndës një qen leshtor kishte futur kokën midis pultrave të këmbës e flinte nën hije. Pa prituri qeni lehu.

- Diçka ka kur leh qeni - tha njëri nga kaçakët.

- Belec i nuk ha një rëz, ai s`leh kot, leh vetëm ku ndjen erën e ujkut e të zebekëve. Të gjithë rrëmbyen pushkët. Nuk arritën të zinin

vendet. U tërhoqën duke luftuar me zebekët e kalasë të Nivicës që ishin vënë në ndjekje të çetës.

3.

“Atë e vrau plumbi por e ngjalli kënga”.

Motin tjetër, kur çeta e Birbilenjve limerjaste në fshatrat rreth Janinës dhe u shpërndante të vobektëve mall nga i Ahmet beut, Kajmekami i Kurveleshit, Çollak Zylyftari i shoqëruar nga memurë, xhelepçinj, taksidarë, iftizamlerë, Emir Kunadhen me koshadhë, kalon fshat më fshat. Shikon e regjistron. Porosit:

- Të shkruhet e të dihet saktë ç`mbetet akoma për t`u mbledhur. U mbushën defterët e taksave që duhej të vilesnin. U mat dhe u rimat toka, u nëmëruan tufat.

- Kërkon taksa Ahmet beu ... Kërkon nizamë valiu për Ordinë e Shtatë në Jemen. Dy njerëz ishin zotër në Janinë, Ahmet beu dhe Hysni Pasha. Pashai e rëndonte kalanë e Janinës me topa. Ahmet beu me flori.

U mbushën deftrët e rekrutëve me emra djelmoshash për nizamë. U mundua kajmekami dhe Emir Kunadhja, por nuk e arriti dot të krijojë defterë të nizamëve ashtu si ato të yzbashit Asllan që Birbili i humbi në thellësi të detit. Më mirë punohej në regjistrimet e iftizamllëkut. Aty u ngul të gërmonte Emir Kunadhja. Aty pikonte.

- Na prishi punë dinsëzi Birbil, ai me shokët e tij po e bën vendin raja - u tha memurëve Dizdari i kalasë së Nivicës, fshami:

- E kishim ujkun në kafaz dhe na iku, tani ti ndjekim gjurmën.

- Na kërkohen edhe nizamë, edhe taksat të vilen, edhe karvanët me mallra të sigurohen. Ai foli për Gurin e Ylyncit ndërnjet Tepelenës e Vlorës, Grykën e Mesaplikut, Qafën e Drrasës në Kuç dhe Qafën e Skërficës në Zhulat. Në këto vende, Birbil Shako e Resul Sejdinin i Progonatit, kishin prerë përsëri karvanët.

Valiu i kishte thënë:

- Jazëk të qoftë, ke një taborr me zebekë në Kurvelesh dhe i lë të lëvizin lirshëm ata dinsëzë? Po nuk u morën masa do të bjerë në fund Janina, në batac ka për të rënë ...

Kajmekami Çollak Zylyftari në shtegtimin e gjatë që bëri maleve të Arbërisë solli me vete tufa me bagëti, pare e prodhime

bujqësore. Me shtrëngim e me koshadhë diçka kishte vjelur. Ishte i kënaqur për atë që kishte arritur. Sapo arriti te burimi i kroit të Zotërisë i dha ujë kalit. Uji e bëri kafshën të turfullojë e të godasë zallin me këmbë. Kishte një kalë arabie qafëgjatë që ishte erë në vrapim.

- Ya, - i foli i zoti dhe i shtrëngoi frerin. Kali si të mos kishte bërë rrugë të gjatë u ngrit mbi këmbët e pasme.

Dy njerëz, një burrë i moshuar dhe një vajzë e bukur qëndronin përballë si të ngrirë ... U bë më i tërbuar i zoti nga kali. Sa pa bukurinë e vajzës, qafëdemit, Kajmekamit Çollak iu zgurdulluan sytë.

- Si e ke emrin, moj bukuroshe - e pyeti. Qafëdemit iu ndezën sytë, vajzës iu mehën. Ajo uli kokën e turpëruar e nuk i foli.

Emir Kunadhja afrohet dhe i përshpërit te veshi:

- Eshtë ajo që të kam folur, Hirua e bukur, thëllëza e Birbilit.

- Më gëzon evlati im, ja një thëllëzë që duhet të mbyllet në kafazin e haremit të pashait të Janinës. Bukuria e vajzës do ta verbojë Pashain. Për allah do ta verbojë. I foli Hiros:

- Afromu moj bukuroshe.

Emir Kunadhja i tha qafëdemit një fjalë që e shtyri edhe më tepër atë në drejtim të vajzës. Kajmekami filloi ta shihte Hiron me epshin të ndezur. Ishte hapur fjala që Kajmekami ishte pusht por në atë çast u bë i papërmbajtur në vështrime e në fjalë. Ngacmoi kalin. Kafsha shkërfëriti në hundë, u ngrit ashtu si një qen ujk mbi të dy këmbët e pasme. Kajmekamit i shndriste syri, bëri buzën në gaz dhe i dolën një radhëz dhëmbë floriri. I foli vajzës:

- Më jep ujë moj thëllëzë krahëshkruar e Këndrevicës? Më jep ujë nga ky burim se plasa.

Hirua e bukur u meh nga fjalët që dëgjoji. Ajo ia hoqi vështrimin e syve të bukur kalorësit sytërbuar dhe ia hodhi t'atit. Priti të shpërthente sherri.

Në një kohë vajza vështroi Kajmekamin dhe t'atin. Ç'po bënte kështu Zejno Krekëza, babai i saj? Si heshte ai kur ...

- A ke etje të madhe Kajmekan i Progonatit, - foli burri i shkurtër me rroba shajaku, Zejno Krekëza. Hirua u gëzua që baba i saj më në fund u bë i gjallë.

- Më është bërë shkumb buza e syri, o njeri, - i tha Kajmekami.

- Sytë e dhanë shenjën ç'mendojnë, por fjala ç'thotë; o njeri, se fjala është ndryshe nga syri - foli, Zejno Krekëza, i qetë.

- Nuk më ka gënijer kurrë syri - tha Kajmekami i ngazëllyer,

me sy të verbuar nga bukuria e vajzës.

- Ashtu? - Zejno Krekëza u mpi në shpirt. E shikoi kalorësin me sy të mjegulluar.

Hirua priti vendimin, si i dënuari në sallën e gjyqit. Ajo do të donte më mirë të binte në tehun e kordhës së kalorësit se ... Ai, njeriu që e kishte rritur e bërë aq e hodhi në greminë kur i tha:

- Jepi ujë bija ime, shuaja shkrumin që ka në buzë e zjarrin që ka në sy e në zemër Kajmekami i Progonatit, njeriut zot në malet tona duhet ti bindemi!

- Askoshun! - tha Kajmekami dhe iu ndezën sytë e epshi.

- Babë! - Lëshuan zë të mekur buzët e Hiros. Babë - iu lut ajo shpresëhumbur. Zejno Krekëza u bë edhe më i rëndë në fjalë.

- Jepi ujë njeriut, vajz-o, - dëgjoji zërin e të jatit.

Sa i rëndë iu bë zëri i babës. Sa i egër u tregua me atë dhe si u përul ai e u bë baltë para Kajmekamit.

Ajo, e detyruar nga fjalët e babës, mbushi ujë dhe kalorësi lëvizti mbi shalë, u përkul e piu. Ai pinte ujë me vështrimin mbi gjoksin e vajzës, me afsh akoma më të ndezur në sy. Hirua e ndjeu veten të vdekur. Çdo të thoshte i fejuari i saj, Birbili, kur të dëgjonte?!

- U ngope me ujë o Kajmekam i Progonatit, - i foli babai i vajzës, Zejno Krekëza.

Hirua baltë në fytyrë. Kajmekami Çollak, te kroi i Zotërisë, hëngërin si ujk e donte ende të pinte ujë nga duart e vajzës. Ai tha:

- A s'bën të më japësh ujë me grushtat e tua moj bukuroshe që të shikoj gushën tëndë?

Tring bëri plloça, që i ra Hiros nga dora në tokë, dhe uji filloi të derdhej. Syri i Hiros verbonte, shtati belonjë dhe bukuria e fytyrës i humbte qëndresën çdo mashkulli.

- E kemi zakon, o Kajmekam, kush s'i jep ujë shtegtarit është turp, por ujë i jepet njeriut të lodhur dhe jo pushtetit, - i tha Zejno Krekëza dhe i zbrazti kajmekamit të Progonatit në gjoks gjarpërushën. Ai ra nga kali i mbytur në gjak.

Ata të dy, babë e bijë ikën. Zebekët i vunë në shenjë. I ati u plagos rëndë por Hirua e mori dhe e fshehu shpellave. Dy zaptie dhe Emir Kunadhja i ndoqën. Një luftëtar i çetës së Birbilenjve që u ndodh aty afër i qëllloi me pushkë. E qëllloi njërin dhe ai ra në buzë, copë. Tjetri u kthye i trembur. Emiri si Emiri, u struk në shkëmb, iu vodh syrit të luftëtarit. Hirua e shpëtoi të jatit nga kthetrat e turkut, por

Zejno Krekëza mbas një jave vdiq nga plagët. Të bëmat e Zejno Krekëzës i ligjëroi Sorka. U tha nga njërëzit: "Zejno Krekëzën e vrau plumbi, por e ngjalli kënga!".

4.

*"Ç'ke moj Hiro që vështron?
Sheh Birbilin që këndon..."*

Kur erdhi vitin tjetër çeta e Birbilenjve në Kurvelesh, Birbili shkoi në malin e Këbuzit, ku kishte kaluar fëmijërinë. Birbili ndjeu ëmbël erën ledhatonjëse në fytyrën e tij. Qendroi një çast me përfytyrimin te vitet e fëmijërisë. Befas brofën një tufë thëllëzash me krahë të shkurtëra, të rënda nga dhjami. Shpatet e Këndrevicës e Këbuzit dhe fladi i tyre janë të begatë në kullota, jetëdhënëse për shpendët, kafshët e njerëzit. Birbili, vjedhurazi syrit të zebekëve erdhi në stan, përqafoi fortë nënë Sorkën. Në sytë e shpirtin e saj ai ndjeu mallë dhe hall!

- Më kërkove nënë? Ja ku erdha. Ç' hall të mundon? Si mund të ndihmoj për të shkullur nga shpirti brengën që të mundon aq shumë?

Një qind shpirtëra të kisha do t'i jepja për këto vende. Pse ankon moj nëna ime zemërmirë?

- Nuk është mjaft o bir.

Ç' të bëjmë më tepër moj nëna ime zemërmirë?

- Atë që do nëna jote.

- Veç fol se fjala jote është ligj për djalin tënd.

- Mendo edhe për rrënjën djalo, zoti një herë ta jep jetën. Thëllëza endet gjithë jetën në shkëmb, por edhe ajo bën fole, kurse ti ... Kalon moshën e ndërrohet njeriu bir. Nuk e shikon, më mbuluan thinjat e bardha. Nuk më vjen mirë të shuhet fisi i Shake. S' dua djalo! Nuk dua!

- Ku e ke fjalën nënë, unë kurrë s'ta kam prishur qejfin, fol, nënë, fol!

Sorka nuk foli, vështroi nga pllaja e Këndrevicës dhe ndërroi pamje nga fytyra. Diçka të rëndësishme donte ti thoshte të birit.

- Nënë, fol nënë! - i tha i biri i shqetësuar.

Sorka hodhi sytë nga djepi. Ishte djepi që kishte përkundur Birbilin ... I biri nuk e pat të zorshme t'i lexojë mendimet e saj.

Sorka shpreh atë që ndien në fytyrë, në fjalë dhe në vështrim.

- Të preftë palla në turkun si Skënderbeut, por edhe Skënderbeu

që ishte Skëndërbe la djem prapa.

Fjalët e nënës e habitën Birbilin. Atij i kishin folur për Skënderbeun. Nexhip Bedena i Zhulatit në Janinë. Edhe në Ergjëri dëgjoji fjalën Shqipëri dhe Iskënder. Dhe ja, e dëgjon atë edhe nga zëri i nënës. Këto fjalë i ka dëgjuar edhe nga Budo Bredhi. Thoshte Budo Bredhi: "Themi fjalën **Dhe** pastaj e vëmë përpara fjalën **mëmë**, e quajmë ashtu se na i do xhani "MEMEDHE". Shkruajmë fjalën At dhe fill mbas saj fjalën Dhe, e themi: "ATDHE". Këto fjalë Birbilit ia kishte mësuar Budo Bredhi në kohën që mësoi të shkruante e të lexonte. Nga ai e dëgjoji së pari emrin Skënderbe. Duke shëtitur nëpër stane, Budo Bredhi kësi fjalësh përhapte ...

Nëna Sorkë është si gjithë nënat. Ajo e shikon të birin në sy e me sytë e saj te djepi i lutet:

- E dua bir, e dua. Valiu i Janinës kërkon të na i thajë djepet. Pa nëna shter jeta, s'ka më Birbilin. Pastaj u bë i teti vit që pret bijë e botës, është rritur vajza Birbil, është e helmuar vajza. S'i nuk mendon? Jam nënë, e nëna s' duron dot pa djepin ... I ligjëroj trimërisë së Arbërisë, po s'ka këngë me djepet bosh. Rrënjëdalët as dinë të këndojnë e as dinë të qajnë.

Balli i Birbilit si balli i shëndreut, vetullat e Birbilit re mbi majën e Këbuzit. Shpirti i Birbilit muzg. Ai e kishte kujtuar shpeshërë Hiron e bukur por asnjëherë nuk i shkoi ndërmend që në kohën që pritet me pallë me zebekët e pashait të janinës të martohet.

- S'ka pallë pa djep, Birbil - ngulmoi nëna Sorkë.

Birbili hodhi sytë nga shpati i malit.

- Mendoje mirë këtë punë bir ...

- Ç' do të thonë njerëzit për mua nënë. Si mund ...

- Shëët, mos guxo të më dalësh përpara, kjo do të bëhet. Sa për atë se ç' do të thonë njerëzit të tregon nëna. Lypset ta dije vetë, pse me sa duket nuk e ke menduar. Tani dëgjo nënën. Njerëzit do thonë: "Birbil Shakua u bë edhe një herë Birbil. Kush s'mejton për rrënjën nuk është kurkush". Mos harro që Kajmekami u mundua t'i vinte brirë Zejno Krekëzës. Nuk do të ishte, Birbil me zë e nam, po burrë me brirë turpi, po ta kishte lëshuar zemra të ziun Zejno. Zejnua e bëri të vetën, tani të ka mbetur radha ty. Fol, përse nuk flet, nuk je dudum po Birbil, yt atë me kokë e këmbë. S' mund ta lesh vajzën e fejuar në mëshirë të gojëligjëve. Si? I sajti vit po kalon që vajza po të pret. Ku ka ndodhur të presë vajza një jetë.

-Birbili yt nuk është nga ata që të mos e kuptojë atë që ka ndodhur, nënë.

- Hirua vuan, Birbil, ajo mbeti pa babë. Është ofenduar vajza. Hodhi sytë mbi të i huaji. I duhet t'i dalim për zot vajzës.

Birbili nuk foli. Sorka erdhi njëherë rreth stanit e prapë vazhdoi:

- Zebekët me njëmijë marifete kërkojnë të thahen rrënjët tona. Ata duan të mos përkundim fëmijë në djep. Unë s' mundem, më beso që vdes pa djepin. Më beso bir, që nëna jote vdes .. Zebekët duan që të jemi të përhumur, as të gjallë e as të vdekur, por unë, ja kështu jam. Mbase pak e sertë po tjetërsoj s' mund të bëhet nëna jote. Më bëri kështu kënga e lëngata e Arbërisë, trimëria dhe gjaku. Dua t' i këndoj djepit. Birbili belbëzon, hutohet e zbehet në fytyrë, thotë:

- Mos nënë, mos kështu, më rëndon dyfish peshën e halleve.

- S'bën dot ndryshe nëna jote. Ose kështu, ose Sorka bie e vdes.

Birbili heshti ... Sytë e tij u ngulitën te sytë e nënës. Ajo e kuptoi që ata sy të dashur për të i luten të ketë mëshirë. Kaçakun e rreh vala e jetës me kopan. Kurse ajo ...? Më kot i biri priste mëshirë. Ajo vazhdoi:

- Për dasëm rrita pesë shelegë që kanë pirë qumësht nga dy nëna. Edhe kecin e bucëkenës që e mori xhelepçiu me mori lopa.

- Nuk kam dëgjuar që lopa mund të rritë edhe kecin ...

- Ai nuk është kec por cjap, do ta shikosh?

Ajo zbriti te vatha, hapi derën dhe nga kasollja e vogël buzë shkëmbit doli briçatalli duke bredhur.

- Përse shpejtohesh nënë?

- Më vjen keq për vajzën, është zemërvrarë e shkreta Hiro! Kushedi ç'mendon, e preku në erz, e ofendoi zullumqari djal-o, i vrau gëzimin, i vrau babën. Është vajzë me erz Hirua, i vrau shpirtin zebeku që iu bëftë shpirti lugat. S'ka asnjë faj ajo, Birbil?

- Kush tha që ka faj?

- Ai dritëshkurtëri, Emir Kunadhja ka lëshuar fjalë: "Në se bushtra nuk e lëviz bishtin, qeni nuk e merr prapa". Fjalët e gojëligut i rëndojnë vajzës, është vajzë me erz Hirua, Birbil!

- Ashtu? Fliten fjalë? "Ah Emir Kunadhja, një lëvizje krahu më duhet për ty".

Nëna iu tremb syve tërbonjës të të birit.

- Ta ka nëna dhe një gjel në shtëpi, - i tha duke qeshur.

- Ç`e do gjelin? moj nëna ime zemërmirë?! - e pyeti Birbili pak si i habitur dhe me zë të butë, jo si zë prej kaçaku po të butë, ledhatonjës.

- Kaçakun gjithmonë e ka ngrënë gjumi i mëngjesit, gjeli na duhet se të çon herët

-Si? - mendon që biri i këngëtares më me zë të Arbërisë të bëhet gjumash?

- Jo biri im, nuk i rrëmbeve vetëm pamjen babës tënd por edhe bëmat por ja, erdhi vakti t`i shtrohemi udhës së jetës që është udha e zotit.

Kur u ndanë Sorka mërmëriti ligjërimet e saj për ditën që u vra Zejno Krekëza. Do t`i këndoj në këngë ditën e dasmës - tha.

- Nuk është udha e kaçakut kjo moj nënë.

- E përse? A nuk janë njerëz kaçakët?

5.

Dyzetepesë kalorës Dhëndërri vezir mbi ta”.

Dy javë më vonë Birbilenjtë, që ishin strukur në pyllin e Llukës, dolën përballë stanit të nënë Sorkës. Aty i priste Birbili. Ai kishte dalë te zalli i bardhë afër burimit. Dëgjonte gurgullimën e ujit të bardhë që delte nën rrënjët e lajthive. Uji delte nëpër guriçkat i bardhë si qumështi, i ftohtë si bora. Këtu e kishte takuar ai, së pari herë, Hiron e bukur. I erdhi në kujtesën e syrit të mendjes ajo ditë. E përjetonte, prandaj qe përhumbur, kur i foli Resul Sejdini, te shtegu në shpatin përballë.

- Eh e e! Ku e ke shtëpinë o kaçaku i Këndrevicës, - dhe e zbrazi arnautkën.

Birbili hapi krahët e gjëra ashtu si të ishte shqiponja majë thepit që rreh krahët e niset në fluturim të pandërprerë. Atë kohë ecte nëpër rrugën që dredhon nëpër verranë e bardhë një grumbull burrash nga Rexhini i Nivicës. I pari i tyre, kryekrushku bën ashtu siç bënte Mylazimi, më i vogli oficer në gradë i nizamëve. Kryekrushk i kaçakëve kishte ardhur vetë Budo Bredhi. Ai kishte prurë edhe dashin e nuses, një bejkush të bardhë me shtat demi. Desh si ai veç aty, mes shkrepave të Grykës Jetëshkurtër mund të rriteshin.

Kaçakët me fustanella të bardha e me veshje të bukur kaçaku

dolën te bliri, aty nga vështronin stanin ku bëhej dasma dhe krushqit që afroreshin. Syri e veshi i kaçakëve përherë në përgjim. Krushqit të dehur nga gëzimi këndojnë. Urojnë thonë:

- Lum ti moj Sorkë ia arrite kësaj dite.

- I vogël fshati ynë, po i madh gëzimi - thanë njerëzit.

Zemra e vejushës Sorkë nga gëzimi përpëlitej në gjoks.

Prapë krisma armësh e këngë. U dhanë krushqit te stani përballë. Në fund, mbi kalin e bukur pullali nusja e veshur me pendolira, mbuluar në mëndafshe të bardha e këmisha cipëgjarpëri, të holla e shndritëse, me xhupin e ngrirë në argjend, ku midis shpatullave është qëndisur shqiponja. Është dasmë kaçaku dhe domosdo këngët e trimave zënë kreun e këngëve. Budo Bredhi, që printe në krye krushqit, i kaloi nëpër shtigje të verbëra. Nuk duhej ta mësonin zebekët e kalasë dasmën e kaçakut. Krushqit afrohen e kënga ndizej më tepër. Edhe nënë Sorka sapo erdhën krushqit ia mori këngës. Rreth Sorkës mblidhen të gjithë, gra e burra. Zëri i Sorkës mbi gjithë zërat:

Dyzetepesë kalorës

Birbili vezir mbi ta.

Gjithë me dyfëk në dorë

Dhëndërrri vezir mbi ta.

Do të prishin Stambollë

Dhëndërrri vezir mbi ta.

Menjëherë mbas këngës doli dhëndërrri te hija e Blirit të madh. Birbili me flokë të artë e të dredhura, me gjoks të gjërë leshator, me supe të lartë, qafëgjatë e fytyrëhequr. Sytë e mëdhenj e hetonjës, faqekuqë e i zhdërvjellët, i lehtë në ecje po i rëndë në peshë. Ai është dhëndërr që mban robe kaçaku e silah plumbash për mezi, dy pisqolla që shndrisin, flokë çepekrëndë, mustaqet tumë si xhufka misri të mbushura e të rënduara si të jetë dy herë më i madh në moshë. I pashëm si asnjë mashkull tjetër.

Nusja zbriti nga kali.

- Symëshqerra e nënës - i foli nëna Sorkë. Ajo iu hodh dhe e qafoi.

Në cipën e bardhë të vellos shihej bukuria e fytyrës së nuses, shtati i saj belonjë. Hirua ishte e bukur, ngjante në pamje nga nëna,

në të bëme nga i ati. Sikur ajo t' i ngjante në të bëme nënës do të kishin thënë: "Lindi sherri sherrin: Po Hirua nuk i ngjante të ëmës, ajo ishte e butë si një dele manare. Nëna e saj kishte kohë që kishte vdekur por me sherret që ndezi ende merreshin me to dy copë fshatra. Kjo grua, sa qe gjallë, ngarkohej si mushkë e punonte në arë si burrë. Kur vdiq, Hiros iu duk se u përmbys shtëpia, i erdhi shumë keq, kurse të tjerët i dëgjoji të thonë: "E kishte gojën helm, më mirë që vdiq". Po Hirua i kishte marrë asaj vetëm dëshirën e forcën për punë dhe bukurinë.

- Sorkadhja e nënës - i flet Sorka. Hirua i hyn në gji, don ti ledhatojë ballin e flokët, ti flasë: "Nënë! Nënë!" Po nusja sipas zakonit nuk duhet të flasë. Këngët janë ndezur, gëzimi sillet rreth shtredhit.

Ligjëronjë birbilat mbi degët e blirave, thëllëzat kërcejnë gërçh më gërçh, krushqit e kaçakët te stani. Hirua e bukur nusëron, mishrat dridhen në hellë. Sorka llërëpërveshur sillet rreth, aty ku janë gratë dhe te hija e blirit të madh ku janë shtruar këmbëkryq me raki e meze përpara burrat dhe kaçakët, shokët e Birbilit. Birbili qëndron aty, në këmbë u shërben shokëve dhe miqve. Befas i tërheq vëmëndjen emri i tij në këngën që ia kishin marrë shtruar kaçakët:

*Të kesh mall për djalërinë, të kesh mall
Se djalë më s' bëshesh kurrë, të kesh mall
Të kesh mall të flesh me gunë, të kesh mall.*

Sapo mbaroi kënga, Myrto Dukagjini, djali i hallës, njëri nga shokët e Birbilit, ngriti gotën dhe iu drejtua dhëndërrit:

- Të kam gjetur o dhëndër, të trashëgohesh.

- Me fund për miqtë e shokët që na nderuan konakun.

- Me ngadalë rakinë, o dema të tërbuar - u tha Resul Sejdini.

Gëzimi i përfshiu të gjithë. Ndihet tejngopja e mendjes me raki e gaz aq sa harrojnë se janë kaçakë. Kaçakët e burrat u ngritën në valle. Vallën e hoqi Budo Bredhi. Si u ngrit ai, ashtu paparitur u tha kaçakëve:

- Mbamani se fluturova - dhe drodhi shaminë. Vallja mori zjarr. Dikush uroi Budo Bredhin dhe zbrazti një armë në ajër.

Budo Bredhi si të ishte djalë kërcente majë thoit, "dridhej" vrullshëm. Kur dridhej, fustanella i hapej e dukej sikur do të fluturonte. Dhe prapë qëndronte me të dy këmbët, merrte vrull e godiste tokën me këmbë. Sikur thoshte: "Eshtë jona kjo tokë, s' ka vend halldupi në këto

vende”. Të tjerët të ulur bisedonin me njëri-tjetrin me zë të lartë:

- Ç’ka në mënd, të vdesë në valle imami Budo!

Njëri nga burrat tregoi se në një dasëm në Nivicë kishte shkuar dizdari i kalasë, yzbashi Yzjedin Takijexhiu. Kur pa krushqit të zënë në një valle, si kjo e sotmja, mbeti i habitur. E pyeta:

- Si të duken vallet tona, efendi?

- Të sërta - tha dhe nduku mjekrën e zezë.

- Ndryshe s’do të na hynin në punë vallet. Të sërta malet, të sertë njerëzit, të sërta vallet, - i thashë. Do ti që i vari hundët dizdari i kalasë, nuk i erdhi mirë që ia thashë atë fjalë.

Birbil Shakon e vuri në mendim ai llaf. Përse i cukthin Dizdarit të kalsë kur vallet tona shoqërohen me krisma dyfeku? Të gjitha ato që bëjnë zebekët kanë symin të vetëm për të na hequr çdo zakon të vecantë që na bën të jemi arbër. Ata duan të vrasin shpirtin tonë të Arbërit. Por nuk mund ta vrasin shpirtin pa vrarë më parë këngën ku skaliten aq mirë ritet e zakonet tona, shkruhet historia jonë. Si nuk e kuptojnë që kënga nuk vritet. Nuk vritet kënga me plumb! Ato rrjedhin si ujët nëpër damarin e shkëmbit dhe ulen pastaj në ujëvarat e bardha. Ato janë shkrirë në një të vetme me shpirtin e arbërit.

Hyzmetçinjtë prunë të pjekur kecin e dasmës. Keci i lopës u pre e u vu në tepsi. “Ha e vdis, lëre ç’është” - tha hyzmeçi që e hoqi nga helli.

- Hyr në valle Birbil - i thanë.

Ai s’desh të hynte në valle, por duart e kaçakëve e rrëmbyen. Birbili erdhi rreth në fillim, kërceu shtruar, pastaj edhe ai u ndez.

Duke qeshur i këndon vetvetes:

*Seç u bëshë për në peta
Të më vijë e gjithë çeta.
Gjithë çeta të më vijë
Të më rënkojë të zinë.
Për mike buzë kutinë ...*

Mbasdite dasma mbaroi dhe çeta e Birbilenjve ndërroi vend për ti humbur gjurmët koshallës ...

VIII

1.

*Do ta shes shtëpinë, do ta bëj lëndinë
Do blej martinë, do shkoj me Birbilë.*

Të ishe anëtar i Çetës duhej të plotësoje disa kushte të domosdoshme. Çdokush nuk mund të mbahej në çetë. Anëtar i saj duhej që patjetër të ishte shëndetplotë, i varfër por aspak lakmitar. Kush lakmonte paranë përzihej nga çeta, sepse në duart e luftëtarëve të çetës binin thesare që u rrëmbeheshin taksidarëve, të cilat duheshin të shpërndareshin një për një. Fjala se Birbilënjtë shpërndanin lira të varfërve u përhap tejndanë Vilajetit të Janinës.

Kur Birbilënjtë po shtegtonin, së dyti, në drejtim të fshatrave të Janinës u strukën në një shpellë sekrete në anë të rrugës, në afërsi të Kardhiqit e Zhulatit. Shkak u bë lajmi që morën se koshadhet do të shoqëronin një nizam të arratisur për ta dërguar në Janinë. Nizami ishte arratisur nga Ordia e Shtatë. Birbilit iu kujtua që edhe ai ishte dënuar të vdiste nga pika e ujit në sheshin e kokës.

Për të shpëtuar nizamën e arratisur Birbilë i organizoi kapjen e një mylazimi, të cilin e mbylli në shpellë. Dërgoi haber në hyqymet dhe kërkoi që të bëhej ndërrimi i nizamit me mylazimin.

- Në djall të vejë shpirti i Mylazimit, - dërgoi fjalë Valiu i Janinës. Kur nuk diti të mbrojë kokën e vet nizam i arratisur duhet të vdesi që të mos guxojnë të tjetër të bëjnë si ai.

Pas kësaj Birbilënjtë u strukën te Shpella e Lopëve, një shpellë shumë sekrete. Aty afër, tek Qafa e Priftërve, ishte një bari i veshur copë e çikë. Ai ishte mbështetur mbi kallëmin e kërrabës, shikonte nizamën e lidhur dhe këndonte këngë halli e derti, këngë për djemtë që i rrëmbente Ordia e Shtatë:

Djemtë tanë vaj me det

Birbilit iu kujtua vapori kusar me emrin "Daut", zhurma e tij mbyhtëse: y-y-y - y-y-y! Dhe shokët e kurasë së tij që një e nga një po u vinin kartat e djegura nga Ordia e Shtatë.

U panë zebekë e koshadhet që e përcillnin në Janinë nizamini të lidhur në litarë e zinxhirë. Birbilenjtë nga shpeilla nëpër daljet e nëndheshme u dolën në pritë, zunë shtegun tek Shkalla e Erës, një orë larg hanit të Skërficës. Çeta e Birbilenjve në ecje bëhej erë, në pritë e padukëshme.

Birbili e mbushi pushkën top dhe zuri vend tek një kllapë guri. Asnjë shenjë që aty ishte vënë pritë. Prita ishte një nga format kryesore të luftimit që e përdorte çeta e Birbilenjve. Pritave u trëmbeshin zebekët dhe zabitët. Kur hynë të gjithë zebekët në pritë ishin vënë në shënjestër, vetëm nizami i arratisur nuk ishte marrë në shenjë. Një sinjal u dha nga Birbili, një i vetëm dhe tri batave u dhanë radhazi nga luftëtarët e pritës. Në trupin e çdo zebeku shenja plumbi. Asnjë prej tyre nuk mbeti i gjallë.

- Të vënë mënd po deshën, i vrasim se na vrasin - tha Birbili. Nizami i arratisur u armatos dhe shfaqti dëshirën të qëndronte në çetë.

Ende pa u larguan nga vendi i pritës, Birbili shkroi në një copë letër fjalën: "Birbilenjtë". Në çdo aksion që kryente çeta linte gjurmë. Ajo shpjegonte shkaqet që e detyronin të bënte aksionin. Pastaj çeta e Birbilenjve mori të përpjetën dhe doli në majën e malit. Çobani pranë shpellës sekrete ende këndonte. Birbili qëndroi një hop, u mbështet mbi arnautkën e tij të gjatë dhe dëgjonte çobanin që lutej me këngë:

Do ta shesë shtëpinë do ta bëj lëndinë

Do të blejë një martinë, do shkoj me Birbilë.

Birbili i heshtur dëgjon atë që këndon. Hedh vështrimin nga deti. Deti bënte tallaz.

2.

Kohë më parë, disa kaçakëve të Birbil Shakos, në një fshat të Progonatit, u prenë rrugën fshatarët.

- Kthehuni prapa - u thanë. Ata nuk dëgjuan. Konflikti përfundoi me një kaçak të plagosur.

Shkaku i ngatërresës e kishte zanafillën në një ngjarje tjetër. Njëri, nga pjestarët e çetës, kishte ndyrë dorën, kishte rrëmbyer një dorë me para nga një fshatar i Fllomoit. Birbili e Resuli, kur e mësuan ngjarjen, zbritën nga mali dhe shkuan në fshatin Çatistër.

- Ç`hall i madh të ka zënë, o Birbil i maleve, që shtegtove nëpër këtë borë të rëndë dhjetori - i thanë në Çatistër.

- Dua të bisedoj me Fllomovitët.

- Përse - e pyetën.

- T`u them që ata kishin të drejtë. Kusari që i vodhi u ndëshkua.

Keqbërësi s`ka jetë me xhemedijen tonë.

- E pastaj?

- Kemi dëgjuar që dikush e ngacmon këtë ngatërresë. Njerëzit e hyqymetit i fryjnë erës, duan që me këtë ngjarje të zhvleftësojnë nderin dhe besën e kaçakut, të na vënë në grindje.

Ditën tjetër erdhën edhe burrat e Fllomoit. U mblodhën te kisha e fshatit.

E mori fjalën i pari Birbili, i cili tha:

- Erdhëm t`ju shpjegojmë që njeriu që bëri vjedhjen në Fllomo nuk ishte kaçak.

- Kush tha - foli i zoti i shtëpisë që ishte vjedhur, e pashë me këta sy, ja me veshjen tuaj, me armë si tuajat ishte.

- Ngadalë, o barbazemërmirë, prit të shpjegohemi, ta pleqësojmë çështjen bashkërisht.

- Ngadalë? Si ore, ç`të pres. Mirë flet, o pedhja, po dëgjoni ju ç`thotë fshati e gjithë Pogoni?

- Ç`farë?

- Birbilentë e vodhën Fllomonë. Më mirë mos e ngacmo sherrin kur duhesh t`i largohesh.

- Nuk është e vërtetë, mbi ballin e Birbilenjve ndrit drejtësia dhe e vërteta kundërshtuan Çatisjotët.

- Xhemedie tjetër nuk është endur në këto anë, veç Birbilenjve. Me se shpjegoheni që ajo nuk është e vërtetë?

- Ja ku e kemi hajdutin, e kemi këtu të lidhur.

Dy Birbilenj nxorrën nga hajati i kishës vjedhësin. Birbili e pyeti:

- Fol, o dobiç i bushtrës, pse e bërë këtë vjedhje.

- Më ngarkoi Kajmekami. Ai mi bëri teshat si kaçak dhe më dha armë si të kaçakëve.

- Që të vidhje?

- Po, më porositi të quaja veten kaçak i xhemedijestë Birbilenjve.

- Paret që rrëmbyet ç' do ti bënit.

- Do ti ndaja me Kajmekamin.

- I ndatë?

- Jo.

- Përse?

- Më kapi çeta e Birbilenjve në dhokan.

- Këto janë paret.

- Po, këto janë.

- Urdhëro, o barba, ja ku i ke paret, merri dhe dëgjoni dhe ju të tjerët Birbilenjtë nuk e ndyjnë dorën.

Plaku u ngrit rrëmbimthi, mori qesen me flori duke thirrur greqisht:

- Zito qirje Birbili, zito!

U bë një kohë heshtje gjersa u nxorr kusari te bregu, në anë të fshatit, aty te lisi i madh. Pastaj u dëgjua një krismë pushke, një e vetme.

- Ndëshkim i rëndë - tha një Çatisjot.

- I rëndë po i domosdoshëm, i tha Birbili, që të vënë mend kusarët dhe njerëzit e hyqymetit.

E mori fjalën Resul Sejdini, burri me tipare të veçanta, i cili, me zë të fortë, tha:

- Edhe një ngjarje tjetër lypset ta pleqësojmë. Disa luftëtarë të çetës tonë u qëlluan me armë. Flitet sikur Birbilenjtë kanë thënë: "Do të hakmerremi për shokun që nau plagos. Edhe kjo nuk është e vërtetë, o Fllomovitë". Ja ku është djali që është plagosur. Ai ka ardhur këtu që ju të bindeni që as ai dhe as xhemedija jonë nuk kërkon të marrë gjak. Armët tona kanë në shenjë vetëm zebekët, kajmekamët dhe gjithë keqbërësit. Birbilenjtë do ti keni përherë në krahun tuaj.

Në emër të çetës, Birbili nënshkroi një marrëveshje me Fllomovitët. Ajo u nënshkrua, aty, në kishën e Çatistës.

Në këtë marrëveshje thuhet:

"Deklaroj i nënshkruari Birbil, nga Nivica, lagje Rexhini, pasi kam patur fërkime me Fllomovitët së bashku më shokët e mi, dhe sot bëra marrëveshje me këta, u a falëm dhe s'ka për tu bërë ndonjëri

davixhi as t'u kërkojë gjë prej nesh ose të dali ndonjë tjetër për këtë çështje t'i preki gjë, apo nga shokët e mi, kam për t'u përgjigjur unë Birbiil në çdo kokëçarje të tyre dhe për sigurinë e Fllomovitëve dhash këtë senet dhe nënshkruajmë:

Unë Birbil pranoj dhe nënshkruaj me dorën time.

Dhe unë vëllai dëshmitar

Dhe unë Xhule Zeneli dëshmitar

Unë foto (Xhixho) ... dëshmitar

E martë, i pari 1 1853

Manastiri i Çatistës

(Përkthim fjalë për fjalë)

Originalin e ka Andrea Toli mësues në shkollën "A. Zeneli".

[Handwritten text in Albanian script, likely a translation or transcription of the original document's content.]

[1853] ...
[Handwritten signatures and stamps, including a circular official seal.]

3.

Birbilenjtë për të humbur gjurmët shtegtuan larg. Ata arritën gjer në disa fshatra rreth Janinës. Pastaj ata u ngjitën në male. Qëndruan në fshatin P. Grekërit e këtij fshati, të humbur mes maleve, ishin bërë disa herë jataku i çetës së Birbilenjve. Kur u larguan Birbilenjtë nga ky fshat, papritmas një koshadhe e madhe këmbësore e suvari dhe një patrullë më zebekë, të komanduar nga një mylazim, erdhën enkas nga Janina dhe e bastisën fshatin P. Bashkë me ta erdhi edhe krahu i djathtë i Ahmet beut, Agim Xhemal Vatina. Ai mblodhi burrat e fshatit dhe u tha:

- Mjaft livadhisët, mos e dini se Valiu i Janinës s'ka veshë të dëgjojë, e s'ka sy të shikojë. U gënjen mëndja juve, fshatarëve të Kaçandonit. Po Kaçandonit iu hodh nga Valiu litari në qafë. Mos pandehni që s'ka nizamë Valiu i Janinës t'u shtrojë e t'u bëjë pulë, juve grekërve të fshatit P. Si ore kokëtharë guxoni t'u shtroni darka e dreka e t'u bëni jatakë jezitëve të Aliut, Birbilenjëve. I kishit bërë rixha Valiut t'u mëshirojë në xhelepet. Ka disa vite që nuk u duk këmbë e taksidarit e xhelepciut në këtë fshat. Mos pandehni se trëmbeshin nga zullumet e Birbilenjve. Jo, jo! U mëshiroi Valiu, o grekër rrjepacakë ... Erdhëm këtu që të paguani edhe kacidhen e fundit për gjithë vitet e tjera. Kush nuk jep taksat do të kalbet në hapsanë.

Kur mësuan Birbilenjtë se ç'po bëhej me grekërit e fshatit P u bënë erë. Udhëtuan një ditë e një natë dhe ju vunë pritë tek shtegu, në afërsi të lumit, ndërmjet Konicës e Janinës. U bënë sy e veshë. Qëndruan në pritë një natë e një ditë. Asnjë lajm ... Dyshuan që taksidarët dhe patrullat që i shoqëruan dhe Xhemal Vatinën kishin kapërcyer pritë. Si të bënin?

- Të presim - i tha Resuli.

Për Birbil Shakon fjala e Resultit ishte ligj. Ata pritën edhe një ditë e një natë tjetër. Kur u venit shpresa dhe ata e humbën durimin, në kohën që u gatitën për t'u larguar u shfaq papritur karvani i kafshëve të ngarkuara me bereqet e gjithëfarë plaçka të rrëmbyera nga fshati P. Ndëshkoheshin malësorët e fshatit P. se ishin nga ata grekërit kokëshkretë që nuk nënshtroheshin. Sepse ata ishin bërë jatak për Birbilenjtë.

- Po vijnë, po vijnë! - thiri njëri ngë Birbilenjtë që qëndronte

në përgjim.

Birbili i dha shënjë dhe prita mbushi armët. Birbili rrëshqiti këmbadorazi dhe zbriti tek shkalla e gurit. Aty ku shtegu ishte më i ngushtë. Kur zebekët e kalorësit kishin hyrë të gjithë në pritë Birbili thirri:

- Dorëzohuni o zebekë të ndyrë, Birbilenjtë u kanë vënë pritë. Kalorësit, sa dëgjuan emrin Birbilenj, u hutuan. Nuk mund të lëvizje në asnjë anë pa rënë në humnerë. Ata e panë veten pa asnjë shpresë dalje. Nuk u dhanë. Qitën flakë armët e tyre. U egërsuan kuajt e shalës dhe të zotët.

- Atëhere ngordhni. Këtu do t' u ngelet lëkura, t' u hanë korbata - tha Birbili dhe zbrazti arnautkën disa herë radhazi.

Mbas krismave të pushkëve Birbilenjtë ranë me pallë, u hodhën sipër zebekëve dhe filluan të përdornin jataganët. Disa nga zebekët që nuk patën guximin të vriteshin u dorëzuan. Mblazimin, që komandonte patrullat, e morën peng, të tjerët si i bënë mëzat, u morën armët dhe i nisën për në Janinë.

Taksidarët dhe xhelepçinjtë Birbili i paralajmëroi se nëse s' do të hiqnin dorë nga zanati i ndyrë që ushtronin do tu pritej koka.

Birbili ishte i kënaqur që aksioni përfundoi me sukses. Karvani u rikthye përsëri në drejtim të maleve. U kthehej pasuria të zotërve ...

Kur mësoj Birbili se përmes thellësive të përroit e shkrepave Xhemal Votina duke rrëshqitur si gjarpër i kishte shpëtuar pritës qortoi veten. Tha: "Këtë akrep duhet ta kishim kapur të gjallë". U vendos që Xhemal Votina duhej të ndëshkohej. Dhe çeta u vu në kërkim të tij.

Birbilenjtë u endën disa ditë në fshatin P. derisa u kthyen bagëtinë e plaçkat të zotëve dhe pastaj i humbën gjurmën koshadhes. u zhdukën si era. Dy javë më vonë zbritën në Votinë dhe rrethuan sarajin e Xhemal Votinës. Aksionin e kreu Resul Sejdimi. Ai me një progonatas tjetër u ngjiti sipër, në odën që flinte beu i Votinës, miku e dora e djathtë e Ahmet beut. Nga dritarja Resuli i dha flakë pushkës dhe njeriu i goditur për vdekje, pasi u përpëliti një çast, vdiq në shtrat ...

Ata u larguan duke i vënë zjarr sarajit dhe lëshuan fjalë: "Birbilenjtë janë e do të jenë në krah të hallexhinjve, të shqiptarëve dhe të grekërve. Ne nuk do ta kursejmë plumbin për ata që rrjepin fakir fukaranë".

Më vonë u mësua se njeriu që u përpëliti në shtratin e beut nuk ishte Xhemal Votina por qehajai i tij. Nga kjo ditë Xhemal Votina u bë edhe më i egër dhe u vu në gjurmë të Birbilenjve.

4.

*Odrë e bukur Odrë
Gjithë lisa, gjithë hije.
Odrë qafë Çajupit
Konaku Birbil Hajdutit.*

Kjo ngjarje ndodhi më vonë. Gjatë muajve të verës çeta e Birbilenjve që endur rreth e rreth Labërisë. Kishte shkelur fshatra e stane dhe njerëzit morën zemër për të qëndruar. Taksidarët e xhelepçinjtë nuk guxonin të delnin nga kalatë. Nuk vilej topjaku e vergjitë.

U ndërprenë rekrutimi i djemve për t'i dërguar nizamë në Ordinë të Shtatës në Jemen. Këtu arritën në sajë të veprimtarisë të Birbilenjve. Ata, me një grupet e tyre e paralizuan administratën në krahinën e Labërisë. Ashtu shfaqën, po ashtu u zhdukën.

Nga mesi i gushtit Birbilenjtë shtegtuan përsëri në drejtim të Janinës. Ata qëndruan një ditë për të vapuar në malin Çajup, afër burimit me ujë të ftohtë, në stanin e Arshi Melunit, një kryeçelik nga Ergjëria. Izoti i stanit Arshiu, përgjërrohej. Në napat e bardha kullonte djathi dhe në hell pëqeshin mishrat.

- Kemi raki, hë si thua, o Birbil hajduti. Të dërgojmë e të marrin në Topovë ca hudhra e qepë.

- Kaçaku nuk pi, Arshi, lëre atë punë.

- Ma do zemra o Birbil. Kaloi një vit që nuk jemi parë. U kam pritur më beso, m'u tha bebja e syrit duke ju pritur. Katër vite rradhazi kaluan nga ajo ditë që re në stanin tonë. Prit e s'ka. Çajupi është shtëpia e kaçakut. Ka vend si Çajupi? Sa mall kisha. Për allahun që është një u prisja o Birbilat e maleve.

- Do të çmallemi më tepër kemi kohë.

- Ashtu de, asgjë nuk ndodh në stanin tim, Çlodhuni o trima, fladin e Çajupit ma kërkon dhe valiu i Janinës po nuk ka ku e gjen. Ja mori këngës Arshi Meluni:

O Çajup o vend i bukur

O haçeja e luleve.

- Kështu janë këto punë o mik i dashur, - i foli Asllan Gjoça i Zhulatit. - Valiu ka flori e topa, ne të zotët e vendit, bar e trëndëlinë dhe erën e trëndëlinës e të lirisë.

Arshi Meluni u bë bazë e çetës me ndërmjetësinë e Asllanit. Mik pas miku e shok pas shoku u gjend ky stani në mal, larg syrit të koshadhes.

Shtegu i Qafës Çajupit punohej nga njerëz. Kalonin udhëtarë e përshëndetnin kaçakët. Përshëndetnin edhe Arshin zemërmirë që deklaronte se stani i tij është fole ku kaçakëve s' do t' u hynte gjëmb në këmbë.

- Aha, këtu e ke ngritur madrinë o Birbil Kaçaku? - i tha Spiro Kodheli i Sheperit që kaloi aty dhe shtoi: - Eshtë vend i mirë Çajupi, e lakmon koshadhja djal-o, këta të qytetit të heqin qafe për hiç gjë.

- Mos ki merak barba Spiro, konakët në male kudo në vilajetin e Janinës nga shqiptarë e grekë janë jatak për Birbilenjtë.

- Nuk thashë gjë, po mendjen mos e vini në gjumë, nuk e kini larg kasabanë. Fill pas tij doli te qafa një shtegtar tjetër. Kur kaloi afër takoi Birbilin. Këmbyen fjalë:

- Më ke dhënë fjalën të pres shokët në stan.

Ai ishte nga Hormova dhe stanin e kishte në malin e Golikut nga ku shikon detin.

- Mos e lëvdo malin e Çajupit pa e parë malin e Golikut - i tha Hormoviti.

Birbili gëzohej me zemërbardhësinë e çobanëve. Aksionet që kishte bërë çeta, ndihmat që kishte shpëndarë, përkujdesja për të varfërit, prerja e thonjve të hesapçinjve e taksidarëve, ndihma familjeve të nizamëve që u kishte ardhur karta e djegur.

Për çetën e vogël të Birbilenjve flitej kudo. Kjo e ndihmonte çetën. I hapte asaj shtigje, por i ngrinte edhe prita. Po Birbilenjtë, si lisat e mëdhenj e të veçuar të maleve të Arbërisë, ishin të gatshëm për të papriturat.

Valiu i Janinës kishte lëshuar në gjurmë të çetës afije dhe koshadhë, që ndiqnin vazhdimisht gjurmët e saj.

Birbili u veçua dhe këmbëu fjalë me barinjte për shpenzimet e shumta që po bënin, kurse Resul Sejдини me disa prigonatas borriteshin e hashariteshin në barin e njomë, kapeshin e përplaseshin

dhe ngacmonin njëri-tjetrin me fjalë.

Kur drekosën, Birbili ia numëroi një për një të gjitha shpenzimet të zotit të stanit. Arshi Meluni e kishte bërë zakon, për një kërkonte dy.

Disa niviciotë të ngosur si qengji pirës në maj u shtrinë në diell dhe ia filluan këngës. Asllani dhe Shahini i Zhulatit, Balili i Kolonjës dhe Myrto Dukagjini i Golemit, dridhnin duhan dhe bisedonin. Atë kohë tek shtegu doli nga mali një njeri. Ishte fill i vetëm.

- Kujdes - u foli shokëve Birbili.

Njeriu mori tërthoren nga buzat. Asaj ane ishte buza e humnerës.

- Ai s' di ku shkon - tha njëri nga Birbilenjtë.

- Nuk është vendas - tha Birbili.

I lëshuan zë. Njeriu e ndaloi ecjen. Nuk shikonte njeri. Birbilenjtë ishin bërë një me armën dhe me barin. Nuk e ka të lehtë syri të zbulojë vendin ku qendron kaçaku. Kaçakët, në rast rreziku, bëhen të padukshëm.

Në fillim kaçakët ia drejtuan syrin të sapoardhurit. Më vonë u mblodhën rreth tij. Ai binte një letër për kaçakët.

Birbili u hoq, veças dhe e lexoi. Bisedoi me Resul Sejdinë. Në fshatin P. dhe në fshatin e Kaçandonit, siç e quanin Birbilenjtë, Ahmed beu kishte vënë shtrengim të madh për taksat dhe puna kishte arritur deri në vrasje.

Lajmi i tronditi të gjithë. Letërprurësi fliste greqisht dhe e përkthente Birbili.

- Të pa në rrugë beu, ja të shtyri, ja të gremisi. Sillet si egërsirë. Si nuk i vjen keq kur vret njeriun për disa grosh? - thoshte greku.

- O mik, fakir fukaraja, shqiptar a grek të jetë, për Ahmed beun është kafshë dhe për kafshën nuk i vjen kujt keq - foli Birbili Shakua i pikëlluar.

- Kjo është poshtërsi, nuk durohet - thanë të tjerët. Ahmet beu është xhebraili i Vilajetit të Janinës.

- Një zot e di çfarë është duke bërë në këtë kohë që ne po flasim - tha greku.

- Zoti? Cili Zot - ndërhyri plot mllef Myrto Dukagjini. Zoti sheh e gjykon njerëz por jo Ahmed beun. Është zot mbi zot Ahmed beu. Nuk ka shpirt Ahmed beu, jo! - vazhdoi ai.

- Ai është si këpusha, thith gjak njeriu e s' ngopet - foli përsëri

greku që pruri letrën.

- Ahmet beu thotë: "shlyej taksën e pastaj vdis".

Dy ditë më vonë, Arshi Melunin, e thirrën në hyqymetin e Ergjisë dhe e qortuan. Ishte vonuar në dhënien e lajmit për lëvizjen e çetës së Birbilenjve.

Kur po delte nga hyqymeti Arshi Meluni u habit nga lajmi që mësoi nga tellalli se Birbilenjtë, në një pritë kishin vrarë e bërë hatanë, i kishin tharë krahun Valiut të Janinës duke vrarë Ahmed bej mjekërzinë.

5.

*O Birbil ç'e bërë mirë
Që kur preve Osmanllinë
Me grushte e ndave florinë.*

Hysni Pasha shpalli zi në Vilajetin e Janinës për vrasjen e Ahmed beut. Ishte meritë e veçantë e Ahmed bej mjekërzit që Vilajeti i Janinës si asnjëherë tjetër vjeljen e taksave e kishte bërë të plotë. Taksat e vjela si asnjëherë tjetër kishin mbushur kasafortat me pare. Dyjavë më vonë u fol që do të nisej thesari për në Stamboll. Fjalët si fjalët, asgjë e besueshme. Krejt rastësisht doli fjala që nga Janina u nis në Stamboll thesari i Vilajetit. Fjala erdhi me vonesë në çetën e Birbilenjve.

- Një rast si ky është një fat i madh - u tha luftëtarëve të çetës Birbili.

Ky vit ishte viti i shtërngimeve të mëdha në vjeljen e taksave. Taksë për bagëtinë, vergji për shtëpinë, taksë për arën e bereqetin, taksë për rrugën ku kalon, taksë për kalimin mbi urën e lumit, taksë për kokën, taksë... Me shtrëngim të madh është mbledhur para sa s'që e mundur të mblihdeshin në disa vite. Vjelja e taksave e nxorri Vilajetin e Janinës nga fundi, në krye të Vilajeteve të tjera të Shqipërisë. Hysni pashai, Valiu i Janinës, në një gazetë të Stambollit, shpalli se tash e mbrapa veç për mirë do të përmendej Janina.

- Hare e gëzim ka në sarajet e valiut dhe pikë e vrer në çdo vatër të vëllezërve tanë. Po i rrjep për së gjalli njerëzit valiut. Do të ishte në nderin e çetës tonë të bëjmë diçka - u tha kaçakëve Birbil Shakua.

- Ç'ka mund të bëjmë, o Birbil, kur vendi është mbushur me zebekë e koshadhë.

- T' u dalim në pritë - tha Birbili. - të presim karvanin e thesarit.
- E pastaj?
- Eshtë detyra jone t' ua kthejnë njerëzve djersën e mundin e tyre. Janë telendisur shqiptarët e grekërit nga këto taksa. Po iu la dora e lirë të tjera taksa do të kërkohen.

Mendimi u përkrah nga të gjithë dhe Birbil Shakua dhe Resul Sejdini u hoqën veças, këmbyen mendime. E gjithë çeta ra në një mendje. Po si? Ku do t' i vihej prita. Ku ishte karvani i thesarit? Udhëtuan dy ditë e tre netë birbilenjtë gjersa ranë në gjurmë të karvanit të thesarit. U desh edhe një ditë tjetër që t' u pritej rruga karvanit të ngarkuar me flori.

Birbilenjtë zunë pritë në një grykë të ngushtë pranë një fshati grek. Erdhi fjala prapë te ajo se ç' do të bëhej me paret e thesarit.

- Të shpërndahen paret si përhera - u tha luftëtarëve Birbili. Ligjet e kaçakëve nuk ndryshohen. Syrin e kaçakut nuk e verbon dot shkëlqimi i lirës. Ne s' mund të bëjmë ndryshe. Në qoftë se ka vajza që s' martohen dot, se nuk bëjnë dot pajën, tu jepen para. Kush nuk ka parmëndë për punë t' i jepen vetëm për një pendë qe ... Kush nuk ka për cangadhe t' i jepen për të njomur bukën e fëmijëve me pak bulmet, por jo për të bërë stan. T' u jepen pleqve pa njerëz të mbetur kërcunjtë në vatër, se djemtë u janë vlarë në Ordinë e Shtatë. T' u jepen fëmijëve bonjakë... Aty ku mundet do t' u kthehen edhe të zotëve.

Birbili përmëndi atë ditë edhe bejtin e një Dervishi shqiptar nga Vlora që thoshte:

*Gjithë halldupët pashallarë, të mëdhenj e si zotë
Shqiptari s' ka të mbaj, asnjë feste në kokë.
Gjynah, pra nga perëndia, të punojë shqipëtar.
Dhe të hajë e të pijë, e të bëjë rehat konjari ...*

6.

*O Birbil se të rrethosnë
Hidhi armët se t' u sos.*

Mbas prerjes të karvanit të thesarit, çeta e Birbilenjve, si u soll rreth në disa krahina u kthye në malet e Kurveleshit. Nusja e Birbilit, Hirua, e malluar qëndronte e mbyllur në Sarajë dhe me shpresë se Birbili do ta thërriste të shkonte në takim. Një natë kur Sorka ishte në

Nivicë, ajo e malluar e njomte me lot fustanellën e Birbilit. "Hirua lante, Hirua qante" - thotë një këngë. Rronte me valën e papërmbajtur të pasionit për të takuar burrin e saj. Të gjitha nuset e tjera i kishin burrat në vatrën familjare, ajo e ka të sajën në shkrep e në shkëmb

- Kush do të jetë? - tha Hirua kur dëgjoi lehmata e qenit në oborr.

E vuri veshin në përgjim. Ajo dëgjoi kur goditi një guriçkë mbi dërrasët e shtëpisë. Qeni ngulmoi edhe ca më tepër. Ajo pa hijen e njeriut që lëvizti. Qeni në vend që të lihte mjaulliu dhe filloi të lëpohet. "Ngordhësh murro, për këto çaste të ushqejmë". Priste që murrua t'i hidhej atij që lëvizti. Po tani nuk shikohej më hieja e njeriut dhe qeni nuk lehte më.

Dëgjoi një trokitje të lehtë. Ku u dhanë ato trokitje në derë apo në dritare? Trokitja nuk ishte te dritarja. Asaj ane ajo e kishte pritur Birbilin sa herë.

Kush do të ishte? Kur pinin zebekët delnin nga kalaja, endeshin sokakëve.

Atë natë ajo ishte nuse pa zonjë në shtëpi. Nënë Sorkën e kishin thirrur në lagjen fqinje të Nivicës. Kishte ardhur në Nivicë karta e djegur e një nizami nga Ordija e Shtatë dhe vajovica Sorkë shkoi të ligjëronte me ligje.

Hirua shkoi mbas derës, mori sopatën e mprehtë, sopatën me teh therës, nga ato të qerestexhinjve. Ishte mjaft një goditje me sopatë për ta hequr qafe hijen e zebekut.

Asaj iu kujtua i shoqi që i kishte lënë një pisqollë bishtëverdhë, armë e qendisur me ar nga kreu në fund. Atë e kishte fshehur në llozin e derës. Dontë ta merrte. Lëvizti drurin lehtë, që tjetri të mos e dëgjonte. Kur i huaji trokiti, së treti, ajo e kishte gishtin në këmbëzën e armës, të drejtuar nga dera. Dësh ta zbraste. Para se të shtie më mirë të flas - tha me vete:

- Kush është - foli Hirua me zë të dridhur.

- Jam unë, Birbili! - u dëgjua zëri prapa derës.

Ajo u drodh edhe më tepër.

- Qyqja! Për pak të vrava, qyqja! - tha dhe e hodhi armën tej.

Arma bëri bramp, goditi mbi diçka, por nuk dha krismë.

- Përse këndej Birbil! - e qortoi të shoqin ... Ik Birbil, ik sa më parë, e shikon ku përgjon zebeku i rojës?

- Nuk kam ardhur për të ikur.

Në dritën e hënës endej hieja që lëvizte mbi sipërfaqen e gurit.

Ishte hija e zebekut të karakollit që delte çdo natë, aty në anën e shkëmbit, për të përgjuar çdo lëvizje në shtëpinë e Birbil Shakos.

- Hija e rojës, - i tha Hirua.

- A, tha Birbili me mospërfillje dhe filloi të zërthejë tokëzat e silahit.

Dy pisqollët i vuri sipër, në kamarën e vogël te muri, kurse "arnautkën" e vari me kujdes në faqen e murit përballë.

Hirua endej nëpër dhomë, pakëz e hutuar.

- Ke frikë? - e pyeti me sytë hetonjës Birbili.

Ajo rrudhosi supet. Birbili u afrua te dritarja dhe shikoi hijezën.

- Më vjen keq ti pres kokën hutaqit, qëndron si i përhumbur me sytë nga shkëmbi.

Ai zebek ishte i papërfillshëm për kaçakun.

- Ndize zjarrin - i tha i shoqi.

Ajo ngadalë mbylli kanatet e dritares dhe ndezi zjarrin.

Dhoma llapri nga dritat.

Ai u ul afër oxhakut. Ndizen sytë e tyre si prushi i vatrës.

- Më ke pritur? - i tha dhe i hodhi sipër dorën e tij të rëndë.

- Përherë mbeta me sytë te dritarja, por në vend tënd shikoja hijen e zebekut të karakollit - tha ajo.

- Ku është nëna?

- E thirrën në Nivicë, s'di pse vonoi.

Dëgjohen hapa.

- Ik, Birbil! Ik!

- Nuk kam ardhur për të ikur.

Dora e ashpër dhe e rëndë e Birbilit shkiste mbi flokët korb të zeza e të butë të saj. Ai e përkëdheli të shoqen, i vinte në dukje trimërinë, sojninë ... Të gjitha ia thoshte që asaj t'i dukej më e lehtë qëndresa.

- E moj Hiro, ç'i duhet gruas një burrë si unë. Veç emri dhe hija më mbetën në shtëpi, trupi në malin e Këpuzit e të Këndrevicës.

- Mos e thuaj atë fjalë - i tha ajo. - Ka burra që s'bëjnë hije në shtëpi edhe kur mbyllen në të gjashtë muajt rresht. Të kam thënë edhe herë tjetër, shqiponja s'qëndron në fole, asaj i pëlqen të jetë përherë në fluturim.

Atij i pëlqeu fjala ledhatonjëse. Mërmëriti të njëjtën fjalë: "Shqiponja s'qëndron në fole, i pëlqen të rrahë flatrat ..."

- Bukur, Hiro, bukur!

Hirua përsëri heshti. Ajo shikonte tek burri i saj njeriun që nuk i dridhej qerpiku. I pëlqente guximi, por i dridhej zemra. Ajo e dinte që plumbi e shëmb edhe trupin sa një lis. Sa trima të Labërisë ishin vrrarë nga plumbi e prerë nga shpata:

- Ulu, eja këtu afër - i tha komiti.

Hirua u ndrojt. I shoqi ishte bërë më i ashpër në tiparet e fytyrës, por më i ëmbël në vështrim. Ajo nuk kishte frikë nga armët, as nga shkëlqimi i tegeleve të qëndisur bukur në këmishë e në tirqet e bardhë. Ajo i kishte punuar vetë, por habitej që Birbili ishte mospërfillës ndaj zhurmës së zebekëve që kalonin sokakut.

- Qesh një herë moj Hiro e bukur, i tha.

- Të qesh?

Asaj i mori zjarr fytyra.

- Të qesh kur nënat e gratë e Arbërisë janë veshur në të zeza për nizamët që u erdhën kartërat e djegura, për taksat që u rrëmbejnë vatrave tona kafshatën e bukës së fëmijve? Jo, imzot, jo! S' mund të qesh ...

Ata nuk vunë gjumë në sy. Ishin në folezën e tyre dhe guisnin. Kur hëna u fsheh prapa majës së mureve, Birbili i tha:

- Jeta e kaçakut është jetë me thikën te gusha ...

Kokoshi e nisi këngën. Ishte sinjali i parë i agimit.

- Duhet të shkoj!

Nënë Sorka e ruante kokoshin sepse ishte sinjali që i duhet kaçakut.

- Sahati harron, kokoshi jo! - përsëriste shpesh ajo.

- Ndoshta një ditë, moj Hiro, s' do ta kesh Birbilin tënd.

- Mos ma thuaj atë fjalë. Mos! Mos! - i tha ajo dhe i afroi dorën e saj te buzët e tij.

Në çast u mendua. Duhet t'i thoshte të shoqit një fjalë. T'i thoshte që donte ta kishte Arbërinë të fortë e pa të huaj brenda, por edhe Birbilin ta kishte më shpesh në vatër. Kur ishte me të, pranë tij, Hirua zbukurohej edhe më, merrte krah, ndizej zjarr po edhe guxonte më shumë, bëhej më trime. Ndërsa e përshkonte mendimi për një të ardhme të bukur, e Birbili po vishej e ngjishej, u dëgjuan zëra.

Zërat e zebekëve të kalasë u dëgjuan afër shtëpisë. Hiros iu zbeh fytyra.

- U trëmbe? - i tha i shoqi.

- Kam frikë për ty, imzot?!

- Gruaja e kaçakut s'e njeh frikën.

- Birbil - thirri me gjysëm zëri Emir Kunadhja tek ledhi nga dritarja në anën e mureve të kalasë.

- Kush më flet me gjuhën e nënës - i tha Birbili.

- Jnë, Emir Kunadhja. Të kanë bërë tre rrethime, jepu e mos u prish.

- Nxirre kokën, he kromë e ndyrë - i foli dhe arnautka lëshoi flakë.

Një kohë i iku zëri Emir Kunadhes, pastaj u përmend.

- Nuk mbahen njëqind zebekë me një pushkë, Birbil - foli Emir Kunadhja, i struktur mbas ledhit, jepu e Valiu do t'u mëshirojë.

- Mos lih si zagat anash ledhit, nxirre kokën andej o rrufjan.

Nuk u përmbajt:

- Tradhëtia të piksi gjakun, të vrau dritën Emir, Eh, Emir, o maç i lig. Dil shesh për shesh në ta mban.

Edhe Emir Kunadhja nuk duroi. E shau me emër Birbilin.

- Nuk e pluhurosim dot fytyrën e Birbil Shakos. Birbili mbetet Birbil! - thanë Rexhinasi, sa dëgjuan llomotitjet e Emir Kunadhes.

Zebekët i afrohen edhe më afër shtëpisë dykatëshe mbi shkëmb. Përballë shtëpisë dy kulla guri.

- Të kapen ata dy shkëmbenj dhe të dyfeqiset andej kulla - urdhëroi Yzbashi Yzejdin.

Zebekët i zunë vendet. Në këto çaste erdhi me rrëmbim nënë Sorka. Ajo u kthye flokëlëshuar. Zebekët e ndaluan. Dizdari i kalasë shpresonte se me rrethimin e trefishtë që i kishte bërë kullës s'kishte mbetur shtegdalje për kaçakun. Ai e quajti shpresëdhënëse ardhjen e nënës. Mundohet me fjalë të qeta t'i ngjallë shpresë:

- Thuaji djalit të dorëzohet dhe Valiu i Janinës do të bëhet zemërgjerë.

Sorka e dëgjonte me vëmendje, thuajse i pëlqenin fjalët që dëgjonte. Kjo e nxiti Dizdarin e kalasë të lëshonte vrushkull lajka e premtime. Ajo ngjiti shkallët e kullës me rrëmbim. Rreth shtëpisë shndrisnin sytë e zebekëve dhe tytat e armëve. Ajo hyri me rrëmbim si era në dhomë dhe e përqafoi fort të birin.

- Vdis me nder o bir - i foli nëna.

Ninat e Sorkës të sërta, këngët të sërta, fjalët të sërta, jeta më e shtë...

- Më shtjer ujë, dua të lahem nënë.

Lahej kaçaku ... Krihej Birbili me krëhër ...

Çirren tej në anë të përroit të Lekës, në muret, në shtigjet, te gurët e te buzat:

- Dorëzou Birbil kaçaku! Edhe pesë minuta afat ke që të mendohesh.

Birbili ngjesh vezmet. Vë në brez pisqollat dhe i thotë nënës:

- Dua të ha nënë, bëmë diçka?! Petulla më bëj, mëmë. M' i bëj të mira si atëherë kur isha i vogël.

- Kur ishe i vogël? ...

Sorkës i mbeti fjala në gojë. Atëherë, kur ishte i vogël, Birbili lodronte si shqerrat më livadh, donte të futej në gjiun e Sorkës, kurse tani jetonte në gjiun e furtunës.

- Edhe dy minuta kohë - thërrisnin përjashta.

Nëna Sorkë e vuri tiganin në zjarr. Përjashta nisi pushka. Një orë luftë .. Dy orë luftë ... Shumë shenja plumbash mori shtëpia mbi shkëmb. Nga Progonati prisnin të vinte topi i kështjellës.

- Dorëzou dinësëz, dorëzou!

Nëna mbushte fishekët, i biri kalonte nga njëra dritare në tjetrën dhe qëllonte ...

Nënë Sorka mbush trajsën me bukë, djath e petulla. Ajo zuri vend te dritarja dhe qëlloi dy tri herë. Përsëri thirrje:

- Bëju teslim kaçaku Birbil.

Birbili Shakua heshte, radhiste me silah plumba të tjerë.

7.

Bamb e bamb

Dhe dot se vrisnë

Plumbat mbi Birbilin

nuk kolisn.

Mos u ligështo, bir! - i foli nëna Sorkë.

- Nuk ka rrethim që s' i bën ballë kaçaku moj nëna ime zemërmirë - i tha Birbili, - veç doja të kishte akoma natë.

- Këndezi i tretë thotë që dhe pak e vjen agimi i ditës.

- Erdhi koha të bëjmë atë që duhet, moj nëna ime zemërmirë.

- Shtegun e hap palla biri im - foli Sorka dhe veshi gunën e rrëmbeu martinin e gjatë.

- Ç'po bën kështu nënë?

- Kujdes gruan, bir, nëna ia ka bërë ditët e perëndisë. Eshtë detyra ime që të ruaj të mos thahet rrënja në këto troje.

Mënyra si fliste e shqetësoi Birbilin. Sorka vendosi të vepronte. Ajo nuk i tregoi se kishte vendosur të sakrifikohej për t'i hapur shtegun birit të saj. Pa pritmas hapi derën dhe u hodh nga shkallët në oborr. U duk si një shqiponjë në fluturim. Ndërsa po vraponte njëherësh u zbrazën mbi "kaçakun" me gunë pushkët e zebekëve. Çirret Bimbashi Yzejdin:

- Dyfeqisni kaçakun! Zjarr! Zjarr!

Dhe plumbat kafshonin dheun dhe thërmonin gurët. Përmes plumbave lëvizte Sorka e veshur me gunën e kaçakut. Ajo kishte marrë në trup plagë dhe prap lëvizte. Një çast zbrazti armën. Ajo mundi të shtinte vetëm njëherë dhe drejt flakës së martinës së saj tërhoqi gjithë zjarrin e armëve. Ishte goditur por nuk kishte vdekur. Pushkët i dërgojnë plumbat drejt gunës, presin plumbat pallton ...

Kurzbardhi dita zebekët shtangën. Mësuan që Sorka sakrifikoi veten për t'i hapur shtegdalje të birit. Në çastin kur vëmendja e zebekëve ishte te "kaçaku" me gunë në oborr në krahun tjetër, papritur, në afërsi të buzës te dy karsellat¹, Birbili me flokë të hasharyera, me çepen të derdhur mbi supe çau njerën pritë duke zbrazur arnautkën, pritën e dytë e çau me tehun e jataganit dhe të tretën te shkëmbi duke zbrasur njëherësh të dy koburet.

Përballë, te një nga kullat e mëdha, volli flakë pushka top e kaçakut. Topi dha oshëtimë dhe gjëmimin e rrëmbyen shpellat e honet. Gjëmimi dredhoi nëpër thellësi të honit dhe sapo doli andej plasi me gjëmim të dhjetëfishuar në gryka e hone të tjera.

- Na iku - i thanë zebekët Dizdarit të kalasë.

- Ndiqeni pas gjurmës, ndiqeni! - urdhëroi dizdari i kalasë i hutuar.

Ata të dy, Birbili dhe Hirua hynë në shkëmb. Shkëmbi gjëmonte. Goditej me plumba. Birbili qëllonte e largohej gjithnjë e më në thellësi të shkëmbit.

Kur po digjeshin sarajet e Shake, Sorkën e përcillnin në drejtim të Grykës Jetëshkurtër për tu strehuar e mjekuar me ilaçet e

1) Kështu quhen edhe sot dy gurë të mëdhenj përballë themeleve të kullës së Shake.

vendit në stani e Budo Bredhit. Shtëpinë e Shake e përfshinë flakët.
Njerëzit kënduan për ç'ka panë e dëgjuan.

*Digjen kullat e Birbilit
Si Lithariç'i Vezirit.*

I ngritën një këngë trimërie edhe Sorkës të Golemit, që u dergj
dy muaj rresht te stani i Budo Bredhit dhe e rea, Hirua e mjekoi me
bimë shëruese të maleve. Kur u shërua Sorka u këndoi maleve ku
dergji dhe u shërua nga plagët e plumbave:

*Malet tona të argjenta
Dhe ilaçet i kanë brenda*

IX

1.

*“Janina çerek Stambolli
Daltë dhe e mbuloftë Gjoli”.*

Në natën e festës së shenjtë, Kurban Bajramit, sapo errësira e natës ra mbi qytet, Hysni pasha, Valiu i Janinës, vjedhurazi syrit të milletit, i shoqëruar nga garda e tij dhe nga qatipi gjulludibërës zbriti nga shkallët e sarajit të bardhë buzë Gjolit, u hodhi një sy rremturës dhe u ul në çiltënë te bashi i “Rosës Qafëgjatë”, siç thuhej për varkën e bukur të Valiut. Në dy anët e anijes lundruese qëndronin të mbërthyer njëzet lundërtarë që me krahët e tyre të fuqishëm i jepnin anijes shpejtësinë e erës. Sa herë shëtiste në liqen me “Rosën e florinjte” Hysni pasha ngazëllehej i vinin në buzë fjalët: “I gjetët shehadet shpirti njeriut që e ndërtoi këtë anije!”. Po fjalët i përtypte si belban, nuk guxonte ta thoshte. Murmuriste: “Allah të qofsha falë, ma largo emrin e jezitit Ali nga uxhuti”. Anijen e bukur e kishte ndërtuar Ali Pashë Tepelena, hieja e Vezirit Ali ende nuk ishte shuar në Janinë.

U largua nga bregu ngadalë pastaj çau me shpejtësi sa që la pas në ujë një shkumëz të bardhë. Nën vezullimin e dritës të një hëne të plotë, bukuria e liqenit të Janinës bëhej më shndritëse, valëzimet ishin të buta dhe çuditërisht, atë natë reflektohej në ujin e liqenit jo vetëm anija shndritëse por me një pamje magjepëse zhytej në ujë qyteti me saraje të bardha, me kambanore të kishave dhe minaret e bardha të xhamive.

Janina ishte i vetmi qytet në Epir ku lartoheshin e dilnin mbi sarajet një pyll i dëndur me kështjella, xhami, kisha, manastire, teqe, sinagoga, saraje. Janina mbahej si kryeqyteti i Shqipërisë së Jugut.

Asnjë qytet tjetër nuk kishte aq shumë xhami e kisha sa Janina. Në asnjë qytet tjetër të Epirit nuk kishte një trazim të njerëzve me fe

të ndryshme si në Janinë. Kishte Janina shqiptarë e grekë, çifutë e turq më pak. Endeshin sokakeve të Janinës hoxhë, priftër, dervishë. Tundej qyteti nga zërat e imamëve dhe tingujt e këmbanave. Natën e ditës së shenjtë Janinën e kishte rrëmbyer gazi e harea. Në çdo sokak lëvizje. Në çdo kafe aheng ...

Kjo zallamahi e kënaqte, pinte e bëhej thumb opingari e zilepunuesi, këpucari e samarxhiu, argjendari e armëndreqësi. Të gjithë bëheshin atë natë tapë.

- Fukarai e largon të keqen nga uxhuti duke pirë - tha me vete Valiu dhe kërkoi që "Rosa Qafëgjatë", ajo lundër e çuditshme të largohej, në thellësi të Gjolit.

Hysni pasha i hodhi sytë te kështjella hijerëndë. Mendoi: "Ç' vlerë do të kishte kalaja pa Vezir Aliun që ja mbushi bodrumet me burrat dhe ja ngarkoi bedenat me topa? Asnjë vlerë."

Hysni pasha, sa herë u kishte thënë vartësve:

- Kështjella është zemra e Janinës, është historia e saj ...

Dhe ai vlerësonte historinë e Janinës të përafërt me historinë e një kryeqyteti.

Me Janinën qenë lidhur të gjitha ngjarjet që përjetuan nën sundimin osman shqiptarët e grekërit e krahinave të ndryshme. Shtypja rëndonte mbi gjithë shqiptarët e grekërit e Vilajetit të Janinës me peshën e rëndë të maleve të Pindit, të Malit të Gjërë e të Gramozit, prandaj me brengë e dhimbje njerezit i këndonin qytetit të tyre:

Janina çerek Stambolli

Daltë dhe të mbuloftë Gjoli.

Shtypja e egër e kishte afruar grekun e shqiptarin, halli e gjëma ishin të përbashkëta. Kështjella qe zemra e Janinës. Ai e dinte që kryengritja s' do të qe mbytur në vitin dyzeteshtatë po të mos ishte kjo kështjellë hijerëndë e ngarkuar me topa ... Çdo gjë që kishte ndërtuar Vezir Aliu i shërbente baba Dovletit, veç hija e tijjo! Ai harërsëz ndezi dëshirën e arnautëve e grekërve të veçohen nga hija e padishahut. Allahu vuri dorë mbi jezitin, e la trup pa kokë.

Nga këto mendime e shkëputën gjëmmimi i topave që ranë në kështjellë. Qatipi i shkronjave e kujtoi se kishte ardhur vakti që të dilnin në ishullin e Larithës, aty qe mbledhur paria e Janinës dhe e prisnin. Ai dha shenjen që "Shigjeta e Argjendë" të endej edhe një

herë përmes liqenit, ku shfaqeshin si në pasqyrë siluetat e maleve të Pindit dhe qyteti i bardhë i Janinës.

Kur u luhatën së dyti topat në Këshjtjellë, Hysni pasha dha shenjën dhe “Shigjeta e Artë” rrëshqiti me shpejtësi në drejtim të ishullit ...

2.

*“Mos harro, je Vali edhe për Arbërinë,
prandaj nizamët ti kërkojmë, taksat të
vilen dhe Birbilenjtë të kapen”.*

Hysni Pashai, mbas vitit të kryengritjes së madhe të Gjolekës, shpërndante pa prerë hashash për Arbërit e pabindur, që arbërit ta pinin dhe të viheshin në gjumë, të harronin gjësimin e topave gjatë viteve të qëndresës së Ali Pashë Tepelenës në Janinë, të harronin rrebelimin e madh të vitit dyzeteshtatë, të harronin trimërinë e të mos dëgjohej më fjala arbër dhe Arbëri, të harroheshin këngët e trimërisë dhe ligjërimet me fyell. Të harroheshin ... I pëlqente Hysni Pashës që t’i shkulte kujtimet e bukura e zakonet e mira siç shkulen nga rrënja lulja dhe pema. Ahengu, nanuritja e imamëve dhe marrëzitë e dervishëve heretikë qenë përsëri hashashi që mund të vinte në gjumë lebërit. Këto kushte endëronte të arrinte dhe nuk kishte mundur.

Stamolli, me një urdhër i tërhiqte vëmëndjen pashait dhe e porosiste të bënte kujdes: “Mos harro, je Vali edhe për Arbërinë, pranadaj nizamët të kërkojen, taksat të vilen dhe Birbilenjtë të kapen”, - përfundonte urdhëri.

- Hëm! Xhindet?! Po a kapen, xhanëm? - u shpreh për Birbilenjtë Valiu sapo lexoi urdhërin.

Nismën e fjalëve memece Hysni Pashai ia ndërpreu përfytyrimi i maleve të Labërisë. Në sytë e mëndjes i erdhën kreshtat e larta të maleve të Kurveleshit. Dallgëzimet e mendjes i rënduan shpirtin në ditën kur ai duhej të ishte i qetë. Njerëzit e prisnin atë në shtëpinë e bardhë të ahengut.

Janinën e kishte përfshirë hareja e gëzimi, kurse atë e shpoi si gjemb ajo shkresë që erdhi nga Porta në pragun e festës. Ai lëshoi në drejtim të Labërisë imamë : dervishë, e mbuloi vendin me koshadhe e zebekë. Lebërit, siç ishin ashtu mbenë “halë e brihalë”, nuk u bindën. Xhemedija e Birkuljenjve silllej lirshëm shkrepare të maleve.

Gjëma të mëdha bëri me rrëmbimin e Thesarit të Vilajetit.

- Duhet palla - tha. E përmënda fjalën në çastin kur zbriti nga "Rosa e Argjendë", kështu e quanin Janinjotët barkën e Valillëkut, që te bashi kishte një qafë të bukur si rosë të punuar me flori nga mjeshtri më i mirë i çifutëve të Janinës.

"Rosën e Argjendë" e kishte veshur anash me metal shkëlqenjës të larë me flori, kurse anash te bashi e në fund ajo kishte kolltukë dhe mbulesë për të mbrojtur nga shiu e dielli. Rremtarët mbërtheshin në vend me trupin e barkës dhe punonin laopatat. Nuk mund të kishte tjetër njeri në Janinë, as barkën më të bukur, as kalin dhe as karrocën.

Atë mbrëmje barka e Hysni Pashait rrëshqiti lehtazi. Vozitësit i punonin shpejt e lehtë lopatat dhe "Rosa e Argjendë" lëkundej butë e lehtë sipër ujit, kështu që iu larguan agushia e vapës dhe mendimet e këqija. Ishte në prag të ceremonisë së çeljes së ramazanit dhe Valiu ishte i shqetësuar.

Në sallën e bardhë të ahengut, në ishull, nuk mund të hyjë hundë e buzë. "Një Vali lipset të jetë në një kohë mace dhe qëngj, shejtan dhe engjëll" - mendoi Valiu. Ai ishte në gjendje të luante bukur çdo rol që t'i paraqitej. Konsujt e diplomatët e shumtë e nuhatin nga larg. Atyre, Hysni Pasha di t'ua fshehi mendimet shqetësuese. Kot nuk thuhej për të: "Dhëlpra e Janinës".

Shëtitja në liqen ia zbuti nervat, ia largoi shqetësimin. Ahengu e harea kishte përfshirë të gjithë ishullin. Ai u mundua të mos shikonte andej në drejtim të maleve të Arbërisë të pabindur.

Ra përsëri topi në kështjellë për çeljen e ramazanit.

- Do të bierë edhe disa herë të tjera - tha Valiu, ka kohë.

"Rosa e Argjendë" rrëshqiste mbi ujin e kaltër të liqenit. Valiu e ndiente fladin, i pëlqente të shëtiste sa më gjatë nëpër breg. E prisnin në pallatin e ahengut.

Një kohë Hysni Pashai harroi vetveten, e rrëmbeu bukuria e liqenit dhe e qytetit. Ai kishte tetë vite që ishte emëruar Vali në Janinë dhe mbarë i kishte shkuar edhe puna edhe shëndeti. Vetëm vitin e parë të sundimit e pati pisk. I kujtohej gjithnjë ai vit i mbrapshtë i kryengritjes së madhe të Labërisë.

Nga këto mendime u shkëput vetëm kur hyri në gostinë e madhe, atëhere kur e rrëmbeu harea e gëzimit dhe sazexhinjtë ja morën një kënge për dorën e fortë të Vilajetit:

*Hysni pasha me shtatë zemra,
Hysni pasha, Valiu jetgjatë i Janinës,
Hysni pasha vezir mbi vezirë ...*

3.

Ahengu në sarajin e bardhë vazhdoi deri në orët e vona të natës. Dy herë e mori fjalën Valiu dhe të dy herët foli për nizamë. Thesarin e kaloi në heshtje. Në shtëpinë e të varurit nuk flitet për litarin.

- E shpon gozhda. Stambolli kërkon nizamë, - tha një nga fundi i sallës që njihej për antipatinë që kishte për Valiun.

Ishte një burrë i pashëm, i veshur me kostum allafrennga, nga xhepi i sahatit të jelekut i dilte një zinxhir floriri. Mbante feste të kuqe me xhufkë. Në pamje, Zhulatasi, pronari i Hotelit më të madh të Janinës, të bëhej i tëri turk, më osman se osmanllinjtë. Në të vërtetë në atë vënd ai ndihej i huaj, tjetërsoj. Syri i Valiut hetonte por Zhulatasi, Nexhip Bedena, hidhte çapin e fshehte gjurmën. Valiu i binte në erë po's'kishte mundur dot ti binte në gjurmë. Pronari i Hotelit të madh të Janinës vuri re që Valiu si në fjalët e para edhe në të dytat ishte i pezmatuar. Fjalët e sërta të Valiut i detyruan sanxhakbejlerët e Ergjërisë, Vlorës e Delvinës të ulin kokën. Pastaj Valiu pyeti:

- Gjer kur do të lejohet që Arbëri të mos japi taksa dhe nizamë? A e dini ju që padishahut tonë i thahet buza po nuk rrodhi hazineja në kasat e tij? Ndoshta e dini, por nuk e dini mirë.

Lëpiu buzët. Kur vinte shtrengatë i shtoheshin lirat flori. I hodhi duart mbi tavolinë, bëri si të mblidhte vërtet lira. I ishte bërë zakon, i ngacmonte shqisat ku dëgjonte të flitej për para, lëpihej sa herë dëgjonte tingullin e metalit të verdhë. I erdhi në përfytërim çasti kur përcolli nga kështjella thesarin. Katër mushka të ngarkuara me flori. I përcolli suvarinë që shoqëroi thesarin, i uroi:

- Udhë e mbarë evlatër.

I porositi:

- Bëni kujdes.

Zabiti dhe çashët suvarinj, që shoqëronin thesarin, u prenë në pallë, nuk u dhanë, e mbrojtën thesarin me jetën e tyre. Dhe u vranë.

Valiu i la në harresë. Nuk i duhej trimëria, Thesari i duhej. Mendja aty, te Thesari i shkonte, syri i hetonte njerëzit një për një.

Hysni pasha i hodhi një sy hetonjës Nexhip Zhulatis, pronarit

të hotelit. Hafijet e tij, që kishte në hotel, e patën informuar se Nexhip Bedena i Zhulatis e mbante të hapur hotelin për djallin e të birin. Ai e dinte që pronari më i madh i hotelit të Janinës kishte patur lidhje me kryengritësit e Gjolekës por në gjykimin që ju bë çështjes doli i pafajshëm. Gjatë kësaj kohe që munduar të mësonte së cilit gjykatës ia kishte vrarë dritën e syrit floriri i Nexhip Zhulatis dhe ende nuk kishte rënë në gjurmë.

Janina fshihte gjëra të tjera më të mëdha. Kundër Valiut bënë komplete shqiptarë e grekë, prandaj i duhej të bënte kujdes. Mos pronari i hotelit të madh të Janinës mbante lidhje me Xhemedjen e Birbilenjve? Kishte dhënë porosi dhe priste lajme. Në se do të vërtetohej, që kishte gisht Nexhip Bedena i Zhulatis, ai do të vinte dorë mbi të dhe do të organizonte punën ashtu që, mishi të piqej e helli të mos digjej. Do ta lëshonte paren sheshit që pastaj të merrte një pjesë të thesarit, që i rrëmbu çeta e Birbilenjve, pjesës tjetër do ti bënte çare.

Pronari i hotelit ishte njeri kamës por edhe me mënd. Hysni pasha bëri irjet të mënjanonte hotelxhiun, por iu duk se duke vepruar kështu prishte më tepër punë nga ç'farë mund të rregullonte.

Përplasi pëllëmbët. Kur përplaste pëllëmbët, diçka e rëndësishme ndodhte. Këtë e kishte zakon të vjetër dhe të tjerët ia dinin zakonin, prandaj salla ra në heshtje. Mbas përplasjes së pëllëmbëve Valiu do të thoshte një fjalë që lypset ta dëgjonin të gjithë.

- Më thërrisni bimbashin Shahin Hatibzade - tha.

- U a a a, bënë zëra nga fundi i sallës, prej nga u çua nga vendi një burrë i pashëm, me fytyrë të gjatë, mjekër korb të zezë e vetulla të lëpira përpjetë si një majë thike.

Salla e mbërtheu vështrimin mbi uniformën shkëlqejëse të bimbashit, Shahin Hatibzades. Uniforma e oficerëve madhorë atë vit kishte zënë vendin e uniformës së vjetër të ushtrisë osmane. Ajo ia hieshonte Shahin Hatibzadesë shtatin e gjatë. Ai në fillim u mpi nga e papritura. Nuk prishte që Valiu t' i bënte nder aq të madh. Lëvizja e bimbashit në sallë ndezi kureshtjen e të gjithëve. Ata e shikonin me zili bimbashin që u ul në krah të Valiut e bisedonte me të kokë më kokë.

- Taborr si i yti, që ecën veri nëpër shtigje malesh s'ka tjetër serasqeri i Rumelisë. Vetëm taborri yt mund t' i ndjekë prapa xhindet!
- i tha Valiu bimbashit Shahin dhe i fërkoi mjekrën bimbashit.

Ndërsa e ledhatonte çek i hoqi një fije nga mjekra, aty ku e

kishte prerë plaga e kreyngritësit Birbil, në grykën e Kuçit, në vitin dyzeteshtatë. Bimbashit nuk i lëvizi qerpiku e as iu rrudh fytyra. Krehja e mjekrës nga eprori ishte përkëdhelje për zabitin. Ndërsa kur këtë përkëdhelje e bënte dora e Valiut Hysni, që mbretëronte në Vilajetin e madh të Janinës, kënaqësia ishte e veçantë.

- Do të shkosh në Arbëri, biri im. Kujdes, megjithëse nuk ta kam merakun se ti i ke shkëlur ato vende. Veç mos kujto që arbërit janë ata të vitit dyzeteshtatë, që Ordija i shkeli dhe i bëri pulë. Tani kanë filluar sojsëzët të lëvizin. Mos harro që dajaku ka dalë nga xheneti, dajaku e zbut edhe derrin e egër. Ki në mendje evlat, Birbilenjtë, janë xhind, jetojnë në shkëmb si xhindët. Një haber që mora sot më ka tronditur, biri im. M'u afro e dëgjomë: "Xhemedija e Birbilenjve" ka prerë karvanin e floririt që nisa në Stamboll. Gjëmë e madhe! Këtë haber e dimë unë, Ju dhe Zoti. Thuhet se Birbilenjtë u kthyen në folenë e tyre, në Arbëri.

Shahin Hatibzadeja ndjeu një trazim të brendshëm po nuk e bëri veten. Ju kujtua përleshja në Grykën e Kuçit. Plaga që mori. Valiu diçka pikasi dhe shpejtoi ta cyste:

- Askoshun biri im, nuk do t'i harroj bëmat e taborrit tuaj. "Xhedit Tabor" e quajti Padishahu ynë. Askoshun. I kam dërguar Portës që të vijë grada e Miriallait. Ka lezet o bir, të ngjitesh nëpër shkallët e udhës të Allahut.

Bimbashi u përkul edhe më shumë para Valiut.

- Kujdes biri im, kryengritja e Gjolekës ka lënë mëri të madhe për ne. Hë! Harruan kopilat Padishahun, diellin që kemi mbi kokë, që ka hije e diell aq sa mbulon dynjanë, harruan ata dhe u ngritën duke "pretenduar" se ishin shqiptarë! E ç'fituan që e hodhën dorën të palla? Asgjë! Do të na duhet mundim i madh që ta zhdukim farën e keqe që mbiu, Mirialla Shahin, - e përkëdheli një gradë më lart Valiu Hysni Pasha.

- Palla dhe zjarri i nënshtron të marrët. Palla pret e zjarri djeg, s'ka mëshirë për të pabindurit - tha komandanti i "Xhedit Taborrit".

- Askoshun, evlat!

Hysni Pashait i pëlqeu fjala e bimbashit. Ai zgjati qafën si qafën e rosakut në liqen dhe afroi t'i thoshte diçka tjetër. Njerëzit që merrnin pjesë në mbremje e kuptuan që bimbashi Shahin Hatibzade gjeti çelësin për të hyrë në zemrën e ftohtë të Valiut plak.

- Dëgjomë më kujdes evlat - i tha Valiu.

Shahin Hatibzadeja u bë sy e veshë. Afroi veshin te buzët e pashait dhe njëkohësisht dëgjonte e me bishtin e syrit shikonte nga salla që ishte pushtuar nga kureshtja. Hysni Pashai fliste ndërsa mëndja e bimbashit regjistronte fjalët dhe lëvizjet e tij. Pashai kishte sy prej ujku dhe dorë me kthetra tigrin. Por tani edhe sytë edhe dora e tij iu dukën bimbashit Shahin të buta, ledhatonjëse. Mbas ledhatimit Pashai nxorri dhëmbët prej egërsire dhe tha:

- Një lajm me rëndësi ka ardhur nga Stambolli, afrohu evlat. Krahu i bimbashit Shahin preku në të Valiut. Kjo e ndezi edhe më shumë cmirën në sallë. Pashai vazhdoi:

- Ka ardhur urdhër nga Stambolli që të zëmë Birbilenjtë.

E tha këtë fjalë dhe sytë i hodhi mbi fytyrën e bimbashit. Shahin Hatibzadenë e shqetësoi ky lajm. Ai e njihte mirë Labërinë, por nuk e bëri veten në sy të Valiut, tregoi besim.

- Çdo gjë duhet të bëhet si urdhëron Padishahu - foli shpejt.

- Nuk e bëmë atë që kërkon Padishahu. Lavdia që fituam në vitet e shuarjes së kryengritjes iku, si zjarri i kashtës që s'le prapa hirin, por blozën e zezë. Ashtu edhe puna jonë. U vumë në gjumë dhe i zgjuam shejtanët, Hejstarulla, çmilet i keq?! Xhedit Taborri do ti bëjë zap.

- Izën tuaj presim të lëvizim - foli plot besim Shahin Hatizadea.

Hysni Pashai përpoqi pëllëmbët. Salla heshti. Edhe muzikantët ndaluan rënien e veglave. Valiu kërkoi qatipin e bujruddive. I dha shënjë të afrohet.

- Dëgjo këtu!

Qatipi vuri dorën mbi zemër e veshin në përgjim dhe u përkul.

- Hidh në arfe një bujruddi dhe të lajmërohet tellalli që nesër të zbrazet topi në bedenat e kalasë e ti jepet lajmi Janinës, se del nga tebojat "Xhedit Taborri". Le të dalë Janina ta shikojë, të dalë mileti kur të kalojë asqeri. T'u bëhet temena nizamëve të taborrit nga zanatçinjtë e tregtarët, nga shqiptarët e nga grekërit.

Qatipi u përkul dhe u largua. Hysni Pasha vazhdoi:

- Kërkohen nizamë trima e të fortë për Ordinë e Shtatë. Kujdes xhindet e Arbërisë nuk pranojnë t'u kajojë sipër rea, jo më gjurma e rëndë e nizamit. Bën kujdes biri im! Mbaj mënd ç'të them: Në fushë mbledhim pula, në mal shqiponja. Këtë e di Padishahu, prandaj Padishahu kërkon nizamë nga ato male që t'i lartohet trimëria e qëndresa e Perandorisë në Jemen. Nuk heq dorë Padishahu nga ajo

krahinë! I zgjedh me dorë hyqymeti nizamët që dërgon në Ordinë e Shtatë.

Shahin Hatizadesë iu ndezën dy sytë flakë siç luhatet flaka e topit Shahin ... Ai është krenar që mban emrin e një topi, që ende qëndronte në armatimin e ushtrisë osmane. As në Vilajetin e Janinës, as në Serasqerin e Rumelisë, asnjë bimbash tjetër nuk kishte emrin e një topi, si ai.

- Nisu biri im, dielli i Padishahut rëntë mbi gjurmën tënde. Dhe mos harro, pres ta shtrosh vendin, baltë ta bësh. Pres të mi sjellësh në Janinë Birbilenjtë, të lidhur me zinxhirë. Pres të veshim sa më shumë nizamë për ti dërguar në Ordinë e Shtatë, në Jemen, presim Shahin bej. Ata janë shtuar si krisja që mbulon barin e gurët, shtohen si mizat e dheut. A ke vënë re si dalin nga stanet gratë, si dosat me gicër, varganë si kope. Hejstafullah, i mbulon gurët bari, por jo dheun ta mbulojnë njerëzit si milingonat. Për allah si milingonat. Në çdo guvë e stan sheh njerëz. Kur rriten dhe kërkon nizamë për dovetin, s' i gjen, humbasin në shkrep. U ysht xhindi në vesh, e të thonë: "Jam arbër". Kanë kokë guri mbi shpatulla. Ata ... ata ... belbëzoi.

Ashtu si foli u kuptua. Valiut ia mbysnin fjalën zëmërimi dhe inati që kishte për Birbilenjtë. Sazexhinjtë nuhatën që diçka ngeci në bisedë dhe ia morën sërish këngës që i pëlqente Valiut:

Hysni Pasha me shtatë zemra ...

Hysni Pasha, Valiu jetëgjat i Janinës

Hysni Pasha vezir mbi vezirë ...

4.

***"Syri i Valiut të Janinës është topi,
Veshi i Valiut të Janinës është topi".***

Në errësirën e natës kështjella dhe sarajet e vezirit ngjanin si përbindësja me trupin të fundosur në ujë. Dritat në saraj të Valiut duken si dhjetra sy lugati. Ato ndizeshin si të lodronin enkas që të ngjallnin frikën te shqiptarët e grekërit e Janinës. Aty, mbi muret e kështjellës endeshin roja e përgjonin topa. Thuhej në qytet:

- Syri i Valiut Hysni pasha është topi.

- Veshi i Valiut të Janinës është topi!

Ai e kishte rënduar kështjellën e Litharicës me topa të kalibrave të ndryshëm, si topa të lehtë, topa të vendosur mbi shtrat, topa ...

Në orët e vona të natës qyteti u mbyt në errësirën dhe dritat e sarajit dolën më në pah. Hysni Pashës i pëlqente që ditën Janinën ta shikonte nga bedenët e kalasë. Andej shiheshin rrugicat e ngushta të qytetit të shtruara me kalldrëm, dyqanet në radhë. Janina ishte e zhurmshme po e bukur. Atë natë ai e soditi qytetin nga liqeni. Natën, Janina shfaqte bukuri mahnitëse dhe shpesh qyteti mbi bregore zhytej në ujë e liqenit ku ndriçonin mijëra drita të shtëpive karakteristike janinjote.

Nata kaloi në heshtje. Njerëzit që ishin në sarajin e Valiut dolën me varka në skelë dhe u shkoqën nëpër rrugicat e ngushta të qytetit. Këmbeheshin fjalë. Valiu e dinte se ditën e nesërme afijet do ti njoftonin ç'ka thuhej për Valiun.

- Nuk bën hije asnjë vali tjetër pas hijes të Aliut tonë - thoshin shqiptarët.

- Eh, vre Ali Pashë Kajmeni - shpreheshin grekërit. Hija e Ali Pashë Tepelenës qëndronte pezull mbi qytet dhe atë hije nuk kishte forcë ta lëvizte prej vendi. Janina këndonte edhe një këngë për Vezirin Ali që thoshte: "Luftova për Janinë e s'e gëzova!"

Kur hija e cipës të zezë të natës lëshoi majat e Pindit, errësira e natës filloi të zbehej. Rrezet e diellit të mëngjezit ranë mbi minaret e xhamive e mijëra dritare të qytetit dhe ndriçuan bukurinë e liqenit. Qyteti dhe Liqeni ndriçojnë në një bukuri të përgjeshme.

Hysni Pasha u zgjua herët, doli mbi bedenat e kalasë me vështrim mbi qytetin dhe liqenin. Dielli i kishte dhënë kaltërsisë së liqenit dhe qytetit pamje tjetër, një dritë shkëlqenjese. Ai qëndroi te bedenat në kala gjersa dielli i mëngjesit lëshoi rrezet e tij mbi kaltërsinë e ujit, mbi ishullin e Shën Pandelejmonit, mbi kupolën e lartë të manastirit majë kodrës, mbi kupolën e lartë të Manastirit majë kodrës së ishullit dhe mbi godinën e madhe të sarajit të bardhë të ahengut. Atë godinë, Hysni Pasha e ndërtoi fill pas dështimit të kryengritjes. Kur hodhi shtat godina e bardhë dhe e bukur Valiu Hysni Pasha lëshoi ferman që ahengu të zinte vendin e këngëve të sarta, nanurina e imamëve majë minareve këngët e trimërisë, melaqetë e tij (dervishët) vendin e xhindeve.

Gjëmimi i topit të madh që çeli në mbrëmje ramazanin, në

mëngjes njoftoi qytetin për diçka tjetër. Tellallët rrugëve të pazarit të Janinës dhanë njoftim: "Xhedit Taborri do të dalë nga kazerma".

- Ku shkojnë?! - pyetën janinjotët të shqetësuar.

- Do të shkelin dinsëzët e maleve të Kurveleshit, ata s' duan të veshin rrobën e nizamit, prandaj ... Do të hedhin në pranga xhemedijen e Birbilenjve që prenë karvanin e thesarit të Vilajetit. Do të ... U dëgjuan mbyturazi këto zëra që tregonin të vërtetën.

- Sus, asnjë fjalë, - e di Valiu ku e dërgon "Xhedit Taborrin".

Sokakët e Janinës u mbushën me njerëz. Dëgjohej ropadumet e daulleve, thirrjet e tellallëve:

- Dëgjoni, milet! Valiu ka dalë të përcjellë "Xhedit Taborrin".

Urdhër i Valiut që "Xhedit Taborri" i Miriallait Shahin Hatibzadesë të përshëndetet nga kordhëtarët e argjendarët, kambanetarët e bakërpunuesit, bukëpjekësit e opingarët. Nga ... të dalin të gjithë shqiptarët e grekërit që banojnë në Janinë e Madhe. Dëgjoni milet!

"Xhedit Taborri" kaloi me tërsëllimë dhe pas la heshtjen ...

Janina s' kishte kohë të merrej me "hasonatë" e Valiut. Konsujt e Janinës nxituan të mësonin ndonjë lajm. Valiu e shtoi kureshtjen e konsujve në mbrëmje kur pohoi se "Xhedit Taborri" i miriallait Shahin Hatibzade, që në çdo hap që hedh mëlcon tokën e njerëzit, do të ngjitet për të bërë shëtitje në malet e Arbërisë. Po konsujt e Evropës nuk e hanin sapunin për djathë.

Konsujt si konsujt, i dhanë zjarr punës. Gazetat botuan lajme për Birbilenjtë dhe për thesarin e humbur që Valiut nuk i erdhi hiç mirë. Sipas Pashait të Janinës në vend sundonte paqja e mirësia, kurse ata flisnin secili më zi se tjetri. Njeri kishte thënë se në këto anë vërtetohen trazira e ushtria si bën dot zap, kurse një konsull nxiti një gazetë të shtronte çeshtjen që Valiu i Janinës kërkon djemtë e Shqipërisë të bëjnë nizamllëkun përtej deteve, aty ku piqet buka në diell. Po shqiptarët, në veçanti Lebërit e Gjolekës, s' duan të largohen nga trojet e tyre ... Në baltën tonë e duam "punën, këngën, trimërinë dhe varrin" - thonë ata.

Ai lajm i cukthi Valiut të Janinës.

5.

“Njeriu që ia shpëtoi jetën kali”

Njerëzit e këtij shkreti janë arrëza të tërbuara që s’duhet tu besoj në asnjë çast - foli me vete Shahin Hatibzadeja, kur “Xhedit Taborri” kaloi dredhat e shtigjeve për të dalë në fshatin Golem. Ai e bënte gjumin me një sy të hapur. I trembej të papriturës. E kuptonte që e vështronin vengër edhe nizamët e tij dhe druhej nga e papritura. Filloi të dyshojë në qëllimet e Valiut. Mos shenja prej ari e gradës së miriallait që i premtoi ishte një copë që i hidhet tigrin për të hyrë në thellësi të shpellave? Qëndronte mbi një gur i menduar. Ishte lodhur nga rruga e gjatë që kishin bërë. Ndjen afshin e etjes nga mëlçitë e qëngjave të ngrënë. Vuri buzën te shkëmbi ku delte currili i ftohtë i ujit. Uji që nga guri rridhte me shpejtësi dhe stërkalat i lagën mjekrën e zezë e të gjatë.

- Khu, khu, u mbyt.

- Ç’ke - i tha imami i taborrit.

- Më kaloi keq uji në fyt.

- Të kam thënë që dhjami i tepërt është i keq për huxhutin - i tha imami.

Shahin Hatibzadeja ishte njeri trupngjeshur e qafëngjitur. I kishte hypur shumë shëndeti. Ai ishte mishngrënës i madh. Dashin e pjekur e kapte nga këmba dhe i delte në fund, të dorëzonte kocka të pastërta. Goja e madhe i fshihej poshtë xhufkave të mustaqeve e mjekrës së zezë me dredhëza si fundi i thekëve të buzëve të bëra dredhëza-dredhëza. Kishte duar të gjata. Falë tyre hapi shtegun e karrierës vetëm me erën që i jepte këllçit. Në ato duar të stërgjata qëndronin gishtat e dorës me dhëmbëz të holla e të gjatë si të sfurkut që binin në sy për keq tek njerëzit. Një shëmtyrë e vërtetë ishin ato duar, por për Valiun e Janinës ishin me vlerë të madhe. Për to thoshte: “Duart të gjata e gishta kanxhë si të Shahin Hatibzadesë janë dhuratë e Allahut. Ato i duhen zabitit për të prerë me pallë e për të rrëmbyer se kush nuk derdh mexhite e lira floriri në thesarin e Padishahut është derr me zile nga të sokakëve të Janinës”.

Kali i Shahin Hatibzadezë ishte kalë qafëgjatë me këmbë të gjata e të holla, me bishtin të prerë që i shkante nën kyçin e këmbës. Ajo kafshë ishte gjë e bukur për tu parë, por nizamët i magjepshte më

tepër lehtësia si ecte dhe vrapimi erë i tij. Thuhej se Bimbashi Shahin kalin e tij pullali e ushqente me sheqer që nga ditët e kryengritjes së madhe. Atë e bënte sepse në vitin e kryengritjes Shahini ishte prerë me jatagan në faqe. E dinte që e kishte prerë në faqe një kryengrites në moshë fare të re. Djaloshi me emrin Birbil që e preu ishte nga fshati i vogël Rexhin. Këtë ai nuk e dinte. Dhëmbët e kishin penguar tehun e jataganit të Birbilit të shkonte më thellë. Ajo plagë që i kishte dhënë kryengritësi i ri në moshë i dërmoi nofullën e dhëmbët. Më vonë Shahin Hatibzadeja kishte pyetur për emrin e djaloshit, por buzët e leberve ishin qyçur.

Ecte shkrepit mbi kalin e lartë e të shpejtë. Nuk i largohej nga mendja ai arnauti, djali i ri me trup të bëshëm, çasti kur ai e preu me jatagan. I kujtohet se si atë ditë shtrëngonte kokën fort që të shuante dhimbjet. Mendoj se kishte mbaruar, por kur hapi sytë e pa kalin e tij pullali të sh.rirë. Kafsha enkas kishte rënë pranë të zotit rafsh me tokën ta ndihmonte. Shahin Hatibzadeja, në vend që të ruante frymën e ti shtonte vetes edhe një minutë jetë, i dha forcë trupit deri sa ra sipër mbi shalën dhe ashtu si një trup pa jetë qëndronte sipër kafshës që ecte ngadalë e lehtë nëpër dymijë nizamët që priteshin me palla në grykën e Kuçit me luftëtarët e Gjolekës. Kali dhe njeriu ecnin ngadalë në sheshin e luftës nëpër zallin e bardhë të Shurit të Kuçit. Kali u afrohej uniformave të nizamëve, i zoti lëshontë grahmë të rëndë. Kishte plagë të rënda, i kishte ikur shumë gjak dhe ai nuk përmendej. Edhe vështrimi i syve ishte venitur nga gjaku. Por kryengritësit e Gjolekës e Hodo Nivicës nuk kishin kohë të merreshin me kufomën që rëndonte sipër shalës, ata dhe nizamët i mbanin jataganët në dhëmbë, priteshin e vriteshin.

Përleshja në Grykën e Kuçit e kryengritësve me Ordinë Osmane u bë shesh përshesh. Kështu i vinte ajo tani në kujtesë bimbashit, si një xhehnen i vërtetë, i lyer me gjak nizami. Dhe ja, përsëri ndodhej përballë me kryengritësin që e preu me pallë. Përmendi emrin e Birbilit.

“E ka shpirtin nga kali” - thanë kur u shërua. Dhe ai e donte shumë kafshën, e përkëdhelte dhe e ruante. Nuk dontë që ta mundonte. Pa atë kafshë çdo gjë për të ishte e vështirë. Kishte peshë të rëndë. Ai nuk i zbriti kalit. Një krismë pushke aty ku mbaronte Përroi i Dukagjinit, në afërsi të fshatit Golem, bimbashin e “Xhedit Taborrit” e bëri të ulë qepallat e syve. Iu duk sikur mali e goditi me një dorë

kokrizash stralli. Dy herë më i egër iu bë vendi. Shikoi shkrepat rreth fushës dhe përroi e thellë në afërsi të fshatit Golem.

- Si quhet ky vend mirjalla - e pyeti imami. - Ky vend më ngjan me shtëpinë e xhindëve.

- Ehtë shtëpia e atij syfetsëzit, - tha bimbashi Shahin.

- E kujt, e kujt? - pyeti gjithë kureshtje imami dhe iu afrua ta dëgjonte.

- E kaçakut Myrto Dukagjini që është me xhemedijën e Birbilenjëve.

- Si është vetë e ka edhe shtëpinë, në përrua te folea e shejtanit.

- Ky kal, si të jetë njeri, si ra ashtu, rrafsh me tokën kur ranë pushkët.

Kur u dëgjuan krismat e pushkëve pullaliumi u gjunjëzua. Pushkët e pritave ai i nuhaste dhe binte në tokë. Kali bëri ashtu që të shpëtonte të zotin nga plumbat. Sa herë që kali bënte ashtu, Shahin Hatibzadeja gjithnjë e përkëdhelte, ndërsa atë çast e qortoi dhe i shtrëngoi me forcë frerin që kali të ngrihej.

- Ush, drej - i thirri dhe i tërhoqi frerin.

Kali e mori veten shpejt, kurse i zoti më ngadalë. Atë kohë zbriti bylyku i kavalerisë dhe suvaria u dha erë kuajve nëpër fushë.

Disa kalorës morën vrapin në drejtim të shkrepit.

- Ku shkojnë ata, ku shkojnë? - pyeti imami.

Asaj ane, në drejtim të përroit të Dukagjinit, u dëndësua krismat e armëve. Shahin Hatibzadeja qëndroi majë kalit të tij të gjatë, krehu mjekrën e zezë të mbushur me flokë dhe me majë të hollë në fund, si mjekër cjapi.

- Aty diçka ndodh - i tha imamit.

Yzbashi i Skuadronit i raportoi që Birbilinjët kishin qëlluar me pushkë.

- Bënë dëm? - pyeti bimbashi Shahin.

Kufomat e pesë zebekëve shiheshin të përkulur pa jetë sipër shalëve.

- Allahu u ndritë shpirtin nizamëve të vrarë - tha imami dhe mërmëriti një fjalë të Kuranit që lehtësonte shpirtin e tyre. Yzbashi i rekrutimit hapi faqet e defterit. Lexoi:

“Lista e humbaraqëve”. Këtu jo. Më tej “Lista e dinsëzëve”. Edhe këtu jo” - thoshte me vete dhe prapë shfletonte ...

- Të shkruhen në listën e shehitëve - i tha Shahin Hatibzadeja

dhe u shkëput nga nizamët i shoqëruar nga rojet duke e bërë veri dorinë e tij të bukur. Kali u sul në gallop na drejtim të çezmës së fshatit Golem. Pas tij ecte lehtë kali avdall i imamit. Ai ecte më qetë e herë pas here turfullonte, kurse kalorësi mërmëriste fjalë nga Kurani që duhet t'i dëgjonin nizamët e taborrit.

X

1.

*Birbili si dhe Gjoleka
Zë koshadhët dhe i bën feta
I var lisave në dega.*

Në prag të vitit të Ri dy njoftime që u dhanë ditën e pazarit në Janinë e shtynë Valiun të kërkojë më tepër të dhëna për çetën e Birbilenjëve. Thirri qatipin dhe i tha:

- I dua këto habere të hedhura me arfe në kartë, një siç janë thënë. Qatipi gërmoi gjatë nëpër shkresat. I mbloodhi të gjitha ç'që thënë e çfarë nuk qe thënë. U mbyll në dhomën e tij e veç atyre që diheshin veçoi disa të tjera të lëna në harresë. Si u sigurua që kishtë mbledhur ç'i duheshin Valiut filloi të shkruante:

- "Në ditën e Baramit të vogël Birbilenjtë prenë dy karvanë që vinin nga Vlora. Rojet e karvanit u bënë mëzat, ua hoqën armët, u morën mallin dhe humbën nga sytë."

"Qafiri Birbil Shakua me shokët e tij rrëmbeu yzbashin e koshadhës që endej në Zagorie për të mbledhë taksat, e çoi symbyllura një ditë larg dhe e fshehu në një shpellë. I la bukë e ujë dhe derën ia mbylli me një gur të madh që as pënda e buajve nuk mund ta lëvizte nga vendi. Na kërkoi dhe pranua ta ndërrojmë me tre nizamë të mbyllur në hapsanë."

"Të hënë, ditën e pazarit në Ergjëri, u pa të kalonin përmes pazarit katër dinsëzë. Koshadhet u vunë në gjurmë të tyre dhe dot nuk i kapën."

"Në fshatin Hajdaraga Birbilenjtë ranë në pritën e koshadhes. Bënë dyfek me njëri tjetrin dhe gjë tjetër nuk u pa. Më vonë dy nga koshadhet u gjetën të vrarë."

"Në afërsi të fshatit Vergo një suvari i yni u gjuajt me pushkë.

Sipër shehimit është lënë një kartë ku shkruhej “Birbilenjtë”.

“Natën Birbilenjtë shtinë në dorë karakollin në Palokastër dhe mbyllën në bincë çaushin dhe rojet e kalasë. Mallin e tregëtarëve që gjetën ia shpërndanë milletit.”

“Ditën e shtunë, kur qe berë pazari citë me njerëz Birbilenjtë goditën te Ura e Vrizit dhe e plagosën Kajmekamin e Delvinës.”

Tre habere të tjerë:

“Në Lunxhëri janë shpërndarë mijëra grosh nga Birbilenjtë për të martuar vajzat e mbetura se nuk kishin me ç` të bënin pajën. Ato i quajnë këta dinsëzë vëllëzer dhe ata motra.”

“Natën në Fushën e Valaresë, afër Ergjërisë, Birbil Shakua rrëmbëu kopenë e madhe të mbledhur për xhelepet. Thuhet se ua ndau atyre që nuk kishin cangadhe.”

“Disa birbo nga ata që nuk kanë ku tu a hedhi dhëmbin qeni, kanë blerë pendë me qe, thuhet që paret ua japin Birbilenjtë.”

“Në Ergjëri ditën në drekë, kur Kajmekami i qytetit me të tjerët ranë në pikën e vapës te burimet e freskëta afër këmbës së malit, mbiu si nga dheu xhemedija e Birbilenjve. Nuk bëri zullum por mori një barrë me pare që thuhet se ua ka ndarë fakirfukarasë.”

“Kur shkante nga Nivica në Progonat për të takuar afijen Nezir e kapën Birbilenjtë, e prenë në dy copa, e shtinë në hebe dhe e rrahën kafshën që të vraponte në drejtim të fshatit. U llahtarisen zebekët dhe trimat e kalasë kur lexuan: “Peshqesh për Kajmekamin. Nga Birbilenjtë”.

“Birbil Shakua disa herë u ka dërguar taksidarëve letra, i tremb duke ju thënë: “Po u zura do t`ju var lisave nëpër degë”.

Dhe në fund një haber tjetër me rëndësi:

“Thuhet se hairsëzët Birbilenj duan të mbjellin meritë tek arbërit për osmallinjtë. Ata sa herë ndajnë pare e flasin me njerëz thonë dhe ca fjalë të ngjashme me arfet e Kuranit por me llafë të yshtura nga shejtani:

*“... Ky halldupi, ky konjari
bukën tonë po na ha,
ç`veshur, z`bathur na ka lënë
lakuriq pa një para”.*

2.

*“Kush e mban gjatë prushin në dorë,
mos të ankojë se digjet”.*

Hysni Pashën, Valiun e Janinës, e thirrën në Stamboll. Prej andej u kthye i mërzitur. Kësaj here Sulltani i kish treguar dhëmbin, ashtu siç i tregon çobani shkopin qenit që nuk e ndjek egërsirën.

Thirri qatipin e bujurlldisë dhe i diktoi një urdhër. Ishte në pritje që të firmosë bujurllidinë dhe endej nëpër dhomë i shqetësuar duke vështruar në drejtim të maleve. Fërkoj duart.

- Andej fryn era - tha.

Doli në dritare nga liqeni. Liqeni bënte tallaz. Ky vit erdhi më i ftohtë se vitet e mëparshme. Valiu u afrua tek dritarja. Dëgjoi vuvërimën e paperë të erës. Malet qenë mbuluar me borë.

- Erë, erë e madhe - murmuriti Hysni Pashai.

Ai donte të qëndronte sa më tepër afër dritares. I prunë kafe. Sa e vuri në buzë u ngërdhesh në fytyrë.

- Zeher, më keq se zeher!

I sollën sherbet me erë të këndshme dhe përsëri nuk e piu. Nuk i hahej e nuk i pihej. Kërkoj përsëri qatipin e bujurlldisë. Qatipi e kishte zakon të mos rrëmbehej, por kësaj here Hysni Pashait nuk i pritej.

- Më shpejt! Më shpejt! - i foli.

- Kur qatipi ia vuri bujurllidinë mbi tryezë sytë e tij i përpinë rreshtat. Në të shkruhej:

“Sanxhakbejlerëve të Delvinës e Vlorës, kajmekamëve, memurëve, dizdarëve të kalave: Tepelënë, Përmet dhe Ergjëri u bëj selam dhe ju njoftoj se:

“Zebekët e kështjellave dhe karakollëve gjithmonë janë bezdisur nga xhemedja¹ e Birbilenjve. Ata dinsëzë bënë gjëmën e madhe, prenë disa herë karvanët, vranë shoqëruesit e tyre dhe akoma më keq, duke vranë Ahmet Beun, vunë në zi gjithë Vilajetin. Nuk është e para herë që këta dinsëzë bëjnë fesate. Karvani e malli që erdhi nga deti e prenë përsëri te Guri i Ylinecit. Dy herë prishën karakollin në Qafën e Skërficës (Zhulat). Në Qafën e Muzinës u dyfeqisën me nizamët e një

1) Turqisht: çeta

taborri dhe dogjën karakollin në Hanin e Subashit e në Grykën e Selcës. Birbilenjtë z'dinë të ndalen në veprimtarinë e tyre. Këta dinsëzë nuk u mjaftuan me zullumin që bënë duke vranë Ahmet Beun, njeriun më të nderuar të Vilajetit, atë që i solli dovetit një det me mall e para. Fill mbas tij dogjën sarajin e Xhemal Bej Votinës, vranë njerin nga trimat e tij dhe bënë mëzat të tjerët. Kohët e fundit, siç u kemi vënë në dijeni, ndodhi mënxyra e madhe. Xhemedija e Birbilenjve bëri gjëmën e madhe që i prishi qetësinë Padishahut tonë, i dolën në rrugë karvanit të Thesarit që dërgon çdo vit Vilajeti i Janinës në Stamboll, vranë shoqëruesit e karvanit dhe më keq akoma rrëmbyen thesarin. Katër mushka me flori evlatër çoç janë. Ky zullum i madh i tyre zemëroi dovetin e për këtë Padishahu më qortoi duke më thënë: "Kush sundon në Arbëri, hija ime apo hija e Birbilenjve". Fjalët që mu thanë në Stamboll, evlatët e mi, më futën shtatë pashë nën dhe. Prandaj, me ngutje përgatitni forcat që do të dërgohen në Kazanë e Kurveleshit ku është krijuar një gjendje lesh e li, ku se njih qeni të zonë. Këto forca vihen nën komandën e Miriallahit të "Xhedit Taborrit", Shahin Hatibzadesë, njeriu që i njih mirë këto vende. Ai me "Xhedit Taborrin" dhe forcat që do të dërgohen të lëshojë koshadhën për kapjen, një sahat e më parë, të xhemedies së Birbilenjve. Bëni kujdes në gatitjen e nizamëve e zebekëve se duhet të kuptohet nga të gjithë që malet e Arbërisë po bëhen për Vilajetin e Janinës përsëri mollë sherri. Kësaj here s'kemi të bëjmë më një Gjolekë për nga numri i kaçakëve, ndërsa qëllimet e tyre janë po ato. Nuk është një rastësi që Nizami i arratisur Birbil, në tërë Arbërinë, quhet "Gjolekë". Edhe kësaj here diçka është ndezur në gjirin e Arbërisë të pabindur".

"Nuk do ta kemi aq të lehtë për ta shuar. Duhet ta kuptoni evlatë fjalën e Padishahut tonë që më tha me qortim kur më thirri në Stamboll: "Kush e mban gjatë prushin në dorë mos të ankohet se digjet". S'mund të durohet të endet si hije rrugëve të Vilajetit kjo xhemedije. Ky është një rrezik i madh dhe të gjithë së bashku duhet ta shuajmë zjarrin. Mos të harrojmë asnjë herë që zjarri shuhet më lehtë në fillim, kur ende nuk e ka rrëmbyer pyllin. Prandaj të shkelet Kurveleshi e gjithë Labëria. Edhe herë të tjera e kemi ndjekur dinsëzin Birbil Shako e shokët e tij, por pa asnjë shefajet, sepse Kurveleshasit bashkohen me xhemedijen e dinsëzit Birbil Shako e Resul Sejдини. Ata, në vënd të ndihmojnë në kapjen e kryengritësve, i ndihmojnë ata. Prandaj sapo të merrni kartën t'i nisni asqerët dhe në ditën e caktuar

ata të mbërrijnë në vend. Bëni kujdes që të veprohet sipas bujurllidisë që ju dërgohet. E prisnim që të shuhej xixa e sherrit por ajo në vënd që të shuhet erdhi duke u rritur, deri në atë shkallë sa që duhet të vëmë dorë për të qetuar vendin. Më rëndon gjynahu që nuk hodha ujë në kohë që të shuaja sherrin. Dhe atëherë doli açik xixa e sherrit. Birbil Shakua mblodhi rreth vetes raja të tjerë e formoi xhemedijen. Dhe ndodhi e papritura. Dinsëzët bënë atë që s' mbahet mënd të jetë bërë në jetë të jetëve, rrëmbyen katër mushka me lira. Më vjen turp që u katandisa të luftoj me zuzarët por ... Të gjitha forcat, edhe zebekët e kalave të Kurveleshit, që ndodhen në kalanë e Nivicës, Progonatit dhe atë të Zhulalit, vihen nën komandën e Shahin Hatibzadesë”.

Hysni Pasha
Vali i Janinës

3.

*“Gjiun e gruas tënde, në vend ta thithë
fëmija, do ta thithë çumështin e saj një gjarpër”.*

Barinj të që kishin ndjekur lëvizjen e erës në verë kishin lajmëruar që dimëri i vititi 56-të do të bënte me furtunë. Fjalët nuk ishin një shterpësi e kotë. Një natë dhe një ditë u desh që të mbulohet vëndi nga bora.

Kopetë i zuri bora në male. I gënjeu koha. Në një kohë me shtrëngatën endeshin si korbat e natës me jataganë në dhëmbë Taborrat e Miriallait Shahin Hatibzade. Ai mblodhi nizamët e zebekët dhe u tha:

- Kësaj here ose zëmë Birbilenj të dhe i varim ose do të varim vetveten!

Mblodhi në Progonat burra nga çdo fshat i Kurveleshit dhe u tha:

- Kupa e durimit u bë rrafsh o Kurveleshas, s' dujon as dheu që mileti të bëjë si të dojë, jo më Valiu e aq më pak Porta e lartë. Duhet ta ndieni zullimin që bëni. Troket në portat tuaja taksidari, dalin gratë me miqën e sopatës. U kërkon imami për t' u thënë dy fjalë të kuranit, ikni e humbisni në pyll. Gjatë duroi hyqymeri. Ju kalb stomaku Valiut të Janinës duke duruar e pritur që harbutëria e nahijes së Progonatit të bjerë në rrugë. Kësaj here bëni mirë t' i vini gishtin kokës. Duke u

dhënë ndihmë Birbilenjve u keni vënë zjarrin konakëve tuaj. Eshtë ky faj një me njeriun që bëhet gjynaqar ndaj nënës së tij dhe i bie pishman për hapin pa mënd që hodhi, ashtu edhe ju. Kërkohet të ndrroni rrugë. Hyqymeti e di që u nxisin të flisni keq, më mirë mos i dëgjoni! Në qoftë se kini harruar atllarët tanë që në 47-të shqyen në dy copa njerëzit në grykën e Kuçit në vitin e kryengritjes, bëni mirë të mos i harroni! Kësaj here nuk do t' u pikojë më dhjamë dashi, o kurveleshas. Tjetër gjë do t' ju bëj, atë që nuk u besohet. Kësaj here ose e bëj atë që them ose po nuk e bëra e flaka mjekrën e nishanët e padishahut. Më njihni kokën, atë që thotë Shahin Hatibzadeja, nuk e lë pa bërë.

Sapo mbaroi breshërinë e fjalëve kërcënuese për kurveleshasit u foli nizamëve:

- Më thërrisni dervish Ramadanin!

Dervish Ramadani, i veshur si një gogozhel i mbuluar në leckë, u afrua. Ai mbante në qelqë dy gjarpërinj.

- Kësi gjarpërinjsh do t' ua lëshojnë dervishët e mi në gjoks grave tuaja!

- Këtë s' e ka bërë asnjë Pasha - tha një nga vendasit. - Kjo është

...

- Jam i pari unë në Ushtrinë Osmane që formova një repart që do të ketë si armë gjarpërinjtë. Kjo do ta shtrijë drithërimin cep më cep të Labërisë. Unë do të bie pa tjetër në gjurmë të xhemedies së Birbilenjve. Do mi hapin shtigjet dhëmbët e gjarpërinjve në gji të grave tuaja.

Njerëzit shtangën kur panë dervishët. Njëri nga vendasit mori guxim të fliste:

- Përse kërkoni gjurmë kur shikoni ujkun!

- Ku është?!

- Në male, ku mund të jetë.

- Mos më folni mua me hidh e prit. U thashë që nesër bëheni pishman për atë që nuk tregoni. Ja ku po të them se ti do të shikosh i pari një gjarpër duke thithur qumështin e gjut të gruas tënde, në vënd që ta thithë fëmija. Atëhere do të flasësh ndryshe, kokëshkëmb. Krahas repartit të lëshimit të gjarpërinjve do të veprojë edhe 'Reparti i thyerjes së kockave'. Të dyja këto marifete do t' i përdor.

Hodhi sytë rrotu, dhe pasi nuk po shikonte atë që kërkonte thirri:

- Dervish Ramadani, - ku shkoi thyesi i kokallave, dervish

Ramadani?

XI

1.

Çobanët e varrosën luftëtarin aty në thellësi të guvës së malit, kurse gjarpërin e vranë.

Thuhej se në lashtësi, një luftëtar i Kaonisë u plagos duke flutuar me armiqtë që dolën nga deti. Ai e pa veten që po vdiste dhe fluturoi, donte të vdiste në njërën nga majat më të larta të maleve nga të shikonte gjithë Arbërinë e të hidhte vështtrimin mbi detin, Çajupin e Tomorrit vetullvrenjtur, të shikonte edhe më tej nga Sazani. Iku andej nga buza e detit dhe erdhi në malet e Kurveleshit, siç vjen zogu te foleja. Djepi dhe varri përjetësi. Nuk i dilte shpirti larg vendlindjes.

Rrugës i ra një pikë gjak majë shkëmbit dhe njerëzit aty ku ra pika e gjakut të luftëtarit ndërtuan kalanë e Nivicës ... Fluturimi i luftëtarit ishte i pandërprerë gjersa arriti te shkrepit në majën e malit Këndrevicë. Aty mbeti. Thuhej se aty, në guvë, gjeti përgjumur një gjarpër. Gjarpëri kishte ngrirë po njeriu nuk e vrau. E mori dhe e futi në gji. Kur u ngroh gjarpëri u bë për ç'qe dhe e kafshoi për vdekje mirëbërësin. Çobanët e varrosën luftëtarin aty në thellësi të shkëmbit, kurse gjarpërin e vranë. Kushdo që kalon aty në mos hedhtë groshin, hidhte kacidhen, por diçka duhej të hidhej te Guva, me kusht që t'i marrë të gjitha ç'gjen. Nuk dihet ç'hodhën Birbilenjtë. Nuk dihet në se e kishin atë ditë një pjesë të thesarit me vete apo e kishin shpërndarë.

Guva e Dragoit u quajt ai vend. Ishte shpellë e madhe me hyrje të ngushtë. Atë vend, nuk e godiste furia e erës dhe s'kishte lagështirë. Bora e kishte mbyllur hyrjen e Guvës dhe kështu ajo ishte bërë akoma më e ngrohtë. Në muajt e verës Guva u shërbente çobanëve për të mbajtur të freskët bulmetin dhe mishin e pjekur të paprishur, kurse në dimër aty, majë malit të Këndrevicës, s'mund të jetohej.

Gjurmimi i Birbilenjve zgjati dy javë. Rrethimi bëhej çdo ditë

e më i rëndë. Ata endeshin maleve pa bukë e pa zjarr. Në fund të javës së dytë të janarit ata, ashtu si ai luftëtari i Kaonisë së lashtë, edhe Birbilentë të ndjekur këmba-këmbës nga zebekët u larguan nga shpella e Tërbaçit, thyen prita të tjera dhe ngritën folenë majë të maleve të Këndrevicës. Te shpella e Dragoit hynë aty natën, pasi fshinë gjurmët me borë.

- Në këtë vend do të pushojmë disa ditë - u tha Birbil Shakua. Ata u strukën nën guva, u strukën nëpër cepat e Guvës, zgjodhën vendet më të ngrohta. Ishin të pangrënë dhe të lodhur nga ndjekja që u bëhej.

- Si nuk therëm një dash, më hahet mish - tha me shaka Myrto Dukagjini.

- Nuk e harrojnë shakanë Golemasit - tha një tjetër.

- Kemi pak bukë - foli Resul Sejdini dhe u dha nga një rrip të hollë buke.

- Lëroje dorën o cungo, bëri shaka Myrto Dukagjini kur mori në dorë copën e bukës.

Resul Sejdini ishte i lëshuar në fjalë, por si kopraci që s'ë lëshon groshin e jepte bukën.

Në shpellë bisedojnë, kujtojnë ditët që endeshin staneve. Kujtojnë shtëpinë. Si të tjerët edhe Birbili kujton. Ku ishte tani Hirua? Budo Bredhi i dërgoi letër dhe i thoshte se e kishte marrë Sorkën dhe Hiron në stanin e tij, në Grykën Jetëshkurtër. I jam borxhlli për jetë të jetëve Babë Bodos - mendoi me vete dhe ashtu mendueshëm u hodhi një vështirm shokëve.

Nisën të këmbejnë fjalë.

- Nuk mjafton që vramë Ahmet beun, nuk është mjaft që vumë zjarrin në sarajin e Xhemal bej Votinės. Nuk mjafton që premë karvanin e thesarit dhe ua ndamë fakirfukarasë.

- Ç' duhej të bënim tjetër, Myrto?!

- T'i prisnim kokën Shahin Hatibzadesë. Mjaft u end ky zebek i ndyrë mbi trojet tona. I ka marrë koka erë këtij zebeku.

Njëri tha:

- Le të lajmërohet miriallai Shahin, ta dijë, që do ta dënojmë me vdekje.

Mendimin e shkruan në kartë.

- Në pak fjalë u tha ajo që duhet thënë - tha Myrto Dukagjini kur dëgjoji letrën që e shkroi dhe e lexoi Birbili.

Në letër thuhej:

“Shahin Hatibzade,

Xhemia e Birbilenjve për zullumet që ke bërë e po bën të dënon me vdekje. Po të zumë të gjallë do të të shkojmë në hell dhe kemi për të të pikuar me dhjamë cjapi. Nuk të zumë të gjallë do të hysh në dhe trup pa kokë. Mos kujto se mban emër topi dhe s’ të pret jatagani e s’ të rrëzon plumbi.

Birbilenjtë”

- Ku do të vihet kjo shpallje? - pyeti një progonatas.

- Në çdo fshat - tha Birbili. - Do të kalohet natën.

- Në portën e zyrave të hyqymetit në Progonat e vendos unë - tha Progonatasi.

- Në Nivicë i vendos unë tha një i Niviciot. Në Golem e në Kolonjë shkoi Balil Zhupa. Në Zhulat dolën dy njëherësh, Asllani e Shahini. E hodhën në short dhe i ra Shahinit.

Dënimi i Miriallait u mirëprit nga njerëzit dhe u besua. Kurse Shahin Hatibzadea as i ra atij shtegu. Si të ishte shurdh nuk ua vuri veshin fjalëve. Në të vërtetë filloi të ndiej hijen e dorës që i dha erë jataganit, që e preu në vitin Dyzeteshtatë. Me vete tha: “Ai krah që më preu një herë mund të më presë përsëri.”

Sa herë hidhte dorën në faqe për të dredhur e krehur me furkalicat e gjata mjekrën e ndjente goditjen e tehut të jataganit të ish kryengritësit të vogël Birbil Shako dhe prap mermëriti: “Krahu që më preu një herë mund të ma presë edhe një herë tjetër.”

Në vend ta ligështonte kërcënimi, e bëri më të egër komandantin e “Xhedit Taborrit”.

2.

Luftëtarët e xhemedies u hoqën secili në vendin e vet dhe hynë në guvat e ngrohta. Qëndruan të heshtur vetëm për pak kohë. Myrto Dukagjinit iu kujtuan fëmijët. Ai kishte dy fëmijë, që ishin degët dhe gjethet e tij. Ai i shikonte rrallë, shumë rrallë, por e dinte që rriteshin. Seç iu kujtuan në këtë moment të dy fëmijët e tij. Një ditë më parë kish

shkuar për ti parë. Sapo erdhi në çetë e pyetën të tjetër:

- Si ishin fëmijët, Myrto?!

- Rriten për t'i prerë kokën Pashait të Janinës.

Kur foli Myrtua për fëmijët e tij, Birbilit iu kujtua Hirua. Edhe ai do të kishte fëmijë një ditë. Kështu e kishte lajmëruar nëna Sorkë. Edhe ai do të ketë degë e rrënjë. Heshtja në errësirë e pushtoi Myrto Dukagjinin. Ai e filloi i pari shakanë. Edhe kësaj here ai diç i thotë Asllan Gjoçës të Zhulatit që e ka në krah.

- Fol me zë të lartë Myrto, me zë të lartë që ta dëgjojmë të gjithë - i tha Asllani.

Ata ishin zhytur në një errësirë të thellë. Përjashta të verbonte bardhësia e borës, në shpellën errësirë.

- Nuk është fjalë, është lodër - tha Myrtua.

- Edhe më mirë, lodra bëhet me shokë.

Ai filloi:

- Na ishte ç'na ishte ...

- Oj, ti na the që është lodër, tani e ktheve lodrën në përrallë.

Myrto Dukagjini nuk ia vuri veshin. Ai vazhdoi fjalën për një nuse, bëri pyetjen:

- Ç'e bëre mishtë, nuse?

- E hëngri macja - u përgjigj një kaçak tjetër i struktur thellë në një zgavër të shpellës.

- Macja ç'u bë? - pyeti një tjetër.

Të gjithë i rrëmbeu lodra.

- Hipi në lis - tha një tjetër kaçak, si i përgjumur.

- Lisi ç'u bë? - pyeti një progonatas.

- E preu sopata.

Papritur Myrtua heshti.

- Fol, Myrto, fol - i thanë të tjetër në errësirën e thellë të dheut.

- Ç'u bë sopata që preu lisiin - ndërhyri një tjetër Progonatas.

- Sopatën e theu guri - ia priti tjetri që e dinte lojën.

- Guri ç'u bë?

- E mori lumi.

Sillet rreth fjala në shpellë si në një pallat. Ashtu largonin urinë e mundimin. Në fund e pyetën përsëri me zë të lartë Myrto Dukagjinin:

- Ujku ç'u bë o Myrtua i Golemit?

- E vrau dyfeku.

- Dyfeku ç`u bë?
- E mori mirirallai Shahin Hatibzade.
- Mirirallai Shahin ç`u bë?
- Hëngri fiq e vdiq!
- Ha-ha-ha! Ha-ha-ha! - Shpërtheu gazi në Guvën e Dragoit ...

3.

*“O Birbil, Birbil Nivica
I larti sa Këndrevica”.*

Kur i ra në gjurmë çetës së Birbilenjve Shahin Hatibzadeja i hodhi malit të Këndrevicës tre rrethime njëherësh. Ngjiti aty dhe pyeti me padurim:

- Ku janë Birbilenjtë?

- Ja, aty, në Guvën e Dragoit - foli i pari me mburrje Emir Kunadhja.

Emiri i tregoi hyrjen e guvës së Dragoit.

- Aha, - tha Miriallahi.

Ndjeu një afsh në gjoks e shpresë në sy.

- Lajmi është shpresëdhënës - tha.

Nga ky çast fati i bardhë zuri vend në gjoksin tim. Foli me sytë e ndezur si llampushka. Besoi se Birbilenjtë s`do t`i shpëtonin kurtlit ku kishin rënë. I gëzuar, me gishtat furkulica filloi të krehë mjekrën.

- Kësaj here i kam brënda dorës, ja këtu në grusht i kam - tha duke u mburrur.

Dhe prapë shqetësohet, i duket sikur në çastin kur do të hapë grushtin e tij zogu i mbyllur do të fluturojë. Si për inat, në këtë çast të rëndësishëm, kur çdo mendim duhej të çonte vetëm në fitore, për drej seç iu kujtua që një herë, kur ishte i vogël ashtu i kishte ikur një zog dhe kishte mbetur i zhgënjyer.

- Çarku duhet të bëhet më i rëndë - u tha Yzbashëve, - ngjeshni rradhët e nizamëve.

Dhe prapë pyeti:

- Mos ka ndonjë shteg nga mund të dalin?

Një re që ra mbi mal ia verboi pamjen. Ai u dëshpërua që malin e Këndrevicës e mbyti mjergulla. Qëndronte te shtredhi përballë guvës së Dragoit dhe po pushonte pranë zjarrit. I mbështjellë me pallto

të madhe, treste në gojë një copë sheqeri që të përballonte të ftohtin. Kur vetëtimte Miriallai bënte: “Allah! Allah Suduhannallah!”

Edhe bubullimat në këto male ishin të çuditëshme, zhurmëmëdha e të stërzgjatura.

Emir Kunadhja, më zebek se zebeku. Kur e liroi malin rea, ai i tregoi Shahin Hatibzadesë hyrjen sekrete të Guvës së Dragoit. Ajo hyrje ishte e pazbulueshme për zebekët, por Emiri e dinte. Në gjurmë të Birbilenjve u kishte rënë Emiri. Edhe hyrjen e shpellës vetëm ai e dinte.

- Askoshun! Askoshun! - e mburri miriallai Emirin.

Foli me dorën të mbledhur grusht. Murmëriste me vete të njëjtat fjalë: “Në dorë i kam, ja në grusht”. Dhe sërisht i erdhi në kujtesë ai zogu i vçgël që e kishte mbajtur në grusht papritur i kishte ikur e la të zhgënjyer. Mendimi e nxiti të veprojë.

- Të ngushtohet akoma rrethimi. Dhe pastaj vazhdoi:

- Si i sillet rreth, dhe u shtrëngon mezin zebekëve gjerdani me fishekë, ashtu të sillet edhe rrethi i zebekëve malit të Knëdrevicës.

Ai i vuri katër rrethime njëri mbas tjetrit.

Pritej çasti të niste pushka. Ju bë kretësisht e besueshme se ndeshjen me Birbilenjtë do ta fitonte. Besonte se, njëlloj si në vitin dyzeteshtatë, do të ligjërohej me ligje trimëria. Emir Kunadhja jo rastësisht iu përçqas dhe ia përmendi disa vargje që ishin thurur për trimërinë e Shahin Hatibzadesë. Emiri tha vetëm vargjet që vlerësonin trimërinë dhe nuk i përmendi ato fjalë që e thumbonin zebekun Shahin. Atij i pëlqyen ato vargje. Pyeti:

- Më thuaj o arnaut Emir, a mund të flitet përsëri në këngë për bëmat e mia?!

Emir Kunadhja u përcoll në fyt gjer sa i erdhi fjala që duhej të thoshte:

- Kënga zuri fill me kryekaçakun Birbil. Edhe kënga tjetër me atë do të bëhet. Nuk është e mundur që vajovicat ta lënë në harresë këtë ngjarje. Do të tundet Vilajeti kur të mësojë se Birbilenjtë u kapën.

- Ishallah - shpreh Shahin Hatibzadea. Pastaj pyeti:

- Si shpjegohet futja e emrit tim në këto vargje, unë i kam vvarë, i kam prerë - tha i habitur Shahin Hatibzadea.

- Eshhtë zakoni i vendit - trimëria i përket atij që e bën, tjetër pastaj që gratë zullumqare si ajo Sorka e Golemit, krahas fjalëve të mira lëshojnë ca fjalë të liga që s’ke qejf ti dëgjosh.

Kësaj here ç'të thonë?

- Uh, si ç'të tonë? Kush e bëri sus Labërinë? - Miriallai Shahin.

- Kush i vuri në kurth Birbilenjtë? - Miriallah Shahin Hatibzade.

- Kush ia ktheu floririn e rrëmbyer hyqymetit? - Miriallai Shahin Hatibzade.

- Një mal me këngë do të jenë pak.

Fjalët e Emir Kunadhës ia ledhatuan Miriallait cmirën e lavdisë. Ai, Emir Kunadhja, me fjalët që thoshte i ngjante një kurbatke që të hedh fall dhe të ndez shpresën për një gëzim të madh. Kjo ia nxiti mendimin që të dërgonte letrën e parë në Janinë.

- Do të gëzohet Pashai plak - mendoj me vete dhe shkroi:

*“Hysni Pashës
Valiut të Janinës,*

*Desh allahu dhe fuqia e Padishahut dhe Juaja që ta mbyll
xhemidijen e Birbilenjve në Guvën e Dragoit, në malin e Këndrevicës.
Dinsëzët Birbilenj kanë hyrë nga një hyrje e vogël si vrimë miu në
barkun e malit. Në mos dalshin do t'u vë tymin dhe në hyrje do të
hap grykën e thesit, do ti zë e ti lidh me pranga. Kanë për të ardhur
vetë një e nga një në thesin që u kam ngritur.*

*Dashtë Allahu që kjo letër e dërguar nga një bir i Allahut t'u
gëzojë me një sihariq akoma më të mirë”.*

*Shahin Hatibzade
Nivicë e Kurveleshit, dita e njëzeteshtatë e Janarit.”*

XII

1.

*“S’e hedh Birbili maxharë!
E kam fituar me pallë,
Në Voshtinë kur vura zjarrë”.*

Shahin Hatibzadeja e vëzhgonte me dylbi Grykën e Guvës së Dragoit nga larg, pushkët e zebekëve nga afër. Te një radhua gurësh para Guvës së Dragoit kishin zënë pozicion luftimi Birbilenjtë. Gurët ishin si muret e një avllie, silleshin rreth Guvës. Kjo ua lehtësonte Birbilenjve qëndresën.

Armët e nizamëve vështronin shkëmbin e Guvës së Dragoit. Edhe miriallai Shahin aty vështronte. Birbilenjtë zunë rradhoin përballë.

- Të shkohet më afër hyrjes së guvës - urdhëroi Miriallai Shahin Hatibzade.

Zebekët me radhë të ngjeshura duke rrëshqitur këmbadorazi në borë i afrohen guvës ku janë Birbilenjtë. Asnjë fjalë ... Shahin Hatibzadeja e shtyu Emirin përpara.

- Shko aty, në vijën e parë, folu Birbilenjve që të dorëzohen - i tha.

Emir Kunadhja rrëshqiti si me frikë përpara. Nuk do t’u shkonte aq afër tytave të pushkëve të Birbilenjve, po s’mund të kundërshtonte miriallain. Afrohen nizamët e zebekët. Afrohej edhe Emir Kunadhja.

- Folu - u tha dizdari i kalasë së Nivicës, yzbashi Yzjedin.

- Dorëzohuni o të mjerë, kështu urdhëron padishahu - u dëgjua zëri i Emirit.

1) maxharë - një lloj pushke e prodhuar në Hungari.

Birbilenjtë nuk u përgjigjën.

Birbil Shakua e njohu Emir Kunadhen në zë dhe nderi qafën sipër gurit ku kishte zënë pozicion. Donte ta shikonte. U kishte thënë shokëve: “Me shenjën e dyfekut tim do t’i qëlloni”. Po, në se do e shikonte atë gjarpërin e gurit Emirin, s’do të priste, do t’ja zbraste maxharen në bark. Birbilin kot e mbante shpresa. Emir Kunadhja u vidhej vështrimit të pushkëve të Birbilenjve.

- I lëshoi zemra, s’po bëhen burra - tha gjithë shpresë Miriallai Shahin Hatibzade, i sigurt në kapjen e tyre dhe në gjetjen e thesarit. Farkulicat e gjata të duarve të tij mbetën te mjekra, e krehte dhe e bënte dredhëza. E bëri veten në Janinë. Do të pritej “Xhedit Taborri” i tij dhe ai vetë me hosana.

Urdhëroi që të hidhej edhe një rrethim tjetër. Mbas “unazës” së parë rrethuese ai vuri një tjetër, e mbas saj edhe një tjetër. Ai nuk i trembej aq shumë ditës sa i trembej natës. Dërgoi e thirri yzbashët e bylykëve. U vuri në dukje pikat e dobëta, kërkoi që zebekët e nizamët të ngjesheshin përherë e më shumë. Urdhëroi të zireshin shtigjet nga Vërmiku, nga Salaria e Nivica. Kur u bënë të gjitha këto nxorri nga mesi pisqollën dhe i dha zjarr. Zebekët e kalasë së Nivicës dhe një bylyk nga ata të “Xhedit Taborrit” rrëshqitën përpara.

Këmbelen pushkë. Mbi gurët ku janë Birbilenjtë godasin plumba. Shahin Hatibzadeja e mban dylbinë në sy. Nizamët hidhen në drejtim të gërshit.

- Ata dinsëzë s’po tunden, si të jenë bërë një me shkëmbin, - mendoi me vete dhe menjëherë urdhëroi të vinin aty dy topa. Topat e rrahën shkëmbin me gjyle.

- Do u bluaj si kafen në mulli, dorëzohuni he qafirë! - bërtiti. Kur Shahin Hatibzadea mendoi se te shkëmbi u shua qëndresa nga arnautkat e Birbilenjve ende dilnin flakë ...

2.

Dikush foli mu afër gërshit.

- Emiri! - tha Birbili dhe vështroi që ta shihte mirë. Resuli që e kishte parë më parë Emirin e mori në shenjë.

- Ma ler mua Emirin, - Resul. Mënyra si i foli, lutja që bëri e detyroi tjetrin ta ulë çarkun e armës.

- Dorëzohuni Birbil Shako! - foli njëri nga yzbashët e “Xhedit

Taborrit" dhe e përktheu në shqip Emir Kunadhja.

- Ç' të bën yt!, s'ta bën dot i huaji, qelbaniku, - tha Birbili dhe e mori në shenjë Emirin.

Duke mos lëvizur shenjën nga koka e Emirit, Birbilit iu kujtua që tamam ashtu e kishte marrë më shenjë një herë te lisi në fshat, te Maja e Gjizës. Në kokën e Emirit që ngulur vështrimi i tytës së pushkës të Birbilit. Atëherë i pat folur: "Ik, s' dua të të vras!" Më vonë, në një rast tjetër Birbili me dashje e kishte lëvizur shenjën pak përmbi ballin sa që plumbi i rrëmbeu Emirit festen. Përsëri pat thënë: "Edhe kësaj here s'desha të të vrisja!"

Pas kësaj ishte takuar edhe një herë tjetër me Emirin.

- Jemi rritur në një vatër, vëlla - i kishte thënë.

- Nuk të them jo, por rrugës u ndamë.

- E përse!

- Unë ndjek erën e lirisë, kurse ju erën e jataganit.

- E s'je në gjendje të kuptosh ç'sjell njëra dhe tjetra?

- Unë? Pse, ç'më merr, për budalla? Jo, jo! Me sa bën hije rigoni, aq bën shpata. Me lirën të shtrihen udhët për të shkuar deri në Stamboll, kurse me shpatën i afron qafën litarit. E përse? Hë, më thuaj përse?

- Që të jetojmë të lirë, që të mos tretemi në Jemenin e largët, nizamë të Ordisë së Shtatë. Që të gëzojmë Arbërinë tonë.

- Baba dovleti nuk e ka nxjerrë kot bedelin, lira i shtron rrugët me sixhade, palla me gjëmbe. Nuk më pëlqen të ecë në këtë të fundit. Jo Birbil, jo!

- Emir, Emir, je bërë për t'iu dhembur edhe gurit, si të verbon kaq shumë shkëlqimi i lirisë?

Emiri ishte kopje e zagarit që s'vihet në gjurmë.

Emiri si Emiri, "Gjak i prishur" - tha me vete Birbili. Tani zemërimi nuk njihete më kufi. Prandaj i lutej Resul Sejdit: "Mos e nga atë, ma lër mua atë, vëlla!"

- Uxhum! Uxhum! - gromësinte te bregu miriallai Shahin.

Zëri i korbit dëgjohej fare afër.

- Dorëzohu Birbil Shako, dorëzohu! Yzbashi lexon përsëri bujurdi të Valiut të Janinës që Birbil Shakua, sipas të cilës, nëse jepet i gjallë bëhet agë. Fill mbas zebekut e mori fjalën Emir Kunadhja:

- Jepu Birbil Shakua, këtu ose bëhesh agë me zë ose pleh, jepu!

Birbili priti gjersa ai grup zebekësh i erdhi më afër dhe vuri në

përgjim topin e dorës. Një herë e zbrazi topin. Disa nizamë u përpëliten si pula të therrura. Birbilit iu kujtua Nexhipi i Zhulatit. Ai ia dërgoi atë pushkë top. U mundua të dallojë kufomën e Emir Kunadhes. E kërkoi syri, por nuk e pa.

Mbas dy orësh krismat u rralluan. Në hyrje të shpellës kishte mbetur vetëm një kufomë, të tjerat i tërhoqën. Shahin Hatibzadea që e mbante Guvën në syrin e dylbisë dalloi kufomën. Pyeti:

- Përse është lënë aty ajo kufomë?

- Limoni i shtrydhur s'vlen për asgjë, zoti im! - i tha dizdari i kalasë Nivicës, yzbashi Yzjedini Takijexhiu.

- Kush është ai?

- Emir Kunadhja.

- Aha, mirë! - tha nëpër buzë dhe e hoqi vështrimin nga kufoma.

3.

O Birbil, Birbil Nivica I larti sa Këndrevica.

- Kujdes evlat, kujdes! Kanë pallë e plumb të idhët jezitet - i dha porosi yzbashi të bylykut të ri që e hodhi në veprim. Kujdes evlat se janë ngjeshur aty, kanë hyrë me këmbët e tyre në hapsanë. Na duhen prangat - tha dizdari i kalasë të Nivicës.

- A! - lëshoi një pasthirmë Shahin Hatibzades - Mirë t' u kujtua. Ku janë mushkat e ngarkuara me pranga, në kala? Dërgoni shpejt disa nizamë nga të meqares ti sjellin. Të bien pranga hem për duar e hem për këmbë. Duket që janë mbi njëzet shpirt.

- Jo, janë më shumë.

Erdhi çasti të shikohen sy për sy e të ndeshen dhëmb për dhëmb. Në përlëshje u përfshinë të gjithë.

Përballë Resultit të Progonatit, fare pranë ishte një zebek i fuqishëm. Birbili thirri i shqetësuar:

- Resul! Resul!

Resul Sejдини kishte rënë në pallë dhe s'mund të tërhiqej. Ai në çaste luftimi e harronte veten.

Zebeku u hoq anash që ti shpëtonte telut të jataganit të Resultit dhe për të marrë urush. U hodh në veprim të papërmbajtur. Ai

ngjasonte me një dem të egër që baritet dhe me majën e brirëve gërryente dheun. Ende zebeku rreth e qark e prapë i jepte veri këllçit. Resuli ishte më i matur në lëvizje dhe më i rëndë në forcën e krahut. Zebeku e ndjeu epërsinë e forcës së krahut të Resul Sejdinit, rriti në një kohë zemërimin dhe hilenë që t' i bënte ballë. Birbili e pa nga afër zebekun kur hodhi dorën te pisqolla që mbante në mes. Zebeku deshi që atë që i jepte shqiptarit krahu, t'ia jepte atij baroti po nuk arriti. Birbil Shakua me një goditje të rëndë e të menjëherëshme ia veçoi kokën nga trupi. Resul Sejdini u pezmatua, i dhëmbi krahu. I kishte dhënë krahut hov të madh që të priste zebekun dhe u praps i mërziatur. Kufoma e zebekut ra afër tyre ...

- Kokë boshi - tha Birbili - dhe i hoqi sytë prej syve të ngrirë të zebekut.

4.

*“Ta zëmë për mjekre pashanë
Ti nxjerrim dhëmb’e dhëmballë”.*
*O burra t’i hidhemi
Eshtë nat’e s’vritemi,
Me plumba s’goditemi
Me pallë do pritemi.”*

Birbili me arnautkën përqafe kujton fjalët e betimit ditën që kaçakët bënë besëlidhjen e krijuan çetën. “Kur të vjen fundi prite si u ka hije kaçakëve. Të preu palla duroje dhimbjen, të goditi plumbi mos u gjynjëzo. Ai që s’gjynjëzohet vdes ballëlartë. Kush vdes për dheun e vet lind dhe nuk vdes. Mos ju druaj vdekjes, vdis siç i ka hije luftëratit me vështrim drejt qëllimit për të cilin luftove”. I bëhet se kishte ardhur ajo që duhej, të tregojnë se Birbilenjtë s’njohin frikën. Miriallai kërkon atë natë kokën e tyre, Birbilenjtë kokën e miriallait Shahin Hatibzade.

Morën vendim të sulmojnë natën çadrën e Shahin Hatibzadesë. Ata hynë fshehurazi në kampin e ushtrisë.

- Ja shehit, ja gaza! - u thirri shokëve Birbili dhe doli nga Guva e Dragoit.

- Ja shehit, ja gaza! - përsëriti secili.

Hynë në rrjedhën e një nate me dallgë. Shpatat prisnin zebekë,

pisqoliat qëllonin. Të vdekurit që binin ndiznin trimëri në sytë e atyre që vinin prapa. Të dy anët, edhe Birbilenjtë edhe zebekët, hynë në luftim për të mos u sprapsur. Birbilenjtë shkuan drejt qendrës të gjithë bashkë si një trup i vetëm. Asnjëri nga ata nuk e kishte ndërmend të zbrapset. Ata donin të bëhej patjetër ajo që kishin vendosur, t'i prisnin kokën miriallait dhe të çanin rrethimin. Në çastin që dolën nga Guva e Dragoit Resul Sejдини mori me vete një shul dëllënjë me majë të mprehtë.

- Di t'ja ngul kokën Shahin Hatibzadesë majë këtij huri - u tha shokëve dhe nuk e lëshoi nga dora. Kur ju këput palla e përdori drurin dhe kërciste krandja e dëllinjtë si zhubica në misër, bluante kokën e një zebeku. Në kohën kur një zebek ra plasur pa frymë, Resuli ndjeu që krandja i ishte thyer. Rrëmbeu shpatën e zebekut të vvarë dhe prapë në pallë ... Shpata u hapi shtigjet ...

Birbilenjtë nuk arritën dot të gjithë gjer aty afër çadrës së miriallait ku arriti Birbil Shakua. Nizamët e "Xhedit Taborrit" u sulën mbi të. Rojat e Miriallait e panë dhe i bënë çadrës të miriallait një rreth mbrojtës. Ata, Birbili e nizamët vetëm për vetëm.

Njëzet hapa më përpara, njëri nga Birbilenjtë progonatas vrapoi drejt Gorricës, afër disa çadrave. Andej doli një nizam. Birbili e pa kur ata iu sulën njëri-tjetrit me atë hov e mënyrë që medoemos të vriteshin, l'i hidhnin zorrët njëri-tjetrit të dy në tokë. Ashtu mbetën, të shtrirë në borë. "Sa keq që nuk e njoha tha me vete Birbili për shokun që iu vra. Cili ishte ai? Pruri disa emra në mendje. Asnjëri nga ata nuk ishte, i njihte në të ecur. Atëherë kush ishte?" Ndjeu mpirje të mendjes. U mundua të dallonte çadrën e miriallait. Nuk e pa ... Diçka iu mjegullta.

Zebekët ngjeshën rradhët. I folën të dorëzohej po ai s' dorëzohej i gjallë. Qëllonte e qëllonte. Plumbi i njëres pisqollë e rrëzoi një zebek. Birbili u hodh më tutje. Edhe një plumb tjetër doli prej tytës së pisqollës. Edhe një zebek u plagos. Gjashtë zebekë si gjashtë dema u hodhën drejt e mbi të duke klithur: Allah! Allah! Allah! U goditën me shpata. Sa herë goditeshin shpatat lëshonin shkëndija. Dy herë iu këput Birbilit jatagani. Duke u përleshur me duar rrëmbeu një tjetër më në fund mbeti balëpërballë, fill i vetëm me një zebek. Të dy të shpatës dhe të fuqishëm. U ftonin me tërbim, aq sa pritej nga çasti në çast që Birbili ose zebeku t'i merrnin kokën me tehun e pallës njëri-tjetrit. Do të kishte fituar Birbili por i treti jatagan i këputet. Ai hidhet

sipër rrugës mbi një shkrep dhe humbi në shkëmb në grykat e thella
e në honet pa fund të maleve të Kurveleshit.

*Birbil Shakua furtunë
I'rave shumë, preve shumë:
Tre këllëçe t'u këpunë.
Këndrevica mal me borë
Birbili me pallë në dorë
Gremisi katër taborë.*

XIII

1.

*“U shkretua Labëria,
E mbuloi vaj’e zia
U fut si lugat ordija
Dridhet në bark fëmija.”*

Natën tjetër Miriallai Shahin Hatibzade u kthye në Kështjellën e Progonatit. Në kështjellë ishte më i sigurtë. Kalin e la në avllinë e kështjellës, te ahuri i vogël. E ledhatoi dhe iku. Ai urdhëroi qet’i vinin kafshës të përtypej me zahire.

Dy zebekë që i shërbenin kalit i zuri gjumi. Kafsha hera-herës, sapo dëgjonte zërin e të zotit hingëllinte. Aty nga mesi i natës ata ranë në gjumë. Sapo i zuri gjumi u hodhën nga muri tre Birbilenj. Të tre pragonatas. Ata erdhën aty për të vrarë miriallain Shahin. Nuk mundën. Rojat ua prenë rrugën. Para se të largoheshin u shkrepri të bënin diçka. Njëri nxori jataganin. Dy zebekët që ruanin kafshën heshtën.

- Sus, - u folën Birbilenjtë.

Ata nuk u bënë gjallë. Njëri nga Birbilenjtë me një të rënë jatagani i preu kalit bishtin dhe u largua me rrëmbim. Kur krismat e fjalët mbaruan, zebekët që i shërbenin kafshës klithën.

- Kali! Kali! Jazek! Jazek!

Shahin Hatibzade i foli kalit pullali si të ishte njeri. Kafsha hingëlliu, goditi tokën me këmbë, bëri ashtu siç bënte përherë kur ndjente rrezik! Shahin Hatibzadea u foli rojeve: - Kujdes! Kujdes! - Ai zbriti te kafsha. Ata të dy në kësi çastesh donin të qëndronin pranë njëri-tjetrit. Kafsha s’po qetësohej.

- Çka ndodhur - pyeti Shahin Hatibzadeja i shqetësuar. Kur e pa kafshën të mbytur në gjak u zbraps i trëmbur. Pyeti:

- Kush e bëri këtë?

- Ata, kaçakët - folën njëherësh dy zebekët që mundoheshin t'i lidhnin plagën kafshës. Ishte e pamundur.

Ai ishte dhënë mbas asaj kafshe si të ishte ai vetë. Përkujdsesë për çdo gjë dhe ja, kishte ndodhur ajo që s'duhej të ndodhte. Do të hapej fjala që miriallai Shahin ka një kal shale bishtëprerë. Ç'të bënte? Ajo kafshë i kishte shpëtuar disa herë jetën, kurse ai s'dinte ç'të bënte.

- Turp! - u thirri zebekëve, - ky faj nuk u falet. Ende pa rënë dita e nxorrën kalin buzë shkëmbit. Aty e dyfeqisën dhe i vunë të shtymen, e hodhën në buzë. Kali pullali humbi në thellësinë pa fund të honeve.

Shahin Hatibzadea ndjeu një dridhërim në gjoks, një dhimbje të fortë. Nuk e pati të lehtë. Ju bë se një fat si kalin pullali e priste edhe atë. Ra në mendime. Jo, jo! - foli me zë të brendshëm. Unë s'do të përfundoj në thellësi të honeve që të më hanë trupin shkabat. Më mirë ta lëshoj qafën në tehun e pallës dhe koka ime t'i shkojë Valiut të Janinës në tepsi. Njëqindherë më mirë ashtu. Dhe u kthye në dhomë. Priti gjersa u hap dita, pastaj i shoqëruar nga rojet u drejtua nga kampi.

2.

Shahin Hatibzadeja doli prej çadrës e hodhi vështrimin mbi humnerën e thellë ndërmjet Progonatit e Lekdushit, te guva e shpellës përballë ku hynë Birbilenjtë. Nuk i qe larguar dëshpërimi që ndjeu për kalin. Nuk donte të delte fjala. Ku ishte parë që të bëhej një turp aq i madh një pashai si ai. Një kalë me bisht të prerë! Bah, ku i ka shkuar mendja jezitit të Aliut? Ai u qetësua kur i thanë që Birbilenjtë ishin vënë përsëri në rrethim. Kësaj here jo në Këndrevicë por në humnerat pafund të koanit të Kurveleshit. Donte ta shikonte vendin ndaj doli aty, buzë shkëmbit. Ju duk sikur e përpiu humnera. Një rrënqethje i kaloi nëpër lëkurë. Hodhi krehërat e gjatë në mjekër, jo për të krehur por për të ndukur. Ishte fytyrvërejtur, ashtu si reja e zezë që i qëndronte sipër shkëmbit të Buzëbredhit. Atë shkëmb thinjosh që i qëndron malit si kapuç mbi kokë e vështronte me habi. Ai i ngjante me një kështjellë gjigante. Dukej, që duke ditur dëshirën e madhe të Ali Pashë Tepelenës, ish kaçakut që u bë vezir, për të parë një kala guri të përafërt më Buzëbredhin arkitekti i mori me qyngje malit ujin e

flohtë. Po Veziri u kishte thënë arkitektëve: “E dua të gjithë atë shkëmb ta shoh të vendosur këtu, buzë Vjosës.” Ata e ngritën kështjellën në Tepelenë duke përfytëruar shkëmbimin e rëndë të Gërxfhunit. Edhe Shahin Hatibzadea e zgjodhi me qëllim të caktuar si vendqëndrim Sheshin e Eshtrave përballë këtij shkëmbi. Aty nizamët e zebekët e tij ishin më afër Grykës Jetëshkurtër.

U kthye në çadër. Zymtësi në mal, zymtësi te çadra. E zymtë edhe fytyra e Miriallait Shahin. Me sy të shqetësuar ai shikon dy sinitë e lara në flori që ia dërgoi Pashai ditën që mësoi se Birbilentë kishin dalë nga rrethimi. Ato qëndrojnë aty, në një vend të dukshëm që ai, Shahin Hatibzadeja ti shikojë përherë. I ngjajnë si një thikë e tendosur dhe e drejtuar nga zemra e tij, si një grykë pisqolle e drejtuar te balli i tij. Atë që është nisur nga Valiu i madh Shahin Hatibzadeja s’ka forcë ta ndryshojë. Urdhërin e mori të prerë nga Valiu: “Deri në fund të shkurtit ose më dërgo kokën e Birbil Shakos e të Resul Sejditit në sisinë e florinjët që të dërgova, ose ... “Nuk e thotë Valiu i Janinës atë që kërkon.” Po Shahin Hatibzadeja e kupton. E keqja e ndjek këmbakëmbës. Ajo ka hijen e xhindit dhe të mortajës. E keqja kapërcen çdo pengesë që i vihet përpara, çfarëdo që të jetë ajo gur, dru apo hekur. U përumb.

Donte të pushonte po mendja e dalldiste. I qëndronin pranë shpresa dhe vdekja.

Shkurti ishte muaj me pak ditë ... Numëroi ditët që i kanë mbetur shkurtit. Në ato pak ditë që i kanë mbetur do të luhej drama e tij. Sa herë mendohej hidhte vështrimin te sinitë prej floriri. Aty shikonte fundin e tij të zymtë. Si ndodhi ashtu? Në një kohë të shkurtër, ngjiti të përpjetën pa u ndaluar në asnjë vend, i ngjiti shkallët e jerarkisë ushtarake me rrëmbim. I dukej që me atë vrull që bëri ngjitjen pobënte edhe zbritjen. Fitoi e humbi në një kokë e në të njëjtin vend. E kishte humbur karrierën ashtu si humbet paren njeriu që luan bixhos. Kumarxhiu brënda natës bëhet milioner e gdhin fshesaxhi. Ashtu edhe ai. E ndjen afër hijen e zezë të mortajës. E shikon te shkëlqimi i atyre dy tepsive prej floriri. Hedh vështrimin te ato dhe papritur i kujtohen porositë e Valiut: “Në këto dy tepsi pres të më dërgosh gjer në fund të shkurtit kokën e atyre të dyve (ishte fjala për Birbilin e Resulin) ose kokën tënde!”

Ah, psherëtiu! Do të ishte më mirë të ishte më i gjatë shkurti. Po shkurti, si shkurti, muaj me pak ditë ... Shahin Hatibzadeja ishte

në mendime. Njeri i lëkundshëm.

“Eshtë e pamundur ti vësh në zap këta njerëz. Këtë e ndiej por s’guxoj ta shfaq mendimin. Ndryshe mendoj e ndryshe duhet të veproj. Ankthi është diçka e fshehtë që ruhet te insani, është i padukshëm dhe s’guxoj por ...” Një herë foli, tha: “Dielli ynë ka njolla ... Hëna jonë ka njolla ... Kurani ynë ka” U pendova që fola keq për diellin, hënëën dhe kuranin. “Hejstarfirulla, - thashë, - më largo të keqen nga uxhudi. U bëra pishman për ato që mendova. Gjithë natën nuk më zuri gjumi.” Mendime të tilla mëdyshtëse vërtiteshin në mendje tek shihete ato dy sini që vezullonin mu përpara syve të tij pa “pikën e turpit”. Jetoj edhe me çastin kur erdhën e i thanë: “Ndëre qafën Shahin Hatibzade, të të bjerë koka në tepsin”. Ai nuk kishte hezituar, bëri si i thanë. Koka e prerë do të vinte në xhenet. I dhimbte shpirti. Ai kishte parë në kamaret e një saraji në Stamboll shumë koka të prera. Klithi i trëmbur dhe u ngrit prej shtrati gjithë llahtarsë ... Erdhën rojat. E gjetën me flokë të shkapërdyer. Atij i qenë bufatur sytë.

- Një kafe! - i tha rojes.

3.

*“O Progonati me vulë
Shtatë pashallarë u çkulë,
Për Birbil e për Resulë
Të bënë sa doli ujë”.*

Era e mbushte me frymë grykën e thellë midis fshatrave Progonat e Lekdush. Shahin Hatibzadeja e mbushte atë me kufoma ... Në grumbullin e njerëzve te Sheshi i Eshtrove gjetën gjurmën e djalit të një kaçaku. Miriallahi Shahin urdhëroi dhe e prunë buzë humnerës. Ai u foli, Progonatasve:

- I ati i këtij djali është me Birbilinjtë. I dërgova fjalë, falu jezit i Aliut, falu që të ta fal djalin. Nuk më dërgoi xhevap. Ai, në uxhumin që bënë Birbilinjtë mbi çadrën time, hyri si ezhderha midis “Xhedit Taborrit” dhe u thërriste kaçakavë: “Kokën e Pashait Hatibzade! Kokën e Pashait Shahin Hatibzade!”

- Ma mori të keqen, ja ku jam, s’ka pallë që e pret Shahin Hatibzadenë. S’ka plumb që më vret. Duhet të vriten gjithë nizamët dhe zebekët e mi që të vritem unë, o Progonatas!

Dha urdhër:

- Djali i kaçakut të fshehur në shkëmb të gremiset. Kështu e kam vrarë atë përsëgjalli.

Dy zebekë e prunë djalin te shkëmbi. Dha shenjë e foli me zë:

- Të hidhet në shkëmb.

- Mos, mos! - thirri e ëma nga mezi i turmës. Ajo çan përpara të arrinte aty. Djalin e lëshuan në shkëmb.

Fëmija nuk bëri of. Asnjëri nga ata që bëhet "kurban" te shkëmbi nuk bëri of. Thërret nëna e djalit:

- Egërsira! Egërsira! - Dhe përleshet me çaushin e zebekëve që gremis njerëz në buzë. E tërhoqi drejt buzës atë siç rrëmben shqiponja në kthetra gjarpërin.

Dhe të dy i përpin humnera ...

- Një tjetër thirri Miriallahi.

Ai ishte burrë i moshuar. Ishte kapur duke u çuar bukë Birbilenjve. Atë e lëshuan në humnerë.

- Askoshun evlat, mburri Çaushin.

- Më lësho një tjetër ... Edhe një tjetër ... A, po kybukurosh kush është?

- Babai i atij jezitit, babai i Resul Sejditit.

- Ashtu! Lëshojeni në shkëmb.

Kjo skenë përsëritej e përsëritej vazhdimisht.

4.

"O ju të shkretet çaskënë

Shkurti ua prishi takëmë

U hodhi borë të rëndë".

Kur çanë rrethimin e parë çeta e Birbilenjve u nda në tri pjesë. Zhulatasit shkuan në malet e tyre, Myrto Dukagjini në Prroin e Thellë të Dukagjinit, në Golem, Niviciotë në malet e tyre në humnerat poshtë Shpellës me Qiell, kurse dymbëdhjetë luftëtarë Progonatas në humnerat ndërmjet Progonatit e Lekdushit. Komandanti i çetës Birbili shkoi me Progonatasit. Ditën tjetër dymbëdhjetë birbilenjtë Progonatas dhe Birbili e ndjenë veten më të qetë nga ndjekjet e nga stuhia. Aty hynë në shkrepë të thella të padukshme për zebekët por me rrezik rrethimi. Ishte borë dhe mbas u kishte mbetur gjurma.

- Duhet të lëvizim prej vendit, të humbasim gjurmët hall-dupëve.

Ata, ditën tjetër, herët në mëngjez shtegtuan nëpër shkrepa. Ata i shikonte syri i zebekëve por nuk i arrinin plumbat. Shahin Hatibzadeja i afronte ata me syrin e dylbive.

- Ikën! Për allah po ikin! - tha.

Po u befasua. Papritmas trembëdhjetë birbilenjtë u ndalën në vend.

- Aha, s'ka shteg më tutje, i përpiu humnera, s'kanë ku shkojnë - foli një çorës vendas.

Miriallait iu rikthye shpresa. Kurse në shkrep thuheshin të tjera fjalë. Birbilf thoshte:

- Përballë na pret humnera, mbas pushka, E provojmë!

Ecën nëpër humnera. Shkelnin aty ku nuk shkelnin dot zorqethë.

Miriallai fliste:

- Zhinde, për Allah, xhinde!

Birbili ndaloi te Shtegu i Provës. Përpara humnera! Qëndruan si të shtangur. Frika qëndronte pezull. Humnera ishte e thellë dyqind metra ..., treqind ..., katërqind ... mbase edhe më shumë. Hodhi për kalim drurin ajror, që sapo e kishin prerë. Druri ajror bashkoi dy anët e humnerës.

- Do të jetë turp të gremisemi - tha Birbili. - Ndryshe është kur të pret palla e zebekut, - dhe i pari, ai, me rrëmbim u hodh në anën tjetër.

U mbërthye në shkrep si mace e egër me sy të ngulur te humnera. Qëndronte i shtangur, i ngurosur dhe me ankth. A do të mund të kalonin të tjerët?

I pari pas Birbilit shkeli mbi drurin ajror Resuli. Ai kishte trup sa për dy të tjerë. Druri ajror u përkul më tepër kur kaloi Resuli por edhe ai u hodh përtej. Pas tij një tjetër. I shkurtër po burrë gjoksgjerë me peshë. Edhe ai kapërxeu.

- Mos e shiko humnerën - i folën më të vogël.

Birbili i buzëqeshi djalit. Djali ishte mësuar të ecte mbas gjurmës së tyre. Çdo hap që hedhin ata i afron nga vdekja. Djali s'do ta dijë. I pëlqeu të ecë pas hapit të trimave.

- Bukuroshi i Totos - i foli Birbili sapo djali e kaloi humnerën dhe i ledhatoi flokët.

Djalit i ndritën sytë ...
E hoqën druri ajror dhe e hodhën në humnerë. Tani për zebekët humnera ishte e pakalueshme.

5.

Shpella në Çoçko të Lekdushit, ku u strukën ditët e fundit të shkurtit Birbilentë, është e ftohtë. Midis saj disa pllaka guri sa një vatër, ku ndizet zjarri. Rreth vatrës hiri ka mbetur grumbull, i ngopur nga lagështia e dimrit. Tre ditë e tri netë u strukën aty. Zjarr nuk ndezën. Përgjohej drita dhe tymi. Ngroheshin me frymën e tyre. Ishin të zalisur për bukë. Malet u rënduan me borë të re dhe të rëndë. Kishin ngrirë kallkan. Në mengjes herët, Birbili doli në hyrje të shpellës dhe e hodhi në fillim vështrimin ballas te humnera e më pas akoma më lart te Sheshi i Eshtrave¹. Për rreth kudo shkëlqim akulli ... Edhe në hyrje të shpellës ku doli ai vareshin hoje akulli. Birbili eci disa hapa më përpara dhe u ndal te një gur. U befusua kur pa një lule të bardhë. Ja nguli vështrimin lules mbi petale. Çdo gjë ishte e bardhë, e ngrirë. Edhe palët e fustanellave të tyre qenë ngrirë. “E lulja mos është diçka e ngrirë dhe me shkëlqim të rremë?” - mendoi dhe u përkul që ta shikonte më mirë njomësinë e lules. Bima e kishte mposhtur ngricën, ajo kishte shpërthyer me petale të shtrira anash ...

- Lule! Lulja e borës - u tha shokëve Birbili i ngazëllyer.

- Kur del Lulja e borës merr tatëpjetë dimri - foli Resuli i Progonatit. - Është afshi i dheut që e ngroh lulen. Lajmëtarja e pranverës na jep zemër të qëndrojmë. Edhe pak ditë do të jenë me dimër - përfundoi Resul Sejdini.

- Një dimër si ky është mortje e vërtetë.

- Ashtu është. Edhe për këtë lule moti është me ngrica e i ftohtë, por ajo gjeti fuqi dhe i bëri ballë dimrit të madh, e mposhti ngricën dhe doli në jetë. Edhe çeta jonë kështu është, ja si kjo lule që sfidon dimrin dhe shpërthen. Edhe ne sfidojmë dimrin, valiun e dovletin ...

- Ndryshe njeriu, Birbil. Bima e ka rrënjën në tokë!

1) Në kampin e ushtrisë të Miriallait shumica vendosej i veçantë reparti i thyerjes së eshtrave. Aty bëheshin të rënda e të padurueshme. Ky vend u quajt nga vendasit “Sheshi i thyerjes së eshtrave”

- E ne, ku e kemi rrënjën ne? - e pyeti Birbili atë që foli.
- Ai që foli ndjeu që fjala e tij zuri në boshllëk.
- Në një vend e kemi trungun dhe rrënjën por ajo thith ushqim kurse unë vështroj qiellin, - bëri shaka një tjetër.

6.

Birbilent' e kanë shtëpinë Te shkëmbi në përcëllimë

Birbili e kishte bërë zakon që sa herë çeta qëndronte në shpellë, zinte vend në afërsi të hyrjes. Edhe në shpellën Çoçko ashtu bëri. Shtroi thrumet mbi një rrasë të gjatë guri dhe hyri nën gunën e rëndë.

- Këtu jemi si në sarajet e Valiut të Janinës - tha njëri nga luftëtarët.

Ata kishin hipur nëpër vende të thella e të ngrohta. Aty, vetëm aty, u pushuan veshët nga era e zhurmshme. Thëllimi ishte më i pakët me shpellë. U gatitën për të qëndruar aty deri në pranverë. Në pranverë del gjethi dhe lehtësohej lëvizja e kaçakëve. Pranvera është stina e kaçakëve.

U mblodhën në gunat e ngrohta e rrallë këmbenin fjalë. Tre ditë mbas arritjes te shpella Çoçko, te shpati përballë shpellës u rrokullis një lëmsh bore. Ai ra me rrëmbim gjer afër hyrjes së shpellës.

Nga "lëmshi" prej bore që ra përballë shpellës përpëlitej një qënie e gjallë. Birbili e vuri në shenjë.

- Egërsirë do të jetë - mendoi.

U befasua kur pa që ai ishte njeri.

- Mos qëlloni - foli njeriu që u shfaq papritmas nga lëmshi i borës.

Ata nuk mund të qëllonin se krisma e pushkës i zbulonte.

- Më dërgoi babë Budua - tha ai.

Birbili e njohu. Ishte njëri nga nipat e Budo Bredhit. Ai pruri bukë dhe lajme. Birbili lexoi ato ç'ka i shkruante Budo Bredhi. Njoftoheshin Birbilentë se kishte filluar të vepronte Reparti i thyerjeve së eshtrave. Reparti i thyerjeve së eshtrave, çdo ditë, një burrë e linte ulok të përjetshëm. Njerëzit preferonin më parë hedhjen në humnerë se sa t'u nënshtroheshin goditjeve të Repartit të thyerjes së eshtrave.

Birbili, edhe pse ishte i uritur nuk mundi ta kapërcente

kafshatën e bukës. I dhëmbi në shpirt.

- Eh! - psherëtiu - kjo është e padurueshme, e padurueshme!

Në një njoftim tjetër shënoheshin emrat e njerëzve që me urdhër të Valiut u përcollën në Janinë. Ishin marrë nga çdo fshat pesë burra. Ky lajm e shtangu edhe më shumë Birbil Shakon. Dhe së fundi, një njoftim nga Janina. Thuhej se Valiu kishte dhënë porosi që nga pesë burra të mbledhur nga çdo fshat, katër do të sikteriseshin në Konjën e largët, kurse i pesti do të mbahej peng për t`u bërë kurban për Birbilenjtë. Birbili, mëmëriti:

- Kjo është poshtërsi.

Thuhej se Valiu kishte thënë: "Arbërit e harruan Manastirin"

Kur Birbili mësoi që Hysni Pasha i mbante peng të gjithë burrat e Tërbaçit dhe kishte lëshuar fjalë se të parët që do të kalojnë në satër do të jenë burrat e këtij fshati u rëndua edhe më shumë nga dëshpërimi.

- Kjo s`duhet të ndodhë - tha dhe e goditi rrasën e gurit, ku ishte mbështetur, me forcë. Pëllëmba e dorës iu gjakos. Nuk tregoi asgjë. U mblodh e u bë sa grushti. Mbuloi kokën dhe qëndroi në heshtje.

Jetoi një kohë me ditët që Birbilenjtë i kaluan në shpellën e Tërbaçit. Shpella e Tërbaçit, që gjendej në krye të fshatit, për vite me radhë, ishte bërë jatak i Birbilenjve. Ajo qe bërë si shtëpia e tyre. Kjo shpellë ishte aq e padukshme sa dhe e pabesueshme që aty të ishte një shpellë e madhe. Nuk lëshonte asnjë pikë ujë. Ishte e ftohtë në muajt e verës dhe e ngrohtë në dimër. Por, në rradhë të parë, ishin fshatarët e Tërbaçit ata që kishin urrejtje të thellë për osmanët dhe respekt e dashuri për Birbilenjtë që kishin ngritur krye.

Në Tërbaç, para disa kohësh, kishte ndodhur një gjëmë e madhe. Nga 95 djem, që kishin shkuar nizamë në Ordinë e Shtatë, vetëm pesë ishin kthyer të gjallë. Të nëntëdhjetë të tjerëve u kishin ardhur kartat e djegur. Fshatin e kishte mbuluar ulërima. Njerëzit ishin bërë sikur u kishe hedhur mavrinë. Dhe ja tani vrasje të tjera pritëshin të bëheshin nga Valiu i Janinës. Me këtë veprim ai i bënte jehonë krimtit.

Kur u rrëmbyen nga zebekët burrat e Tërbaçit, Birbilenjtë ishin në shpellën mbi Përcëllimë. Çeta e Birbilenjve, për t`u lehtësuar

1) Aludohej që në Janinë të bëhej një masakër e madhe si ajo e Manastirit.

dhëmbjen Tërbaçasve, doli nga shpella dhe luftoi me zebekët e ardhur. Pas kësaj çeta zbriti në vende më të buta dhe pa borë.

Birbili enkas e bëri këtë lëvizje për të humbur gjurmët e për t'i lehtësuar Tërbaçasit. Por Valiu zemërzi nuk lëshoi pe. Fjalët që flitëshin në Janinëse Tërbaçi do të përjetonte dhe një herë tjetër gjëmë e shtynë të merrte vendimin fatal. Atë çka mendoi nuk guxoi t'ja thoshte as Resulit me të cilin shprehej për çdo problem. E bluajti në mendje tërë natën. Sa herë iu rikthye vinte po aty, te ajo që kishte vendosur të bënte.

Ç'kishte vendosur të bënte Birbil Shakua?

7.

Ditën tjetër, ende pa zbardhur dita, Birbili doli në hyrje të shpellës. Mbushi çibukun me duhan dhe shkrepri hurrarin, i dha zjarr eshkës. Në agim honet dhe shpellat oshëtinë nga ortekët që bien dhe zhurma e ujëvareve.

Bum, bëri topi i vendosur te sheshi i Eshtrave përballë shpellës së Çoçkos ku qëndronin të fshehur trembëdhjetë Birbilenjtë. Birbili e dëgjoi krismën dhe i pa flakën. Gjylia fishkëlleu e si një mëllënjë e zezë mori drejtimin e anës tjetër të humnerës në drejtim të Birbilenjëve. Gjyles iu shua fuqia rrugës dhe ra në humnerë.

- Ehë ta përmjerrë miriallai topin "Shahin"! Na, na, iu sos fryma rrugës dhe ra në përrua, - foli një nga të dymbëdhjetë Birbilenjtë Progonatas.

Bum, bëri sërish topi.

- Prëç - tha Resuli ...

Birbili nuk foli. Ai, i mbështjellë nën një, vazhdonte të bluante mendime. Ishte i dëshpëruar se bëheshin përditë vrasje e internime në Konjë. Burgu i Janinës u mbush me burra të Kurveleshit. Këto e hodhën Birbil Shakon në mendime të rënda. Nuk ishte gjë gjëmimi i topit, s'qe veçse një hiç vuvurima e erës së grykës së thellë, para asaj dallge ere që e rrëmbeu gjoksin dhe mendjen e Birbilit. E thithi çibukun si i babëzitur me sytë të ngulur te sheshi i Eshtrave ku ishte kampi i zebekëve.

- Ngadalë se i vure zjarrin shkëmbit, - i tha Resul Sejдини.

Fjala nuk e përmendi Birbilin. Ai qëndron i heshtur.

- Ç'ke kështu sot, mos je sëmurë? - e pyeti Resul Sejдини i

shqetësuar nga trazimet që shikonte në sytë e shokut.

- Jo vëlla Resul, jo!

- Më trëmbe, si je zbehur kështu në fytyrë. Ç'farë të mundon kaq shumë? Të qëndrojnë sytë hapur si sytë e kaut që ka përpara ujkun.

- Më duhej sot Imami Budo - foli Birbili.

- Përse?

- Ky operacion po zgjat pa fund. Masakra si këto që po u bëhen vëllezërve tanë të rrënqethin mishtë. Mallin e gjënë e kanë bllokuar, mullinjte nuk i lënë të punojnë. Shtigjet të gjitha të zëna. U bë e padurueshme jeta për njerëzit. Ku është parë të bëhen thyerje eshtrash si kësaj here. Është e udhës t'i lëmë të priten Tërbaçasit për sebebin tonë? Do të duhej të bënim diçka. Të bënim atë që do të ishte e pëlqyeshme për njerëzit.

Foli fjalën dhe ia nguliti vështrimin Resulit.

- Çfarë? - pyeti Resul Sejdini.

- A është mjaft koka ime dhe tuaja për të qetësuar gjëndjen? Fjala e shtangu tjetrin. Një çast ai heshti, pastaj foli:

- Të shkojmë vetë në satër? Çdo të thonë njerëzit? U trembën

dhe ...

- Të shkosh i vetëdijshëm drejt vdekjes nuk është e lehtë.

Askush nuk të merr për ful.

- Edhe për trim, - jo.

- Në këto kushte dorëzimi ynë është bërë domosdoshmëri. Kjo ekspeditë po bën dëme të pallogaritshme. Në emër të zbrapsjes së ligësisë duhet të flijohemi ne të dy. Vetëflijimi ynë dhe t'u shërbejë vëllezërve e motrave tona.

Resuli e kundërshtoi.

- Dëgjo vëlla, e kam blojtur gjatë këtë mendim. Një fuqi e fortë, më e madhe se vullneti im i hekurt, më shtyn drejt vetëflijimit.

- Ç'është kjo brengë, o Birbil i maleve.

- Malli për njeriun është tej shpirtit. Shahin Hatibzadeja po e shtyp njeriun, nxorri ujë të zi, mbjell vdekje. Mirësitë që kanë bërë njerëzit për xhemidijen tonë lypset tu kthehen.

- Si, duke u vrarë?

- Kur duhet pse jo! - Eh, vëlla Resull, e shikon që hija e vdekjes ndjehet kudo. Shahin Hatibzadeja ka mbledhur parinë e kazasë dhe e dërgoi në Janinë. U mbushën bodrumet e Janinës me burra të Labërisë. Flitet që Pashai i Janinës do të bëjë gjëmë si ajo e Manastirit.

Ordija djeg, Pashai i Janinës vë në satër vëllezërit tanë. Mallin e gjënë e rrëmbejnë zebekët. U shkretua vendi. Shkurti hodhi borë të rëndë ... Pashai i Janinës e kërkon kokën time dhe tënden. Ai beson se duke më shtënë të gjallë në dorë do ta shtijë në dorë floririn që shpërndamë. Ai kujton se duke na vrarë ne të dyve do ta shuaj qëndresën.

Fliste Birbili, kurse Resuli heshtëte. Ai u shndërrua në një copë shkëmb, i ftohtë si akulli.

- Përse hesht? - e ngacmoi Birbili, - të duket e rëndë?
- Mendohem o Birbil shpirtmadh. A mos nuk duhet ta bëjmë atë që thua? Çdo të thonë të tjerët?

- Kush?

- Vëllezërit tanë, kush tjetër.

- Mendoj se fuli nuk shkon vetë me këmbët e tij në satër.

Njerëzit do të kuptojnë se halldupët një jetë të tërë të na vihen prapa s' do të mundin të na kapin. Po dhunimet, ato çka bëjnë e pritet të bëjnë janë me peshë aq të rëndë që na bëjnë të vendosim ... Hë si thua?

Resuli heshti. E blojti gjatë fjalën. Më në fund tha:

- U bëftë jotja o Birbil shpirtmadh dhe i dhanë dorën njëri tjetrit si atë ditë që u takuan në fillim, kur i thanë njëri tjetrit: "Besa besa do të luftojmë". Po ashtu edhe kësaj here: "Besa besë do të vdesim bashkë!"

Kur u njoftuan mendimin që morën Birbilenjve të tjerë ata nuk e pranuan. Në pamundësi të ndryshohej ajo që u vendos edhe njëmbëdhjetë Birbilenjtë e tjerë prigonatas vendosën të shkonin mbas gjurmës të dy kryetrimave.

8.

Dije turçe dhe nuk fole Me terxhuman kuvendoje.

Të vetëdijeshëm në mëngjezin e ditës tjetër ata, u nisën drejt vdekjes. Ecnin në heshtje. Ishte një vendim i përbashkët dhe askush nuk kishte në mend të bënte ndryshe ... Të gjithë me vështrim te kampi. Të gjithë ecnin në një hap. Hapat e tyre të rëndë. Topi "Shahin" i mbante në shenjë. Miriallai sapo mori lajmin e papritur doli me rrëmbim nga çadra e vuri dylbinë në sy ti shikonte. Ata të trembëshjetë ishin afër. I numëroi një e nga një. U dalloi veshjen e

armët. U foli zebekëve:

- Mos i lerni të afrohen me armë. Kujdes evlatër?!

Shahin Hatibzadenë e mbyti gëzimi. Endej si i delur nëpër shesh, priste me padurim afrimin e Birbilenjve. Ndërkohë, i frikësuar u foli përsëri shokëve të tij:

- Bëni kujdes, bëni kujdes! Hejstarfulla, mos është ndonjë dredhë e jezitëve?

Kur u hodhi në këmbë e në duar prangat, urdhëroi të zbrazej dymbëdhjetë herë topi Shahin. Ndjente krenari që mbante emrin e topit.

Lajmi mori vrapin e erës që ta mësonte Valiu ...

Miriallai hodhi vështrimin mbi ata të trembëdhjetë. Ai ndjeu frikë. Nuk guxoi t' u shkonte më afër. Gëzimi e frika bashkëjetonin te ai në një kohë.

Pyeti:

- Ua keni hequr armët? I keni lidhur mirë nga duart e këmbët me pranga?

Kureshtja e shtinte të shikonte një e nga një fytyrat e tyre. Ndaloj disa hapa para fytyrës së Birbilit.

- Si të duket?! Më në fund t' u sos vaji i kandilit o Birbil Shako!
- i tha.

Hodhi dorën te mjekra. Ndjeu gjurmën e plagës që i kishte lënë vite më parë jatagani i Birbilit.

- Halldup i ndyrë. - foli Birbili. Pështyma që i lëshoi nuk arriti gjer te Miriallai.

Miriallai e solli ndryshe fjalën. Birbili foli fjalë të sërta.

- Nuk të kuptoj. Folmë turqisht. Në mos gabohem ju edhe e flisni edhe e shkruani gjuhën turçe.

- Kam gjuhën e nënës, më pëlqen të bisdedoj vetëm me gjuhën e nënës o zebek i ndyrë.

- Terxhuman - foli Miriallai.

Këmbejnë fjalë. Miriallai endet rrotull para fytyrës së burrit të lidhur, e ngacmon.

- Ç` të pengon të flasësh turqisht?

- Nena ime, Arbëria, ajo do që unë të flas. të kendoj e te qaj vetëm në gjuhën e Arbërit.

- E përse?

- Sepse ky vend është shkelur shpesh nga të huajt, por kanë

ardhur dhe kanë ikur, kurse shqiptari duron, qëndron si guri dhe s'ka mort. Ja, ka mort shkëmbi?! Ka mort lisi në shkrep? - dhe hodhi vështrimin te shkëmbi e pastaj te lisi.

Miriallai Shahin afrohet, mundohet që të mos duket bishë në vështrim, por sytë e tij s'ndryshojnë. Ata mbeten sy me rrema gjaku, nuk janë më të bardhë, por gjak të kuq ... Ai s' duron, i lëshoi kthetrat në drejtim të kaçakut. I foli me zë kërcënues:

- Trego, ku e keni thesarin që rrëmbyet? Nuk e tregon? Do t'u mbërthej me goxhdë ... Do t'ua pres mishin me thikë, do ua pjek mishin me kripë, flisni! Për allah që është një do të të pikoj me dhjamë dashi e do të vë në hell, të piqesh si Çausi i Hormovës nga vezir Aliu.

- Nuk më trëmb. Edhe ajo e ka emrin vdekje.

- Bën mirë të thuash sa pa të prerë atë gjuhë.

- Ç'të them? Të qortoj veten që si dhashë me forcë krahut në vitin dyzeteshtatë për tu ngrënë korbati me Grykën e Kuçit?

- Ku janë Birbilenjtë e tjetër, o xhind i prroit?!

- Mos u mundo, nuk e shikon dot syri i halldupit fluturën e shkëmbit - foli Birbili.

- E sheh syri yt, o ujk i shkëmbit, e sheh!

- Edhe në shoh s'më pëlqen të tregoj.

- Hesht ujk! ngordh aty, ngordh! Në dorë të kam, ja këtu në grusht - zgurdulloi sytë Shahin Habitzadea dhe lëvizi gishtat e gjatë si sfulq.

- Si? Shqiponjë the? Fjalën shqiponjë e solli përtushëm nëpër buzë nga që iu kujtua ai zogu që kishte kapur kur ishte i vogël dhe e mbante në grusht, po sapo e hapi dorën zogu fluturoi dhe kishte mbetur i zhgënjyer. E mbante dorën të mbledhur grusht. E shtrëngonte fortë.

- Shqiponja nuk është rabeckë, Mirialla! - i foli Birbili.

Lajmi me vrapin e erës shkoi të valiu. Dhe valiu i gëzuar dërgoi haberë:

Gjarpërinjtë që fërshëllijnë

M'i dërgoni në Janinë

Do t'i pres e do t'i grijë.

XIV

1.

*“Janinë e zeza Janinë
Del të shikosh kush po vijnë,
Vjen Resuli me Birbilë
Që nderuan Shqipërinë”.*

Ditën e fundit të shkurtit të vitit '57, në hyrje të Janinës te rrapi i madh, në anë të qytetit, kaluan katër suvarinj. Mbas vinin suvari të tjerë. Rrapi i Janinës quhet “Rrapi i Kaçandonit”.

- A mos edhe unë jam një kaçandon? - tha Birbili. - Jo! Më pëlqen të quhem kaçandon. Po Kaçandoni vdiq në litar, kurse unë do të tretem nga pika e ujit në kokë. Kaçandonit grekërit i këndojnë këngë të bukura.

Birbili e ndjen që edhe gjurmën e tij e ndjek prapa jehona e këngës. Nuk i ka harruar asnjëherë Arbëria bijtë e saj. Aq sa thellë i humbet i huaji, aq lart e ngre kënga.

Trokthi i kuajve të suvarisë nuk tërhoqi vëmendjen e njerëzve. Sokakut të zilepunuesve të Janinës kalonin me tërsëllimë shpesh suvarinj dhe njerëzve nuk u bëri aq shumë përshtypje trokthi i këmbëve të atllarëve. Tjetër e nxiti kërshtërinë e janinjtëve. Mbas kalit të suvariut ishte lidhur një njeri. Njeriu mundahej të ecte shpejt që të mos rrëzohej. Fjala se çdo suvari binte një njeri të lidhur nxiti kureshtjen që njerëzit të dalin e të shikojnë. Në krye të patrullës ishte një çauash. Fill mbas tij, robi i lidhur pas kalit.

- Kush është ky? Nga është?

U mësua që ishte kryengritës. U mësua që ishte Arbër. U mësua që ai ishte kaçaku i maleve, Birbili. Në Janinë u ndez kureshtja ...

Birbilit i kanë hedhur zinxhirë të rëndë hekuri në këmbë e në duar dhe e tërhiqnin me litare mbas kalit. Ai trupin e mbante drejt.

I hidhte hapat ngadalë e rëndë. Zinxhirët i hiqeshin zvarrë. I kanë rënë flokët sipër ballit, mjekra i është shkapërxyer, vetullat e trasha i qëndrojnë të shtruara, hunda midis dy syve e kthyer me kurriz si sqep shqiponje. Çapitet rëndë, i është zërtthyer xhamadani dhe i duket gjoksi leshtor.

- Shimpaze, për allah shimpaze! - tha çaushi i patrullës së koshadhes që ecte mbas kalit që mbante të lidhur Birbilin. Çaushi ju akërrua:

- Ec shimpaze, ec!

Birbili për të mos u rrëzuar eci më shpejt. Trokthi i kuajve u dëgjua më i rëndë mbi kalldrëm. Hapi i Birbilit më i rëndë se gjurma e kalit. Ai mundohej që të mos rrëzohej. Nuk donte ta shihnin njerëzit që të rrëzohej e të pengohej mbas kalit. Ecte e trupin e mbante drejt. Mbas tij Resul Sejдини vetullngrysur e syrreptë ecte me pranga të hedhura në këmbë e duar. Në radhë të gjithë. Edhe më i vogli i lidhur në pranga.

- Edhe pak e arrijmë te xhamia e vezirit - tha me vete Birbili.

Shikoi minarenë e gjatë. U dukën sarajet e Vezirit. Rrapi degëgjërë. Kështjella më tutje ... Edhe pak edhe ai do të ndodhej brenda në birucat e kështjellës. Ishte nizam i arratisur nga Ordija e Shtatë. Do ta mbanin në qeli. Aty do të tretej, do ti pikojë në kokë pa prerë një pikë uji. Ajo është mjaft për të tretur njeriun. Dhe ata të tjerët, të dymbedhjetë mund të dënohen në një kohë me goditjen e pikës së ujit në sheshin e kokës. Kanë vënë dorë mbi thesarin e dovetit. Kush i prekte valiut të Janinës lirën i shpon neshteri në zemër, Birbili e din që Valiu do t'ua kërkojë thesarin. Po paret e rrëmbyera nga çeta s' do të gjëndeshin kurrë, ato ishin shpërndarë në tërë Vilajetin e Janinës. Të gjithë do të tretemi nga pika e ujit në kokë - tha zemërdhembshur për shokët. Dëgjoji zërin e Çaushtit:

- Ec shimpaze, ec!

Kështjella e Janinës ka shumë qeli ku kryhej dënimi me pikën e ujit në sheshin e kokës. Një është dënimi i nizamit të arratisur me të kaçakut. Pikën e ujit në kokë ose litarin. Gjyqi është i prerë për kryengritësit. Kryengritësi vdes në bodrumet e lagështa të kështjellës nën një pikë uji, dënim i veçantë ky për nizamën që arratiset dhe për kryengritësin. Pika e ujit e shpon gurin. Pika paprepë në kokë nuk durohet ... Asaj i trëmbej Birbil Shakua. Nuk do të jem në gjendje të qëndroj, njëqind herë më mirë litari - tha me vete. Dëgjoji zëra. Disa

zebekë i folën çaushit të koshadhës.

- Ç'e ke atë mjekërosh, çausht aga.

- Shimpaze arabistani - tha çaushti, mburravec.

Birbili u zbeh nga tallja që ju bë. Mbas tij vinte Resul Sejdini. Janinjtët nuk dinin ta krahasonin shtatin e lartë të Resultit me një tjetër. Birbili dëgjonte tingëllimin e prangave që vërviteshin nëpër këmbët e Resultit. Ai ecte pa e kthyer vështrimin pas. E ndjente hapin e Resultit, e përfytyronte pamjen e shokut të tij. Asnjëherë nuk e kishte parë Resultin të ligështuar. Ata, Birbilenjtë e tjerë, vinin në varg. Të trembëdhjetë të lidhur me pranga të rënda në këmbë e në duar. Ecnin në varg.

- Myshteria im - foli greqisht një zilepunues, kur pa njerin nga birbilenjtë progonatas, një alamet djali të lidhur me pranga. Ai vinte fill pas Resultit.

- Mavrua ai - tha greku i pikëlluar - i donte zilet të kurdisura, me zë të ëmbël. Çfarë qejfliu i madh ishte pas zileve. Pyeti përse e kanë vënë në pranga?

- ...?

Ata i kaluan nëpër sokakun e bakërpunuesve dhe të hekurpunuesve. Miriallai Shahin Hatibzadeja printe në ballë. Kur kalonin ata sokakët binin në heshtje. Dëgjoheshin vetëm tingujt e rëndë të zinxhirëve. Ata të trembëdhjetë. Në mes të tyre ishte edhe i vogli. E kjo ngjallte te Janinjtët respekt për kryengritësit dhe urrejtje për zebekët pushtues. Ajo ngjante me diçka të organizuar. Kaloheshin sokakëve që ti shikonte Janina Birbilenjtë të mbërthyer me pranga.

Në ballë të vargut ecte Birbili, në fund vocua i vogël. Si ishin ashtu ata, të trembëdhjetë si njëri tjetri, me shtat të bukur, çepedredhur. Birbili ecte i menduar. Përse mendonte? Për vdekjen apo për diçka tjetër. I kujtohej dita kur e kishte parë për herë të parë Janinën e madhe, Janinën e bukur! Atëherë në vitin dyzeteshtatë, kishte ardhur kaluar së bashku me pjestarë të tjerë të taborrit kryengritës të Budo Bredhit. Prita e asgjësoi patrullën osmane, i ndoqën gjer te ky rrap i madh ku qëndronte përherë i varur litari ku Valiu mbyste armiqtë e hyqymetit. Aty Budua i ra me tërë fuinë e krahut, preu litarin e lyer me dyllë. Dhe thirri:

- Do ti soset vaji i randilit edhe Valiut të Janinës. Do të bjerë Janina. Po Janina nuk ra.

Erdhën kryengritë: it në portat e Janinës dhe u tërhoqën.

Kryengritja dështoi. Pema ishte mbjellë. Ajo kërkon përsëri të ujitet. Ata të trembëdhjetë e njomën me të bëmat e tyre, me gjakun e tyre të kulluar. Ata e ndejnë që me të bëmat e tyre mbjellin trimëri. U pëlqen ta shikojnë vdekjen në dritën e syrit dhe ecin krenarë.

Kur po i afroheshin kështjellës dredha e rrugës e pruri që Birbil Shakua ta shikojë afër djalit e vogël. Trembej se atë mos e lëshonte zemra. Po djali ecte me po atë qendresë sa edhe të mëdhenjtë.

- "Voco! Voco, o trim i Totos?!" - i foli ai.

Njerëzit panë që trimëria dhe qendresa e maleve të Labërisë parakalonte nëpër sokakët e Janinës. E hapte kollonën e Birbilenjve më burrërori i tyre Birbili dhe e mbyllte një vogëlush me sy të bukur me një cullufe të gjatë floku që i binte në mes të ballit. Sa herë ia shikonte Vocos të vogël atë cullufe balli Birbilit i kujtoheshin vitet e vegjëlisë kur nëna Sorkë i tha:

- Cullufja u duhet trimave o bir'i nënës. U duhet që dushmani të mos e ndyjë fytyrën e kokës së prerë. E shihte vogëlushin të ecte kryelartë. Ai ndjeu madhështinë e qëndresës. Ajo, qëndresë e mban gjallë Arbërinë.

- Mjerë burri që i përpëlitet vdekjes - mërmëriti Birbil Shakua. Hodhi edhe një hap tjetër në drejtim të kështjellës burg. Hapi i tij kumboi: Tring! Tring! Kush trëmbej? Birbilenjtë para vdekjes apo vdekja para Birbilenjve?

2.

"Të xhumanë atë ditë

Ja - Janin-o,

Janinës ç'i panë sytë

Ja - Janin-o".

Janina shikonte ... Janina dëgjonte. Ishin ditë me drithërima. Mbeti koha jehonë në këngë: "Janinës ç'i panë sytë".

Oshëtinë në kështjellë topa... Me të shtëna topi i dhanë lajmin Janinës:

"U kapën Birbilenjtë! U kapën Birbilenjtë!"

Me të shtëna topi u rikthye në kazermë "Xhedit Taborri" dhe gjithë kosharët e zebekët. Urdhëroi Valiu:

- Ta presë Janina "Xhedit Taborrin" me hosana.

- Ta presë Janina me hosana Miriallain Shahin.

Rrezet e diellit ranë pjerrtas mbi kaltërsinë e liqenit. Edhe mbi Janinën zhurmëmadhe binin rreze dielli, por ajo ndiente vazhdimisht të mbardhur. Kishte ngrirë kallkan Janina ...

3.

Birbil Shakua jetoi me vite në errësirën e shpellave e të guvave por ajo, errësira e birucës është tjetër soj. Ajo është më zi se nata e zezë. I djegin sytë për pak dritë. Ai s'mund të jetojë pa dritë dhe pa bardhësinë e maleve. Humbi në kujtimet e jetës si kaçak. Eci mendja e tij mbas gjurmëve, larg ... larg në malet e vendlindjes.

Ende i shfaqej ndër sy fytyra e komandantit të "Xhedit Taborrit" që e përcolli gjer në mbylljen e derës të qelisë. Qëndroi aty në këmbë mes errësirës e qetësisë së plotë. Dëgjoji çapin e rojës që afrohej. Diçka bëri krrëk në derë. U hap një dritare e vogël, një dorë hyri brenda kamares së portës, la një copë bukë dhe kamarja u mbyll me rrëmbim. Dëgjoji hapat e rojes që u largua në drejtim të qelive të tjera.

Ai mendoi për shokët.

Ç'ishin duke bërë ata?

4.

*"O Birbil ç'e bërë mirë
Që kur preve turçelinë,
Me grusht e ndave florinë ..."*

Si luanin, që e mbyllin në kafaz hekuri, ashtu e kishin mbyllur edhe Birbilin. Ende më këmbë. Nga jashtë s'arrinte as dritë e as zë. Një dritare e ngushtë që me vështirësi merrte grushtin e tij sjell në qeli ajër me atë masë që i duhet njeriut për të jetuar. Nga jashtë vjen vetëm një copë bukë, hyn një reze dritë dhe ... Nga jashtë hidhet nga brima e derës ushqimi dhe prapë kafazi i vogël mbyllet me çelësa të rëndë. Në korridor dit e natë enden roje. Birbili i dëgjon hapat e rojave. Ka dëshirë të dëgjojë ... Eshtë e vetmja lidhje e tij me botën e gjallë. Në fillim ai e pati të vështirë të qëndrojë. Priste të fillonin pikën e ujit mbi kokë ... Në ditët e netët me errësirë të plotë Birbili i kujtohej jeta e

maleve, shokët e tij, Birbilenjtë e tjerë që ende mbeteshin kaçakë në male. Ai nuk e këpuste shpresën. Trimëria nuk do të shuhej në Arbëri, kurse ai e priste vdekjen i qetë.

Edhe në birucë mbahej me zinxhirë hekuri te këmbët. Mendoi: Prangat janë forca e perandorisë ... Në ditët e operacionit në Labëri nizamët prunë shumë kafshë me pranga. Edhe në kryengritjen e vitit dyzeteshtatë ashtu kishte ndodhur, kishin prurë karvanë të gjatë të ngarkuar me pranga për kryengritësit.

Tri javë i mbyllur. Humbi orientimin midis natës e ditës. Përse ajo heshtje e gjatë? Ishte një sflitje që i bëhej atij dhe të tjerëve për ti thyer. Ditën e parë të javës së fundit të marsit hyri në qeli miriallai Shahin Hatibzadea. Ai i kërkoi Birbilit t'i binte në gjunjë Valiut të Janinës.

- Kurrën e kurrës?! - i tha Birbili.

- Atëherë ç'kuptim ka dorëzimi juaj - i tha Shahin Hatibzadea. Këmbyen edhe fjalë te tjera. Më në fund miriallai e hodhi fjalën te thesari.

- Shkon gjuha te dhëmballa që të dhëmb. Birbili e priste që ai do të dilte atje.

- Ndjehet në sarajet e Janinës boshllëku i thesarit - i tha ai Birbilit. Stambolli e kërkon karvanin me flori. Ç'e bëre floririn? Fol, o insan i allahut, e ke vënë Valiun në sekëlldi. Thesarin e vilajetit që rrëmbeu xhemidija juaj?

Pastaj e pyeti:

- Fol, i rrëmbyet paret një Vilajeti, apo jo?

- Premë me jatagan tetë zebekë e një yzbash dhe morëm katër barrë mushke me para - tha Birbili.

U shpreh lirshëm si të pohonte një ndod i të thjeshtë.

- Hata e madhe! Për allah, hata e madhe! - tha Mirallai Shahin Hatibzadeja i habitur dhe i pezmatuar nga mospërfillja e kaçakut.

I papërmbytur pyeti:

- Ku e keni fshehur floririn? - foli Miriallai e filloi të lëpihej. Mërmëriti disa herë fjalën: "Flori! Flori! ..."

- Floririn e kërkon Padishahu. Trego dhe kërk o ç'të do xhani, o kaçaku Birbil! Në ç'vend e keni fsheur thesarin?

Birbili ia ktheu:

- Shkriu thesari i vilajetit, bej?!

- Nuk shkrin floriri, Birbil, - tha beu dhe prapë lëpiu buzët.

Murmuriti fjalët: "Flori! Katër barrë mushkash me flori."

Përsëriti me zë:

- Nuk shkrin floriri?

- Në qoftë se nuk shkriu, atëherë humbi ...

- Si humbi?! - A humbasin njëzet milionë grosh? - foli, Shahin Hatibzadeja që nuk e kuptoi ironinë e fjalëve të Birbilit.

- U bë erë paraja, bej! U bë erë dhe humbi.

- Ehursturfullah! Xhind kur ishte në shpella, xhind edhe nën pranga. U mundua me fjalë të butë e duke i bërë lajka e premtime.

- Fol, nuk je më shqiponjë po zog me krah të prerë. I mbyllur si zogu në kuvli hekuri... Do të flasësh?

- Përse të flas, ç'të them?

- Thesarin që rrëmbyet e kërkon Stambolli, mos i bën dredha fjalës, s'duron Valiu kur flitet për thesarin.

- Ashtu?! - bëri enkas sikur u habit Birbili nga pyetja e Miriallait.

Pastaj foli qetë: - Nuk e vodhëm, morëm atë që të tjerët na i kanë rrëmbyer ...

- Kjo s'ka rëndësi. Kryesorja është që të dorëzohet thesari. Stambolli nuk fal asnjë për floririn. Pa flori Stambolli do të kishte tjetër emër.

- Kështjella e Janinës është e mbushur dhe e renduar nga baroti dhe floriri. Minaret e xhamive të Janinës dhe këmbanat e kishave shndrisin nga floriri. Ka para Janina për vete dhe për Stambollin.

- Ç'ka Janina e di Janina. Ju shpjegoni se ku e çuat floririn?

- E shpërndamë? Ke provuar ndonjëherë Mirialla të ndash flori? Është lezet i madh kur e ndan si e ndamë ne.

- Kujt?

- Gjithandej. Ngado që shkuam ... Në çdo hap që hodhëm shpërndamë florinj. S'ka gëzim më të madh mirialla, Shahin Hatibzade se sa t'u ndash të varfërve thesarin e Padishahut. Oh, ç'gëzim i madh?!

- Ku është parë që të shpërndahet floriri - pyeti i hutuar miriallai Shahin Hatibzadeja.

- Nuk e dhamë sadaka, jo bej, jo! Ua kthyer floririn atyre që ua kishit rrëmbyer ju.

- Bën mirë të flasësh.

Birbili heshti.

- Nuk flet? - Harron që hyqmeti ka darë që të shkul nofullën. Mos kujto se e ke të lehtë t'i bësh ballë hapsanës.

- Ç' do më bësh, o halldup?

- Në ujë të valët do të treten kockat, do të bëhet një mish me eshtrat tuaja dhe me një thes të qelbur do ti hedhim kockat në humnerë. Në fund të Gjolit do të ngordhësh, aty të të hanë peshqit.

- E pastaj?

- Xhebraili yt do të jem unë.

Njeriu i lidhur me pranga ju gurmua.

- Po, po! Unë zabiti që më preve me jatagan në Grykën e Kuçit.

Të kujtohet?!

- Si jo. Shpesh herë kam thënë: "T'u thaftë dora Birbil, si nuk i dhe më tepër veri jataganit për t'ia prerë kokën zebekut Shahin!"

- Kjo gjurmë plage kërkon të hakmerrem, por unë i respektoj rregullat e robit.

- Kush është rob? E gjithë Ordia e Rumelisë të mblidhej s' do të më kapte dot. Tjetër është robi e tjetër është ta kërkosh vdekjen vetë. Të biesh rob është turp, ta kërkosh vdekjen vetë është trimëri. Ik të them, ik! iu hakërrye Birbili.

Shahin Hatibzadea u largua nga biruca si një qen i trembur që ul bishtin nën shalë dhe largohet i heshtur e vjedhurazi.

5.

Nga kamarjae vogël, Birbilin ju hodh ushqimi siç i hidhet ujkut të mbyllur në kafaz. Ai s' donte ushqim. Donte ajër. Ishte mësuar me ajrin e maleve. Nuk ngopej me frymë, ngulçimi e zinte në fyt, e ndjente zagushinë e tmerrshme të birucës së nëndheshme, e ndjente lagështinë e mureve. Priste ndëshkimin. Ishte i vendosur për t'i bërë ballë çdo ndëshkimi. Pikën e ujit në kokë nuk e deshte. Ai nuk donte të vdiste nga pika e ujit në kokë, as ai vetë dhe as shokët e tij. Donte të vdiste ndryshe. Si do të ishte vdekja e tyre? Filloi të mendojë për vdekjen. Kishte edhe vdekje të kobëshme. Mortja nuk u shkonte Birbilenjve. Në Labëri kur e mallkojnë djalin i thonë: "Të hëngërt mortja"! Se mortja është si qen dhe të ha. Kurse vdekja është ndryshe. Dikush vdes e dikush jo, e ha bushtra me emrin mortajë. Mortje për trimat nuk ka. Të paktën ai këtë s' e kishte dëgjuar. Labërit e veçojnë atë që e merr mortja nga atë që e merr plumbi. Gjithë vdekjeve në Labëri ju bëhet

klasifikimi. Ai bëhej me një fjalë. Vdiq apo e hëngri mortja. E për atë, Birbil Nivicën, komandantin e kaçakëve, si do të thuhej? I kujtohej një fshatar kur e shpëtoi nga torturat se nuk kishte paguar taksën. Ai njeri i cilitur kishte thënë:

“Nuk ka për të vdekur kurrë Birbil Shakua!”

Sa herë kishte shpëtuar nizamë që i përcillnin buzë detit te vapori kusar me emrin “Daut” ata kishin thënë:

“Nuk ke për të vdekur kurrë, o Birbil!”

Sa herë ndihmuan me para nënat që ju kishte ardhur karta e djegur për djemtë nga Ordija e Shtatë kishte marrë urimin:

“Gjëmb në këmbë mos ju hyrtë o djalë, diell rëntë mbi gjurmën tënde”.

Kur takonte në rrugë plakun qorr që i binte fyellit edhe i lëshonte në dorë pare përsëri dëgjonte urimin:

“Mos vdeksh kurrë o Birbil”.

Sa herë u delte në krah grekërve shpreheshin urime e dashamirësi.

Kur çeta e Birbilenjëve u hakmuar për masakrat që kishte bërë Ahmet beu në disa fshatra greke, prap i njëjti urim nga grekërit:

- Mos vdeksh kurrë o Birbil”.

Po ja që vdekja i trokiste. Aty mes errësirës ju shfaq gruaja e tij Hirua. I delte në errësirën e birucës si një rreze drite herë me rrobta e nusërisë, herë në burimin ku mbushte ujë. Një natë më parë e kishte parë në ëndërr sikur Hirua kishte lindur djalë dhe ai i vuri nën jastëk fëmijës jataganin. Ashtu ia kishte vënë Birbilit nëna Sorkë. I kishte nanuritur nina-nana dhe e uronte: Të preftë jatagani zebekët që të vranë babanë”. Dhe pastaj Hirua e veshur në të zeza i thoshte fëmijës: “Rritu, bëhu i fortë që të presësh me jatagan zebekun që të vrau babën”. Ai kishte dashur të ishte e vërtetë ajo ëndërr. Deshte të zgjaste sa më shumë ëndërra. Ishte i përmalluar dhe i dhimbsej Hirua.

I vetmuar mes errësirës e lagështirës mumëriti me vete fjalë, belbëzonte vargje të një kënge. Brengën e të burgosurit e shprehte në vargje:

I drejtohej vetes së tij:

*Budrum nat' e budrum ditë
Më plasi kandilja sytë ...*

I drejtohej gruas së tij, Hiros:

Po ti ç 'më thua moj vitë?

Gjegjet Hirua:

*Thyej budrumin ' e ngreu e ikë
Që të pëllcasin osmanllinjte.*

Ai dalldisi të këpuste prangat, po prangat ishin të rënda. Dalldisi të shëmbte muret, po muret e kështjellës së Janinës as tërmeti s' i lëvizte nga vendi.

Ai e bëri vetë këngën e tij. U përhap ajo edhe në qelitë e tjera, në gjithë të burgosurit e kalasë së Janinës. U përkthye edhe në gjuhën greke dhe e këndonin atë të burgosurit shqiptarë e grekë. E këndonin në orët e pushimit. Birbili e ndjeu që në birucë jetonin bashkërisht jeta dhe vdekja.

Mendimet e Birbilit shkonin nga stani në Këbuz, te shtëpia në buzë të përroit të Lekës, në Rexhin. Hirua s' kishte tjetër njeri. Babain ia vranë zebekët, burrin ia rrëmbeu veziri i Janinës. I vinte keq për Hiron. Donte ta përfytyronte më tepër, i pëlqente të qëndronte më gjatë portreti i saj në sytë e tij. Tek po jetonte gjatë me këto mendime plot dëshpërim murmëriti vargje për Hiron e bukur:

*Të më qepë atë këmishë
Me fill të qerpikut të saj,
Të më lajë atë këmishë
Me lot të syve të saj;
Të më terë atë këmishë.
Me zjarrin e zemrës së saj”.*

6.

*“Doli marsi, hyri prilli,
Pse s' u dëgjua Birbili,
Në Janinë e mban veziri.
- Ç' ke ti vezir me Birbilë?
- Për asqerët që më ka grirë,*

*Për sarajet që dogj Voshtinë,
Për Ahmet bej mjekërzinë”.*

Anës mureve të kështjellës ndjeheshin hapat e rojeve dhe tingëllimi i prangave në këmbët e Birbilit që e përcillnin natën për të zbritur buzë liqenit. Prangat si gjyle hekuri i zvarriteshin nëpër këmbë duke lëshuar një tingull zhurmues tring, tring, tring!

- Ku më çojnë? - pyeste Birbili vetveten. - Mos aty buzë liqenit do të më lidhin si atë nizamin që e zhyste në ujë dhe e nxirrte nga ujët ai, çaushti trup dhjamosur? Mbase! Këta dëfrenjë si egërsirat. Deri sa jam në gojën e bishës s’ mund të ankojem se ajo më shqyen. Mbytja në ujë është e rëndë. S’ do ta pranoja kurrë të kolovitem në rjetë si një ngjalë e rëndë e gjolit të Janinës. Më pëlqen më mirë të vdes në pallë. Sido që të jetë do të mundohem të qëndroj, që ai, Shahin Hatibzadeja mos të zgërdheshë dhëmbët e të krehë dredhëzat e mjekrës me ato cfurqet e gjatë e të pështira të duarve. Do ta mbaj veten dhe nuk kam për t’u përpëlitur. U befasua kur papritur u ndodh në një dhomë të madhe të ndriçuar me qirinj dhe të shtruar me sixhade me bojra verbuese. Muret me piktura të çuditshme ari që në fillim e habitën kaçakun, pastaj syri i tij u qetua. Ulur në një karrike përballë portretit të Sulltanit Birbili sodiste pikturat. I foli vetes: “Lum si ti o Birbil, po bëhesh vezir”.

Përreth shënjtore, palla, njerëz të therrur, gjak... Mjedis i bërë ashtu me qëllim që njeriut t’i krijonte frikën. Po frikën nuk e njehtë kaçaku Birbil. Ai qëndronte në atë sallon ashtu i ftohtë e mospërfillës me vështrim mbi tablotë në mur. Më shumë vështronte prangat në duart e tij. Filloi të mendojë përse e kishin prurë në atë sallë lluksoze. Sakaq nga një derë sekrete doli një njeri. E njohu, ishte miriallaj Shahin Hatibzadeja. Ai u afrua dhe u ul në krah të Birbilit.

- Derdhe zemërimin, Allahu e Padishahu bëjnë vetëm të mira
- i tha.

Birbili nuk i foli.

Shahin Hatibzadeja e prishi fytyrën, rrudhi faqen me gjurmë plage. Njeriu që kishte pranë i kujtoi luftën me kryengritësit. Syri i tij e kishte fiksuar Birbil Shakon në çastin që iu turr për ta vrarë me pallë në Grykën e Kuçit. Ai sy shpesh ende i loton, si atëhere kur ju mbush me gjak në Grykën e Kuçit.

- Ah, - psherëtiu Birbili.

I erdhi keq që tehu i jataganit të tij nuk i kishte shkuar më thellë. Por atëhere fuqia e krahut të Birbil Shakos aq arrinte. Ishte i vogël në moshë në vitin e kryengritjes së madhe të Gjolekës.

Miriiallait filloi t'i mjegullohej pamja në syrin e prerë. Nuk e shikonte mirë kaçakun.

Birbili mendoi ti fliste miriiallait për plagën dhe për Gjolekën, por nuk arriti të fliste. Një refleks drite e bëri të hedhë syrin në fundin e sallës ku u shfaq një burrë trupshkurtër dhe i dhjamosur.

Njeriut që hyri në sallë ju përlën të gjitha, vetëm Birbili qëndronte si gjëmb gushti. Nuk lëvizi prej vendit. Valiu bëri dy tre lëvizje para pasqyrave dhe erdhi e zuri vend para kaçakut. Birbilit iu bë se iu afrua gjarpëri. E ndjeu ftohtësinë e rrëshqitësit, si t'i lëvizte sipër lëkurës së tij, për ta kafshuar e derdhur helmin. Nuk iu drodh qerpiku dhe as zemra. E shikonte drejt në bebet e syve, ashtu që Valiu u shqetësua e hodhi sytë rreth për të parë se jmenët që e ruanin.

- Si je o Birbil i maleve - i foli Valiu.

- Si jo më mirë, o Pashë, - tha Birbili pa lëvizur nga vendi. -

Ku ka më mirë se sa kaçaku të bisedojë me një Vali.

- Ashtu? Mos kërkon t'ju heqim hekurat?

- Jo Pashë, jo! Unë e di që ju s'mund të m'i hiqni hekurat.

- Dua të bisedojmë - i tha Pashai dhe i nguli sytë e vegjël kaçakut.

Birbili e hetoi me vëmendje. Sytë e vegjël ngjyrë hirre të Pashait iu ngulën si pikë tek balli. Ata dukej sikur pyesnin: "E, u pendove?"

Birbili as lëvizi dhe as nuk foli.

- A të rëndojnë prangat, o Birbil i malit.

- Hiç fare. Sa më shumë pranga dërgohen në malet tona, aq më afër troket liria, o Pashë!

Valiu iu shmang fjalës që dëgjoji.

- Një sihariq për ty o Birbil Fesati. Një sihariq i madh Padishahu te ngre lart si asnje tjetër. Të shtron në një kohë për të zgjedhur ose titullin Aga, ose shpirtin në xhehenem. E para të afrosh rehatin, e dyta skëterren. Unë të dua të mirën pa të them hiq dorë nga zullumi që të te hapen sytë për të shikuar atë që do të fitosh. Vërtet xhemedia juaj ka bërë zullume të mëdha e të rënda, por Padishahu me mundim të madh i nxorra një ferman. Padishahu u fal dhe u emëron Derven-aga të vilajetit - tha valiu me zë të mekur. Ja, e shikon,

u bëre agë në vend të kaloje në satër. Gëzohu evlat! Gëzohu o njeri?!
Gëzohu!

- Jo, Jo! Kurrë! - foli Birbili me shikimin lart e krenar.

- Hestarfulla, e përse? - Ç`kërkon më tepër?!

- Atë që kërkon Arbëria i djeg Stambollit, nuk e jep.

- Paratë e thesarit kërkon Stambolli dhe agë mbi agë do të bëhesh.

- Paratë, eh ç`janë paratë, pleh nëpër duar, s`ka lezet të merret me to Valiu.

Fjala e shfytëroi Valiun. Papritur ai u shndërrua nga një qengj në ujë.

- I duam dinsëz, i duam paratë! - e ktheu me inat Valiu me sytë e tij të zgurdulluar.

- Sa më rëndon fjala nuk më rëndon plumbi, o Pashë!

- Do të të dredh zorrët në rodhan, sus edepzës, sus! Si guxuat dhe ngritët dorën kundër Portës? Oj më hiqesh si fisnik, efendëm, dhe ma ndan paren e Vilajetit si pa gjë të keq. Kush djallin ju fryn kështu në vesh, ju Arbërve?

- Erae lirisë, o Pashë. Liria çel nga shpirti kryengritës i arbërit, o Pashë.

Hysni Pasha e ndjeu që i kishte mbetur predha në duar. Ai bënte dredha në bisedë me Birbilin, ashtu siç bën dredha predha kur fluturon në ajër.

Kur rojat e shoqëruan Birbilin në kështjellë, Valiu i tha Shahin Hatibzadesë:

- Mos kujto evlat se Stambolli do të na thotë askoshun se zumë Birbilenjtë. Pa shtënë në dorë thesarin jemi në sèkëlldi të madhe, evlat, Porta kërkon ...

I ulur në shilte Hysni pasha shkroi me dorën e tij një bujurllidi, ku u drejtohej sanxhakbejlerëve dhe kajmekanëve:

"Evlatër të mi! Nderi i valiut dhe i gjithë vilajetit të Janinës do të vihet në vend kur të gjendet Thesari me florinj që na mori xhemia e harbutit Birbil Shako, prandaj hetoni për të vërtetën nëse dinsëzët, Birbilenjtë e pabindur kanë shpërndarë lira flori tek njerëzit e kazave tuaja. Hetimet e gjurmimet që do të bëni na i dërgoni sa më parë".

Hysni Pasha
I'ali i Janinës"

XV

1.

*Birbilenjtë trembedhjetë
Vanë në litare vetë,
Një nga një të trembëdhjetë.*

Janina atë ditë prilli të vitit '57 gdhinte e mbytur nga mjegulla. Herët në mëngjes, në rrugicat e qytetit dhe në qepenat e dyqaneve, u vunë shpallje nga hyqymeti. Po as shqiptarët dhe as grekërit nuk tregonin interes për ti lexuar. Janina kishte zakonet e saj, i thithte fjalët nëpër sokaket, përmes thashethemeve. Fjalët kalonin nga shqiptarët te grekërit dhe nga grekërit te shqiptarët.

Thuhej ato ditë se në skajin e Janinës, te rripi i madh, buzë liqenit lëviznin ditën e natën zebekët e Shahin Hatibzadesë. Thuhej se aty punohej. - "Diçka po ndërtohej". Dhe kureshtja i shtynte janinjotët të mësonin se çfarë po bëhej aty. Mos hapnin zebekët gropa varresh? Shpesh asaj ane në skajë të Janinës hapeshin gropa varresh ku mbuloheshin kufoma të shqiptarëve e grekëve që kundërshtonin pushtimin e që vdisnin në birucat e Janinës ose pushkatoheshin sepse kërkonin LIRI. Këto thashetheme që qarkullonin në Janinë kishin brenda të vërtetën dhe e detyruan Hysni Pashanë të lëshojë urdhër që "Afijet dhe zebekët ta bëjnë Janinën sus, t'iu presin gjuhën dashakeqasve shqiptarë e grekë që lëshojnë zehër në vend të fjalëve". Valiu lëshoi edhe një bujurllid ku shpallej se hidheshin në hapsanë shqiptarët e grekërit e Janinës që përmendnin fjalën "LIRI" dhe "LEFTERI".

- Evlatër, - u drejtohej Valiu afijeve e zebekëve. - të hapni sytë, zien Janina, mileti ka mlllef e na shikon me syrin e jezitëve.

Erdhën në Janinë forca nga kaza të tjera. Hoteli i Nexhip Zhulatatit frekuentohej nga njerëz që nuk ishin parë fytyrat e tyre në Janinë. Hysni Pasha mendoi të vinte dorë mbi jezitin e Zhulatatit, por

i bëhej se dëmi do të ishte më i madh se ta linte të lirë. Do të ngrihej në këmbë, me kuç e maç, e gjithë Janina. Në vendet rreth hotelit natën endeshin patrulla ushtarake, ditën endeshin hafijet. Njerëzit u mësuan me hapat e rënda të këpucëve të nizamëve. Frika endej rreth, dalëngadalë ajo po bëhej e plotfuqishme. Ndjehej ajo mbi janinjotët por edhe mbi hyqymetin.

Një lajm që endej si nën dhe i shkonte më afër së vërtetës dhe u bë më i besueshëm. U tha se Valiu pruri nga Stambolli një ferman, që Birbilenjtë faleshin dhe Birbili, kryetari i tyre emërohej Agë i Vilajetit. Kur që parë të shkonte te rrapi i madh disa herë radhazi vete Valiu Hysni Pasha u tha se aty do të bëhej një xhami e madhe dhe një kishë e bukur që do ti gëzonte janinjotët, si grekërit dhe shqiptarët.

Thashethemet u vanitën ditën që dolën tellallët sokakëve të Janinës dhe duke u rënë daulleve lëshonin zë:

- Dëgjoni milet!

Flisnin tellallët me dy gjuhë, shqip e greqisht. U zgjua Janina herët nga zhurma e daulleve dhe zërat e tellallëve:

- Dëgjoni milet!

- Valiu kërkon të dalë Janina te Rrapi i madh e të bëjë sehir. Të mbyllen dyqanet, të mehet salaja e imamëve të xhamive e të mos bien këmbanat e kishave. Të mblidhet e gjithë Janina e madhe e të bëjë sehir.

Çfarë të shikonte Janina? Kureshtja e detyrimi i shtynte njerëzit në drejtim të së panjohures.

Rrapadum! Rrapadum! U binin tellallët daulleve.

Dhe përsëri thirrje në dy gjuhë, shqip e greqisht:

- Të dalë të bëjë sehir Janina!

- Të dalë mileti te Rrapi i madh të ...

Dhe përsëri daulle: Rrapadum. Rrapadum! Dhe thirrje:

- Urdhër i hyqymetit: Të gjithë te Rrapi i madh.

- Të dalë Janina të bëjë sehir!?

Çfarë do të shikonte Janina?

2.

Trembedhjetë litarë të lyer me dyllë mjalti e të qëndisura me pikëla që të mos dalloheshin nëse ishin nepërka apo litarë vareshin në degët e rrapit të madh të Janinës. Në çdo litar shihej koka e gjarpërit, syri i rrëshqitësit helmues, cipëza shkëlqenjese e pikaloshe e lëkurës së nepërkës. Shahin Hatibzadeja i kishte bërë litarët enkas ashtu që tu shtinin Birbilenjve në uxhut frikën. Ai donte që ata të vdisnin të hutuar. Gjëma do t'ia dridhte zemrën miletit.

Valiu i Janinës, Hysni Pashai e kishte porositur Shahin Hatibzadenë që para varjes Bibilenjtë të shfaqeshin kokëulur, njerëz të leckosur. I kërkoi të visheshin me savan të vdekjes, me ato kostumet ngjyrë gri që tu shtinin në shtat frikën Janinjotëve, shqiptarë e grekë. Me një gur Valiu donte të vriste dy zogj. Të ulte krenarinë e Birbilenjve e t'i shtinte frikën Janinës që ziente nga prapësitë, donte ti thoshte hotelxhiut Nexhip Bedena, tërë shqiptarëve e grekëve të Janinës: “Po deshët mos zini mend se ta vë hyqymeti litarin në gushë. Ja, i shikoni si qëndrojnë nepërkat të varura në degët e rrapit ku u var Kaçandoni?”¹. Era i tundëte litarët. Tellallët u ranë kryq e tërthor sokakëve. Ata vazhdimisht thërrisnin: “Të vijë Janina të bëjë sehir ... Të mblidhet mileti tek rrapit i madh. Të dalë mileti shqiptar e grek të shohë Birbilenjtë kryengritës sesi do t'u merret shpirti nga gjarpërinjtë”.

Dhe Janina doli ...

Miriallai Shahin me sytë e ngulitur te litarët “nepërka” krehte me gishtat e hollë si cfurqe bishtin e mjekrës, e bënte dredhëza. Nga mënyra se si vepronte dukej sikur ndjente diçka të frikshme edhe ai vetë nga ato “nepërka”.

“Gjarpërinjtë” e verdhë vdekejprurës të Shahin Hatibzadesë nuk ishin bullari i trullësuar që e merr prapa dervishin si një kafshë manare. Edhe tërë dervishët e taborreve të Ordisë së Rumelisë të mbidheshin e të bënë ato numrat e tyre trullësuese s`do t'ia arrinin asaj që kishte pregatitur ai. Në qytet tellallët s`pushonin:

- Shehadet i Xhamisë së Madhe do të bëhet në aksham. Davetet e vakitë shtyhen ... Dyqanet mbyllen dhe mileti shqiptar e grek të

1) Kaçandoni kaçak grek me zë, nga një fshat i Janinës.

shkojnë të bëjnë sehir te rrapit i madh i Janinës.

3.

- Ai po vjen! Ai po vjen! - thirrën.

Rojet dhe afijet zunë vendet.

Kaloshina e Valiut ecte me rrëmbim në rrugën që kalonte anës së liqenit. "Rosa Qafëgjatë" e lyer me argjend e Valiut rrëshqiti mbi kaltërsinë e liqenit. Në drejtim të rrapit shkonin në një kohë "Rosa qafëgjatë" dhe karroca e Valillëkut. "Rosa" rrëshqiste mbi valët e liqenit, karroca me katër atllarë të bardhë anash. Edhe nga njëra edhe nga tjetra, pritej të dilte Valiu. Karroca ishte stolitur me salltanete e lulka të bukura, me pamje verbonjëse që tregonte se Janina nuk kishte vetëm topa por kishte edhe shumë flori e akoma më shumë argjend. Me atë karrocë që e tërhiqnin katër kuaj të bardhë vinte te Rrapit i madh Hysni Pasha, i vetëquajtur "Pashai gjëmëmadh".

Miriallai Shahin së largu e bëri provën e përljes dhe të buzëqeshjes. Valiut i duhet macja në sofër dhe e gjeti. Ai e di që kur përkëdhelet s'ka mace të mos mjaullijë. Edhe Miriallai Shahin mjaullin si macja dhe gjuan si macja!

Hysni Pasha zbriti ngadalë dhe filloi të ecë me një hap pozant. E la kaloshinën ndritëse dhe foli:

- Biri im, Shahin bej!

Fjala bej e ledhatoi Miriallain.

Pashai e pyeti:

- E, si qëndron puna, mos u bë ndonjë fesat?

- Eshtë shtruar, është bërë pulë Janina, shqiptarë e grekë heshtin e shqejnë synë kur shikojnë ata - i tha me zë të ulët Shahin Hatibzadea.

Valiu i hodhi sytë te trembëdhjetë nepërkat e varura në trembëdhjetë degë të Rrapit të madh.

- Ashtu biri im, ashtu. Allahu na ndihmon. Mileti më duket i shtruar, gëk s'po bën. Mi ke veshur Birbilenjtë me savanet e jevgëve. Ashtu u shuhet zëri e rami, të vdesin me turp. Ç'thonë këta syfandaksur që janë rrotull?

- Disa zëra çuçuririën, deshën të na prishin punë por i bëmë sus. I shtrua disa me dajak

- Dajaku e vë në çin Janinën.

- Disa fesatxhinj i shtyra në hapsanë.

- Askoshun! Atëherë fillo evlat. Kujdes evlat, dinsëzët duhet të vdesin të pordhosur. Ata duan që në çastin e vdekjes të ndriçojnë trimërinë e arnautit. Do të jetë punë e ligë. Ata edhe në çastin e vdekjes do të mundohen të mbjellin trimëri. Duan të kthehen në mit i qëndresës, të shndërrohen në simbol qëndrese për ata kokëshkëmbat e Arbërisë. Këtë e ka shprehur ai ujku i madh. Kjo është me zarar biri im.

- Nuk ka për të ndodhur, ashtu si janë veshur me rrobe jevgu veç të bëjnë të tallet Janina. I, i, i! - Të shikosh si duken me atë veshje jevgu, si pula të lagura duken. Për allah, si pula të lagura!

Xhelatët afruan nën litarë trapeza të vogla. "Nepërkat" në degët e rrapit gjallërohen si të jenë gjarpërinj të vërtetë. Drejt tyre ecin Birbilenjtë. Në krye është Birbili. Atij i del shtati një shuplakë sipër radhëve të nizamëve. Ecën me hapa të rëndë, çapitet ngadalë. Në çdo hap që hedh hekurat bëjnë tring-tring! Tring-Tring! Tring-tring!

Trembëdhjetë herë tring-tring, tring-tring. Janina i vështron se si ecin drejt litarëve ashtu, njëri mbas tjetrit, krenarë ata të trembëdhjetë. Dëgjon hapin e rëndë të tyre dhe zhurmën e prangave. U ndalën përballë litarëve. Ballë përballë njeriu dhe vdekja. Ky ankh rëndon mbi shpirtin e njerëzve. Dalin përballë trembëdhjetë imamë me dollma e çallma të bardha.

Pyetën imamët:

- Dëshirën e fundit - u thanë Birbilenjve.

- Veshjen e kaçakut - thanë ata në një gojë.

Miriallait Shahin i cukthi kërkesa, por ligjet e fesë nuk mund të përdhunoheshin. Ata u veshën me teshat e kaçakut, për të vdekur me rrobë kaçaku.

4.

U shfaqën njëherësh trembëdhjetë Arbër me zog në gjoks... Të veshur me fustanella. Të pashëm si njëri-tjetri. Edhe ai, i vogli i tyre, ka pranga të rënda në këmbë e duar. Një vuvërimë ere që erdhi me rrëmbim nga malet e Pindit shtoi zhaurimën e fletëve të Rrapit të madh dhe i gjallëroi litarët e varur në degë. Këto u shndërruan në sytë e njerëzve në rrëshqitës të gjallë, që lëvrinin për të ngulur dhëmbin e derdhur helmin vdekjeprurës për Birbilenjtë. Drejt çdo rrëshqitësi

shkonte një nga ata.

Ecte njeriu drejt vdekjes. Ecnin të gjithë me hap të rëndë e me qetësi. Enkas çapiteshin ngadalë që të ruanin pamjen e shtatit, bukurinë e veshjes së kaçakut dhe qendresën. Me të bëmat shpjegonin se ata ishin vetëflijuar për t'u lehtësuar dhimbjet të tjerëve, për t'i shpëtuar ata nga masakra që kërkonte të bënte Valiu i Janinës.

Ecnin ashtu të vendosur që ta bënin vdekjen si me le. Edhe ai, më i vogli i tyre, e mban trupin drejt e kokën lart. Të trembëdhjetë u afrohen litareve të lyer me dyllë. Janinjotët me vështrim tek Birbilenjtë. Ata me vështrim tek malet e vendlindjes së tyre dhe te janinjotët.

-Kjo s' duhej të ndodhte evlat - i tha Valiu, Shahin Hatibzadesë.

Vallë çfarë e rrëmbeu më tepër Janinën, kureshtja apo trimëria? Njerëzit ngriheshin në majë të këmbëve që të shikonin. Të tjerët shtyheshin, por asnjëri s' mund ta kapërxente gardhin e zebekëve. Zhurma u platit sapo të trembëdhjetë Birbilenjtë u dolën përballë litarëve. Njerëzit shikonin me sytë çapëlyer. Në tokë ata të trembëdhjetë, në degët e rrapit "litarët nepërka".

Kishin ardhur Arbër me fytyra të rreshkura në diell e në erën e maleve, argjendarë e tunxharë që bënin zile, marangozë, këpucarë, samarxhinj e lëkurëpunues. E tërë Janina ishte mbledhur aty. Shqiptarë e grekër, me mllëf në zemër për Valiun zemërzi, vështronin ata të trembëdhjetë. Edhe ata donin t' i shikonin. Kishin dy muaj në qeli dhe donin të shikonin njerëz, qiell e male.

Në malet e Arbërit, pylli ka lëshuar burbuqe. Valiu kërkon që të thahet bari në malet e Arbërisë, që të mos çeli më gjethi. Po Arbëria merr frymë me erën e saj, jeton në qënien e saj. Birbili shikon andej nga malet e vendlindjes. E rrëmben dëshira të marrë fluturimin e zogut. Por krahët i janë prerë. Mendon se vdekja e papërkulur nuk është vdekje, ajo kthehet në forcë për të gjallët, zgjon trimëri ...

Sa herë që lëvizte, Birbili ndjente tingullin dhe peshën e rëndë të prangave, tingëllimën rrëqethëse: Tring! Tring! Ç' ishte ajo tringëllimë? Mos ishte psherëtima e vdekjes? Apo ishin tinguj e zileve dhe këmborëve të staneve të Labërisë? Tinguj jete! Ai jeton në një kohë, ëndërrën dhe realen: Jetën dhe vdekjen. Në një moment sytë e tij nguliten tutje, në drejtim të maleve. Shikon me sytë e mëndjes Hiron e bukur. Iu bë sikur ajo përjetonte ditë të gëzuara, sikur ai e përkëdhelte dhe i vlerësonte bukurinë, qëndresën, irimërinë. Murmëriti:

- Eh, Hiro, moj Hiro! Zemërmira Hiro! Zebeku nuk ka në gjoks zemër po gur, moj Hiro! Enkas lëvizi që të shkëputej nga ato mendime.

Tring, bënë zinxhirët. Tring-Tring disa herë radhazi si për ta kujtuar kaçakun se ato ishin të pakëputshme. Ishin si një paralajmërim për t'iu larguar endrës dhe ta shihte të vërtetën në sy; të shikonte zebekët që endeshin me jatagan në dhëmbë, nepërkat që qëndronin në pritje t'iu merrnin shpirtin trembëdhjetë Birbilenjve. Dhe njerëzit të shtangur prisnin. Ishte vetë vdekja. Dëgjoji zë:

- Birbil-o, Birbil palla, e nderove Shqipërinë.

Kush ishte ai zë? Kërkuan sytë e tij Hotelxhiun e Janinës, Nexhipin e Zhulatit. Ai që foli nuk ishte Nexhipi i Zhulatit. Ai ishte kreu i burrave të Tërbaçit. U bë sy e veshë. Donte ta dëgjonte, donte ta shikonte. Ishte i pikëlluar se ishte mbushur kalaja e Janinës me burra të Tërbaçit.

Kur mësoi Hysni Pasha se Shpella e Tërbaçit kishte qënë shtëpia e Birbilenjve u hakmuar, i mblodhi tërë burrat e fshatit dhe i mbylli në kalanë e Janinës. U tha:

- Vallahi, Bilahi, për atë allah që lëshon nur mbi dhe, këtu do të kalbeni o Tërbaças, do të ngordhni si qena, do t'iu var një e nga një në litar ... Do t'iu pjek në hell, o derra të pabindur, do t'iu pikoje me dhjamë dashi, o dushmanë! Si guxuat, o jezitet e Aliut, të fshihni e të ushqeni me muaj të tërë ata që ngritën dorën kundër Padishahut?

Birbili, gjatë kohës që ishte i mbyllur në kështjellë solli ndër mend se kishte vepruar drejt që pranoi t'iu lehtësonte vuajtjet e t'iu shpëtonte jetën Tërbaçasve dhe gjithë arbërve të tjerë të mbyllur në birruca. Sa herë i erdhi në mëndje gjithmonë thoshte se kishte vepruar drejt. Të vdiste për të tjerët, kjo ishte një vepër që vetëm kaçaku mund ta bënte. Kaçaku e priste vdekjen si me le, kur pritej me pallë dhe vritej me plumb për të tjerët.

Dhe tani duke shikuar litarët Birbili psherëtiu:

- I pjell mëndja gjithfarë dënimesh Pashait të Janinës. Edhe Kaçandonin e grekërve, kështu e varën në Janinë.

Mbas shpine dëgjoji disa hapa. Dikush po i afrohej. Kush ishte xhelatit?!

Ai që afrohej ishte Miriallai Shahin Hatibzade. Ndalet përballë Birbilit dhe i lexon bujurllidinë e Valiut:

Birbili shfryn me zemërim:

- Ule kokën, he qafir, - shfryu Shahin Hatibzadeja, që lexonte bujurllidinë e Valiut. Fole fjalën e fundit:

- Kujt, xhebrailit t'i flas?!

- Jo Allahut! Padishahut! Bëhu pishman për çke bërë - iu ngurmua Miriallai. - Trego thesarin dhe je i falur. Kërko ç'të duash - vazhdoi Shahin Hatibzadea. - Thesari i duhet hyqymetit. Kërko ç'të duash. Fol, fol! - ngulmoi Shahin Hatibzadea.

- Atë që kërkoj unë nuk ma jep dot as ti dhe as Valiu. Ajo nuk i përket asnjërit dhe as tjetrit. Ajo nuk lypet por fitohet.

- E dëgjon ai lartë, Zoti, fjalën - tha Shahin Hatibzadeja - fol!

Birbili lëvizi dhe tendosi muskujt fortë. U duk sikur zinxhirët e rëndë u këputën. Ata lëvizën të trembëdhjetë. Miriallai hodhi vështrimin te të trembëdhjetë. U zbraps i trembur, fytyra dinake ju zbeh më shumë dhe sytë ju futën nën zgavra. Ndjeu si diçka të afërt me goditjen e jataganit që pat marrë nga dora e Birbilit në Grykën e Kuçit.

- E, ç'tha dinsëzi Birbil? - pyeti Valiu sapo u afrua Miriallai Shahin.

- Ç'kanë trimat tuaj që janë zbehur në fytyrë? Ne varemi në litar ju trëmbeni.

- E paska kokën në thembër të këmbës ky njeri, o evlat! Provo një herë, afroju atij ujkut, me mustaqe te veshi, Resuli është ai?

Shahin Hatibzadea iu afrua si me frikë. Ato litarë "nepërka" ishin diçka më e frikshme se litari i trekëmbëshit. Shahin Hatibzadea filloi t'u trembejatyre "nepërkave" që i kishte sajuar ai vetë, po që tani tundeshin nga era dhe ngjanin me gjarpërinj të vërtetë. Ai bëri t'i afrohet po kaçaku lëvizi. Tingulli që lëshuan zinxhirët e zbrapsi. Kaloi afër secilit. Përsëriti po një fjalë:

- Kush flet e tregon për thesarin është i falur.

Ata shurdhë e memecë.

- Kush flet e tregon për thesarin është i falur.

Ata përsëri shurdhanë e memecë.

- Hëm, belbëzoi, - dhe fytyrë zbehët u kthye në vend.

- E, evlat?

- Janë xhindër. Më prenë me sy. S'guxova t'u afrohem.

- Ka hazmër të mëdhenj perandoria jonë, evlat - murmuriti

Valiu.

Vështrimi i tyre mbeti si i ngrirë tek ata të trembëdhjetë. Pashai

dhe Miriallai kishin menduar se duke varur ata litarë do të nxirrnin nga errësira e pusit thesarin e rrëmbyer. Po “nepërkat” nuk arritën t’i bënin të flisnin Birbilenjtë.

Hysni Pashai e ndiente frikën dhe ashtu i pezmatuar e me dëshpërim iu drejtua vartësit:

- I humbëm paret evlat, i humbëm.
Shahin Hatibzadea u zbeh në fytyrë ...

5.

*“Ngreu Birbil hidh litarë!
Dale bej të dredh cigarë,
S’e nuk jam çanak me dhallë
Po jam Birbili me pallë”.*

Dikush foli përsëri me zë të lartë:

- Birbilo, Birbil palla, e nderove Shqipërinë!

Zëri ishte i njohur, i afërt për Birbil Shakon. Ishte kreu i burrave të Tërbaçit të Vlorës, ku gjeti strehë më tepër se kudo çeta e Birbilenjve, apo Budo Bredhi kishte ardhur në Janinë. Ai ishte. Birbili e njohu në zë.

- Kush e tha atë fjalë? - pyesnin afijet nëpër turmë.

- Kush guxon të përmendë emrin Shqiptar e Shqipëri? - pyesnin zaptiet.

Një tallaz i brendshëm si i detit e përshkoi turmën e njerëzve. Afshi i urrejtjes nga pesha e dhunës shuhej brenda gjoksit. Valiut iu drodh mjekra. Kjo thirrje nga populli i erdhi atij si një dackë e fortë. I trëmbej tallazit sa edhe tërmetit.

- Eshhtë bela me miletin, bela e madhe! - iu drejtua vartësve që kishte afër.

Shahin Hatibzadeja nxorri dhëmbët si qeni, kur e nxit i zoti, u ngërdhesh dhe tamam si qen i ranë jargët. Duke shikuar njerëzit me inat, ai bërtiste:

- Kush e përmendi emrin Shqiptar dhe Shqipëri, hë flisni o dokuzë të pabindur, kush?

Hafijet endeshin nëpër turmë si hije nate. Zëri bëhej më i fortë por i pakapshëm. Krejt i pakapshëm. Kush ishte? Budo Bredhi, burri i Tërbaçit, Lazia, Miço Abazi, Malo Miço Kuqali apo Nexhip Bedena. Birbili i shikonte në një kohë të gjithë.

Mendja e Hysni Pashait gjykoi se "Zërin Shqiptar dhe Shqipëri nuk do ta mposhtnin edhe sikur të gjitha pushkët e Ordisë dhe topat e kështjellës të binin." Ai zë ishte tallaz. Dhe tallazeve ai u trembej.

Qëndroi një kohë me duar të kryqëzuara para gjoksit, u shtir si njeri i qetë, që lypte qetësi nga njerëzit, për t' u treguar atë që kishte përgatitur.

Duhej të bënte sehir Janina! Në sytë e Birbilenjve shihej qëndresa dhe trimëria ... Njerëzit që kishin zbritur nga fshatrat dhe ata të qytetit të Janinës qëndronin në heshtje. Dhimbja ishte e përbashkët për shqiptarët dhe grekërit që ishin aty. Vështrimet e tyre shprehnin mllefin e madh që kishin për zebekët dhe Valiun e Janinës. Qëndresa burrërore e Birbilenjve u dha zemër të gjithëve. U dëgjuan fjalë:

- Kjo i duhet Arbërisë tonë! Kjo i duhet asaj që të marrë frymë, ndryshe na mbytën zebekët.

Ata të trembëdhjetë përjetonin ditët shpresëdhënëse.

- Ah, Liria! - murmuriti Birbili.

Endërra për të jetuar në liri atij dhe shokëve të tij iu ndërpre në mes. Përballë i qëndronte vdekja. Nuk donte ta afronte. Kërkonte në sytë e njerëzve. Në një çast i erdhi përsëri në dritën e syve të mendjes Hirua e bukur. Murmuriti një këngë:

Hiro ta kam silloinë, moj Hiro

Si do ta kalosh me jetimë, moj Hiro

I përgjigjet Hirua:

Si guri në rrukullimë, Birbilo!

Murmuriti:

- Djalë do të lindë, patjetër djalë dhe do të marrë emrin tim, si ia mora edhe unë emrin babës tim që u vra me Balil Nezhën në luftën e Peshkëpisë. Do t' ia vërë emrin ai që më vuri emrin edhe mua, babë Budua.

Trang lëvizën prangat. Ai u shkund nga hutimi. I dha gjoksit përpara si të donte t' i qëndronte erës therëse që po afrohej. E hodhi vështrimin te shokët. Ata qëndronin në vend si statuja. U buzëqeshi dhe u dha shënjë të qëndronin se ndryshe dot' u bëhej qejfi halldupëve.

Disa herë njerëzit shpërthyen në zhurmë. Zebekët vunë jataganët në dhëmbë dhe i zbrapsën, por në ata mijra njerëz dikush përsëri guxonte t'u fliste Birbilenjve në emër ... Pastaj sharje. E përsëri janinjotët thërrisnin në dy gjuhë, shqip e greqisht:

Rroftë liria!

Zito Elefteria!

E sërish nëpër njerëz futen afijet, xhandarë dhe zebekë me jatagan në dhëmbë ...

Birbil Shakos i erdhi mirë që ai me shokët po bënin një vdekje që nuk i turpëronte kaçakët e tjerë. Ligji i kaçakut e kërkonte që të tregoheshin trima edhe në çastin e fundit të jetës. Kjo vdekje nuk ishte e papëlqyeshme për të treguar se kaçaku si ka frikë as pushkës dhe as jataganit. Kaçaku nuk jepet, ai i bën ballë çdo dënimi.

Dikush po i afrohej. Kush ishte, xhelati! Jo! Xhelati vishej me rrobe të zeza, kurse ai nga veshja shkëlqente nga koka te këmbët. Kush ishte ai? E njohu, ishte vetë Valiu i Janinës.

Nuk ishte parë ndonjëherë që Valiu i Janinës të shkëmbente fjalë me kundërshtarët e tij faqe njerëzve. Harbuti - harbut, e Valiu - Vali. Ndërsa me Birbilenjtë donte të bisedonte edhe para litarit. Fjalën e fundit ai këmbëu me Birbil Shakon. Kërkonte thesarin. Fjalët e tjera Valiu i kishte shpallur dhe njerëzit i dinin, i kishin lexuar në shpalljet. Valiu vazhdonte në të tijën:

- Kërkohet thesari i rrëmbyer, - ku shkuan katër barrë mushka me para, fol o xhind, fol o syfestsëz! Ndryshe do t'u shuaj me rrënjë e degë, që të fshihet nga kujtesa e njerëzve emri Arbër dhe të mos dëgjohet më fjala Arbëri. Një hije sundon mbi tokë. Eshtë firaun ai që kundërshton hijen ... Fol o syfetzëz, fol!

- Eshtë rrënjë shumë e fortë dhe nuk ka focë që e shkul dashurinë që ka njeriu për vatanë e tij, o Hysni Pasha ... - iu përgjigj Birbili.

Këmbyen edhe fjalë të tjera.

Pastaj Valiu tha:

- Një rrënjë është e pashkulshme në Perandorinë tonë, Padishahu! E zëmëruat Sulltanin dhe e goditi Arbërinë tuaj të pabindur me rrufe ... Do të godasim pandërprerë gjer sa ju ta harroni Arbërinë tuaj, të shuhen ato yshtjet e imamit Budo Bredhi që ju ka shtyrë në vesh dreqin. Budo Bredhi nuk është imam po xhind. Ta shkulni nga zemra të keqen e të zhdokni zogun prej bronxi, - turfulloi

me zemërim Pashai.

- Jemi shqiptarë! - iu përgjigjën me krenari Birbilenjtë.

Valiu nuk foli më, tani do të flisnin trembëdhjetë nepërkat që lëviznin në degët e rrapit. Valiun e mposhti pikëllimi. U venit shpresa se mund të binte në gjurmët e thesarit që u rrëmbye.

I foli Shahin Hatibzadesë:

- Evlat, lëshoi dinsëzët në karamanjoll.

Edhe Valiu si Miriallai u tremb nga vështrimet e të trembëdhjetë Birbilenjve. Ai u zbraps ndërsa u afruan njerëzit me maska të zeza.

- Mos në zërë me dorë qen misri - iu ngërmua Birbili dhe e qëllloi me shkelm.

Hieja e zeze u rrëzua për tokë. Birbili hodhi veshtrimin nga Birbilenjtë e tjerë. Ata ishin aty ... Dymbëdhjetë flutura të bardha ... Dymbëdhjetë drerë malesh me sytë të malet e Arbërisë. Dymbëdhjetë Progonatas ... I erdhi në dritë e syrit nëna Sorkë edhe Hirua si atë ditë e veshur me rroba të bardha me llambro shndritëse ... Shpejt u përmend, iu tremb hutimit, ndjeu përsëri hijen që i afrohej të hiqte karriken.

- Prit të ndez cigaren - i tha njeriut me maskë.

- Xhind, për Allah! - thoshin zebëkët.

Birbili kujtohet se ç' duhet të bënte. Guximi nuk i mungoi. U përpoq të lëvizte këmbët por ato nuk ju përgjigjën si të ishin dy shufra hekuri pa jetë, të ftohta, të akullta, që nuk i përkisnin trupit të tij. Sytë i vanë te njerëzit e ngurosur. Mendoi se duke vdekur ashtu e rriste trimërinë. E vuri cigaren në buzë. Enkas bëri ashtu. Nuk donte që kur ta mbyste litari t' i qëndronte gjuhajashtë. Ai duhet të vdiste gojëkyçur. Ndezi cigaren. Duhani ishte i rëndë. Pastaj goditi fort karriken dhe xhelatin. Xhelati klithi i trembur. Litari u lëkund. Një ah shpërtheu nga gjoksi i njerëzve. Birbili bëri një përpjekje të mundimshme, e shtrëngoi fort cigaren në dhëmbë. Donte që edhe kur të varej të mos shfityrohej. E zgjeroi kraharorin dhe i dha kokës lart, me ballin e vështrimin tek njerëzit e shokët e tij. Nuk mundi të buzëqeshte. Ai donte të vdiste me buzëqeshje në buzë.

"Birbil Shakua me pallë,

Me dhëmbë shtrëngoi cigarë".

Ata të trembëdhjetë vanë një e nga një në litar.

6.

*“Birbil e Resul e vranë,
Myrto Dukagjini fora me pallë,
Kërkon të presë Pashanë ...”*

Kur Nexhip Zhulati, Budo Bredhi dhe Myrto Dukagjini¹ gatitën pritën, Nexhipi i tha:

- Gjoleka me dy plumba koburesh mori hak, vrau një kaftanaz, por më vonë e sulmoi turkun me armatë. Ashtu e filloi edhe Birbil Shakua. preu me pallë një yzbash dhe iku, shpëtoi nga Ordia e Shtatë, e ngriti në këmbë Labërinë, i mbushi malet me Birbilenj ... Ashtu edhe Ju, o Myrto Dukagjini, do t' i jepëni zjarr pushkës top që mban në duar dhe karroca e Valiut do të përfshihet në flakë. Atëhere Janina e Labëria do të thonë:

- S'kanë vdekur Birbilenjtë!

Po ngjarjet rrodhën ndryshe dhe Myrto Dukagjinin s' e mbante vendi:

- Dështuam, - u tha shokëve të pritës, Myrto Dukagjini i dëshpëruar, kur pa Valiun me varkën e tij që rrëshqiste sipër valëve të liqenit.

Të tjerët nuk folën. E përgatitën pritën me kujdes dhe ja, papritur dështuan. Valiu në vend që të kthehej me kaloshin e Valillëkut e ndërroi mjetin rrugës.

- Kot nuk i thonë Hysni Pashait “Dhelpra e Janinës”. Ai i ruhet kurtheve. - Iku! Iku! - thanë në pritë.

Dëgjohet afër zhurma e atllarëve të bardhë. Ajo është karroca e Valillëkut me salltanete e pajime verbonjëse. Ata u bënë sy e veshë.

- Shtrengohuni, merrni shenjë - i thanë njëri-tjetrit.

- Do ta qëllojmë, - u tha Myrtoja shokëve. - Do ta djegim karrocën e Valiut që ta mësojë Janina se Birbilenjtë janë gjallë.

Karroca shkëlqenjese ishte më verbuese se varka qafëgjatë që rrëshqiste mbi liqen. Ata në pritë murmëritën: “Ka flori Janina”. Dhe pushkët e kaçakëve morën shenjë karrocën. Në karrocë ishte Miriallai

1) Komandant i një pjese të xhemedies së Birbilenjve që gjatë operacionit u nda në tri pjesë. Kënga popullore dhe një dokument e veçon këtë luftëtar për përpjekjet që bëri për të shpëtuar jetën e Birbilenjve.

Shahin Hatibzade. Ishte ulur në kolltuk dhe me gishtat e gjatë krihte mjekrën e tij. Ishte i kënaqur. Më në fund mbaruan telashet - tha me vete. Xhindi Birbil vdiq. Rojet personale të Valiut qëndronin përballë Miriallait Shahin. Nuk ishin mësuar rojet të shikonin në karrocën e Valiut njerëz të tjerë. Aty s'guxonte njeri që të hipte. Shahin Hatibzadeja fryllej si kaposh në sytë e rojeve. Do të hynte karroca e valiullëkut në qytet, do të ndiente Janina zhurmën e trokitjen e kuajve të medhenj.

Kur kalonte kaloshina e valiullëkut tellallët bërtisnin:

- Shëndet e jetë të gjithë Valiut! Shëndet e jetë Hysni Pashës!"

Dhe do të habiteshin kur të shikonin në karrocën e valiullëkut Miriallain Shahin. Ai ndiente një cmirë të veçantë. Në një kohë të shkurtër, në disa muaj, i trokitën njëherësh vdekja dhe lavdia. Dhe i bëri ballë si njëres dhe tjetres.

Zhurma e karrocës ishte e vetmja zhurmë në rrugën anës liqenit. Myrto Dukagjini me shokë e ndjenin afër trokthin e kuajve të bardhë. Kuajt shkroftëtitnin ... Njerëzit kur panë karrocën e Valiut mallkonin me zemër e thërrisnin me zë në dy gjuhë:

- Shëndet e jetë të gjatë Hysni Pashës! Shëndet e jetë Valiu të Janinës.

Afër, tek kthesa e fundit, në krye të Janinës kuajt gjunjëzohen. I qëlluan me pushkën top. Kuajt u mbytën në gjak. Kaloshinën e Valiullëkut e përfshiu flaka. Miriallai Shahin Hatibzade doli nga flakët me rrëmbim, me fytyrë të zgërdheshur. Ishte plagosur, por ishte pak një plumb që ta gunjëzonte egërsirën. Ai nxorri pisqollën që ta zbrazte ... Pushkët e pritës nuk e lanë. Dëgjoi zë. I foli Myrto Dukagjini:

- Bëhu selam Birbilenjve, Shahin Hatibzade!

- Nuk vdesin Birbilentë, Shahin hatibzade - ia priti një tjetër.

Miriallait i pështjellohet pamja, i dridhen gjunjët. Një pushkë grykëhollë lëshon flakë prej grykës.

- Arnautka e Birbilenjve - belbëzuan buzët e Shahin Hatibzadesë.

Ai gjithnjë ja pati frikën "arnautkës". Ai e pa atë kur nxorri flakë jeshile. E ndjeu kur flaka e pushkës hyri në gjoksin e tij. Ia plasën zemrën plumbat e "Arnaudkës".

Vdiq Shahin Hatibzadeja me belbëzimin në gojë: "Arnaudët ... dhe "Arnaudka". Për kë e kishte fjalën, për njeriun apo për pushkën?

Prita la vendin dhe e humbi gjurmën në qytetin e madh nëpër

labirinthe e ngritura nga hotelxhiu Nexhip Bedena. Jehona e krismave të pushkëve të asaj prite u shkri në një me këngën:

*Mbenë Birbilenjtë, mbenë.
Flakë e barot nepër këngë...
E nderuan Memëdhënë.*

Në vend të pasthënies

1. "Sepetia e nuses" dhe syri i nënës

Në afërsi të humnerës të Përroit të Leksë, në një vend të dukshëm, përballë themeleve të shtëpisë të Shake, në Rexhin është një gur i prerë në formën dhe madhësinë e sepeteve të nuseve. Edhe në ditët tona ai mban emërtimin "Karsella e nuses të kaçakut Birbil". I thonë edhe "Karsella e Hiros". I vetmi toponim që ndriçon emrin e nuses së kaçakut Birbil. Nga ky vend hidhet vështrimi në një kohë mbi malet e lartë dhe honet e thellë. Mbi këtë gur edhe Hirua e bukur shikonte dhe priste lajme për burrin e saj. Po në vend të lajmeve vinin vetëm ulërima, andej nga Progonati. Derë më derë në Progonat ulërimë. Vajtonin djemtë dhe Resulin.

Gjurmët e zebekëve ende rëndonin mbi progonatasit.

*O Progonati me vulë
Të bënë sa doli ujë
Për Birbil e për Resulë.*

I vajtonte djemtë Progonati me ligje. Ulërimat kishin përfshirë fshatin e vogël Rexhin dhe fshatin e madh, Nivicë. Në shtëpinë e Shake ishte shpallur gjëma. Ligjërimet e nënës Sorkë përcillnin te njerëzit dhimbjen e madhe, helmin që çan lirin e plas gurin. Kurse nëna Sorkë duronte. Hirua e bukur duronte ... Arbërit u mësuan të durojnë dhimbjet. Dhimbje brezash.

Lëngatë e gjatë shkelja e zebekëve. Jeta e Arbërve psherëtimë e pafund. Përherë dora e Arbërve u mpi te palla. Ata u prenë me jatagan dhe u vranë me plumb, por në jetë të jetëve mbetën halë e bori halë të panënshtuar.

Në sarajin e Shake, oborri, dhomat e çdo gjë për reth u mbush me vaj e me ulërimë. Tiparet e bukura të Hiros ishin ngrirë. Birbilenjve

ua ndriçonte të bëmat në këngë Sorka. Asaj i takonte si vajovicë e parë dhe si nënë. Ligjërimet e Sorkës sillnin në Labëri një për një emrat dhe të bëmat e 13 kaçakëve që u varën në Janinë. Sorka e Golëmit u vinte në ligje bukurinë e shtatit, trimërinë e qëndresën para xhelatit.

Njerëzit të heshtur. Thëllëzat të heshtura. Fyelli i çobanëve binte në ligje ... Çdo fluturim zogu u nemit. Disa barinj aty në stan, majë malit Këndrevicë, ku kishin qëndruar Birbilenjtë si në kohën kur u vra Gjoleka i Kuçit e Hodua i Nivicës, i bënë delet me mavri, i nxinë dhe u hoqën cjepëve e deshëve përçorë zilet e buqet. Në çdo derë pllakosi fatkeqësia.

Nëna e Birbilit, Sorka e Golemit i këndonte të birin. E vajtonte me ligje. "Syri" i nënës afronte afër të birin. Pikëllimi e drobiti. Grave të tjera iu mbeti fryma dhe prisnin fjalën e Sorkës. Ajo i foli të resë, nuses së djalit. Hirua i pruri pallën e Birbilit ... Mbi atë pallë Sorka filloi të ligjëronte djalin e saj:

*O Birbil o çepekrënde,
Kulloj lot mbi pallën tënde.*

Fjalët e Sorkës së Golemit lëshonin pikëllim e dhimbje. Hirua e bukur po i bënte ballë. Ajo e shprehte dhimbjen në pikat e lotit që si sumbulla të nxehta dilnin nga bebëzat e syve të ndritshëm dhe i rrëshqitnin nga mollëzat duke i lënë gjurmë të thellë. Kjo ndezi edhe më tepër vajin. Klithmat e vajtoreve delnin si jehona prej guvave të shkëmbit të Perroit të Lekës. Sorka i drejtohej me emër bukuroshes Hiro, nuses të djalit të saj, Birbilit:

*Qaj gushëbardhë me lot
Birbil Shako nuk gjen dot,
Pa burra në radhë plot.*

Historia e Birbilenjve është bërë legjendë

Libri "Birbilenjtë", i Resul Bedos, flet për një ngjarje historike, që më duket, nuk është trajtuar ndonjëherë më letërsinë tonë, në asnjë gjini. Por për këtë ngjarje, për Birbilenjtë, ka mjaft këngë popullore. Historia e Birbilenjve është bërë legjendë, prandaj Resuli ka bërë mirë që kapi këtë temë, bile ka një meritë të veçantë. Dhe jo vetëm kaq, por ka meritë sepse e ka kapur mirë. Unë e lexova me një frymë dhe, si e mbarova, thashë: "A, sikur të isha edhe unë pjesëtar i Birbilenjve". Pse? Për këto arsye:

1. Libri është shkruar mirë, të tërheq, lexon dhe gjithnjë mendon, do të dish si vazhdon, ç'ngjarje të tjera do të ketë, ç'ka ndodhur me Birbilenjtë, për të cilët, që në fillim fiton simpatinë e tyre. Stili dhe gjuha e autorit kanë një cilësi që të tërheqin, fjalët janë të përshtatura me kohën, çdo gjë është në vendin e saj. Përshkrimet e maleve, të vendeve ku zhvillohen luftimet, janë në funksion të ngjarjes, nuk ka gjëra të shkëputura. Edhe toponimat, edhe emrat e personazheve, të shpien në atë kohë kur populli ynë luftonte kundër hordhive turke. Si duket, Resul Bedo ka bërë një studim të thellë, është futur në dokumentet e asaj kohe, ka studiuar folklorin, që është gjithnjë një burim i madh kur është fjala për të njohur ngjarje historike të së kaluarës, dhe jo vetëm i ka studiuar, por i ka honepsur, ka jetuar intensivisht me atë kohë. Nuk mund të bëhet ndryshe. Një shkrimtar që i vë vetes detyrën për t'u kapur me një temë të së kaluarës, kështu duhet të veprojë. Pra, kjo mënyrë e të shkruarit kur gërshetën edhe këngë popullore, më duket se është origjinale, në rastin e Resul Bedos. Një gjë tjetër, e domosdoshme kur shkruan në mënyrë letrare për ngjarje historike, është fantazia. Dhe Resuli, në këtë vepër e ka bërë këtë. Lexon dhe gjithnjë ke përshtypjen se jeton edhe ti me ngjarjet, si lexues.

2. Po përsëris. Kjo është një temë historike dhe si e tillë është

trajtuar mirë se autori ka shkruar fantazinë e tij, se një temë historike pa fantazi, do të ishte e thatë. Në këtë mënyrë autori ka shpëtuar nga skematizmi. Detajet, që ka shumë dhe të domosdoshme, mënyra e të shprehurit dhe nganjëherë, regresionet, e kanë bërë veprën që të ketë freski.

3. Libri, që në fillim e deri në fund, ka lëvizje, ka aksion, malet të duket sikur marrin pjesë edhe ato, shokë të pandarë të kaçakëve, i mbrojnë sikur të ishin njerëz, Birbilenjtë fjalosen me malet, malet shkojnë, ku shkojnë Birbilenjtë. Vepra ka dialogje të shkathët, ka përshkrime të bukura, si ai përshembull, kur Birbilenjtë rrethohen, ose kur janë në burgun e Janinës. Por nuk janë vetëm këto raste, e gjithë vepra ecën mirë. Në këtë mënyrë lexuesit i shkakton admirim dhe simpati për të mbrojtur vendin e tij nga çdo i huaj. Prandaj vepra është, në këtë vështrim, shumë domethënëse.

4. Që kur fillon vepra e deri sa mbaron, shkon gjithnjë në ngjitje. Figura e Bilbilit të mallëngjen dhe, njëkohësisht e do atë, kërkon që të jesh edhe ti me të, pra jeton me të, në çdo hap që ai bën, do të ndash me të gëzimet dhe hidhërimet, të hidhesh, edhe ti, si Bilbil Shakua, në zjarr për të shpëtuar Atdheun.

5. Mendoj që librin ta lexojë edhe ndonjë historian, të japë edhe ai një mendim, për të vërtetuar ngjarjen edhe nga ana historike.

Këto janë disa nga mendimet e mia. Më duket se po të botohet vepra do të pritet mirë nga lexuesi. Se kritiku më i mirë është lexuesi dhe masa më e mirë për të vlerësuar një vepër, është kur e lexon me dëshirë dhe të tërheq. Kjo më e ka ndodhi mua.

Aleks Çaçi, shkrimtar

Shënim: Kopja e recensës së Aleks Çaçit ndodhet në Arkivin e Ndërmarrjes së Botimeve "Naim Frashëri" ku autori vite më parë e paraqiti librin Birbilenjtë për botim.

Mendime për romanin Birbilenjtë

Dihet se lëvizja e kaçakëve në Perandorinë Osmane dhe më konkretisht në Ballkan ose në pjesën evropiane të kësaj perandorie ka qënë një nga dukuritë karakteristike të qëndresës antifeudale dhe çlirimtare të popujve të shtypur dhe më drejt të fshatarësisë kundër sunduesve osmanë. Heronjtë e kësaj qëndrese të armatosur spontane kanë qënë bij të guximshëm dhe të paepur të fshatarësisë, të cilët duke rënë në konflikt me shtypës të huaj dhe vendës, ose duke mos duruar padrejtësitë dhe sulmet që kurdin ata, i drejtonin armët e tyre dhe merrnin malet, delnin “kaçakë” ose siç janë quajtur në vise të tjera të Ballkanit reskokë (Serbi), kleftë (Greqi), hajdutë (Bullgari). Këtyre heronjve populli ose poeti popullor u ka thurur këngë trimërishte kudo në Ballkan, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Dhe kur lëvizja kombëtare e popujve ballkanas mori përmasa të mëdha dhe drejtim, kryekaçakët dhe pasuesit e tyre i dhanë forcë të re të armatosur kësaj lëvizjeje.

Për rëndësinë e kësaj lëvizjeje popullore-fshatare në historinë kombëtare të popujve ballkanas flet qartë bibliografia e gjerë që ka dalë në vendet e ndryshme ballkanike, por fatkeqësisht në Shqipëri kjo lëvizje është trajtuar shumë pak, kryesisht nga folkloristët tanë, sidomos nga Q. Haxhihasani dhe akoma më pak nga historianët tanë. Vetëm kohët e fundit historiografia jonë po fillon të merret më seriozisht me këto çështje.

I theksojmë këto për të treguar se sa me vend është nisma e Resul Bedos për të trajtuar nga pikëpamja artistike-historike në një roman figurën dhe veprimtarinë e disa kaçakëve më popullorë të vendit tonë gjatë periudhës së Rilindjes - të Birbilenjve.

Autori është konsultuar gjerë me letërsinë historike të botuar tek ne, me traditën popullore rreth lëvizjes së kaçakëve, me historianët të ndryshëm. Kështu, autori i romanit ka vlerësuar drejt fondin historik përpara se të ndërmerre hartimin e veprës së tij. Krahas kësaj më pozitive, madje shumë pozitiv është fakti që Resul Bedo tregohet njohës i thellë i ambientit gjeografik dhe shoqëror, ambient në të cilin

kanë jetuar Bilbilentë. Kjo ka lejuar që lexuesi ta ketë parasysh shumë të gjallë natyrën në të cilën kanë vepruar madje kanë gjetur aleatë të luftës së tyre Birbilentë. Duke pasqyruar bukur këtë natyrë, megjithë anët pozitive dhe negative të saj, autori është mbështetur kryesisht te këngët kaçake rreth Birbilentëve, si burime historike, si strumullarë historikë, për t'i mbushur ato ose për të imagjinuar, mbi atë sfond burimor-historik, ngjarje më të hollësishme, natyrisht duke u mbështetur edhe në kujtime të tjera gojore.

Të gjitha këto anë pozitive kanë lejuar që të spikatim heronj pozitivë si Bilbil Shaku, Resul Sejdini, nëna e Bilbil - Sorka, Budo Bredhi dhe ndonjë figurë tjetër.

Romani ka vlera të mjafta edukuese si romani i parë historik mbi lëvizjen e kaçakëve gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Ligor Mile, historian

Shënim: Kopja e plotë e recensës e profesor Ligor Miles gjendet e arshivuar në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri".

Bibliografi

Shkrimtari Resul Bedo lindi më 16 gusht 1926, në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, shkollën e mesme në Liceun e Korçës dhe gjinnazin e Tiranës. Mandej vazhdoi studimet në Universitetin e Tiranës për Gjuhë-Letërsi.

Shkrimet e para i botoi në vitet e luftës, në revistën "Flaka" organ i Brigadës së VI-S, në revistën e Divizionit VI-S dhe më vonë në organet e shtypit ushtarak. Ai trajtoi tërësisht në shkrime temën e luftës e të qëndresës shqiptare.

Disa nga librat e tij janë:

1. Nga Kuçi në Vishegrad, botim i vitit 1958, faqe 100. Është nga librat e parë memuarë të luftës që u prit mirë nga lexuesi.
2. Në zemërtë maleve, botim i vitit 1960, faqe 327, me shkrime për rrugën luftarake.
3. Shqiponjat e vogla, botim i vitit 1961, faqe 118, tregime për pionirë partizanë.
4. Njëqind Episode partizane, botim i vitit 1962, faqe 400.
5. Gryka e Zarelit, botim i vitit 1964, faqe 170, tregime nga jeta në luftë në ditët e Operacionit të Qershorit.
6. Ky vend ka zot, botim i vitit 1968, faqe 152. Tregime për ushtarë e kuadro në luftimet në kufi në vitin 1949.
7. Shtegu i verbër, novelë, botim i vitit 1968, faqe 109.
8. Ata mbeten gjithmonë ushtarë, përshkrim, botim i vitit 1968, faqe 134.
9. Marshimi i pandalshëm. Përshtypje nga vizita në Kinë me një delegacion shkrimtarësh. Botim i vitit 1968, faqe 134.
10. Në fletë të shënjestrës, botim i vitit 1972, faqe 79 (skica).
11. Grusht çelik Brigada e Gjashtë. Historiku i Brigadës, botim i vitit 1971, faqe 540. Libri u shkrua prej autorit dhe u aprovua nga Komisioni dhe ish kuadro e luftëtarë të brigadës.

12. Armët të pathyera, botim i vitit 1973, Tregime.
13. Bjeshka, botim i vitit 1974. Tregime, faqe 92.
14. Goditje, roman, botim i vitit 1972, faqe 231.
15. Edhe ne luftuam, roman, botim i vitit 1971, faqe 172.
16. Mbrapa ekranit, botim i vitit 1973, faqe 94. Skica e tregime.
17. Ditë me furtunë, roman, botim i vitit 1977, faqe 200.
18. Lule me vezme, tregime, botim i vitit 1977, faqe 224.
19. Operacioni Nepërka, roman, botim i vitit 1973, faqe 200.
20. Gjurmë të ndezura, roman, botim i vitit 1980, faqe 309.

Ka përgatitur e botuar vëllimet:

1. Yje të pashuar, vëll. I, II, III, botim i Ushtrisë në vitin 1972 si dhe vëll. IV e të V.
2. Këngë dhe marshe partizane.
3. Fjalën plumb e dorën pallë.
4. Kënga e trimërisë.
5. Shqipërisë, vëllim me vjersha të poetëve të Rilindjes për heroizmat e luftëtarëve shqiptarë.
6. Batalioni partizan Asim Zeneli.

Dorëshkrime të përgatitura e të gatshme për botim:

1. Shenjë në pushkë, roman.
2. Lulja e Shkëmbit, novelë.
3. Dëshmi tronditëse - studim mbi luftimet në vitin 1914 kundër pushtuesve grekë, në zonën e Labërisë.
4. Stuhi në Male (përshkrime të luftimeve në operacionin e Qershorit).
5. Ditari luftarak i një Divizioni partizan.
6. Prroi i pikave, novelë.
7. Ushtari i pushkatuar, novelë.
8. Gjuajtësi i Ballonës, novelë.

Disa nga librat e autorit që kanë marrë çmime në konkurse letrare kombëtare:

1. Ky vend ka zot, vëllim me tregime
2. Shtegu i verbër, novelë.
3. Prapa ekranit, skica e tregime.
4. Armët të pathyera, (tregime).
5. Edhe ne luftuam, roman.

Autori është dekoruar me:

- Medaljen e Çlirimit, Medaljen e Trimërisë, Medaljen e Shërbimit Ushtarak, Medaljen e Kujtimit, Urdhërin e Trimërisë, Urdhërin e Skënderbeut Kl. III, Urdhërin e Skënderbeut, Kl. II, Urdhërin e Trimërisë, të vitit 1949 në provokacionet e 2 gushtit.

Shënime:

1) Në vitin 1942, Resul Bedo edhe pse në moshë të vogël përfaqon Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

2) Në vitin 1943 partizan në çetën "Çerçiz Topulli".

3) Në gusht 1943 partizan në batalionin "Asim Zeneli"

4) 26 janar 1944 partizan në Brig. VI S, komisar kompanie.

5) Në gusht 1949 për trimëri e komandim repartesh në luftime gradohet jashtë radhës dhe dekorohet. Në përshëndetjen që bën Ministria e Mbrojtjes, në shtator 1949, thuhet "Heroizmave të Vojo Kushit, Perlat Rexhepit etj. iu shtuan heroizmat e Memo Nexhipit, Ferit Bregasit, Resul Bedos etj."¹

- Shkrimtari i paraqitet kësaj here lexuesit me romanin historik Birbilenjtë, duke u mbështetur tërësisht në veprimtarinë e çetës të Birbilenjve.

1) Gazeta "Zëri i Popullit", shtator 1949.